

ISSN 2227-8540
ISSN 2312-5748 (Online)

GLOBAL CHALLENGE

Vol. V, Numri 1 • Shkurt 2016



Prof. Asoc. Dr. Endri Papajorgji


Juridiksioni për martesën bazuar në jurisprudencë në Shqipëri

/Faqe 6

Dr. Rovena Vata

Erosi i Migjenit në letërsinë shqipe

/Faqe 12



ADSH

AKADEMIA DIPLOMATIKE
SHQIPTARE



ALBANIAN DIPLOMATIC
ACADEMY

ADA

AKADEMIA DIPLOMATIKE SHQIPTARE

QENDRA PËR STUDIME NDËRKOMBËTARE DHE DIPLOMATIKE

ADRESA: Rr. "Rexhep Jella" Selitë e Vogël

Tiranë - SHQIPËRI

Cel: +355 69 512 4444

Website: www.albdiploacademy.com

E-mail: permetialban@albdiploacademy.com



GLOBAL CHALLENGE

REVISTË SHKENCORE PERIODIKE

Volumi V, Numri 1
Tiranë, Shkurt 2016
© AD SH Press

ISSN 2227-8540
ISSN 2312-5748 (Online)

GLOBAL CHALLENGE

REVISTË SHKENCORE PERIODIKE

Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare

Drejtor	Prof. Dr. Lisen Bashkurti lbashkurti@albdiploacademy.com
Kryeredaktor	PhD Kandidat, Alban Përmeti permetialban@albdiploacademy.com
Redaktorë Shkencor	Doc. Dr. Astrit Memia amemia@albdiploacademy.com Msc. Margarita Muho mmuho@albdiploacademy.com
Këshilli Shkencor	Prof. Dr. Lisen Bashkurti Prof. Dr. Bashkim Rama Prof. Dr. Aleksandër Biberaj Prof. Dr. Joseph Mifsud Prof. Dr. Nabil Ayad Dr. Mlladen Andrić Dr. Ilir Kulla Prof. Dr. Arben Puto Prof. Dr. Vasillaq Kureta Dr. (PhD Uni Graz) Endri Papajorgji Dr. Rovena Vata
Kopertina	Olti Përmeti
Korrektor	Majlinda Bashkurti Margarita Muho
Faqosje	Olti Përmeti

ISSN 2227-8540
ISSN 2312-5748 (Online)

1	Prof. Asoc. Dr. Endri Papajorgji Juridiksioni për martesën bazuar në jurisprudencë në Shqipëri.....	6
2	Msc, Kujtim Bytyçi Tragjizmi i personazhit dhe loja me fatin tek “Monedha e Gentit” e Milazim Krasniqit.....	12
3	PhD Candidate, Sonila Tatili How does technology influence on education in nowadays?.....	21
4	Prof. Dr. Osman Ismaili Kushtetuta e Republikës së Kosovës pas tetë viteve.....	27
5	MA. Dea Karakaçi Formimi i ideor dhe estetik i Migjenit.....	39
6	PhD Kandidate, Drita Avdyli Përpjekjet e emigracionit politik shqiptar për të bashkëpunuar me emigracionin kosovar.....	46
7	Dr. Sc. Bashkim Rrahmani Zgjidhja Alternative e Kontesteve (ZAK) - ndërmjetësimi në Kosovë.....	51
8	Dr. Rovena Vata Erosi i Migjenit në letërsinë shqipe.....	61
9	PhD Kandidat, Erjon Dervishi Federata “Vatra”, organizata “Shqipëria e Lirë” dhe denoncimi i politikave aneksioniste greke në Shqipërinë e Jugut gjatë Luftës së Dytë Botërore.....	66
10	Msc. Lemane Mustafa / Msc. Kastriot Jakupi Baza ligjore dhe parimet e Institucionit të Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipërisë.....	79
11	Studente, Vjoleta Statha Krahasoni i botimeve të veprës “Këngët e Milosaos”.....	95
12	PhD Kandidate, Gelanda Shkurtaç Zhvillimi historik i fitimit të pronësisë në periudhën post-komuniste.....	100
13	Msc, Adi Shehu Panairi i Shën Gjoni Vladimirit, - Analizë antropologjike.....	110

Juridiksioni për martesën bazuar në jurisprudencë në Shqipëri



Abstrakt

Instrumenti më i rëndësishëm për të përcaktuar juridiksionin e gjykatave shqiptare është Ligji i së drejtës ndërkombëtare Nr.10 428, datë 2.6.2011 (në vazhdim: ligji ndërkombëtar) dhe përbën kapitullin IX të tij (nenet 71-81). Sipas rregullit të përgjithshëm ndërkombëtar (neni 71) gjykatat shqiptare kanë juridiksion në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur rregullat e këtij kreu parashikojnë ndryshe. Elementët kryesorë të këtij neni janë:

- a. *Elemente juridiko-civil;*
- b. *Elementi i huaj;*
- c. *Pala paditëse ka vendqëndrim të zakonshëm.*

Siç shihet nga këto tre karakteristika pjesë e përcaktimit të juridiksionit janë marrëdhëniet juridiko civile. Së dyti, elementi i huaj duhet të përmbajë karakteristikën ndërshtetërore dhe së treti, përcaktimi i juridiksionit të gjykatës shqiptare është i varur edhe nga kushti që pala paditëse të ketë vendqëndrim të zakonshëm.

Por çfarë nënkuptohet me vendqëndrim të zakonshëm të personit fizik? Sipas nenit 12 të ligjit ndërkombëtar me “vendqëndrim të zakonshëm të një personi fizik” kuptohet vendi, në të cilin ai ka vendosur për të qëndruar në pjesën më të madhe të kohës, qoftë dhe në mungesë të regjistrimit dhe pavarësisht nga leja apo autorizimi për të qëndruar. Në përcaktimin e këtij vendi gjykata merr parasysh rrethanat e natyrës

personale apo profesionale, që tregojnë lidhje të qëndrueshme me këtë vend, apo synimin e personit për të krijuar lidhje të tilla. Pra, rregulli i përgjithshëm parashikon se që gjykata shqiptare të ketë juridiksion, duhet të plotësohen të tre këto elementë njëkohësisht. Duke u bazuar në sa më sipër qëllimi primar i këtij artikulli është përcaktimi i juridiksionit për martesën në Shqipëri.

Fjalë kyçe: *Juridiksion, Martesë, BE, Shqipëri.*

Hyrje

Neni 17 pika 2 i ligjit ndërkombëtar parashikon si vendqëndrim të zakonshëm të një personi fizik, që ushtron veprimtari biznesi vendin kryesor të biznesit. Pra, sipas këtij neni, gjykatat shqiptare ushtrojnë ligjin shqiptar në çështje civile me elementë të huaj, ku pala paditëse ka vendqëndrimin e zakonshëm (vendin ku personi fizik kalon pjesën më të madhe të kohës); ndërsa në rastet e personit fizik me veprimtari biznesi (zyra e administrimit të biznesit të personit fizik).

Çfarë nënkuptohet me vendqëndrim të zakonshëm të personit juridik? Sipas nenit 17 të ligjit ndërkombëtar me vendqëndrim të zakonshëm të personit juridik, shoqatave apo organizatave pa personalitet juridik është vendi ku ndodhet selia qendrore. Me seli qendrore në literaturën perëndimore kuptohet zyra e administrimit ose selia nga e cila drejtohet biznesi i shoqërisë. Në rastet e agjensive, filialeve dhe institucioneve të cilat lidhin kontrata, si vendqëndrim gjykohet vendi ku ato ndodhen dhe si pasojë gjykata e vendqëndrimit ushtron juridiksion në këtë rast. Pra në rastin kur dega e “Mangos” me seli në Tiranë lidh një kontratë shitjeje të mallrave që ajo prodhon e tregton me disa dyqane, atëherë gjykata e Tiranës është ajo që ushtron juridiksion në këto kontrata, ndërkohë që në përcaktimin e vendqëndrimit të zakonshëm, momenti përkatës në kohë është koha e lidhjes së kontratës.

Juridiksioni ekskluziv

Juridiksioni ekskluziv është i rregulluar në nenin 72 të këtij ligji, i cili përcakton se gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv në çdo rast për gjykimin e: çështjeve me objekt të drejtën e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi sende të paluajtshme, si dhe qiranë dhe të drejtat që rrjedhin nga përdorimi i pasurive të paluajtshme kundrejt shpërblimit, kur këto ndodhen në Republikën e Shqipërisë; çështjeve me objekt vendimet e organeve të shoqërive tregtare, kur shoqëria ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë; çështjeve me objekt themelimin, mbarimin e personave juridikë, si dhe paditë me objekt vendimet e organeve të tyre, kur personi juridik ka selinë në Republikën e Shqipërisë; çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit në regjistrat e gjykatave ose organeve shtetërore shqiptare; çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit të të drejtave intelektuale, për sa kohë që këto regjistrime ose kërkesa për këto regjistrime është bërë në Republikën e Shqipërisë; çështjeve, të cilat lidhen me ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë të titujve ekzekutivë.

Pra, legjislatori shqiptar parashikon si kusht për zbatimin ekskluziv të juridiksionit të gjykatave shqiptare në çështjet e pronësisë, parimin e vendndodhjes së pronës, në çështjet tregtare, seline qendrore të shoqërive tregtare dhe në çështjet e pronësisë intelektuale vendin e regjistrimit të këtyre të drejtave. Ky parim njihet ndryshe në literaturën e të drejtës ndërkombëtare private edhe si *parimi i territorialitetit*, që lidh

vendodhjen e objektit, shoqërisë tregtare dhe regjistrimin e të drejtës intelektuale me juridiksionin e gjykatës ku ndodhet objekti, selia ose është kryer regjistrimi.

Në rastet e juridiksionit të caktuar me marrëveshje (neni 73), gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar, kur palët caktojnë me marrëveshje juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare. Këto marrëveshje duhet të vërtetohen me shkrim dhe të jenë në përputhje me zakonet tregtare ndërkombëtare, të cilat janë ose konsiderohen të njohura nga palët.

Gjykata shqiptare, në të cilën është ngritur padia, ka juridiksion ndërkombëtar, nëse i padituri merr pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, megjithëse është i përfaqësuar në proces nga një avokat, ose gjykata e ka sqaruar për mundësinë e kundërshtimit të juridiksionit dhe ky sqarim është shënuar në procesverbalin e seancës gjyqësore.

Juridiksioni për martesën

Në çështjet ligjore që kanë të bëjnë me institutin e martesës (neni 75), gjykatat shqiptare kanë juridiksion në gjykimin e çështjeve që lidhen me martesën kur:

1. *Njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë në kohën e lidhjes së martesës shtetas shqiptar;*
2. *Bashkëshorti, kundër të cilit është ngritur padia, apo paditësi, në rastin për zgjidhjen e martesës, ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë;*
3. *Njëri nga bashkëshortët është pa shtetësi dhe ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.*

Në praktikë, në rast se një shtetase shqiptare është e martuar me një shtetas austriak, atëherë, në çështjet martesore (paditë dhe pasojat, që lidhen me martesën për zgjidhjen dhe shpalljen e pavlefshmërisë së martesës, vërtetimin e lidhjes së martesës, si dhe ato që lidhen me regjimet pasurore martesore) gjykatat shqiptare kanë juridiksion, ashtu sikurse edhe në rastet e zgjidhjes së martesës, kur njëri nga bashkëshortët ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Shqipëri.

Që të kuptojmë më qartë këtë nen, le të shqyrtojmë një vendim të gjykatës së lartë të Shqipërisë që ka të bëjë me zgjidhjen e martesës¹. Në këtë vendim bëhet fjalë për ndarjen e pasurisë bashkëshortore, në një kohë kur nuk kishte hyre në fuqi ligji Nr. 10 428, datë 2.6.2011 Për të drejtën ndërkombëtare private. Në këtë vendim bëhej fjalë për këto të dhëna themeltare:

Martesa mes A. dhe Gj.F. është lidhur sipas ligjit shqiptar, më datë 20.10.1975, në Tiranë. Më pas ata kanë jetuar në Gjermani ku edhe janë bërë pronarë pasurie të paluajtshme atje. Me vendimin nr.8975, datë 23.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë, kanë zgjidhur martesën. Në kuadrin e zgjidhjes së pasojave të martesës, paditësja A. ka kërkuar me padi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pjestimin e pasurisë së paluajtshme bashkëshortore që ndodhet në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë edhe i padituri ka paraqitur një kundërpadi, me të cilën ka kërkuar pjestimin e pasurisë së paluajtshme që palët kanë në shtetin Gjerman. Kjo kundërpadi është pranuar për shqyrtim nga gjykata. *Por ka rezultuar se në seancën e datës 29.04.2009 Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë ka pushuar gjykimin e çështjes në lidhje me padinë, për shkak të mosparaqitjes së paditëses në seancë gjyqësore pa ndonjë shkak të arsyeshëm dhe ka vazhduar të gjykojë kundërpadinë.*

¹Vendim i Gjykatës së Lartë Nr. 61 i datës 9.2.2010.

Si një nga detyrimet e para ligjore, gjykata ka bërë verifikimin e kompetencës së saj për gjykimin e çështjes. Asaj i ka rezultuar se pasuritë që kërkohen të pjestohen nëpërmjet kundërpadisë janë apartamente banimi të ndodhura në shtetin Gjerman. Gjithashtu i ka rezultuar se midis palëve, në datën 15.12.2003 është bërë një marrëveshje e titulluar “kontratë martesore”, ku për efektet ligjore pasurore të martesës, ata kanë zgjedhur të drejtën gjermane. Së fundi, i ka rezultuar se në kohë të mëvonshme nga kjo kontratë, paditësja e kundërpaditur A. F. është bërë shtetase gjermane.

Nisur nga këto rrethana faktike dhe ballafaquar ato me ligjin procedural shqiptar (K.Pr.C.), gjykata ka arritur në konkluzionin se nuk është kompetente për gjykimin e kësaj çështjeje. Gjykata arsyeton se sendet që kërkohen të pjestohen ndodhen në shtetin gjerman dhe sipas nenit 45 të K.Pr.Civile paditë për pjestimin e sendeve në bashkëpronësi ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen këto sende. Kjo është një kompetencë ekskluzive dhe ligji nuk lejon asnjë alternativë tjetër. Edhe në rast referimi të marrëveshja e vitit 2003, sipas gjykatës, ajo nuk duhet marrë në konsideratë lidhur me çështjen që i përket gjykatës kompetente, pasi ligji shqiptar (neni 52 i K.Pr.Civile) e ndalon marrëveshjen për ndryshimin e kompetencës tokësore për kategori çështjesh si kjo objekt gjykimi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se konkluzioni i arritur nga gjykata e rrethit është i drejtë, ndërkohë që arsyetimi i vendimit shihet me vend të ndryshohet si më poshtë:

Gjykata, edhe pse pranon faktin se një nga palët në gjykim (e paditura A.) është shtetase gjermane, e ka zgjidhur çështjen duke patur parasysh dispozitat e K.Pr.Civile që rregullojnë kompetencën në rastet kur mosmarrëveshja është midis shtetasve shqiptarë dhe çështja hyn në juridiksionin e gjykatave shqiptare, apo edhe kur një nga palët është i huaj dhe ka pranuar vetë këtë juridiksion. Ndërkohë që shtrirja e juridiksionit të gjykatës për të vendosur për një çështje, në rastin që ka të bëjë me elementë të huaj, është problem që i referohet të Drejtës Ndërkombëtare Private.

Ligji shqiptar në këtë fushë në këtë kohë (2010) është ai me nr.3920, datë 21.11.1964 “Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”, i cili rregullon të drejtat e shtetasve, si dhe të personave juridikë të huaj në Republikën e Shqipërisë në të gjithë fushat, duke përfshirë dhe atë të marrëdhënieve pasurore, sikundër është çështja objekt gjykimi. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë hollësisht si problemet e ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe problemet e juridiksionit të gjykatave shqiptare kundrejt të huajve, duke i specifikuar ato dhe në kuadrin e ngushtë të marrëdhënieve personale e pasurore midis bashkëshortëve. Lidhur me ligjin e zbatueshëm, duhet thënë se si e drejta ndërkombëtare private në përgjithësi dhe e ajo shqiptare në veçanti, krijojnë hapësirë dhe u japin bashkëshortëve autonomi për të përcaktuar se cilit legjislacioni do t’i referohen për zgjidhjen e marrëdhënieve mes tyre.

Sigurisht kjo autonomi nuk është e pakufizuar, pasi ajo lidhet me disa kritere si shtetësia e të dyve ose e njërit prej tyre, vendbanimi apo dhe vendndodhja e pasurisë. Këto elemente bazë janë edhe me ligjin ndërkombëtar të 2011 në fuqi, siç sqaruam më sipër.

Këtë gjë kanë bërë dhe palët e këtij gjykimi me kontratën e titulluar “martesore” të vitit 2003, ku në nenin 1 të saj, të titulluar “zgjedhja e të drejtës”, është përcaktuar se për efekt të pasurisë bashkëshortore palët kanë zgjedhur me efekt të menjëhershëm të drejtën gjermane.

Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e rrethit, kur e ka përmendur këtë fakt, e ka ngatërruar konceptin e të drejtës së zbatueshme (të drejtës gjermane) me atë të gjykatës që do të gjykojë çështjen (juridiksionin) dhe për rrjedhojë, ka pranuar se marrëveshja ka qenë për këtë të fundit. Kjo ka qenë arsyeja që në vendimin e saj ka përmendur nenin

52 të K.Pr.Civile, i cili nuk lejon ndryshimin me marrëveshje të gjykatës kompetente për rastet e pjestimit të pasurisë. Ndryshe nga autonomia e theksuar më lart, e drejta ndërkombëtare private nuk u ka lënë hapësirë palëve lidhur me problemin e përcaktimit të juridiksionit të gjykatës që do të gjykojë çështjen. Kjo ka arsytet e veta, pasi nëse një çështje nuk gjykohet nga gjykata që ka juridiksionin ta gjykojë, palët do të humbisnin një mjet të rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ndërkohë që nëse gjykata gjykon një çështje që nuk i takon dhe që duhej të zgjidhej nga një gjykatë tjetër, sigurisht që çështja nuk është zgjidhur si duhet. Për arsytet e mësipërme, ligji nr 3920 i vitit 1964 i ka kushtuar një kapitull të veçantë problemit të juridiksionit të gjykatave shqiptare kundrejt të huajve. Ndërsa ka bërë disa rregullime të posaçme lidhur me çështjet për deklarimin e zhdukjes ose vdekjes së një personi, si dhe me zgjidhjet apo pavlefshmëritë e martesës, në nenin 30 ka rregulluar juridiksionin e përgjithshëm që i referohet të gjithë rasteve të tjera. Në këtë dispozitë parashikohet: *“Kur nuk janë rastet e parashikuara në nenet e mëparshme, shtetasi ose personi juridik i huaj mund të paditet para gjykatave shqiptare:*

Kur ka banim në Republikën e Shqipërisë, ose kur ka pranuar juridiksionin e gjykatave shqiptare, përveç kur padia ka të bëjë me sende të paluajtshme që ndodhen jashtë shtetit”.

Siç shihet, në këtë dispozitë, vetë ligjvënësi ka vendosur përjashtimin për paditë që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme që ndodhen jashtë shtetit. Edhe sikur vetë shtetasi i huaj të ketë pranuar gjykimin nga gjykata shqiptare, në raste të këtyre padive, shtetasi i huaj nuk mund të paditet para gjykatës shqiptare.

Siç shpjeguam më lart, gjykata tashmë është duke gjykuar vetëm kundërpadinë, pra *padinë e paditësit Gj. kundër të paditurës A.*, që është shtetase e huaj, me të cilën kërkohet pjestimi i dy apartamenteve të banimit të ndodhura në shtetin gjerman. Për rrjedhojë, në interpretim të dispozitës së mësipërme, gjykata shqiptare nuk ka juridiksion për të gjykuar çështjen.

Në rekursin e paraqitur, paditësi ka pretenduar juridiksionin e gjykatës shqiptare dhe për këtë i është referuar nenit 8 të ligjit nr.3920 të vitit 1964. Kjo dispozitë, në fakt, ka të bëjë jo me juridiksionin, por me të drejtën e zbatueshme, pasi parashikon: *“Marrëdhëniet personale dhe pasurore midis bashkëshortëve rregullohen nga legjislacioni i shtetit, shtetas të të cilit ata janë. Kur bashkëshortët nuk janë shtetas të të njëjtit shtet, dhe legjislacionet e shteteve të tyre janë të ndryshme, këto marrëdhënie rregullohen nga legjislacioni shqiptar”.*

I pabazuar është edhe pretendimi tjetër se e paditura ka dhënë vetë pëlqimin për t’u paraqitur para gjykatës shqiptare, pasi edhe për zgjidhjen e martesës është zbatuar ligji shqiptar dhe është zgjedhur gjykata shqiptare. Kjo, pasi juridiksioni i gjykatave shqiptare për zgjidhjen e martesës në ligjin e mësipërm ka një rregullim specifik të ndryshëm nga ai për çështjen objekt gjykimi.

Së fundi, i pabazuar është edhe referimi i paditësit në të drejtën ndërkombëtare private gjermane, sipas të cilës *rregullimi i marrëdhënieve që rrjedhin nga pasuria bashkëshortore e martesës i nënshtrohet të drejtës së zbatuar për pasojat e përgjithshme të martesës në rastin e lidhjes së martesës.* Edhe ky parashikim ka të bëjë me të drejtën materiale të zbatueshme në rastin e këtyre konflikteve dhe jo me juridiksionin e gjykatës për t’i shqyrtuar ato.

Nga sa më sipër, duke qenë se përfundimi i gjykatës së rrethit ka vendosur të shpallë moskompetencën e saj në gjykimin e çështjes civile me nr. 3733 akti, datë 24.11.2008, pasi kompetente është gjykata ku ndodhet pasuria bashkëshortore. Kolegji Civil nuk e sheh me vend ta cënojë vendimin, por të plotësojë arsyetimin me sa u thanë më lart.

Përfundime

Në rast se e rishikojmë vendimin e mësipërm nën lupën e ligjit Nr.10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, atëherë duhet parë rregullimi i regjimit pasuror martesor në nenin 24 i cili përcakton se:

Regjimi pasuror martesor përcaktohet nga ligji i shtetit, që rregullon marrëdhëniet personale të bashkëshortëve. Ndryshimi i regjimit pasuror nuk prek të drejtat e fituara më parë nga bashkëshortët. Ashtu sikurse nga ana tjetër bashkëshortët, në marrëveshje midis tyre, të bërë me akt noterial apo me akt tjetër të barasvlershëm dhe të lëshuar nga një organ publik, mund të vendosin që për regjimin pasuror martesor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, të zbatohet ligji i shtetit:

- a) *Shtetësinë e të cilit ka njëri nga bashkëshortët;*
- b) *Në të cilin ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm njëri nga bashkëshortët;*
- c) *Në të cilin ndodhet pasuria e paluajtshme.*

Kjo dispozitë ligjore, ka të bëjë jo me juridiksionin por me të drejtën e zbatueshme dhe në vendimin tonë, është e qartë që e drejta e zbatueshme është ajo gjermane. Edhe neni 23 për marrëdhëniet personale të bashkëshortëve i cili përcakton se:

Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve rregullohen nga ligji i shtetësisë së përbashkët; nëse bashkëshortët kanë shtetësi të ndryshme, zbatohet ligji i shtetit, në të cilin ata kanë vendqëndrimin e përbashkët, përcakton të drejtën e zbatueshme dhe jo juridiksionin e gjykatës, ndërsa përsa i përket juridiksionit, ndërkohë që ligji nr. 3920 të vitit 1964 në nenin 30 të tij e kishte zgjidhur çështjen duke përjashtuar juridiksionin e gjykatave shqiptare në rastet e *padive që kanë të bëjnë me sende të paluajtshme që ndodhen jashtë shtetit, ligji ndërkombëtar i 2011 nuk e ka përjashtuar këtë gjë, por në nenin 75 pika 2 të tij ka përcaktuar se gjykata shqiptare ka juridiksion kur bashkëshorti, kundër të cilit është ngritur padia, apo paditësi, në rastin për zgjidhjen e martesës, ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, në rastin që Gj. F. ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Shqipëri, atëherë gjykata shqiptare ka juridiksion dhe duhet të shqyrtojë çështjen për regjimin pasuror martesor në bazë të ligjit gjerman.*

LITERATURA:

1. Papajorgji, E. (2013). “*E drejta ndërkombëtare private*”. Tiranë.
2. Papajorgji, E. (2013). “*E drejta ndërkombëtare tregtare dhe e biznesit*”. Tiranë.
3. Papajorgji, E. (2012). “*E drejta europiane private*”. Tiranë.
4. Papajorgji, E. (2016). “*E drejta e konkurrencës – Praktikë dhe jurisprudencë ndërkombëtare*”. Tiranë.
5. Papajorgji, E. (2014). “*E drejta ndërkombëtare dhe shqiptare e konkurrencës*”. Tiranë.
6. Papajorgji, E. (2013). “*Privatisierung von Unternehmen in Albanien und Mazedonien im Rechtsvergleich*”. Saarbrücken.
7. Papajorgji, E. (2015). “*Privatizimi në Shqipëri – Nga e drejta tek ekonomia*”. Tiranë.
8. Streinz, R (2010). “*Europarecht*”.
9. Vendim i Gjykatës së Lartë Nr. 61 i datës 9.2.2010.

Tragjizmi i personazhit dhe loja me fatin tek “Monedha e Gentit” e Milazim Krasniqit



Abstrakt

Milazim Krasniqi është një nga shkrimtarët më të suksesshëm të letërsisë shqipe. Krijimtaria e tij është e pasur në prozë, poezi dhe dramë. Megjithëse fillimet e tij i ka në poezi, Krasniqi drama duket që i ka shtruar rrugën drejt suksesit në letërsi. Fillimi i viteve 90’ të shekullit XX fillon sprovat e tij në dramë. Komedia paraprin krijimtarinë e tij në dramë, ndërkohë që ngjarjet tragjike të vitit 1999 në trojet shqiptare në Kosovë ndryshojnë drejtimin e rrjedhës së tij në dramë, drejt dramës tragjike. Drama e popullit shqiptar është bërë pjesë e dramës së Krasniqit. Për ironi të fatit të popullit shqiptar, e kaluara dhe e tashmja duket që ndjejnë praninë e njëra-tjetrës, çka është e pranishme dhe në dramën e këtij autori, ku aludimi për aktualitetin është i pranishëm. Edhe drama “Monedha e Gentit” ka këtë ndërthurje. Historia e mbretit të mbretërisë Ilire, Gentit, fati i tij është fati i trishtë dhe loja e fatit tragjik, kalon kufijtë e fatit të një individi, është fati i një kombi, që historia ka luajtur me fatin e tij, duke i imponuar gjithmonë tragjikën, duke mos i dhënë shumë çaste lumturie në jetë. Drama “Monedha e Gentit” është dramë në tre akte, që duket se korrespondon me tri momentet e njeriut, lindjen, rritjen dhe vdekjen. E tillë ishte dhe jeta e mbretit, ku pas momentit të dytë, vjen momenti i zvetënimit të tij si mbret. Në dramë secili personazh ka dramën e tij individuale, mbreti, familja e tij dhe Platori, vëllai i mbretit, i vrarë në pabesi. Megjithëse gjithçka luhet me element të historisë, aludimi për aktualen është e pranishme. Roli i individit në histori ka pjesën e vet të padiskutueshme, por edhe fati i individit ka rolin

e vet në fatin e një populli, për të mirë ose për të keq, gjithçka varet nga synimi që i ka vënë vetes individi. Mbreti Gent e merr fronin përmes krimt, duke vrarë vëllain e tij, pra një mbret i paligjshëm, prandaj dhe fati i tij ishte i parashkruar me një fund të turpshëm. Mbreti Gent dhe vëllai i tij janë dy karaktere dramatikë që dallojnë mes tyre, mbreti që vajton humbjen e mbretërisë dhe Platori që i dhemb fati tragjik i popullit. Karakteret dramatikë në këtë dramë shpalosen përmes dramës psikologjike, çka e bën këtë dramë të kalojë caqet e një drame klasike, drejt një drame psikologjike.

Konflikti dramatik në dramën “Monedha e Gentit” e Milazim Krasniqit

Elementi bazë në përcaktimin e zhvillimit të subjektit dramatik, qëndron konflikti dramatik, i cili realizohet përmes bashkëveprimit të forcave të kundërta. Konflikti dramatik bazohet kryesisht në ide interesa, faktorë socialë, psikologjikë, historikë etj. Konflikti dramatik nuk është qëllim në vetvete, por është katalizatori i cili bën të mundur zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve. Duke u bazuar tek shkaqet e konfliktit, dramaturgu merr përsipër që në fund të zhvillimit të ngjarjes ose të ngjarjeve, të ketë një zgjidhje. Zgjidhja nuk duhet të jetë e imponuar, por në përputhje me zhvillimin logjik të ngjarjeve. Ajo çfarë është më e rëndësishme tek tragjedia, është serioziteti i veprimit, atmosfera, konflikti, tensioni dhe aftësia për ta bërë për vete lexuesin (spektatorin). Një element tjetër në tragjedi është ngjallja e ndjenjës së frikës dhe mëshirës, por nuk mund të jetë një paraqitje e vuajtjeve që pëson heroit tragjik, por kjo ndjenjë është konflikti bazë nga i cili ushqehen vuajtjet e heroit. Tragjizmi nuk vjen nga vuajtja, por vuajtja vjen nga konflikti tragjik.

Tragjedia “Monedha e Gentit”, e autorit Milazim Krasniqi synon të paraqesë pikërisht këtë linjë. Ai nuk niset nga ngjallja e ndjenjës së mëshirës dhe frikës tek lexuesi (spektatori) por mundohet të paraqesë vuajtjet e heroit tragjik, mbretit Gent. Në pamje të parë duket që kemi të bëjmë me konfliktin mes mbretit Agron dhe Platorit, vëllait të mbretit, por në të vërtetë konflikti është brenda ndërgjegjes së Gentit. Konflikti shkallmon ndërgjegjen e mbretit, sepse ka bërë vëllavrasje. Ky model konflikti është trajuar që në fillesat e tragjedisë, por unë do ti referohesha tragjedisë “Hamleti” të Shekspir. Komunikimi me hilen e Platorit kemi dhe skenën shekspiriane, njeriu-mekatar komunikon, është në konflikt me ndërgjegjen e tij të vrarë. Mëkati i vëllavrasjes është i lashtë sa vetë njerëzimi, Kaini vret Abelin. Gjithçka përsëritet në historinë njerëzore, por në rrethana të ndryshme. Genti-Kain vret vëllain e tij Platori-Abeli. Asgjë nuk ka ndryshuar, konflikti për pushtet vazhdon. Autori kërkon të luajë me dy linja në tragjedinë e tij, njëra linjë është vëllavrasja dhe nga ana tjetër është lufta për pushtet. Ajo çka i intereson autorit, është përqsja historike, me historinë e antikitetit shqiptar. Linja e vëllavrasjes është vetëm ngasja për të përceptuar pasojat që sjell etja për pushtet, ndërkohë që loja kryesore luhet në fatin tragjik të Ilirisë. E në këtë rast hija e Platorit është dhimbja e humbjes së Ilirisë, e ngjizur nga krimi.

Platori:

*Edhe në errësirën e thellë të vdekjes
 Mua më dbemb shpirti për Ilirinë,
 Por ajo u përmbys se ti e ngjize me krim.
 Nga ajo shigjetë në Scord u ther dhe mbretëria.
 Brezave që vijnë gjakmarrja u mbeti trashëgim.
 Në vend të një shembulli të mirë, u le një krim!
 Vëlla-vrasje, oh, sa fjalë e shëmtuar
 Krijove për gjubën tonë të bekuar!
 (I afrohet më shumë, gati e prek)
 Unë tash po nisem për në atdheun tonë të shkretë
 Dhe do jem atje përgjithmonë.*

*Në kujtimin e brezave që vijnë.
Dhe sa të jetë jeta do të jetoj në kujtesë,
Ashtu do të sundoj unë në Iliri*

Dhe me vdekjen time do ta ruaj atë mbretëri¹.

Konflikti në tragjedi paraqitet në dy forma: konflikti i brendshëm dhe i jashtëm. Konflikti i jashtëm paraqet konfliktin mes dy palëve, ku në një njërën palë është vetë heroi. Gjithashtu konflikti i jashtëm paraqitet edhe si konflikt mes dy ideve, mendimeve, interesave, pasioneve, parimeve. Në tragjeditë e Shekspirit kemi dy lloje të konflikteve, të jashtëm dhe të brendshëm. Tek tragjedia Makbeth kemi konfliktin e jashtëm, Makbeth-mbështetës i mbretit Dunkan. Në tragjedinë Jul Çezar kemi konflikt të jashtëm, por ajo që e dallon nga tragjedia Makbeth, tek Jul Çezari kemi konflikt mes dy vlerave, Perandori-Republikë. Tragjedia e ka zanafillën në antikitetin e lashtë grek dhe subjektet janë marrë dhe rimarrë nga autorë pasardhës në periudha të ndryshme të zhvillimit të dramës botërore. Ndërsa në dramën e antikitetit heroi lufton në pozita të pabarabarta me hyjnitë, në përpjekje për t'iu kundërvënë fatit të përcaktuar nga perënditë, në dramën moderne (tragjedinë) njeriu sillet rreth ekzistencializmit, absurdit të jetës. Në këto drama individi është në konflikt të vazhdueshëm me shoqërinë.

Një konflikt tjetër është dhe konflikti i brendshëm, i subkoshiençës së heroit, i heroit me vetveten e tij. Për hir të vërtetës dhe në jetën e përditshme njeriu përballet me momente të ndryshme, në luftë me vetveten e tij, për të mposhtur emocionet negative, ambicien, lakminë, xhelozinë etj. Pikërisht tek drama "Monedha e Gentit" Milazim Krasniqi është përpjekur të japë luftën e brendshme që ndodh në nënvetëdijen e Gentit. I zhytur në mëkatin e vëllavrasjes, ai vuan mëkatin e tij. Është momenti kur Platori i bën gjyqin e ndërgjegjes së tij.

Platori :

(afrohet ngadalë drejtë Gentit)

*Para se të bëjnë gjyqin senatorët romakë;
Para se të të përqafojë vdekja mizore;
Para se të qelen haqekrah dyert e ferrit;
Erdha të të gjykoj vetë, o vëlla faqezil!
(Krasniqi 2010: 52)*

Në dramën e Milazim Krasniqi konfliktet piren drejt konflikteve tragjike. Tragjik konflikti Gent-Plator që në fakt është ndërgjegjia e vuarë e një mbreti për të realizuar ambiciet e tij për pushtet dhe për të rrëmbyer të fejuarën e vëllait të tij, Etleven dardane. Tragjik fati i ilirëve, të cilët humbën lirinë, jetën, atdheun e tyre. Megjithëse konflikti i dytë duket që nuk është dominant në dramë, fjala e fundit e Platorit në fakt zbulon dhe linjën e dytë, po aq të rëndësishme sa e para. Ndërsa linja e parë ka të bëjë me krimin monstruoze të mbretit Gent, linja e dytë mbart gjithë emocionin dhe finalen e dramës. Në linjën e parë, krimi i vëllavrasjes për pushtet, është në të njëjtën linjë që ndeshim dhe në tragjeditë e Shekspirit, "Hamleti" dhe "Makbethi". Por dramaturgu Krasniqi shkon përtej një krimi për pushtet. Pasojat e këtij krimi për pushtet kalojnë caqet e tragjedisë familjare, shkojnë kah tragjedia kombëtare. Këtu dallohen qartë dhe karakteret e personazheve, si dhe fatet tragjike të tyre. Mbreti Gent me fatin tragjik të familjes së tij dhe humbjes së pushtetit dhe Platori me fatin e tij tragjik, të vdekjes së parakoshme nga dora e vëllait të tij, vjen nga bota e përtejme, me dhimbjen e shpirtit për Ilirinë.

Platori:

*Edhe në errësirën e thellë të vdekjes
Mua më dhemb shpirti për Ilirinë,*

¹ Milazim Krasniqi, *Vepra "Drama"*, Prishtinë 2010, faqe 56.

Por ajo u përmbyste ti e ngjize me krim,
 Nga aj shigjetë në Scord u ther dhe mbretëria.
 Brezave që vijnë gjakmarrja u mbeti trashëgim.
 Në vend të një shembulli të mirë, u le një krim!
 Vëlla-vrasje, oh, sa fjalë e shëmtuar
 Krijove për gjubën tonë të bëkuar!
 Vëlla-vrasje, oh, çfarë kujtimi i zi
 U le brezave që vijnë trashëgimi!
 (i afrohet edhe më shumë, gati e prek)
 Unë tash po nisem për në Atdheun tonë të shkretë
 Dhe do të jem atje përgjithmonë
 Në kujtimin e brezave që vijnë.
 Dhe satë jetë jeta do të jetoj në kujtesë,
 Ashtu do të sundoj unë në Iliri
 Dhe me vdekjen time do ta ruaj mbretërinë!¹

Megjithëse autori i referohet termit dramë, në të vërtetë është tragjedi. Është tragjedi e cila shtrihet jo vetëm në rrafshin e krimit për pushtet, por dhe në rrafshin e vëllavrasjes dhe të tragjedisë kombëtare. Tragjike nuk është vdekja e Gentit, por ajo çfarë ndodh në të vërtetë në zhvillimet e mëvonshme të ngjarjeve. Fokusi i autorit nuk përqëndrohet shumë në fatin e personazhit, fatin tragjik të mbretit, por Krasniqi kërkon në vetëdijen e personazhit. Vëllavrasja, krimi për pushtet dhe fati tragjik i Ilirisë, janë përranj të cilët zbulojnë dramën psikologjike të Gentit. Asgjë nuk ndodh rastësisht, ngjarjet rrjedhin sipas raportit shkak-pasojë. Tre linjat në të cilën rrjedhin ngjarjet kulmojnë në fundin logjik të fatit të mbretit Gent dhe të mbretërisë së tij. Megjithëse autori praninë fizike të vëllai të Gentit e jep përmes fantazmës, por fantzma e vërtetë është vetë Genti, i cili është një i gjallë i vdekur. Prof. AS. Dr. Rajkumari Ashalat Devi, pranë Departamentit të Anglishtes në universitetin “Manipur University”, në studimin e botuar në British literary magazine “The Criterion”, Conflict in Tragedy, shprehet se:

“Ajo që është më e pranishme në një tragjedi është serioziteti i veprimit, atmosfera e zymtë, konflikti psikologjik, pezullimi, tensioni dhe kapaciteti për të lëvizur audiencën. Tragjedia kërkon të ngjall ndjenjat e “mëshirës dhe frikës”. Megjithatë, ndjenjat e “keqardhjes dhe frikës” nuk është çështje e spektaklit të vuajtjeve të pësuar nga heroi tragjik. Përkundrazi është konflikti që ushqen këto vuajtje, që shkakton “mëshira dhe frikë” tek ne. Vuajtja thjesht nuk është tragjike, por vetëm vuajtjet që vijnë nga konflikti janë tragjike”².

Duke iu referuar konfliktit në dramën “Monedha e Gentit”, autorit nuk i intereson vuajtja e mbretit Gent, por vuajtjet që vijnë nga konfliktet në këtë dramë.

Genti:

(përpiqet të lirohet nga hekurat. Ata lëshojnë tinguj gjithë tërsëllimë)
 Ku je o vdekje që nuk vjen të më marrësh
 Në gjirin tënd më të flohtë se ky mermer?

Etleva:

(me flokë të shprishur. Fytyra i është prishur krejt. Është e hallakatur)
 E mjera unë e mjera për bijtë e mi të njomë,
 Që paskeshin pasur fat të keq të hidhur...
 Dhe unë, nënëmjera, nuk mund të bëj asgjë,
 As të vajtoj me ligjet tona nuk mundem³.

¹Po aty, Milazim Krasniqi, Prishtinë 2010, faqe 56.

²Prof. As. Dr. Rajkumati Ashalat Devi. 12 dhjetor 2013, faqe 1.

³Po aty, Milazim Krasniqi, Prishtinë 2010 faqe 47.

Konflikti me vëllain e vrarë dhe me ndërgjegjen e tij sjell tensionin dramatik në përgjithësi si rrjedhojë e zhvillimit të ngjarjeve, të cilat përmes tensionit dramatik arrijnë në pikën kulmore dhe në zgjidhjen e konfliktit dramatik. Në dramën e Milazim Krasniqit, është i pranishëm që në fillim të zhvillimit të ngjarjeve. Lexuesi (audiencia) duket që jeton me këtë tension dramatik që në fillim të ngjarjes dhe duhet të presë vetëm përfundimin e vazhdimin të mëtejshëm të ngjarjeve deri në pikën e zgjidhjes. Momenti kur Platori i bën të ditur mbretit arsyet e fatit tragjik të tij dhe të mbretërisë, vetëm i bën një rikujtesë mbretit.

Drama fillon me rënien e mbretërisë. Edhe autori, ashtu si Homeri në veprën e tij "Iliada", i cili fillon rrëfimin në fundin e mbarimit të luftës së Trojës, fillon me momentin e fundit të rënies së mbretërisë ilire të Gentit. Romakët të përfaqësuar nga Anici, marrin në dorëzim kështjellën. Pamja jashtë kështjellës që na përshkruan autori qartëson përmasat e konfliktit Iliro – Romak. Me këto pamje, fundi tragjik i mbretit Gent është i pashmangshëm. Fundi tragjik është për familjen mbretërore, Ilirinë, por njëkohësisht dhe për mbretin. Tragjedia e tij është shpirtërore, sepse i duhet të përballet moralisht me fatin e familjes së tij, me fatin e Ilirisë, por edhe me ndërgjegjen e tij të vrarë, pasi ka vrarë vëllain e tij Platorin.

Genti:

(shfaqet fantazma e Platorit)
Ah, kjo fantazmë nuk më lë as të vdes
Pa më nxjerrë mendjen nga koka!
(thërret me zë të ulët)
Ju lutem ruamëni nga kjo fantazmë!
Roje, roje, roje!
Oh ruamëni nga kjo fantazmë!
Heeej!
(bie përdja)¹

Loja e fatit në dramën "Monedha e Gentit" të Milazim Krasniqit

Në dramën "Monedha e Gentit" të autorit Milazim Krasniqi, kemi aktualizimin e historisë. Të kthesh sytë nga historia, do të thotë të glesh momentet më të spikatura historike. Megjithatë historia e kombit shqiptar, duket që ka "privilegjin" e një shumësie të ngjarjeve të spikatura. Duan apo nuk duan të tjerët, historia e Shqipërisë nuk fillon në mesjetë, por që në periudhën e antikitetit dhe më tej në mugëtirat e historisë. Por kthimi i syve nga historia, ka në vetvete dhe aktualizimin e saj, përshtatjen me momentet aktuale. Brenda aktualizimit të historisë, autori jep dhe mesazhin e dramës. "Monedha e Gentit" është dramë historike, me një qasje të drejtëpërdrejtë të aktualitetit. Drama është botuar më 2010-ën por qasja është sa në periudhën e Ilirisë po aq sa dhe me momentet që ka kaluar populli shqiptar në Kosovë në vitin 1999. Personazhi kryesor i veprës, mbreti Gent për shkak të egos së tij për pushtet, sjell fatin e keq për familjen e tij dhe për mbretërinë. Fati i keq nuk është vetëm për mbretërinë ilire, autori shikon përtej fatit të një mbretërie, shikon fatin e një kombi, gjithçka në kuadrin e aktualizimit të historisë. Drama fillon me momentet e fundit të mbretërisë ilire të Gentit. Në aktin e parë, janë të pranishëm të gjithë personazhet të cilët janë pjesë e fatit të trishtë të mbretërisë. Të pranishëm në momentet e fundit janë Pantauhu (përfaqësuesi i persëve), Polemokrati (kryekomandanti i ushtrisë së Gentit), Karavanti (vëllai i mbretit, Etleva (gruaja e mbretit, fëmijët e mbretit, etj. Mbreti humb shansin e tij për të mbajtur mbretërinë dhe për të

¹Po aty, Milazim Krasniqi, Prishtinë 2010 faqe 58.

shpëtuar Ilirinë, por fati i mbretërisë dhe Ilirisë ishte parashkruar me vëllavrasjen për të kënaqur egon e tij për pushtet.

Titulli i dramës, “Monedha e dytë e Gentit” shpalos dy pamjet e personazhit: Gentin si mbret, Genti si vëllavrasës. Brenda këtyre dy anëve të monedhës, luhet fati i trishtë i tij, i mbretërisë dhe i familjes së tij. Që në fillim të dramës, lexuesi njihet me fatin e mbretit Gent.

Genti:

*Si një qyqar tash këtu unë po pres
Duke u endur mes statujave të ftohta
Dhe flamujve të heshtur që vajtojnë lavdinë,
Duke provuar ftohtësinë e vdekjes,
Ndërsa mbretëria ime shtrihet si dele e prërë në fyt
E larë në pllangat e trashura të gjakut¹.*

Momentet që po kalon mbreti, janë momente kur vendoset fati i mbretërisë dhe i familjes së tij.

Genti:

*Tash ne fati na ka ngarkuar barrë të rëndë.
Edhe dëmin e disfatave të kaluara romake,
Edhe hakmarrjen e tyre të mbetur përgjysmë
Duhet ta paguajmë ne me jetët tona².*

Fati është një forcë misterioze. Misteri i kësaj force asnjëherë nuk është arritur të shpjegohet. Në psikologjinë e antikitetit grek, besohej se fati ishte i paracaktuar dhe i pa ndryshueshëm. Besohej se fati duhej pranuar sepse nuk mund të ndryshohej. Një nga tragjeditë ku trajtohet fati i paracaktuar i individit (personazhit) është tragjedia Edipi mbret. Edipi, i cili për shkak të fatit shpëtoi nga vdekja kur ishte foshnje, po përsëri për shkak të fatit të paracaktuar vret babain e tij dhe martohet me nënën. Megjithëse u mundat t'i shmangej fatit të përcaktuar nga perënditë, përsëri nuk arriti ti shmangej. Ai ishte thjeshtë një lojtar që do të luajë deri në fund lojën e fatit. Pikërisht këtu qëndron dhe tragjedia e individit (personazhit) me fatin e paracaktuar dhe i destinuar ti nënshtrohej. Oresti ishte viktimë e fatit të paracaktuar. I mistershëm fati tragjik i Orestit. Një forcë që fshihej brenda vetëdijes së tij, apo hyjnore? Në të dyja rastet njeriu që në fillimet e veta nuk ka arritur që të zbulojë këtë mister, po kështu nuk arriti që të zotëronte këtë pushtet të mistershëm.

Shekspiri në tragjeditë e tij, ka të pranishëm dhe fatin e paracaktuar të personazheve. Tek “Makbeth”, fati paracaktohet nga tri motrat magjistrica, po kështu dhe tek “Romeo e Zhulieta”, përsëri është fati të cilit i nënshtrohen personazhet. Pushteti i mistershëm ndryshon fatin e Makbethit, Romeo e Zhuljetës pa i lejuar që të dalin nga ky rreth vicioz. Personazhet u dorëzohen këtij pushteti, bëhen pjesë e misterit të fatit, që për Shekspirin konceptohet si kohë.

Frati:

*Zot, shkoni brenda; zonzë, edhe ju,
Dhe ti, Paris, dhe gjithë u përgatitni
Ta përcjellim në varr këtë kufomë.*

¹Po aty, Milazim Krasniqi, Prishtinë 2010, faqe 21.

²Po aty, Milazim Krasniqi, Prishtinë 2010, faqe 21.

*Qielli për ndonjë faj ju dha ndëshkim,
 Pra mos e zemëroni me ankim¹.*

Personazhet në tragjedinë e Shekspirit, megjithëse luftojnë kundër fatit, në fund i dorëzohen fatit të tyre të paracaktuar, të lodhur si një anije e lodhur ndër furtuna. Mbretër që shkatërrohen nga lojrat e pamëshirshme të fatit, të dashuruar që u shkatërrohen ëndërrat e dashurisë, asgjë nuk mund ti rezistojë pushtetit të mistershëm të fatit.

Romeo:

*Pilot i mjerë e prijës i përshijshëm;
 Përplase dhe dermoje mbi shkëmbinj të
 Anijen tënde, lodhur nga furtuna!².*

Megjithatë, koncepti i Shekspirit për fatin është krejt i ndryshëm me konceptin e fatit në tragjeditë e antikitetit. Për Shekspirin koncepti i fatit ka të njëjtën vlerë me kohën, domethënë shoqëria njerëzore është në luftë me kohën, por që fundi i kësaj lufte të personazheve tek Shekspiri është po i njëjtë si në tragjeditë e antikitetit, janë viktima të kësaj lufte. Pikërisht është momenti kur për herë të parë kemi një koncept modern të trajtimit të fatit në dramë. Më tej koncepti i fatit të njeriut bashkangjitet me tema të tjera, me absurdin, ekzistencializmin. Alfred Uçi në studimin e tij "Shekspiri në botën shqiptare; ese kritiko letrare", duke iu referuar konceptimit të kohës në tragjeditë e Shekspirit, vëren se: "*Koha ka një koncept krejt të ndryshëm nga fryma panteiste e Rilindjes. Sipas Uçit, koha tek Shekspiri është "si fillësë ontologjike, që identifikohet me jetën e brendshme të Qenies, melëvizjen dhe kabun e drejtimit të saj. Ndryshe nga kozmologjia teologjike mesjetare me parimin e lidhjes së kohës me sistemin vertikal e jerarkik të Qenies."* Trajtimi i fatit të qenies njerëzore, bashkëudhëton dhe me temën e ekzistencës njerëzore, me dilemat dhe me kompleksitetin e tyre, me luftën për të marrë në dorë fatin e jetës së tyre, në luftën me ndërjegjien e tyre. Drama e luftës me fatin tek "Miti Sizifit" të Kamysë, është njeriu me vullnetin dhe me dëshirën për t'iu kundërvënë jo vetëm pushtetit të perëndive, por edhe për të marrë në dorë fatin e tij, shënon dhe një nga kulminacionet e trajtimit të fatit njerëzor në letërsinë botërore. Këndvështrimi për kohën si koncept filozofik, por dhe si koncept në letërsi, në dramën moderne duket që qëndron në ato kufij të konfliktit të përjetshëm Qenie Njerëzore-Krijues. Becket në dramën e tij "Duke pritur Godonë", pikërisht ka të pranishëm konceptin kohë. Ky koncept është i pranishëm tek ky autor përmes idesë që krijohet të lexuesi (spektatori) të pritjes së përjetshme. Koha rrjedh, personazhet presin të takojnë Godonë, dhe pritja është në konceptin e vazhdimësisë. Koha rrjedh në mënyrë horizontale, askund nuk kemi momentin kur koha shkon drejt zgjidhjes së konfliktit Qenie Njerëzore Krijues. Por në brendësi të problemit, së bashku me kohën, paralelisht vazhdon të "mbarset" më tej ky konflikt.

A ka rregulla në lojën e fatit? A bëhet përzgjedhje në lojën e fatit? Apo fati luan pa rregulla dhe pa bërë përzgjedhje, ku gjithçka dhe gjithkush është i dënues ti nënshtrohet? Lojë së fatit i nënshtrohen të gjithë dhe pa përzgjedhje, por duket që fati iu ka përcaktuar secilit rrugët e fatit. Dikush në rrugën e fatit të mbarë dhe dikush në rrugën e fatit të mbrapshtë. Gjithsecili në rrugën e vet. Frojdi duket që është munduar të argumentojë rrugët e fatit për secilin. Duke analizuar krijimtarinë e Dostojevskit, Frojdi përcakton dhe karakteret e grupeve të personazheve. "*I moralsbëm është njeriu që reagon ndaj tundimeve të brendshme, pa rënë pre e tyre...Për kriminelin dy tipare janë thelbësore: egoizmi i pakufi dhe tendenca e fortë destruktive. Premisë për të dyja bashkë dhe për shprehjen*

¹Uilliam Shekspir, "Romeo e Zhulieta", Tiranë 1981, faqe 379.

²Po aty, Uilliam Shekspir, "Romeo e Zhulieta", Tiranë 1981, faqe 395.

e tyre është mungesa e dashurisë ndaj personave të dashur ato dalin në pah dhe në mënyrën se si i trajton ai si autor lexuesit e vet, pra në gjërat e vogla është sadist me të tjerët, në gjërat më të mëdha është sadist me veten përbrenda, pra mazokist d.m.th njeriu më i butë, më shpirtmirë dhe më i gjindshëm”. Në këtë kontekst, duke iu referuar mbretit, raportet e tij me personazhet të tjerë, shohim pika të përbashkëta me idenë e Frojdit. Cilat janë raportet e Gentit me personazhet e tjerë të dramës? A është Genti kriminel? Së pari, përcaktimi i Gentit si personazh, nuk vërehet që në fillim të dramës, e megjithatë, në vazhdimësinë e zhvillimit të ngjarjeve, lexuesi arrin të dallojë qartë njërën anë të medaljes së tij, Genti-kriminel, vëllavrasës. Asgjë nuk është e rastësishme në fundin tragjik të këtij personazhi. Tatëpjeta e fatit të tij ka filluar që në momentin e kryerjes së krimit dhe ashtu siç është natyra e kriminelit, që për të fshehur gjurmët e krimit të parë, kryen krime të tjera dhe nuk arrin të dalë nga kjo lojë e fatit që ka zgjedhur ai vetë. Fati që e ndjek, është zgjedhje individuale, sepse në asnjë moment nuk del në skenë ndonjë forcë tjetër që e detyron atë ti nënshtrohet fatit të paracaktuar. Rregullat e lojës i ka përcaktuar duke iu nënshtuar tundimeve të egos së tij për pushtet. Duke u bërë pjesë e fatit të zgjedhur nga ai vetë, krimi tjetër është shkatërrimi i mbretërisë, thënë më saktë sipas Platorit:

Platori:

*Fillove të zdërballesh në ndeje të turpshme
Me verë të vjetër e me gra të përdala,
Duke e shkuar motin pa e vrarë mendjen
Sie si të forcobej Mbretëria Iliriane,
Për të dëbuar armiqte e shumtë nga kufijtë,
Ku prisnin me dhëmbë përjashtë si ujë të uritur¹.*

Por lexuesi njihet dhe me anën tjetër të medaljes të mbretit, atë anë të medaljes, ku jepen raportet e tij me familjen. Raportet e mbretit Gent me familjen e tij, janë raporte shumë të mira, është i dhëmbshur, ndjen trishtim për fatin e familjes së tij, por që nuk arrin të krijoj një imazh të mirë tek lexuesi për këtë personazh. Evoluimi i shpejtë i ngjarjeve, në një periudhë prej tre ditësh, aq kohë sa ai nuk ka mundësi të riparojë asgjë, përcjell pikërisht lojën e fatit të cilën është idetyruar ta luajë deri në fund, ti nënshtrohet rregullave të saj, me një fund tragjik dhe të turpshëm për veten, familjen dhe mbretërinë. Fundi është i tëmerrshëm, një fund ku fati nuk i ka lënë asnjë rrugëdalje, vetëm rrugën e pendimit. Ndoshta pendimi, për gjithë atë që kam bërë për mbretërinë shprehet i penduar Genti. Familja e cila me të padrejtë, e pafajshme duhet të vuajë për mëkatet e bëra nga mbreti, e imponuar të bëhet pjesë e lojës së mbrapshtë të fatit. Dhimbja e Gentit për familjen e tij është shumë e madhe, shikon si shuhet jeta e familjes para syve të tij.

Genti:

*...Ah, biri im i vdekur, biri im i shtrenjtë,
Të bëra ushqim për luanët, me marrëzinë time².*

Autori duket që fatin tragjik nuk e shikon vetëm në fundin e mbretërisë ilirike të Gentit, shkon më tej. Loja e fatit është mallkimi që ka filluar para dymijë vjetësh vazhdon edhe sot, është një mallkim që vazhdon të ndjekë kombin shqiptar edhe më tej, tash dymijë vjet, ashtu si mallkimi i hyjnive për Arganoutët në Greqinë antike. Mallkimi nuk është vetëm për mbretin Gent, por ky mallkim ndjek Ilirinë tash dymijë vjet.

¹Milazim Krasniqi, Prishtinë 2010, faqe 53-54.

²Po aty. Milazim Krasniqi, Prishtinë 2010, faqe 51.

Aktori i III-të:

A nuk e kuptuat as tash, a Tragjedia ilire na është ngulitur në ndërgjegje...Me një fjalë, shpirti ynë, në esencë është shprehje besnike e tragjedisë së paraardhësve tanë...Ne jemi pasardhësit e tyre dhe jemi tragjikë sa edhe ata¹. (Krasniqi 2010: 43).

Lidhjet e pashmangshme të lojës së fatit me mbretin Gent, familjen e tij dhe Ilirinë, krijojnë një lidhje treshe, dhe pika e referimit e kësaj loje është mbreti Gent. Egërsia e lojës së fatit e bën Gentit të ndryshojë, një metamorfozë në personalitetin e tij, ndjen bjerren e shkëlqimit të tij si mbret, rrënimin e personalitetit të tij si kryefamiljar dhe pasojat psikologjike të kimit të vëllavrasjes. Në këtë lojë fati kaq të egër, mbreti Gent doli një humbës i madh, ku humbi gjithçka dhe u mbullua pa lavdi. Por ky është fati i një mbreti dhe fati i një mbretërie, e cila u shkatërrua, por populli mbeti, nuk u gjunjësua.

“Është e vërtetë se romakët i mundën ilirët pas luftërash dhe kryengritjesh që zgjatën me shekuj. Konsulli romak Paul Emili nuk mundi të nënshtrojë ilirianët edhe pasi ai rrafshoi për tokë më se 70 qytete të tyre dhe dërgoi në Romë si skllëvër 150.000 epirotë – ilirë, me në krye mbretin e tyre Genc. Sipas historianit romak Suetona, kryengritja e ilirëve në vitet 6 dhe 9 pas Krishtit ishte më e tmerrshme nga të gjitha luftërat që Roma ka bërë në botën e jashtme pas luftërave Punike. Roma nuk arriti ti asimilojë ilirët².”

BIBLIOGRAFIA:

Milazim Krasniqi, Vepra “Drama”, Shtëpia Botuese “Zëri”, Prishtinë 2010.

Uilliam Shekspir, “Romeo e Zhulieta. Vëllimi 2. Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”. Tiranë 1981.

Prof. Dr. Lisen Bashkurti. “Global Challenge”. Revistë periodike e Akademisë Diplomatike Shqiptare. Nr 11. Tiranë 2014.

¹Po aty, Milazim Krasniqi, Prishtinë 2010, faqe 43.

²Prof.Dr. Bashkurti, Lisen Bashkurti, “Albanofobia sipas vendeve dhe popujve fqinjë. Albanofobia në Itali”, “Global Challenge”, Revistë shkencore periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare. Nr 11. Tiranë. Nëntor 2014. faqe 11.

How does technology influence on education in nowadays?



Technology is undoubtedly having a major impact on every aspect of our lives and that includes today's learning environments. It is shaping the way in which students learn, teachers deliver material and the way in which we design spaces for future learning opportunities.

It is said that schools aren't just investing in computer stations and keyboards and we are witness to the fact, based on our planning and design work, and that they are quickly embracing the "constant contact" trends that have changed our global culture. As technology continues to evolve, it brings with it new opportunities and challenges for educators and students. Social networking is a great example of technology that can help or hinder education, depending on how it is used and integrated into teaching plans. Privacy and security are two concerns that can come with using social networking in the classroom. It can also become a distraction to students, or even a tool used for bullying.

Learning spaces now, more than ever, are being designed to help with communication and information sharing. From tablets used to asking kids to "raise their hands" virtually, to viewing a lecture via Skype or FaceTime, the traditional four walls and a chalkboard are transforming rapidly. According to a recent USA Today article, a New York-based educational technology startup released the first device, an Android-powered touchscreen tablet, "designed for kids both to take to school and bring home. For sale only to schools for now, the Amplify tablet comes pre-loaded with virtually everything a student will encounter during the school day, including all the textbooks, lessons, tests and e-books she might be assigned."

Key words: *Learning spaces, Technology books, teaching plans, distraction*

Literature review

Research literature throughout the past decade has shown that technology can enhance literacy development, impact language acquisition, provide greater access to information, support learning, motivate students, and enhance their self-esteem (ACT, 2004; CEO Forum, 2001; Boster et al., 2004; Mann et al., 1999; Tracey & Young, 2006; WestEd, 2002). Indeed, researchers have affirmed that computer technology provides abundant opportunities for students to build or modify their personal knowledge through the rich experiences that technology affords.

As technology continues to evolve, it brings with it new opportunities and challenges for educators and students. Social networking is a great example of technology that can help -or hinder - education, depending on how it is used and integrated into teaching plans. Privacy and security are two concerns that can come with using social networking in the classroom. It can also become a distraction to students, or even a tool used for bullying. According to a 2011 Pew report, 15% of children surveyed said they had been the victim of mean behavior on social networking sites like Facebook and Twitter.

However, using social networking as part of the learning process can also have benefits. Students who are more introverted may open up and connect more with faculty and other students when they are communicating through social networking. It also affords students the opportunity to collaborate and work together in a whole new way.

There are also social networking sites designed specifically for education. An article on technology in education by Education Week mentions ePals and eChalk as two sites “designed specifically for learning.”

College students can be notoriously connected to technology, including social networking, through their smartphones, laptops, and tablets. Social media in education presents college students with different benefits and detriments compared to their younger counterparts. According to Mashable, “Facebook is the most used social media tool in higher education”. Additionally, Mashable says that colleges can use social media to encourage school spirit, foster the growth of alumni groups, and offer virtual tours to potential students.

So whether it is a college student studying classic literature or a grade school student first learning to read, technology is now an integral part of the education process.

Technology is undoubtedly having a major impact on every aspect of our lives and that includes today’s learning environments. It is shaping the way in which students learn, teachers deliver material and the way in which we design spaces for future learning opportunities.

Kristen Purcell of the Pew Research Center’s Internet & American Life Project recently co-authored a new study on technology and education. She says schools aren’t just investing in computer stations and keyboards and we are witness to the fact, based on our planning and design work, and that they are quickly embracing the “constant contact” trends that have changed our global culture. Purcell says, “What did surprise us though was the extent to which mobile tools have become part of the learning process. We found that 73 percent of teachers that we surveyed told us that cell phones are now either part of their teaching experience, or their students’ learning experience. Tablets and e-readers are being used by more than four in 10 of these teachers”.


Technology has changed the way we as humans live; it changes our understanding of the way things work and changes the way we interact with one another. Technology was once opposed but is now somewhat welcomed into our homes. During the renaissance period, technology was opposed, as the church believed that technology would oppose the beliefs of god. Well they were right. Technology isn’t just computers or TV’s, its engineering science. And in Science, our goal is to progress and understand everything there is to understand about us, our planet and beyond. However, the way

we understand and experience this concept the most is that it's just to make our lives much more efficient. When you look around, what do you see? Just at an intersection in downtown New York or Los Angeles, you see people walking around with cell phones and carrying around laptop cases, other's just listening to music. But then the companies that build these types of technology want to make them better and more efficient. So they keep releasing new devices that are smaller and faster and mostly more costly.

Methodology

For this paper to be successful, there are used the qualitative and quantitative methods such as the tests and the interviews in 100 schools in Tirana. The questionnaires were made to 50 teachers and 50 students. Then through the SPSS technique there were analyzed the values and results of this paper.


Question 1: Do you know the mean of education technology?



Question 2: "What is the frequency of using technology in the class"



Question 3: "Do you think including technology help in effective education"



Technology is a concept that will never end. New devices will be released and then refined just about endlessly. Not even if or when we start running out of resources, because we would have recycled parts to build new technology and we will build new technology to possibly refine available resources or even find another planet that has the same resources. Technology now is a concept that we cannot survive without; an average North American person needs technology to eat, to entertain, to cook, and to do many other daily functions. Let's face it we need technology to survive. But this is to an extent, for example a computer can be one of man's best friends, it helps us write documents such as the one you are currently reading, it helps us obtain knowledge through the internet, and it helps us entertain ourselves with games, movies, and music. But the computer can also have side effects, to our behavior, and even to our appearance. Some children get so entangled in this technology that their eating and sleeping habits change and along with their behaviors. Not just on the computer, even just playing on gaming platforms such as the Xbox or the PS3 or even iPods, they can all change the way we eat, sleep, and behave. While children play on computers or gaming platforms, they get so involved that they begin to avoid eating and sleep later to play longer, but the games they play really can change their usual behavior, shooting games or fighting games can make them more violent, strategy games can make them more strategic (slightly), and racing games can make them aggressive drivers, it all depends on how much you play and how addicted you become. But gaming can also lead to a loss of physical activity, when someone is addicted to a game, they refrain from leaving the house until they reach a certain 'achievement', until they win a race or even until they 'die' in the game, this behavior can cause us to gain weight and/or become obese because we also begin snacking more instead of eating proper meals and we stop exercising often.

I'm not saying technology is bad, Technology is changing the way we live, changing the way we interact, it lets us understand the world better, and it helps us write documents, do our homework, make money, present neat computerized presentations, and even edit documents with others in real-time. But what I am saying is that technology is evolving, to engulf us into different activities. There was a presentation at DICE (a creative design convention) where a design professor had very interesting arguments. He called his presentation, "design outside the box" he said, "Technology changes the way we do things, it's literally turning our lives into games, who knew that Ford built a car so intelligent that it knew if you were driving efficiently, and would grow a computerized plant around your speedometer" but then he introduced an idea that made the audience think if this was to really happen? He said, "In the future, we are going to be engulfed in points, in a point system where you get points for eating a healthy cereal, for taking the bus instead of a car, for showing a tattoo which shows 'ads' with 'E-ink', where you would get points for watching a certain advertisement on TV or walking or biking to work." He made me think, is this really going to happen? Well if it does, it's going to completely change the way we live, we will be engulfed in a game, and a computerized game not just the 'problem solving' game that we call life but a game for points, full of achievements to win. We will stop eating our favorite food because we wouldn't be getting points for them and not buying certain things because we won't get points for them.

Conclusions

To conclude, I believe in technology, I completely support it, but only to an extent. I say go ahead and enjoy what technology has to offer, learn about the world we live in, entertain yourself and engulf in it. Just until it doesn't affect your appearance or the people around you and especially the person in you. Think about it like this, we as humans made machines we can't let machines make us who we are.

BIBLIOGRAPHY:

1. Peshkëpia. V. (2012) “Mësimdhënia, Mësimnxënia. Raportet e tyre me integrimin evropian”, Tiranë, Fan Noli.
2. e.g.Bork, 1980; Carnegie Commission on Higer Education,1977; Papert,1980
3. Lemke,1999
4. Zajazi.T. (2003) “Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies”, Shkup, Vinsent Graphic.
5. Dibra, G & Dizdari, I: “Metadologjia e mësimdhënies” Shkodër 2004.
6. Grup Autorësh: “Pedagogjia e përgjithshme”, Tiranë 1995.
7. Milaret, Gastan, “Pedagogjia e përgjithshme”, Tiranë 1995.
8. Musai, Bardhyl: “Psikologji edukimi”, Tiranë 1999.
9. Revista “Mësuesi” Nr 4: Nr 10.
10. Becta (2002), Educational research into Managed Learning Environments/Virtual Learning Environments-a selection of abstracts: Coventry: Becta.
11. Becta (2005), The Becta Review 2005: Evidence on the progress of ICT in education. Coventry Becta.
12. Bhattacharya, I. & Sharma ,K. (2007), India in the knowledge economy and electronic paradigm, International Journal of Educational Management.
13. Chandra, S. & Patkar, V. (2007), “ICTS: A catalyst for enriching the learning process and library services in India”.
14. Conole, G. (2002). “Systematizing Learning and Research Information”, journal of Interactive Media in Education, 7. Available online: <http://-jime.open.ca.ac.uk/2002>
15. Conole, G. and Dyke, M. (2004). “What are the affordances of Information and Communication Technologies”, ALT-].
16. Dichanz, H. 2001: “E-learning, a linguistic, psychological and pedagogical analysis of a misleading term”. Paper presented at the 20th ICDE World Conference in Dusseldorf 2001
17. European Commission (2001). “The Learning Action Plan: Designing tomorrow’s education”. [http:// www.elearning.info](http://www.elearning.info).
18. HEFCE (2005). HEFCE strategy for e-learning. London
19. Gallager, M., (2003). “E-Learning in Australia”. In: Boezerooy, P. (Eds.). “Keeping up with our neighbors: ICT developments in Australian Higher Education”. Oxford: ALT.
20. Laurillard, D. (1996). “The educational challenges for teachers and learners”. Paper presented at Virtual University Conference, 24 May 1996, University of London England.
21. Littlejohn, A. and Mc Gill, L. (2004). “Report on the effectiveness of resources for e-learning”, report for the JISC commissioned Research Study ON THE Effectiveness of Resources, Tools and Support Services used by Practitioners in Designing and Delivering E-Learning Activities.
22. Plomp, T.; Pelgrum, W. J. & Law, N. (2007). Sistes2006 “International comparative survey of pedagogical and ICT in education. Education and Information Technologies”.

23. Sanyal, B. C. (2001), "New of higher education and ICT to achieve education for all", Paper prepared for the Expert Roundtable on University and Technology-for-Literacy and Education Partnership in Developing Countries, International Institute for Educational Planning, UNESCO, September.
24. Torstein Rekkedal and Qit-Eriksen "Internet Based E-learning, Pedagogy and Support Systems" NKI Distance Education, March 2003.
25. Duffy T Cuningham D, Constructivism. "Implications for the design and delivery of instructions, in Handbook of Research for educational communications and technology". D. H. Jonassen. Editor.
26. Woolfork, Anita Psikologji edukimi Botuar nga Qendra e Arsimit Demokratik CDE 2011.
27. Bates, A [2000] "Managing technological change. Strategies for college and University leaders". San Francisco Bass Publishers.
28. Barolli E, Gorishti A, B Karamani, Haveri A. "TIK në mësimdhënie dhe mësimnxënie".

Kushtetuta e Republikës së Kosovës pas tetë viteve



Abstrakt

Ky punim është si rezultat i tetë vjetorit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pra përvjetori i tetë i saj. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar më 2008 konsiderohet si kushtetuta më moderne në botën bashkëkohore, kështu e cilësojnë një pjesë e juristëve e në veçanti të lëmit përkatës. Andaj, Kushtetuta aktuale e republikës së Kosovës duhet të lexohet si jurist i mirëfilltë dhe të lexohet edhe siç thonë “poetët” brenda rreshtave! Pra, është moderne në kuptimin e lëshimeve dhe favoreve që iu kanë bërë komuniteteve si qytetarë dhe shtetas të Republikës së Kosovës në aspektin e gëzimit dhe realizimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Por, duke ngushtuar hapësirën e veprimtimit afat gjatë në drejtim të ndryshimit dhe plotësimit të saj sipas kërkesave të cilat i imponon kalimi i kohës. Andaj, në këtë segment Kushtetua e Republikës së Kosovës, pas hulumtimeve dhe analizës time rezultojnë se karshi Kushtetutës së K.S.A. të Kosovës është në minus bukur të madh.

Fjalët kyç: kushtetuta, liritë, republika, qytetarë, komunitete

Hyrje

Në ditën e sotme “festohet” përvjetori i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik – politik i shtetit të Kosovës. Rëndësia e kushtetutës është e shumëfishtë për shtetin dhe shoqërinë tonë¹. Kushtetuta në vete përmban parimet themelore mbi organizimin e shtetit dhe të pushtetit politik, mbi të cilat mbështetet funksionimi i tij dhe ruajtja e raporteve të caktuara politike dhe shoqërore. Pra, nëpërmes këtyre parimeve ndërtohet e tërë hierarkia e organeve të pushtetit shtetëror, ndahen pushtetet në atë legjislativ, ekzekutiv – administrativ dhe gjyqësor. Kushtetutën në të kaluarën e kanë quajtur: “Dokument themeltar juridik – politik”, diku e kanë quajtur “ligji mbi ligj”, “akt politik” etj².

Kushtetuta është akti formal juridik më i lartë, akt burimor prej të cilit burojnë edhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore si edhe parashihen dhe garantohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut si dhe parashihen në mënyrë apriori autorizimet dhe funksionimi i pushteteve shtetërore në tërësi si edhe rregullimi i të gjitha segmenteve të jetës shoqërore, ekonomike, kulturore, arsimore, me një fjalë është një akt gjithëpërfshirës. Andaj, përvjetorët gjithmonë në vete ngrehin gjykimin apo vlerësimin e rezultateve që sjell akti në fjalë nëse ato vërtetë ekzistojnë. Ka mendime se me miratimin e kushtetutës u kurorëzua pavarësia, sovraniteti, qytetarët më në fund i gëzojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, se me të integriteti individual dhe kolektiv i qytetarëve të republikës së Kosovës janë të pa cënueshme, se territori dhe sovraniteti janë të pandara, siguria juridike dhe barazia në mes të qytetarëve tani e tutje janë të garantuara, se Kosova është shtet në VETE!. Të gjitha këto që u shtruan këtu vërtetë ishte dashtë të jenë realitet, në fakt të vërteta që të gjithë qytetarët t’i gëzojnë. Por, gjërat duhen shikuar ashtu qysh janë dhe nuk duhet të krijojmë parafytyrime të rrejshme lidhur me realitetin që na rrethon në përditshmërinë tonë të rëndomtë. Për të sotmen kanë menduar, janë përpjekur që ta kenë edhe stërgjyshërit, gjyshërit, etërit tanë duke derdhur gjakun, mundin, djersën, vetëm e vetëm për të qenë të lirë, brez pas brezi gjer në luftën e fundit të vitit 1998-1999, që si individë dhe si kolektivitet e të bashkuar më në fund në shekullin e ri!?

Lufta ndodhi, vrasje, dhunime, shkatërrime të pronës dhe më në fund çlirimi dhe liria arritën falë ndihmës së pa kursyer të aleatëve tanë qofshin të përjetshme këto lidhje që i bëri i ndjeri Dr.Ibrahim Rugova, me në krye SHBA-të, dhe luftës heroike të djemve dhe vashave tona. Parashtrohen shumë pyetje në ditët e sotme: A po e gëzojmë të gjithë këtë liri, këtë pavarësi, këtë sovranitet, a po sundon e drejta e shumë e shumë pyetje tjera, e lere më bashkimin kombëtar!?

Paslufta

Të gjitha këto pyetje ndoshta për dikë janë jo normale dhe jo të drejta, por klasa politike e shtetit tonë nuk e ka gjykuar – vlerësuar mirë situatën dhe nuk ka pas strategji të mirë të shtet ndërtimit, respektimit dhe zbatimit të së drejtës. Dhe, më së paku nuk ka pas parasysh fare rëndësinë dhe peshën që ka miratimi i kushtetutës si akt konstitutiv të shtetit më të ri në botë, duke u dhënë vetëm pas aspiratës që të shpallemi shteti në vete, e të tjerat “*do i bëjmë si të kemi qejf*”, është një kauzë të cilën ne sot po e përjetojmë në mënyrë shumë të rëndë, sepse, në anën formale akti më i lartë shtetëror u miratua, u shpall, pra, ana formale u realizua por, përmbajtja e saj është e rëndësishme, sepse, me të e tërë jeta politike, juridike, ekonomike, kulturore rregullohet në tërësi. Do të them se ky rregullim i tërësishtëm është i mangët, është jo i drejtë dhe jo e rregulluar siç duhet e tëra.

¹Kurtesh, Dr. Saliu: “E drejta Kushtetuese”, Prishtinë, 1998, fq. 47.

²Po, aty.

Nuk e kam menduar asnjëherë se do ta dëshiroja të kaluarën e të gjykojë apo vlerësojë të tashmen për të cilën kam menduar se do t'i ngjajë ideale, jam i bindur se shumica e popullsisë në Republikën e Kosovës e ndanë këtë opinion.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës bënë pjesë në grupin e kushtetutave të pakta në botë me mënyrën e nxjerrjes dhe ndryshimit të saj. Ajo ka një procedurë shumë të veçantë të nxjerrjes, që renditet në kushtetutat e llojit të NGURTË. Në krijimin e saj siç dihet pjesëmarrja e faktorit ndërkombëtarë ka qenë vendimtar, madje me ndikim parësor në hartimin dhe imponimin e shumë zgjidhjeve kushtetuese të cilat e bëjnë të rëndë bile do të them të pamundur ndryshimin dhe plotësimin e saj sipas nevojave të cilat i sjell koha, e të cilat janë zgjidhje të pandryshuara. Sepse, Projekti gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës sipas ideatorit të saj Z. Ahtisar -it, vëmendjen dhe rëndësinë parësore ia ka kushtuar komunitetit serb pakicë në Republikën e Kosovës, jo vetëm parashikime por edhe duke imponuar shumë përgjegjësi për shtetin në ndërtim e sipër që këto *“liri dhe të drejta themelore të njeriut”* (lexo për serbët) duhet me përpikëri të respektohen. Andaj, në këtë punim do të fokusohem në pikat alergjike të cilat janë pengesa të pa kalueshme në drejtim të shtet ndërtimit të Republikës së Kosovës, janë dispozita të cilat pengojnë dhe nuk lënë hapësirë për të vepruar në drejtimin të cilin shqiptarët shumicë në këto troje nuk mundën me i realizuar në përditshmërinë tonë, e këto janë: *“shteti me shumë etni”*; *“gjuha”*; *“sovrانيتi dhe integriteti i Kosovës”*; *“vota e dyfishtë*, e dy të tretave të *deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës”* (të lexohet se për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të kushtetutës kërkohet edhe vota e dy të tretave të komunitetit serb), për çështjet parësore të rëndësisë vitale për popullin e Kosovës në tërësi; *“çështja e besimit fetar”*; *“shkeljet e dispozitave kushtetuese nga vetë elita politike në republikën e Kosovës”*. Kjo analizë do të ketë edhe anën krahasuese të vështrimit me shtetet dhe kushtetutat e tyre në fqinjësi dhe më gjerë. Këto nocione, këto dispozita brenda kushtetutës do jenë sfiduese për qytetarët - shumicën e popullsisë së Kosovës dhe do jenë pengesa të pakalueshme për të ecë përpara në realizimin e synimeve shekullore për një rregullim dhe qeverisje shtetërore që garanton dhe siguron gëzimin e lirive dhe të drejtave themelore për çdo qytetarë pavarësisht, ngjyrës, racës, gjuhës, përkatësisë etnike, fetare, arsimore etj.

Çështja e shtetit shumetnik pas vete ngreh shumë gjëra të cilat një anë paraqesin një begati, një karakteristikë të qytetërimit modern brenda një territori përkatës, ku liritë dhe të drejtat themelore të njeriut realizohen me përpikëri dhe jeta e të gjithë qytetarëve është harmonike, ku ka barazi juridike dhe materiale, ku nuk cënohet asnjë komunitet, ku të gjithë e drejta i trajton në mënyrë të barabartë, ku sundon ligji mbi të gjithë dhe për të gjitha çështjet jetësore është vërtetë një laramani e këndshme, por, kur është fjala për komunitetin serb, është diçka absurde me menduar një mirëqenie të tillë, kur vrasësi, shkatërruesi, dhunuesi i ndanë këto vlera me të tjerët është turp, është e pa kapshme një trajtim i nivelit të tillë që ta bësh “ortak” në çdo segment të jetës tënde. Kjo është vërtetë e rëndë dhe e pa justifikueshme në anën tjetër.

Kushtetuta dhe shumë-etniciteti

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 3.1 përmban: *“Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, në respektimin e sundimit të ligjit...”*³. Nocioni shumetnik ngre shumë pasoja negative në rrugën e shtet ndërtimit të mëtejshëm, sepse, komuniteteve u

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

mundëson të kenë hapësirë shumë të madhe në drejtim të avancimit të statusit të tyre si qytetarë dhe shtetas të Republikës së Kosovës. Nocioni “shumetnik” nuk ka qëndruar në Kushtetutën e KSA të Kosovës të vitit 1974. Në parimet themelore të kësaj kushtetute pika 1. thuhet: *“Lidhur me të kaluarën dhe jetën e përbashkët dhe përpjekjeve për liri dhe progres social, Shqiptarët, Myslimanët, Serbët...”*, si edhe neni 1 pjesa e parë e dispozitave të përgjithshme ku thuhet: *“K.S.A. e Kosovës, është bashkësi shoqërore politike socialiste, demokratike dhe bashkësi vetëqeverisëse e njerëzve punues dhe qytetarëve të barabartë, Shqiptarë, Myslimanë, Serbë...”*⁴, çka do të thotë se, komuniteti serbë nuk është renditur si komunitet i dytë edhe pse kjo kushtetutë është miratuar dhe fuqizuar nga Kuvendi i KSAK, por është kushtetutë e cila është miratuar në pajtim me kushtetutën e Republikës së Serbisë dhe me kushtetutën e ish federatës Jugosllave. Pra, ky akt me fuqi më të lartë juridike nuk e ka emërtuar Kosovën si territor me shumë etni edhe pse Kosova ka qenë formalisht si pjesë e Serbisë dhe ish Federatës Jugosllave. Andaj, si mundet ky nocion të gjejë vend në Kushtetutën aktuale të Republikës së Kosovës, pas një lufte shkatërrimtare, vrasjeve, dhunimeve e çka jo, nga po të njëjtit njerëz, nacionalist me mendësi mesjetare kishtarë sllave dhe të ketë status të barabartë me komunitetin shqiptarë shumicë në territorin e Republikës së Kosovës? Këtë nocion “shumetnik” nuk e ka asnjëra prej kushtetutave të fqinjëve tanë, madje edhe më gjerë: Bullgaria, Greqia, Kroacia, Italia, Austria, Turqia, Kanada, Sllovenia dhe Maqedonia etj. Jemi të vetëdijshëm se të gjitha brenda territorit të tyre kanë komunitete madje në numër shumë e shumë më të madh se sa Kosova, por, asnjëra prej tyre në aktin e vet më të lartë nuk e kanë inkuorporuar nocionin e tillë, siç ka pranuar republika e Kosovës. P.sh, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ku është e njohur edhe pse të dhënat e kësaj republike nuk e pohojnë një fakt ekzistues, se pjesëtarët e kombit shqiptar në këtë republikë janë po thuaj në numër të barabartë me pjesëtarët maqedonas dhe nuk e gëzojnë statusin çfarë e kanë serbët në kushtetutën tonë. Neni 9 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë përmban: *“Shtetasit e Republikës së Maqedonisë kanë barazi në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra, prejardhja kombëtare e shoqërore, bindja politike dhe fetare, gjendja pasurore e shoqërore”*⁵. Siç po e vërejmë askund nuk përmenden komunitetet e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, por në mënyrë elegante shmangin inkuadrimitin e komuniteteve tjera, qofshin pakicë apo në numër më të madh - e që kanë komunitetin shqiptarë shumë herë më të madh në numër se sa ne në Kosovë që kemi komunitetin serb; Të shohim si qëndron çështja me Republikën Kroate, si ajo e ka të rregulluar këtë problem të komuniteteve? Kushtetuta e Republikës së Kroacisë Pjesa e III lidhur me liritë dhe të drejtat themelore ja se si e rregullon: Kushtetuta e Republikës së Kroacisë neni 16 thotë: *“Në Republikën e Kroacisë pjesëtarët e të gjitha kombeve dhe pakicave janë të barabartë”*⁶. Pra, as shteti kroat nuk është lëshuar në veçanti të merret me komunitetet përkatëse të cilat jetojnë brenda territorit kroat, por në mënyrë korrekte dhe parimore i ka barazuar të gjithë duke qenë të vetëdijshëm se popull shumicë në Kroaci është kombi kroat, gjërat e njohura nuk ka nevojë me i dëshmuar. Të provojmë me kushtetutën e Republikës së Bullgarisë, neni 2 i kësaj kushtetute përmban: *“Republika e Bullgarisë është shtet unitar me vetëqeverisje lokale. Në të nuk lejohen formacione territoriale autonome...”*⁷. Edhe në këtë kushtetutë fare nuk përmenden komunitetet pakicë, sepse i konsideron të gjithë qytetarë dhe shtetas të barabartë dhe si të tillë nuk i trajton çfarë i trajton kushtetuta

⁴Kushtetuta e K.S.A.K, viti 1974, parimet e përgjithshme, Pjesa e parë, neni 1, po aty, faq. 540 (teksti i përbashkët i tri kushtetutave, e R. Të Serbisë, të Vojvodinës, K. S. A. Të Kosovës, botim i Sav. Administracija, Beograd, 1974).

⁵Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 9.

⁶Kushtetuta e Republikës së Kroacisë. Botim i Albin, Tiranë, 1998.

⁷Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, botim i Albin, Tiranë, 1995.

e Republikës së Kosovës. E de facto në Bullgari jetojnë një numër i madh i pjesëtarëve të përkatësisë turke e të tjerë po ashtu në numër shumë më të madh se sa serbë në Kosovë. Po këtu më duhet të them se në nenin 24.2 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës shkruan: “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, vendimeve politike ose të tjerë...”⁸ dhe afro 30 nene i përkasin lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe domosdoshmërisht duhet të them se çfarë iu desh edhe pjesa e veçantë - kapitulli i III i cili trajton dhe rregullon enkas liritë dhe të drejtat themelore për herë të dytë të serbëve, janë këta pjesëtar të këtij komuniteti “ENGJUJË”!? dhe, duke imponuar përgjegjësinë për subjektet shtetërore për kujdesin, garantimin shtesë lidhur me komunitetin serb!!!. E këtu edhe një dështim i ndërkombëtarëve, fare nuk flitet për komunitetet e tjera në Republikën e Kosovës. Diskriminim i thellë ndaj pjesëtarëve të komuniteteve tjera siç janë: Turqit, Boshnjakët, Ashkallitë, Romët, Kroatët, Malazezët... etj. Pra, ja çfarë dispozita dhe pjesë përmban kushtetuta e republikës së Kosovës. Për t’u habitur?!

Gjuha dhe shkrimi

Çështja e rregullimit të gjuhës, përdorimit dhe shkrimit të saj, është çështje jetike që i bënë popujt, kombet të tregojnë identitetin e tyre, vlerat kombëtare që dallohen në mes vete kudo që gjenden. Andaj, përdorimi i gjuhës në Kushtetutën e Republikës së Kosovës ja si është e rregulluar: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 8 të saj shkruan: “*Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe*”. Nuk dua këtu me ngarkuar punimin lidhur me rëndësinë që ka gjuha për një komunitet përkatës, dhe çka ajo paraqet e tjera të tjera, por del qartë nga dispozita që cituam më parë, se gjuha serbe ka status të njëjtë me gjuhën shqipe, një popullsi e cila më tepër se 150.000 - 200.000 (mijë) frymë nuk ka në Kosovë, trajtohet në mënyrë të barabartë!!!. Të shohim në shtetet për rreth nesh ose brenda regjionit tonë ballkanik si është rregulluar përdorimi i saj? Kushtetuta e Republikës Kroate çështjen e gjuhës e rregullon në këtë mënyrë: Në kushtetutën kroate shkruan lidhur me gjuhën dhe përdorimin e saj kështu: “*Në Republikën e Kroacisë përdoren zyrtarisht gjuha kroate dhe shkrimi latin*”⁹, derisa në njësitë lokale të veçanta krahas gjuhës kroate dhe shkrimit latin mund të vihen në përdorim zyrtar edhe një gjuhë tjetër dhe shkrimi cirilik ose shkrime të tjera në kushtet e përcaktuara me ligj. Pra, gjuhë zyrtare është kroatishtja bile është normuar edhe shkrimi se çfarë e si do shkruhet, lëre më të trajtohet ndonjë gjuhë me gjuhën zyrtare - kroatishten. Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë çështja e gjuhës ja si është rregulluar: Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë thotë: “*Në republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe shkrimi cirilik*”¹⁰, çka do të thotë se, gjuhë zyrtare është vetëm një, madje edhe e shkrimit cirilik, a shqiptarët si shtetas të këtij shteti fqinjë, “nuk kanë tru, nuk kanë ndjenja kombëtare, sepse, ata nuk preken, nuk e ndiejnë veten të nënçmuar dhe të fyer si serbët e Kosovës”!? Dhe, në nenin 7.2 të po kësaj kushtetute shkruan: “*Në njësitë lokale, në të cilat përbejnë shumicën e pjesëtarëve të kombësive në përdorim zyrtar krahas gjuhës maqedonase dhe shkrimit cirilik janë edhe gjuha dhe shkrimi i kombësive në mënyrën e sanksionuar me ligj*”, pra, u mundësohet varësisht prej numrit, po e vëreni se në numra shndërrohen pjesëtarët e komuniteteve të tjera për ta përdorë gjuhën e tyre krahas gjuhës maqedonase dhe shkrimit cirilik e cila

⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kroacisë, botim i Albin, Tiranë, 1998, neni 12.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, botim i Albin, Tiranë, 1998.

gjë sërish rregullohet apo sanksionohet me ligj, gjë që gjendjen faktike në Republikën e Maqedonisë e kemi të njohur çfarë është në realitet! Në shtetin Rumun gjuhë zyrtare është gjuha rumune, shih, neni 13 i Kushtetutës Rumune si e përcakton: “*Gjuhë zyrtare në Rumani është gjuha rumanishtë*”¹¹. Pra, kanë ekzistuar shumë mundësi më të mira për përcaktimin e çështjes së gjuhëve dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe as kënd duke mos e nënvlerësuar apo pamundësuar përdorimin e gjuhës amtare duke e rregulluar me ligj përdorimin dhe shkrimin e gjuhës në njësitë lokale pavarësisht a paraqesin shumicën apo pakicën, jo edhe ti shndërrojmë në numra si në Republikën e Maqedonisë.

Sovraniteti

Çështja e sovranitetit shtetëror është rregulluar në Kapitullin e I, në dispozitat themelore neni 1 ku thuhet: “*Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm*” mbaron cit. Derisa në nenin 2 të kushtetutës shkruan: “*Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacënueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj*” mbaron cit. Sot në teori dhe në praktik çështja e sovranitetit është zbehur do të thosha është disi si një e drejtë relative, sepse shtetet demokratike evropiane dhe më gjerë çështjen e sovranitetit e kanë konsumuar me shekuj dhe tani predikojnë se sovraniteti nuk është i qenësishëm çfarë ka qenë dhe i jepet rëndësi mirëqenies së popullit, pra, aspektit material, ngritjes së kapaciteteve ekonomike e të ngjashme. Por, për shtetet çfarë është Kosova në fazën transitore drejt një shteti ku duhet të sundoi ligji - e drejta, ku duhet të respektohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut... sovraniteti e ka kuptimin dhe rëndësinë e vet. Në kushtetutën tonë në fuqi çdo gjë është e lidhur me sovranitetin është e shkruar shumë mirë, por, a thua realiteti i përgjigjet këtyre që përmban Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në fakt, realiteti është krejt tjetër, nuk mund të flitet për shtrirje të sovranitetit kur mungon ose çenohet liria e lëvizjes për qytetarët e komunitetit shqiptar për të lëvizur lirshëm në tërë territorin e republikës së vet, kur nuk shtrihet pushteti dhe qeverisja demokratike në tërë hapësirën e Republikës së Kosovës, si mund të themi diçka që nuk ekziston, *de facto* ajo pjesë e veriut të Kosovës është e pa kapshme për komunitetin shqiptar, ku nuk pranohet ky akt që ne e quajmë Kushtetutë, *ku banorët e saj nuk e njohin shtetësinë e Republikës së Kosovës*, ku integriteti i saj shkelet çdo herë kur hyjnë përfaqësuesit e shtetit serb pa leje, pa njohur fare qeverinë apo pushtetin qëndror të Republikës së Kosovës, madje, e çenojnë integritetin e saj edhe brenda vetë Kuvendit të Republikës së Kosovës duke e quajtur atë jo me emrin zyrtar, por si “*Kosovë dhe Metobia*”, atëherë për çfarë sovraniteti dhe integriteti behët fjalë!; Ku brenda vet Kuvendit pjesëtarët e komunitetit serb nuk janë qytetarë shtetas të Republikës së Kosovës, ku numri më i madh i tyre si deputet as që kanë lindur në hapësirën e Republikës së Kosovës, këtë pyetje askush nuk e ka shtruar, duke iu ikur gjërave të cilat mund t’i prishin “*teket*” e klasës politike brenda vetë Kuvendit si organ më i lartë i shtetit të Kosovës. Atëherë, për çka dhe si të themi se Republika e Kosovës na qenka shtet sovran, unik, demokratik dhe i pandashëm?, kur *de facto dhe de jure* nuk e ka mbikëqyrjen mbi tërë hapësirën territoriale të Republikës së Kosovës. Gjërat nuk duhet t’i shtrembërojmë, aq më pak popullin për ta manipuluar se çdo gjë është në “*rregull*”!? Pra, në fakt kjo pjesë e territorit të Republikës së Kosovës gjer më tani nuk është integruar në hapësirën e territorit të Republikës së Kosovës, sepse, akoma qëndron edhe pas 16

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Rumanisë, botim i Albin, Tiranë, 1995.

viteve në liri e ndarë me urën mbi lumin e Ibrit. Ky është realiteti i hidhur dhe **“dubet ta pranojmë publikisht...”** derisa nuk ke qasje formale e as faktike në këtë pjesë të territorit tonë. Në Kushtetutën e K.S.A. të Kosovës neni 3. 2 shkruan: **“Territori i KSAK nuk mund të ndryshojë pa pëlqimin e Kuvendit Krashinor”**¹² mbaron cit., kjo do të thotë se ndryshimi i cilës do pjesë të territorit të Kosovës behët vetëm me miratimin e Kuvendit të Kosovës, andaj, si ndodhi që të nënshkruajnë dy persona në emër të Kuvendit aktual të Republikës së Kosovës? Kjo është thjeshtë shkelje e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Unë nuk jam me profesion i lëmit ku studiohen dukuritë dhe fenomenet gjeostrategjike, por si laik mund të them me bindje të thellë se ligjet natyrore nuk mund koka e njeriut ti krijojë por as edhe t’i ndryshojë, përveç se mundë të merret eventualisht me përmirësimin e gjendjes ekzistuese. Pra, si ka mundësi kufiri me Republikën e Shqipërisë të jetë vija e cila e ndanë territorin nga territori i Republikës së Kosovës e drejtë mbi majën e bjeshkës (kodrës), ndërsa kjo vijë si të vijë te kufiri me Malin e Zi, devijon duke u shtrirë në hapësirën e Republikës së Kosovës! Kjo nuk mund të kalojë pa llogaridhënie nga strukturat e larta shtetërore, (këtë gjë e vëren edhe një fëmijë i mitur). Pra, qeveritarët i dhurojnë territor shtetit tjetër. Më gjerësisht, shih punimin e Prof. Dr. Zejnullah Gruda¹³ **“Demarkacioni Kosovë - Mali i Zi”**.

Çështja që Kushtetutën e Republikës së Kosovës e bën të jetë në grupin e kushtetutave të ngurta është procedura e miratimit të saj, ku për këtë duhet të votojnë dy të tretat e të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe dy të tretat e përfaqësuesve të vendeve të rezervuara për komunitetin serb. Shih si e rregullon Kushtetuta e Republikës së Kosovës këtë çështje kur është në pyetje ndryshimi dhe plotësimi i Kushtetutës në fjalë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 65 cakton autorizimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në nenin 65, pika 2 shkruan: **“Vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3 e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3 e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë”**¹⁴ mbaron cit., kjo dispozitë kushtetuese në mënyrë klasike është diskriminuese dhe shkelje e rëndë e parimeve themelore të vetë Kushtetutës, sepse, më herët kemi përmendur se të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës para kësaj kushtetute dhe ligjit janë të barabartë. Sepse, edhe vota është e barabartë, një votë një individ, është votë e fshehtë dhe e drejtë kushtetuese nëse dëshiron me e realizuar apo jo. Atëherë pse, një gjë e këtillë është pranuar të qëndroj në këtë akt themeltar të Republikës së Kosovës? Kjo është njëra prej pengesave më të mëdha dhe sfidave të tashme dhe të ardhme lidhur me fatin e tërë Kosovës. Kjo dispozitë është ajo që komunitetit serb i jep hapësirë të pa kufizuar për të ndalë (stopuar) çdo nismë konstruktive që shpie përpara në rregullimin e mirëfillt të çështjeve kapitale për Republikën e Kosovës. Këtë dispozitë asnjë prej kushtetutave të cilat unë i kam hulumtuar nuk e përmbajnë apo nuk qëndron te asnjëra prej tyre! Kjo është si e tillë, një gjë absurde po edhe aq denigruese për shumicën e popullsisë së Republikës së Kosovës, që në gjuhën formale juridike do të thotë se **“pakica qeverisë me shumicën e popullsisë shqiptare në Republikën e Kosovës”**. Faktikisht, as gjë nuk mundë të ndryshohet dhe plotësohet në kushtetutën aktuale të Republikës së Kosovës pa votën e 2/3 - ve të komunitetit serb, gjegjësisht, të deputetëve serbë në Kuvendin e Kosovës. Kjo është **“dburata e z. Abtisarit”** të cilën përfaqësuesit e Kosovës gjatë hartimit të Kushtetutës nuk e kanë pas të njohur apo e kanë minimizuar rëndësinë e

¹² Kushtetuta e KSAK, viti 1974, teksti i përbashkët me Kushtetutën e R.së Serbisë, Kushtetutën e KSA të Vojvodinës dhe Kushtetuta e KSA e Kosovës, botim i S.Admin. Beograd, 1974

¹³ Gruda, Dr. Zejnullah: **“Aspekte ndërkombëtare të demarkacionit: mësimet për rastin e Kosovës, Botim i GIZ, Demarkacioni Kosovë - M. i Zi, 2016, Prishtinë.**

¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.

saj (këtu nuk akuzoj asnjërin prej tyre sepse të gjithëve u ka munguar përvoja) dhe i kanë dhënë rëndësi shpalljes së pavarësisë, me çdo kusht duke rrezikuar për çështjen e kauzës - PAVARËSI! Pra, në Republikën e KOSOVËS qeverisë *“Pakica serbe mbi shumicën e popullsisë shqiptare” de fakto dhe de jure*. Ky është realiteti aktual i pa kontestueshëm deri më tani! Nuk është e drejtë kjo, nuk është dashtë të veprohet kështu, d.m.th., kjo të ndodh menjëherë pas luftës së përgjakshme, viktimave të luftës, shkatërrimeve, pas vrasjes së fëmijëve dhe burrave në furra të ndryshme, dhe therjen e tyre para nënave... është fakt që nuk mund të justifikohet, madje as me *“pavarësinë”!*? Këtë dispozitë kushtetuese u shprehëm se asnjë prej kushtetutave të studiuara nuk e përmbajnë në vete votën e dyfishtë prej 2/3 të dy grupimeve të deputetëve të Kuvendit apo Parlamentit përkatës shtetëror. Për shembull, kushtetuta e shtetit hungarez në nenin 24, pika 5 shkruan: *“Për ndryshimin e kushtetutës si edhe për marrjen e disa vendimeve të veçanta të përcaktuara nga kushtetuta kërkohet vota e dy të tretave (2/3) të përfaqësuesve të Asamblesë Kombëtare”*¹⁵; Derisa, Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë në neni 81, pika 3. shkruan: *“Kuvendi popullor i miraton ligjet dhe aktet e tjera me shumicën e më shumë se gjysmës së përfaqësuesve të popullit të pranishëm, përveç se, kur kushtetua kërkon një shumicë tjetër”*¹⁶; Të shohim si e ka rregulluar këtë çështje Kushtetuta e republikës së Kroacisë? Neni 82 i Kushtetutës së Republikës Kroate përmban: *“...Dhoma e deputetëve dhe Dhoma e rretheve i marrin vendimet me shumicë votash, kur janë të pranishëm shumica e përfaqësuesve”*¹⁷, sepse, këtu kemi të bëjmë me Parlamentin i cili përbëhet prej dy dhomave. Pra, si përfundim për këtë çështje mund vetëm të themi se edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ka pas mundësi apo alternativa se si ta rregullojë çështjen e ndryshimit dhe të plotësimit të Kushtetutës në fuqi duke zgjedhur njërin prej alternativave nga kushtetutat e fqinjëve tanë brenda regjionit.

Trashëgimia kulturore

Një çështje tjetër që në shikim të parë nuk ngre ndonjë vëmendje të madhe të opinionit të gjerë, por, nga ana tjetër si vlerë e veçantë e një komuniteti luan rol të rëndësishëm në rrugëtimin tonë të shtet ndërtimit. Është fjala për trashëgiminë kulturore dhe fetare në shtetin e ri të Kosovës, përkatësisht lidhur me besimin fetar. Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 8 thotë: *“Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare”* mbaron cit., kjo që përmban dispozita e cituar mund të jetë bërë me vetëdije si një lloj qëndrimi karshi faktorit ndërkombëtar që të mos lenë përshtypje të besimit fetar islam për të mos e penguar procesin e shpalljes së pavarësisë, gjegjë, të mos ndikohet negativisht te faktori ndërkombëtar. Por, mendimi im është, po qe se vërtetë është menduar në këtë drejtim, konsideroj se është bërë gabim trashanik sepse, sot askush në botë nuk e çmon individin që heq dorë nga besimi përkatës e të mos aderojë në një besim tjetër përkatës. Do të them se nuk do të shihej si diçka e mirë. Përndryshe e tërë bota e ka të njohur sjelljen e shqiptarëve kudo që gjenden lidhur me besimet fetare, asnjë vend në botë nuk e ka në të vërtetë harmonin e njerëzve mbi bazën e besimit si në trojet shqiptare, jemi shembull për këtë vlerë. Por, të thuash se kosovarët janë laik, në gjuhën e thjeshtë do të përshkruhej se jemi *“të pa fë”* është jo e drejtë për shumicën e qytetarëve shtetas të Republikës së Kosovës. Madje, kjo i ka sjell dëme sa i përket njohjeve nga shtetet e besimit islam.

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Hungarisë, botim i Alpin, Tiranë, 1995.

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, botim i Albin, Tiranë, 1995.

¹⁷ Kushtetuta e Republikës Kroate, botim i Albin, Tiranë, 1998.

Asnjë prej komuniteteve të tjera që jetojnë për rreth nesh, në shtetet fqinje nuk e fshehin përkatësinë e besimit fetar siç e bëri Kosova me aktin e vet kushtetues. Siç janë: Bullgaria, Greqia, Kroacia, Maqedonia, Hungaria, Rumania e Sllovenia. Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë në nenin 13. pika 3 thotë: “*Feja tradicionale në republikën e Bullgarisë është besimi fetar Ortodoks Lindor*”¹⁸; Kushtetua e Republikës së Greqisë, neni 3 thotë: “*Feja mbizotëruese është ajo e Kishës Ortodokse Lindore të Krishtit*”¹⁹; Ndërsa Kushtetuta e Italisë, neni 7 thotë: “*Shteti dhe Kisha Katolike, janë secila në fushën e vet, të pavarura dhe sovrane*”²⁰, por, dëshmon se fe mbizotëruese është feja katolike. Të shohim me shtetin fqinjë si është rregulluar çështja e besimit fetar? Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në nenin 19 pika 3. shkruan: “*Kisha Ortodokse, bashkësitë e tjera dhe grupet e tjera fetare janë të ndara nga shteti dhe janë të barabarta para ligjit*”²¹, që do të thotë se, fe zyrtare në Republikën e Maqedonisë është besimi Ortodoks Lindor. Çfarë ka të keqe në zgjidhjet dhe përcaktimet e këtyre shteteve lidhur me besimin fetar? Andaj, edhe Republika e Kosovës në Kushtetutën e vet ka pas mundësi të neni 8 duke respektuar dispozitën e shkruar, por, të mos i vë pikë, duke shtuar një presje (,) dhe vazhduar po aty me: “*ku shumica e popullsisë është e besimit fetar islam*”, asgjë e rëndë, asgjë që do i nxiste komunitetet e tjera, e aq më pak komunitetin serbë sepse, ata e kanë pas të njohur madje edhe para një shekulli! Dhe me një shtesë do të thoshim se: “edhe të gjitha besimet e tjera janë të barabarta para ligjit” të republikës së Kosovës. Por, jo si kolektivitet të shpallemi si njerëz pa besim fetar!

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës Kapitulli i III i saj, në neni 58, pika 3 e ngarkon shtetin e Kosovës citojë: “Republika e Kosovës do të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilëve mundë t’u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar” mbaron cit., si dhe në nenin 59 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës për kujdesin dhe masat ndaj individëve të cilët mundë t’u nënshtrohen kërcënimeve ... etj”. Derisa, për besimet e komuniteteve të tjera kushtetuta nuk përmban asgjë! Është për t’u habitur se projekti gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (lexo Ahtisari) përfshinë jo më pak se 5 faqe të plota lidhur me besimin fetar ortodoks lindor (sllav) dhe kishën ortodokse me afro 25 nene duke u kujdesur dhe përcaktuar përgjegjësi dhe detyrime për Republikën e Kosovës dhe për pasurinë e kishës ortodokse serbe!?. Kjo përkujdesje e nivelit të këtille na jep të kuptojmë dhe ta perceptojmë se besimi fetar ortodoks në Republikën e Kosovës është besim mbizotërues karshi besimeve të tjera jo vetëm të shumicës së popullsisë shqiptare në Kosovë por, edhe besimeve të komuniteteve të tjera që bashkëjetojnë në Republikën e Kosovës! Kjo është një gjendje të cilën z.Ahtisari e ka keqpërdorë në dëm të besimit fetar islam, por, jo vetëm kaq, por edhe të besimeve të tjera fetare, thjeshtë ka shfrytëzuar zbrazëtitrën të cilën e kanë lënë shqiptarët duke mos u deklaruar shprehimisht lidhur me besimin fetar përkatës.

Atë që e shtrova më herët për një lloj strategjie kam bindjen e fortë se vërtetë e kanë menduar keq, sepse, asgjë më tepër nuk kanë përfituar sa i përket anës në aspektin e njohjeve të shtetit tonë në rrafshin ndërkombëtar, por, kanë çenuar një të drejtë natyrore të komunitetit shqiptar me besim islam, sepse, askush nuk mundet nëpërmes një akti formal të më ndalojë në kohën e tashme të drejtën e besimit për të cilin unë deklarohe.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, botim i Albin, Tiranë, 1995.

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Greqisë, botim i Albin, Tiranë, 1995.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Italisë, botim i Albin, Tiranë, 1995.

²¹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, botim i Albin, Tiranë, 1998.

Është e drejtë e njohur botërisht, andaj edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës më garanton se besimi është çështje personale e individit se cilit konfesion fetar do t' i takoj.

Dhe, çështja e fundit për të cilën në pika më të shkurtra do bëjë fjalë është pak sa më shqetësuese dhe e dhimbshme, sepse, ushtrohet nga vetë subjektet shtetërore. E kam fjalën për shkeljet që i bëjnë Kushtetutës vetë institucionet të cilat e miratojnë atë dhe ligjet në vijueshmëri si dhe vet institucioni i cili e ka detyrë të vlerësojë kushtetutshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore nëpërmes interpretimit dhe të mbrojtë parimin e kushtetutshmërisë duke nxjerrë një akt konkret të natyrës përkatëse lidhur me opinionin e vet Gjykatës Kushtetuese. Kjo tregon se në Kosovën e pas luftës ky institucion që emërtohet Gjykatë Kushtetuese nuk e ka kryer funkcionin për të cilin edhe është krijuar. Sepse, kjo gjykatë vendimmarrjen në të shumtën e rasteve e ka bërë sipas interesit dhe do të thosha se ka qenë e njëanshme në këtë drejtim të zgjidhjes - dhënies së vendimit i cili sipas nenit 116 pika 1. është i detyrueshëm për të gjithë subjektet e së drejtës, qofshin ata persona fizikë apo juridikë, si edhe për vetë institucionet e Republikës së Kosovës. P.sh. përzgjedhja e gjykatësve të po kësaj gjykate përbën shkeljet e vetë Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këtu të gjitha komisionet parlamentare por edhe vetë Kuvendi (parlamenti) i republikës bënë shkeljen e aktit të cilin vet e ka miratuar duke përzgjedhë gjykatësit: Neni 114 pika 1. thotë: "Gjykata përbëhet nga nëntë gjyqtarë, të cilët duhet të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse..."²², pra, kjo dispozitë kushtetuese tregon se si duhet të veprohet në rastin konkret nga ana e organeve përkatëse - të përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës në fjalë. Kjo dispozitë nuk është përfill që në fillim të punës të këtij institucioni të veçantë që të ushtrojë një funksion të rëndësishëm në interpretimin dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë së akteve ligjore, d.m.th., të vlerësojë pajtueshmërinë e akteve ligjore me kushtetutën dhe, kur vet organi i cili përfaqëson tërë popullin e Republikës së Kosovës nëpërmjet organeve të veta që funksionojnë brenda Kuvendit të Kosovës nuk i respektojnë këto dispozita, atëherë çfarë të pritët prej subjekteve të tjera! Asnjëri prej gjykatësve të zgjedhur për këtë gjykatë nuk i ka plotësuar kushtet për të ushtuar funksionin përkatës profesional. Sepse, asnjëri prej pjesëtarëve të komunitetit shqiptar nuk i ka përbushur kushtet e kërkuara, siç është përvoja 10 vjeçare e punës në punët profesionale përkatëse. Kjo është shkelje e rëndë dhe nuk mund të justifikohet me as gjë, sepse, Kosova gjithnjë ka prodhuar juristë të shkëlqyeshëm, pra, Republika e Kosovës ka juristë të njohur të cilët kishin me ushtuar funksionin e gjykatësit duke pas parasysh përvojën e tyre shumë vjeçare. Kjo shkelje ka vazhduar në të gjitha mandatet në vijim pa dallim fare dhe pa kurrfarë vëmendje apo përmirësimi në përzgjedhjen e gjykatësve nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës; Shkelja tjetër që ushtrohet nga vet gjykata është në vendimmarrjen e saj. Neni 116 pika 1. dhe neni 116 pika 4. flasin për Vendimin si akt me të cilin gjykata shpreh opinionin e vet lidhur me rastin konkret, pra, vendimmarrja është me VENDIM, jo me Aktgjykim. Në nenin 116 pika 4. shkruan: "*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallen në Gazetën Zyrtare*", pra, Gjykata vendimmarrjen e ka bërë duke u bazuar në Rregulloren apo ndonjë akt tjetër nënligjor. Asgjë në këtë akt nuk mund të ndryshohet dhe plotësohet nëse nuk zhvillohet e njëjta procedurë kushtetutë dhënëse ashtu siç edhe është krijuar nëpërmes amendamenteve kushtetuese, e jo edhe të zëvendësohet dispozita kushtetuese me një akt të brendshëm të Gjykatës në fjalë. Mos të lëshohem edhe në rastet e dy presidentëve ku gjykimi ka qenë nën një i ngjyrosur me prapavijë politike dhe interesa subjektive, është fjala për rastin e presidentit SEJDIU, deri sa, për rastin PACOLLI

²² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

as që bëhet fjalë, sepse, shkelja është bërë nga vetë Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kam bindjen, se ka qenë shkelje e “qëllimshme” që në momentin e numërimit të deputetëve të Kuvendit për të bërë kuorumin e nevojshëm për të filluar seanca. Të gjitha këto raste përfundojnë me aktin që ne rëndomë e nxjerrim kur çështja juridike e cila paraqet kontekst përfundon me AKTGJYKIM, pra, pranë gjykatave të rregullta, por, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës nuk është gjykatë e rregullt dhe pjesë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, por, është gjykatë e pavarur dhe e veçantë (speciale) me fushëveprim, me objektin e zgjidhjes të një natyre krejtësisht tjetër, merret kryesisht me kontrollin e pajtueshmërisë së akteve ligjore me Kushtetutën, madje edhe kur merret me shkeljen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut pasi të shteren të gjitha mjetet goditëse, prapë, merret me kushtetutshmërinë e tyre edhe pse janë akte të veçanta juridike që e kanë vendosur në mënyrë meritore çështjen në gjykatat e rregullta.

Në lidhmëni me shkeljet e bëra nga ana e vetë Gjykatës Kushtetuese pjesëmarrës janë të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me vet faktin që i kanë zgjedh kandidatët që kanë garuar për gjykatës pa i plotësuar kushtet e kërkuara me konkurs në njërën anë, dhe në anën tjetër, pse i kanë respektuar udhëzimet të cilat në formë të aktgjykimit ua ka adresuar gjykata në fjalë. Jo vetëm kaq, shkeljet janë bërë apriori nga Paneli zgjedhor i kandidatëve duke i intervistuar kandidatët të cilët nuk i kanë përmbushur kriteret kushtetuese dhe i a kanë adresuar pastaj Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pra, si rrjedhojë e të gjitha këtyre që u shtruan më lartë rezultojnë me një situatë e cila edhe vetë sistemin e së drejtës në Republikën e Kosovës e bënë të jetë jo i përshtatshëm, jo efektiv në rregullimin dhe zbatimin e së drejtës në përditshmërinë tonë. Kjo vijë në shprehje drejtpërdrejtë në zbatimin e së drejtës disi do e them pak sa i rezervuar por në mënyrë të përzgjedhjes mbi bazë partiake jo edhe mbi bazën e shëndosh juridike, andaj, i tërë sistemi juridik njolloset jo për justifikime të mos njohjes të së drejtës por, për shkak të grupimeve jo parimore mbi bazën e interesave klanore, partiake, e kur se si të kuptohet se sistemi i së drejtës është jo i shëndosh, përkundrazi kemi ligje mjaftë të mira, kemi kuadro profesionale, por, duhet t’u japim hapësirë që të merren me ushtrimin e profesionit mbi bazën e ligjit jo edhe të anshmërive partiake.

Andaj, lidhur me të gjitha kërkohet në radhë të parë ndërgjegjësimi i elitës politike që qeverisë me pushtetin dhe popullin dhe të kuptuarit se shteti dhe e drejta nuk janë pronë private e tyre, dhe se duhet të jenë njerëz që i shërbejnë popullit e jo populli me u shërbye atyre. Dhe, le të bëjnë përpjekje maksimale në zbatimin e së drejtës, pra, respektimin dhe zbatimin e ligjit, për të mirën e përgjithshme, asgjë më pak apo më shumë.

Në vend të përfundimeve

Në vend të përfundimeve do veprojë pak më ndryshe: Do i lë hapësirë lexuesit që të gjykoj vet lidhur me të gjitha që u shtruan më lartë që të vlerësojë përmbajtjen e kushtetutës aktuale në fuqi dhe të krahasojë zgjidhjet e saja me zgjidhjet e Kushtetutës së K.S.A të Kosovës viti 1974, se cila prej këtyre dy kushtetutave është më substanciale në zgjidhjet e veta për të gjitha segmentet e jetës për qytetarët, për shtetasit e shtetit të Republikës së Kosovës!!!

LITERATURA:

1. Kurtesh, Dr. Saliu: “E drejta kushtetuese”, Prishtinë,1989. libri i I.
2. “Demarkacioni Kosovë - Mali i Zi”, botim i GIZ, Prishtinë,2016 (punimi i Gruda, Dr. Zejnullah: Aspekte ndërkombëtare të demarkacionit: mësimet për rastin e Kosovës).
3. Kushtetuta e R. S. Të Serbisë, Kushtetuta e R. S. të Vojvodinës, Kushtetuta e K. S. A. të Kosovës, botim i Savremena administracija, Beograd, 1974.
4. Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, 26 Mars 2007.
5. Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë.
6. Kushtetuta e Republikës së Greqisë.
7. Kushtetuta e Republikës së Hungarisë.
8. Kushtetuta e Republikës së Rumanisë, botim i Albin, Tiranë, 1995.
9. Kushtetuta e Republikës së Austrisë.
10. Kushtetuta e Republikës së Kroacisë.
11. Kushtetuta e Republikës së Italisë.
12. Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë.
13. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, botim i Albin, Tiranë, 1998.

Formimi ideor dhe estetik i Migjenit



Abstrakt

Formimi ideor dhe estetik i Millosh Gjergj Nikollës (Migjeni) përbën një shkollë për çdo krijues të mirëfilltë, pasi ai nuk njih cektësi, nuk është sipërfaqësor, horizontal, por vertikal, i provuar në veprën e tij si në poezi e ashtu dhe në prozë. Ky formim i shkallë-shkallshëm, nuk është derdhur shkallë-shkallshëm në krijimtarinë e tij, por kur ai ka arritur në majë, pa u ngutur, por vetëm atëherë kur ishte i bindur se i kishte thënë ato që duheshin thënë. Ky formim solid, edhe pse brenda një harku kohor jete të shkurtër, e kish orientuar dhe i kish krijuar bindjen se magjia e çdo krijuesi duhet të ishte jeta, me majat dhe humnerat e saj.

Siç edhe del nga kjo qasje në formimin e tij, Migjeni nuk qe «lustraxhi» në kuptimin metaforik të fjalës. Realitetin shqiptar e sheh drejtpërdrejt në bebe të syrit, arrin të zbulojë plagët e tij, me synimin që poezia dhe proza që na la të ishin sadopak për kushtet e kohës një pasqyrë e padeformuar dhe faktor i rëndësishëm në zhvillimin e jetës shpirtërore të njeriut, duke gjykuar se në procesin e krijimit letrar rol të rëndësishëm luajnë idealet e artistit, në dritën e të cilave ai pasqyron realitetin.

Ushqimi që ai mori nga ideologët dhe krijuesit më të zëshëm klasikë e bashkëkohës, veç orientimit nga jeta, ia shtuan vokacionin për t'i trajtuar shfaqjet e saj në një mënyrë moderne, larg, krejt larg provicionalizmit letrar e besoj, se kjo është një nga arsyet për të besuar se ai do të jetë një nga krijuesit më jetëgjatë të letërsisë shqipe.

Fjalë kyçe: *Migjeni, Shkodra, Manastiri, mësues, art, ide, realitet, vuajtje.*

Në formimin e përgjithshëm të çdo autori, element mjaft i rëndësishëm dhe i pashmangshëm është ndikimi i vendlindjes, qoftë si mjedis kulturor, qoftë si mjedis me veçori të caktuara natyrore, por edhe si mbartës i një stadi dhe trashëgimie historike, sociale, psikologjike, politike, etj.

I lindur më 13 tetor të vitit 1911 në qytetin e Shkodrës, Migjeni jetoi periudhat më dramatike dhe impulsive të një vendi të çuditshëm e tragjik, që ishte sa anadollak aq edhe iluminist e modern, sa mysliman e katolik aq edhe ortodoks, sa feudal e obskurantist aq edhe borgjez e demokratik, siç ishte Shqipëria e atyre viteve ku të huajt, studiues, turistë e agjentë shihnin në patriarkatin e saj vetëm ekzotikën e buzëqeshjes së çiltër të natyrës shqiptare e të mikpritjes.

Qyteti i Shkodrës, qytet i lashtë, i mbarsur me histori të lavdishme, ku janë mprehur mirë qoftë kultura, qoftë përpjekjet për liri, të tërheq vëmendjen me hapësirën e gjelbëruar që i ngjason një oazi të vërtetë, me malet e larta dhe shkëmbinj të thepisur që rrethojnë qytetin, ndërsa në brinjët e tij derdhen ujërat e Drinit, të Kirit e të Bunës. Tej ujërave të shumta, fusha është e pafund dhe syri i mahnitur pushon vështrimin në një liqen të bukur, marramendës, ku jeton një bimësi e palëvizur, shumëngjyrëshe.

Në këto vite qyteti ishte i rrethuar prej tensioneve patriarkale dhe po aty, me shfaqjet ekstreme, moderne të kohës, të cilat, tek pohonin një progres, shfaqnin në të njëjtën kohë edhe snobizmin, që përcillej me humorin elegant e mikpritjen zemërgjerë. Një aristokraci ekonomike dhe kulturore kishte endur rretjen e vet. E ngarkuar me misione të rëndësishme politike dhe përfaqësi në role konsujsh, ajo ishte e aftë të krijonte një dialog të zjarrtë me rrethet e kulturuar të besimit katolik dhe muhamedan e të thithte në këtë dialog të zjarrtë edhe krahun tjetër të rëndësishëm të besimit fetar, atë ortodoks.

Në ato momente të mprehta që kalonte populli ynë, shpesh ata i mënjanonin interesat e besimet fetare dhe në angazhimin për të qenë pranë kombit, sillnin përpjekjet e tyre të përbashkëta. Popullsia e kësaj treve, që gëzonte një edukatë dhe kulturë shpirtërore e mendore, pati aftësinë të orientohej në momentet më epike të udhëkryqeve që kalonte Atdheu. Ky ishte populli i thjeshtë i Shkodrës, i cili mbarte impulse brezash, mbarte botën e pasur shpirtërore, praktike dhe intuitive, edukatën dhe kulturën e thellë, etjen për dije, aftësinë për të rrokur progresin, hapin e vetëmohimit kombëtar. Kjo masë heterogjene në zhvillim e sipër, që përligjte në çdo hap të vetin emancipimin shpirtëror, ku punëtori, fshatari malësor e zanatçiu a tregtari i vogël ishin të komunikim të plotë e ndjente më fort se kushdo nervin politik të elektrizuar të një shteti të porsalindur. Migjeni ishte vetëm një vjeç kur u shpall pavarësia. Dhe jeta e tij zgjati sa vetë jeta e shtetit shqiptar, po të kemi parasysh 7 prillin e vitit 1939.

E Millosh Gjergj Nikolla e jetoi në rininë e tij periudhën zogiste, periudhë kaq e ngjeshur, dramatike, e pasigurtë, plot atentate, intriga të një niveli aziatik, të denja për artin antik apo shekspirian.

Gjithë kjo ngarkesë kohore do ta bëjë Milloshin më të rritur, më vëzhgues, do t'ia moderojë kuriozitetin femënor dhe do të fillojë kështu midis tij dhe kohës një përlëshje ku shfaqet personaliteti i tij, logjika dhe pasioni.

Migjeni jetoi shumë pak, gjithsej 27 vjet dhe për letërsinë shqiptare punoi vetëm katër vjet.

Familja ku u lind dhe u rrit shkrimtari i ardhshëm i përkiste vegjëlisë qytetare. Gjergj Nikolla, me tezgën e tij, i siguronte familjes së madhe prej nëntë vetësh një jetë të mjaftueshme. Por mirëqenia nuk zgjati shumë, një sërë fatkeqësish që i ranë mbi krye njëra pas tjetrës, e tronditën atë fort që herët. Kur Migjeni mbushi 5 vjeç, i vdiq e ëma. Pas humbjes së nënës, kujdesin për të dhe të motrat e mori përsipër gjyshja plakë. Më 1924 vdiq kryefamiljari dhe pas një viti, më 1925, edhe djali i madh. Vdekja e gjyshes në vitin 1926 qe grushti i fundit që gremiste familjen. Motrat e Milloshit që mbetën jetime, u rritën në shtëpinë e dajës, i cili u kujdes për to derisa i nxorri në jetë. Në këtë kohë Milloshi ndodhej në Tivar, ku e kishte dërguar i ati mbas mbarimit të shkollës fillore. I

mbetur jetim, u gjend në vështirësi për të vijuar më tej mësimet. Nga ky hall e shpëtoi daja, i cili më 1927 i nxorri një bursë për të ndjekur seminarin teologjik të Manastirit, të cilin Milloshi e kreu në vitin 1932.

Vitet që kaloi në këtë qytet patën rëndësi të veçantë në jetën e Milloshit. Kjo qe koha e formimit të tij ideor. Manastiri në fillim të viteve '30, ndonëse në periferi të shtetit jugosllav, karakterizohej nga një jetë pak a shumë e gjallë kulturore, po të mbajmë parasysh qytetet provinciale të Ballkanit të asaj kohe. Kishte kinema që frekuentohej me dëshirë nga banorët, sidomos nga rinia, teatër, ku krahas aktorëve vendës, jepnin hera-herës shfaqje edhe trupa nga qytete të tjera, të cilët kishin në gjirin e tyre aktorë të njohur në mbarë vendin, si dhe një orkestër frymore. Qyteti kishte edhe gazetën e vet, pa përmendur se banorët viheshin në dijeni të ngjarjeve të brendshme dhe të jashtme qendrore që shiteshin edhe në Manastir. Qytetit i jepnin gjallëri sidomos të rinjtë vendës dhe ata që vinin nga viset përreth për të ndjekur gjimnazin, akademinë tregtare dhe seminarin. Në jetën e tyre një vend të madh zinte veprimtaria jashtëshkollore; ata kishin ngritur një shoqëri kulturore, në mbledhjet e së cilës lexonin shkrimet e tyre, mbanin referate dhe zhvillonin debate për probleme shoqërore, kulturore dhe shkencore. Migjeni merrte pjesë aktive në këto veprimtari dhe u zgjodh për njëfarë kohe kryetar i shoqërisë. Krahas kësaj, ndiqte koncertet, shfaqjet teatrale dhe filmat që jepeshin, diskutonte me shokët për to, duke shfaqur mendimet e veta, për vlerat e tyre, për ekzekutimin e roleve prej artistëve etj.

Migjeni dallohej për zgjuarsinë e rrallë dhe për interesat e tij të gjëra intelektuale, të cilat u shprehën në përpjekjet e pareshtura që bënte për të pasuruar mendjen me sa më shumë dije. Lëndët kryesore që mësoheshin në seminar ishin historia e kishës, dogmatika, kalihetika, apologjetika etj. Vjeturinat teologjike, me të cilat pedagogët u mbushnin kokën të rinjve nuk e tërhiqnin Migjenin, i cili mësonte me dëshirë historinë, psikologjinë, pedagogjinë dhe gjuhët e huaja, sidomos frëngjishten dhe rusishten. Në kohën e lirë lexonte shumë dhe me pikësynime të caktuara. Edhe pasi nisi jetën e pavarur, ai nuk rreshti së punuari për të fituar dije të reja dhe për të zgjeruar horizontin mendor. Nga kujtimet e të afërmve dhe të shokëve del se Migjeni përpikëq vazhdimisht ta mbante veten në dijeni të të rejave të jetës kulturore dhe letrare të vendeve evropiane, duke u shkruar miqve dhe të njohurve, që gjendeshin jashtë vendit, të blinin për llogari të tij libra që i interesonin. Migjeni nuk bënte lexim të thjeshtë; veprat që i binin në dorë i lexonte me vëmendje të madhe, i studionte. Duke mbajtur shënime gjatë leximit e duke bërë përmbledhje të pjesëve që i dukeshin me interes.

Letërsia, filozofia, sociologjia, shkencat politike, historia e kulturës etj., ishin fushat e dijes që e tërhoqën më shumë. Nga shënimet që na ka lënë, nga kujtimet e shokëve dhe të afërmve si dhe nga librat e pakta që kanë shpëtuar nga biblioteka e tij, del se autorët më të preferuar për të ishin: Hygo, Balzaku, Shileri, Dostojevski, Çehovi, Lermontovi, simbolistët francezë dhe shkrimtarët realistë të dhjetëvjeçarëve të parë Sinkleri, Majakovski, Traven etj. Nga mendimtarët duhen përmendur Rusoi, Niçe, Shopenhauer, Hegeli, Voltëri, Spenseri etj.

Dhe ndikimet e këtyre mendimtarëve vijnë natyrshëm dhe zbrazen në hovet e frymëzimeve të tij poetike. Në atë burg vetmie ku ai gjendet, shpresa në të ardhmen e ngushëllon e i jep zemër për të jetuar. E atëherë *kangae* tij, mrekulli e besimit të plotfuqishëm ndër ideale, naltohet me vërtik shqiponje e në mes të asaj mizerijeje ku dergjet tragjikomedia e jetës, ndërmjet zgërdhimjeve të atyre që tallin idealet, prek për herë të parë kulmet poetike. Vetmia e rrit para syve të vet. Një emër i vjen te buza: Niçe! E për një çast këngëtar i të mjerëve puqet me këngëtarin e Mbinjeriut. Kjo botë duhet rrënuar! Kjo botë është e padenjël! Njeriu duhet të zhduket për të ardhur Mbinjeriu! Atë që filozofi-poet e tha me kuptime metafizike të veçanta, Migjeni e përsërit në një valë dëshpërimi të mbytur në një hov ditirambi. Duhet të ripërtëritje e shoqërisë nga themelet. Njerëzimi është kalbur! Duhet pastruar!

Dallimet konvencionale mes së vërtetës e së rrejtshmes janë false. Siç pati thënë Niçe, Njeriu (o Mbinjeriu) i rigeneruar nuk duhet të ketë dyshime, iluzione. Duhet të jetë një sfinks: pa zemër, pa ndjenja, vetëm logjik e violent.

Ndikimi i Niçes puqet këtu me atë të Dostojevskit (Raskolnikov, Stavrogin, Kirilov). Njeriu prej hekuri. Këtu Migjeni ndeshet me fenë, antagonistin e tij. Fenë ai e njihte mirë nga seminari i Manastirit, të cilin e kishte kryer jo nga dëshira, por për të mundur të vazhdonte studimet. Kur erdhi në atdhe dhe u fut në jetën e të varfërve, kontrasti i madh e shtangu. Atëherë dyshoi dhe ky dyshim që i idhët e plot mllëfpaditës, që u shpreh edhe në poezi, edhe në prozë.

Por ai adhuronte edhe Aliosha Karamazovin. Dhe njeriu që adhuron Alioshën, në mos qoftë fetar, është thellësisht njerëzor. Si Aliosha edhe ai kishte dalë prej seminarit duke u përzier me turmat ku vlojnë eprshet e mbrapshta. Dhe ishte i mirë e i pastër si Aliosha. Dashuritë e tij ishin platonike. Adhuronte bukurinë si ideal që frymëzon.

Krahas leximeve të tjera Milloshin e interesonte edhe historia e vendit, lëvizja shoqërore dhe mendore, që, në ato vite pasqyrohej në libra dhe të përkohshme. Veprën "Historia e Shqypnisë" të Ndoc Nikajt, të botuar nga Faik Konica në Bruksel në agimin e shekullit të kaluar, e ka lexuar me shumë vëmendje dhe në faqen 164 ka bërë shënimin: "Shumë interesante". Edhe shënimet në veprën "Vilhelm Teli" na shërbejnë të kuptojmë formimin e pikëpamjeve të tij.

Rol të rëndësishëm në formimin mendor të Migjenit luajti vetë jeta, përshtypjet e drejtpërdrejta nga realiteti. Atë e brengoste thellë atmosfera mbytëse që sundonte në seminar, e indinjonte disiplina e hekurt që shtypte çdo shfaqje të mendimit të lirë dhe synonte t'i edukonte seminaristët me frymën e nënshtrimit të verbër dhe ndaj çdo lloj autoriteti. Ai kishte për zemër të drejtën dhe nuk ngurronte të ngrinte zërin edhe kundër eprorëve sa herë që vinte re qëndrimet e tyre arbitrare. Kështu u soll ai kur mësoi se drejtorja e seminarit kishte mbajtur të fshehur shumë e bursës që gëzonin seminaristët, duke protestuar pa u tërhequr dhe në mënyrë energjike ndaj këtij veprimi bashkë me të tjerët, deri në arritjen e qëllimit.

Ndjenjën e pakënaqësisë ia shtuan edhe më fort shfaqjet e ndryshme të padrejtësisë shoqërore që vinte re përreth. Migjenit, si vëzhgues i mprehtë i realitetit, i bënin përshtypje të thellë lypësat e shumë të mbushnin rrugët e Tivarit e të Manastirit, skenat e varfërisë në Shkodër dhe në malësi, ku njerëzit e shtynin jetën nga dita në ditë duke kërkuar lëmshë ose duke shitur nderin. Pamjet e mjerimit e shtynë që, kur ishte në seminar, të vriste mendjen për shkaqet e kësaj dukurie. Në Tivar pyeste të moshuarit në se edhe në të kaluarën jeta e popullit të thjeshtë kishte qenë kaq e rëndë dhe nëse edhe më parë kishte pasur kaq shumë lypës.

Vështirësitë që hasi pasi kreu shkollën, ia shtuan bindjen se shoqëria shqiptare e kohës ishte ndërtuar mbi baza të shtrembra. Këtë e provoi mbi kurriz të vet. Kur u kthye në atdhe iu desh të priste 10 muaj për të zënë punë dhe u emërua mësues falë mpleksjes së disa rrethanave. Në fillim të viteve '30 qeveria shqiptare ndaloi shkollat private. Në vazhden e këtij vendimi u mbyll në Vrakë shkolla fillore, ku mësimet jepeshin në serbo-kroatisht dhe në vend të saj hapi dyert shkolla shqipe, ku Migjeni u caktua mësues. Konsulli serb dhe paria ortodokse e qytetit bënë çmos për ta penguar një gjë të tillë. Për këtë qëllim i kërkuan Migjenit që të mos e pranonte detyrën dhe si shpërblim, i premtuan t'i gjenin punë në Jugosllavi ose t'i siguronin bursë për studime të larta teologjike në Beograd ose në Angli, por orvatja e tyre shkoi kot. Migjeni nisi menjëherë punën në Vrakë ku fitoi dashurinë e fshatarëve, të cilët e përkrahën.

Migjeni e nisi punën si mësues në kushte të rënda shëndetësore. Më 1929 iu shfaq tuberkulozi, të cilin në rrethanat e internatit dhe të mungesës së mjeteve financiare, nuk mundi ta shëronte dot. Sëmundja iu zgjua në kushtet e rënda të punës në Vrakë më 1933, ku shkante nga Shkodra përditë me biçikletë për të dhënë mësim. Me mjete të pakta financiare shkoi të kurohej në Greqi, por u kthye brenda muajit pa u kuruar, sepse s'mundi të përballonte shpenzimet.

Pasi punoi për ca kohë si mësues në Shkodër, kërkoi të transferohej në Pukë, për efekt të klimës. Në prill-qershor 1937 sëmundja iu rëndua dhe në dhjetor u nis për në Itali, ku u shtrua në një sanatorium të thjeshtë. Por pa dobi, shëndeti i tij ishte rrënuar. "... jam i vobektë dhe përveç rrogës si mësues, s'kam edhe një të ardhun tjetër për të vazhduë kurën e naltpërmendun. Kam shërbye si mësues i detyrës nëpër malsitë e veriut, ku jeta e vështirë e atyne viseve ma rrenuen shëndetin e lumtuninë e jeme personale". Këto fjalë, me të cilat iu drejtua Ministrisë së Arsimit në fillim të vitit 1938 për të kërkuar që t'i zgjatej leja e pushimit, tregojnë se krahas dëshpërimit që e kishte pushtuar tek shihte që jeta po i shkonte tërthor, ai e kishte kuptuar se edhe ai sikurse njerëzit e gjorë të cilët i haste kudo, ishte viktimë e padrejtësive shoqërore.

Të gjitha këto bënë që në vetëdijen e Migjenit të forcohej më tej pakënaqësia ndaj realitetit, ndjenjë kjo, e cila bashkë me dashurinë për njeriun, u bë tipar mbizotërues i botëkuptimit të tij. Mjerimi, sipas tij, ishte mënxyra më e madhe për njeriun, poshtërimi më i madh që i bëhej atij. Mjerimi të bën zemërgur. Ai që e ka bërë zakon të hajë me bukë dhimbjen e turpin, ai nuk mund të ketë mëshirë. Mjerimi të bën hakmarrës. A mund ta falë lypësi i vogël zotninë që i ra shuplakë? Punëtori i papunë që shikon reklamata e kinemasë dhe të vitrinave pështyn përpara tyre. Mjerimi të bën të ngresh grushtin, të bën revolucionar.

Por jo gjithmonë. Sepse mjerimi të bën edhe alkoolik, vjedhës, prostitutë. Mjerimi të bën tuberkuloz, sifilitik, të çmendur. Kur nuk të bën cub, si ndër malet tona, të bën servil. Drama e dhimbshme e këtij korrupsioni vërehet më mirë në jetën e malit, aty ku shpirti është i zhveshur si shkrepat e tij të thatë e ku burrëria, me të gjitha virtytet që ajo përmbledh, është karakteristikë e këtij shpirti. Burri i malit që bëhet servil për një dorë misër: kjo është drama që Migjeni shkroi në një nga veprat e tij më madhështore:

"Vuej bashkë me feminë, të cilit prindi nuk ia bleu lojën...vuej bashkë me pesëdhjetëvjeçarin, që mbytet në apatinë e jetës, vuej me plakun që dridhet nga frika e vdekjes, vuej me punëtorin, të cilin hekuri e ndrydh, vuej me të sëmundët të të gjitha sëmundjeve të krejt botës...Vuej me njeriun!". ("Të fala nga fshati"), i shkruante shokut të tij të ngushtë Teofik Gjyli, që u botua në mesin e vitit 1934 në revistën "Illyria". Kjo letër mund të shihet si një kredo e Migjenit qytetar dhe krijues.

Indinjatën që i vlonte në shpirt ndaj hipokrizisë që karakterizonte jetën shqiptare, shkrimtari e shpreh me një letër që i dërgonte sërish shokut të tij nga Vraca më 14 prill 1934 ku zemërimi është përzier me qesëndi. *"Mos ec si ta do natyra, por ec si duhet, mos të komprometohesh, mos fol si ta do natyra, por fol si duhet, mos të komprometohesh, mos u sjell si ta do temperamenti, por sjellu si duhet, mos të komprometohesh, mos u shpreh kurrë me sinqeritet, por me rezervë, mos të komprometohesh-dhe kështu gjithë jeta e njeriut, ndër imitacione"*. Në këto pak rreshta del në pah ideali i jetës fisnike dhe të denjë njerëzore, që frymëzonte Migjenin. Të fshehtë njeriu ndjenjat e veta, të tregohet në jetë jo i sinqertë; kjo, mendonte Migjeni ishte dhunë mbi të drejtat elementare të tij. Mungesa e lirive qytetare kishte pasoja negative në karakterin e njerëzve, në rrethanat ku individit i mohohet e drejta për t'u shprehur lirisht, lulëzonte hipokrizia, servilizmi dhe gënjeshtria, shuhej personaliteti i njeriut.

Mendime me vlerë shprehu Migjeni përsa i përket thelbit të artit. Arti, sipas Migjenit, është i lidhur ngushtë me jetën e shoqërisë së kohës së cilës i përket. Shkrimtari, si çdo njeri që shfaq interesa ideore, jeton me shqetësimet dhe problemet e epokës historike, me lëvizjet mendore, ku janë përfshirë klasa dhe forca të ndryshme. Në këtë përfundim arriti qëkur ishte në Manastir. Për këtë dëshmon një fletë dorëshkrimi i viteve shkollore, ku ka hedhur shënimet e nxjerra gjatë leximit të librit të studiuesit letonez R. Pelshe "Zakonet dhe arti i Revolucionit Francez", botuar në rusisht më 1919. Në këtë libër Migjenin e tërhoqi ideja se arti është forcë e ideologjisë dhe faktor i rëndësishëm në zhvillimin e jetës shpirtërore të njeriut dhe se në procesin e krijimit letrar rol të rëndësishëm luajnë idealet e artistit, në dritën e të cilave ai pasqyron realitetin. Kjo shfaqet në mënyrë të veçantë në kthesat e mëdha historike, kur ideologjia dhe psikologjia

e klasave shprehet në art po me atë qartësi si në fushat e tjera të ndërgjegjes shoqërore. Migjeni nuk u pajtua me tezën mbi artin si fushë e veprimtarisë shpirtërore që nuk ka kurrfarë lidhjeje me shoqërinë. Burimi i artit, sipas tij, është jeta e gjallë, ai nuk e pranonte pikëpamjen e Platonit se arti i ka rrënjët në botën e ideve abstrakte që ekzistojnë jashtë realitetit objektiv. *“Të vërtetat e përjetshme në art dhe në jetë, - shkruante më 1936 Migjeni në ditarin e tij, - janë një metafizikë e kulluar...Koncepti i idealit të përjetshem të së bukurës, ashtu si dhe i artit të kulluar, marrë në thelbin e tij, është absurd”*. Veprat e artit e përmbushin funksionin e tyre shoqëror përmes ndikimit që ushtrojnë me mjetet e tyre specifike në botën e brendshme të njerëzve. Duke vepruar në vetëdijen dhe në ndjenjat e tyre, arti i pasuron me mendime dhe i lartëson nga ana shpirtërore. *“Arti, - i shkruante Migjeni redaksisë së revistës “Bota e re”, - duhet të prekë imagjinatën, ndjenjat, nervat...Mendoj se kryesorja në art është artistikja, me anë të së cilës artisti mund të zbulojë me talent dhe vërtetësi thelbin shoqëror, moral dhe psikologjik të jetës intime të njerëzve”*.

Me interes është pikëpamja e Migjenit për satirën si *“purgatori i madh i shoqërisë”*. Ai nuk pajtohej me pikëpamjen hegeliane, sipas së cilës figura në satirë kapet me trishtim pas kontradiktës midis subjektivitetit vetjak dhe parimeve të tij abstrakte, nga njëra anë dhe “realitetit empirik”, nga ana tjetër dhe për këtë arsye satira nuk krijon as poezi, as vepër të vërtetë artistike dhe prandaj nuk ka perspektivë. Ky koncept për satirën, sipas Migjenit ishte i njëanshëm dhe nxjerrë nga veprat retorikë-didaktike të shek. XVI-XVII. *“Satira, - pohonte ai, - nuk shpiket nga koka e shkrimtarit; ajo gjendet vetë në “realitetin empirik”, në botën e vjetër që nuk do të dorëzohet dhe kapet pas madhështisë së saj, tashmë të perënduar, gjendet në mospërputhjen e shëmtuar që aq shpesh haset në jetë dhe në marrëdhëniet e njerëzve, midis pretendimit dhe thelbit, midis fjalëve dhe punëve, midis veprave dhe fjalëve të bukura. T’i tregosh botës pa kurrfarë mashtrimi optik, me anë të mjeteve që ofron fantazia krijuese, pasqyrën e vet, a nuk do të thotë vallë kjo që, në përcaktimin e diagnozës së sëmundjes t’i bësh një shërbim njerëzimit, ndonëse nuk e zhdok të keqen?”*.

Qartësia e Migjenit për çështjet estetike vihet re edhe në konceptin e tij për progresin e artit. Nisur nga kjo, ai theksoi rëndësinë e përvojës krijuese të simbolistëve francezë, të Rembosë, Verlenit etj, e cila, sipas tij, jep dorë të depërtohet në fshehtësinë e ndjenjave dhe të mendimeve të personazheve. Mjetet që përpunuan ata, përbëjnë arritje të çmuar që duhet huazuar prej brezit të ri të shkrimtarëve. *“Pse, - pyeste Migjeni në letrën dërguar më 14 qershor 1936 redaksisë së revistës “Bota e re”, - të mos çmohet përpjekja e impresionizmit dhe e simbolizmit për të afruar sfera të afërta të artit: muzikën, pikturën dhe poezinë, përpjekje që do të ndihmojë njerëzimin të zbulojë një faqe të re, më të bukur në historinë e kulturës shpirtërore?”*.

LITERATURA:

1. Vehbi Bala, “Migjeni”, portret-monografi, Shtëpia Botuese “N. Frashëri”, Tiranë, 1974.
2. Adem Istrefi, “Ti gdhende emrin e kohës”, rev. “Nëntori”, 1981.
3. Moikom Zeqo, “Mozaik migjenian”, rev. “Nëntori”, 1981.
4. “Historia e letërsisë shqiptare”-Tiranë 1983, Botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH (Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë), kapitulli XXVIII - Migjeni.
5. Dalan Shaplo, “Migjeni ynë i madh-vlerat shoqërore dhe kombëtare të veprës së tij”, rev. “Nëntori”, 1988.
6. Rudolf Marku, “Proza e Migjenit, kritika e saj dhe veçoritë artistike”, rev. “Nëntori”, 1988.
7. Ismail Kadare, “Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe”, Tiranë, 1991.
8. Rinush Idrizi, “Migjeni”, Shb Enciklopedike, Tiranë, 1992.
9. Robert Elsie, “Histori e letërsisë shqiptare”, ShB “Dukagjini”, Pejë, 1997.
10. Migjeni, “Vepra të Mbledhura” nga Skënder Luarasi, shtypur në “Gorenjski Tisk”, Slloveni, 2002.
11. Koço Bihiku, “Krijimtaria letrare e Migjenit”, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 2004.
12. Arshi Pipa, “Për Migjenin” (tri esse), Shtyp.Konica kolor, Tiranë, nëntor 2006.
13. Sabri Hamiti, “Letërsia moderne”, vepra letrare 8, botues Enti Botues Faik Konica-Prishtinë, kapitulli Millosh Gjergj Nikolla.

Përppjekjet e emigracionit politik shqiptar për të bashkëpunuar me emigracionin kosovar



Abstrakt

Emigracioni politik antikomunist shqiptar e kosovar kanë bërë një punë të organizuar në radhët e këtyre emigrantëve. U krijuan edhe disa shoqëri e klube në SHBA, Australi, Suedi, RFGJ, Kanada, Francë, Belgjikë e gjetkë. Nga ana tjetër edhe elementë të majtë e pro regjimit të Tiranës, sidomos pas ngjarjeve të vitit 1981 në Kosovë, krijuan disa shoqëri si ajo “Zafer” në Turqi, “Idriz Seferi” në Belgjikë, “Bajram Curri” në Australi, qendrat kulturore “Isuf Gërvalla” në SHBA, Evropë e gjetkë etj.

Për këto arsye, sidomos në vitet ‘70, ‘80, vihej re më tepër tendenca e afrimit dhe forcimit të lidhjeve të grupimeve të emigracionit antikomunist në SHBA, Evropë, Australi, Kanada, vendet arabe e gjetkë, me shoqatat e klubet, pjesëmarrje aktive në veprimtaritë kulturore e sportive, në shkollat e kurset e gjuhës shqipe, në organizmat fetare etj. të emigracionit kosovar

Si rezultat i shtypjes politike dhe diskriminimit ekonomik të popullsisë shqiptare në Jugosllavi pati valë të fuqishme emigrimi. Sipas të dhënave jo të plota deri në vitet ‘90 në Turqi pati 1.890.000 shqiptarë. Sipas statistikave zyrtare jugosllave nga vitet 1954 - 1967 kanë emigruar 340 mijë shqiptarë nga Jugosllavia. Në vendet e tjera ndodheshin: 29.000 në RFGJ, 47.000 në Belgjikë, 3.000 në Zvicër, 30.000 në Argjentinë, 40.000 në Australi, 3.000 në Suedi, 30.000 në SHBA, 4.000 në Siri, 13.000 në Francë, 4.000 në Austri e gjetkë, duke mos përfshirë ata që u detyruan të largohen pas ngjarjeve tragjike të vitit 1981 e këtej në Kosovë dhe viset shqiptare në Jugosllavi. Në përgjithësi këta shqiptarë zhvillonin një veprimtari atdhetare.

Fjalë kyçe: *emigracion, sistem komunist, diskriminim, demonstratë.*

Në vitet <70 Legaliteti afroi disa intelektualë të rinj nëpërmjet zyrës së shtypit të drejtuar nga Xhemal Laçi, Zef Pashko Deda, Reshat Agaj, Rasim Sina etj. Po kështu ballistët arritën të zgjerimin lidhjet me emigrantët kosovarë në Turqi, Australi, SHBA, Suedi, RFGJ etj. BKI, duke krijuar edhe një rrjet që i mbështeste këta emigrantë, sidomos ata nga viset shqiptare në Mal të Zi. Po kështu u zgjerua aktiviteti dhe radhët e organizatave kosovare si Lidhja e Prizrenit, Lidhja Kosovare, Lidhja e Vardarit etj. Ndikim të madh emigracioni politik pati atje ku ishin grumbulluar më shumë shqiptarë, çamë e kosovarë dhe ku kishte qendra e mjete propagande si radio, shtyp, propagandë verbale, institucione fetare, shkolla të gjuhës shqipe etj.

KSHL i Nju Jorkut organizoi prej vitesh nxjerrjen e garancisë për emigrimin e kosovarëve në SHBA e gjetkë¹, duke i tërhequr nga kampet e refugjatëve të Evropës. Çdo organizatë ose grupim politik u jepte udhëzime anëtarëve të tij që të futeshin në grupimet kosovare, të frekuentonin qendrat e lokalet e ndryshme ku grumbulloheshin, këshillat apo shoqëritë e tyre.

Q. Prodani dhe Tahir Kolgjini në Turqi bënë shumë përpjekje për t'u ardhur në ndihmë kosovarëve të mërguar atje. Emigracioni politik i cili tashmë kishte disa dekada që kishte emigruar dhe ishte stabilizuar, u dha ndihma emigrantëve të rinj që vinin nga Kosova dhe viset shqiptare në Jugosllavi, për sigurimin e banesës, të punës; u dha garanci të tjera për stabilizim, për lidhje me organizma të huaja humanitare, për sistemimin e tyre etj.

Emigrantët politikë zgjeruan lidhjet me emigracionin kosovar edhe nëpërmjet shoqërive fetare si ajo myslimane, katolike në SHBA, Australi, Belgjikë, Francë, Kanada. Po kështu ata përpqeshin të afronin nëpërmjet aktiviteteve për Kosovën sidomos pas ngjarjeve të vitit 1981 në Kosovë.

Shtypi i emigracionit politik u përpoq të informojë kosovarët mbi gjendjen në Shqipëri, mbi politikën që ndiqte regjimi komunist brenda vendit dhe ndaj çështjes së Kosovës, si dhe për perspektivat e bashkimit kombëtar.

Në fazën e parë gjatë viteve 1945-1966 shtypi për Kosovën kishte patur një fuqi dhe tematikë më të gufizuar duke u përqendruar në denoncimin e shtypjes në Kosovë. Por pas kësaj kohe deri në vitin 1990 shtypi njohu një zhvillim të madh dhe u rrit cilësia, problematika dhe shpërndarja e tij. Një nga gazetatat më të mira dhe me tirazh ishte Qëndresa Shqiptare” të cilën e botonte KKDSHL i Parisit nën drejtimin e Abaz Ermenjtit. Nuk ngelte prapa saj as gazeta “Përpjekja Kosovare” që botohej në Paris dhe ishte organi kryesor i Lidhjes Kosovare. Më tej mund të rendisim gazetën “Krahu i Shqiponjës” në të cilën botoheshin shkrime nga organizata “Lidhja Çamë”. Kjo për herë të parë u botua në tetor 1974 në Çikago; gazeta e BKI “Shqiptari i Lirë”, gazeta “Lidhja e Prizrenit”, gazeta “Besa” në Turqi; gazeta “Bashkimi” që botohej nga organizata ilegale majtiste “Fronti i Kuq” e drejtuar nga Ibrahim Kelmendi; gazeta “Liria” që nisi të botohej prej vitit 1980 nën drejtimin e Kadri Zekës, në Zvicër; revista “Lajmëtari i Lirisë” që botohej nga “Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës” nën drejtimin e Jusuf Gërvallës. Në fillim të vitit 1982 filloi botimi i gazetës “Zëri i Kosovës”, redaktori i parë i saj ishte Skënder Durmishi etj².

Pas demonstratave të vitit 1981, u gjallërua dukshëm aktiviteti i emigracionit shqiptar politik dhe ekonomik. Në këtë periudhë risi ishin demonstratat e mërgatës shqiptare të cilat, në përgjithësi, pasqyronin rreshtimin ideologjik të organizatorëve të tyre. Demonstrata e parë ishte ajo e New York-ut më 6 prill të vitit 1981. Ndërsa demonstrata e parë e organizuar në Evropë ishte ajo në Bernë më 11 prill 1981 e drejtuar nga Kadri Zeka³. Kërkesa themelore e tyre ishte që Kosovës t'i njihej statusi i Republikës në kuadër

¹Gazeta “Shqiptari i Lirë”, shtator - tetor 1970, f. 2

²Sabile Keçmezi-Basha, Çështja e Kosovës në shtypin e mërgatës shqiptare 1945-1990, në Robert Pichler, Migrimi, Diasporizimi dhe Shkatërrimi i Jugosllavisë, në aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, “Roli i mërgatës në shtetformim”, Prishtinë 2012, f. 287-305-311.

³Xhaferr Shatri, Ndikimi i demonstratave të vitit 1981 në mërgatën shqiptare, në aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, “Roli i mërgatës në shtetformim”, Prishtinë 2012, f. 357.

të RFSJ. Këto demonstrata u pasuan nga të tjera në Cyrih më 25 prill; po me 25 prill në Shtutgart; më 9 maj në Dyseldorf; më 16 maj në Mynih; më 30 maj në Gjenevë; më 13 qershor në Bruksel; më 4 korrik në Frankfurt⁴.

Emigracioni ekonomik dhe politik kosovar që ndikohej nga qeveria e Tiranës, ndeshi në vështirësi të shumta, për shkak të qëndrimeve të tij prokomuniste, sepse autoritetet vendase e panë atë me dyshim. Kështu kjo krijoi pasiguri relative sociale, nuk ishte i organizuar mirë, ndeshi vështirësi të shumta për pajisje me dokumente, për lëvizje etj.

Pas viteve 50 qeveritë perëndimore filluan ta shtonin interesimin për kosovarët në mërgim, të arratisur nga Shqipëria dhe Kosova. Emigracioni antikomunist kosovar do të krijonte një rrjet të gjerë organizatash me influenca të ndryshme: balliste, zogiste, bllokiste etj, Grupimet kryesore ishin:

Organizata “Lidhja Kosovare” - u krijua në vitin 1957, me mbështetjen britanike dhe të Ballit Agrar të A.Armenjtit. Kjo drejtohej nga Nexhat Mitrovica, Luan Gashi, Hafëz Isuf Azemi etj.. Kjo pretendonte se ishte krijuar qysh në vitin 1943, kur BK në Mukje mbrojti tezën e Shqipërisë Etnike. Ajo pohonte se ishte pasuese e Ballit Kombëtar, tek i cili kishte “shpresën më të madhe, provën më të sigurtë për realizimin e Shqipërisë Etnike”⁵. Ajo vlerësonte lart Rexhep Mitrovicën, të cilin e konsideronte si liderin qendror të shqiptarëve, për realizimin e Shqipërisë Etnike. Edhe Balli Kombëtar deklaronte se “Lidhja Kosovare ishte themeluar me ndihmën e punën e Ballit Kombëtar”⁶. Lidhja Kosovare shpalli në programin e saj: bashkimin e kosovarëve të mërguar, për të mbrojtur të drejtat e tyre e të Kosovës; të nxiste qëndrësën e shqiptarëve në Jugosllavi, për një administratë autonome e njohjen e të drejtave të vetëvendosjes; të luftonte me të gjitha forcat, që kombi shqiptar “të çlirohet e të bëhet Shqipëria Etnike demokratike”. Kjo organizatë parashikonte edhe rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri. Ajo propagandonte se kosovarët që ishin viktimat e regjimit titist, kishin përkrahur idetë e saj, se ajo kishte depërtuar në Kosovë e në viset e tjera shqiptare si dhe në emigracionin kosovar. Në nëntor të vitit 1973, në Çikago, Lidhja Kosovare bëri kongresin e parë në mërgim, ku ftoi të merrnin pjesë të gjitha grupet politike. Në këtë forum, A.Armenji u bëri thirrje kosovarëve të bënin përpjekje për vetëvendosje, për organizim të qëndrësës dhe bashkim për çlirimin e Kosovës e për Shqipërinë e Etnike⁷. Lidhja Kosovare denoncoi qeverinë e E.Hoxhës, se nuk kishte ngritur zërin për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi, se PKSHE kishte lënë Kosovën në robëri. Që nga mbledhja e Mukjes, se kosovarët s’kanë çfarë presin nga qeveria komuniste e Shqipërisë etj, Ajo botoi gazetën “Përpjekja Kosovare”. Ajo, shumë shpejt, gjeti një mbështetje të gjerë në emigracionin shqiptar nga Kosova dhe krijoi disa degë në SHBA, Turqi, Australi, Kanada etj. Më tej, pati grindje midis krerëve të saj dhe atyre të BK. Pas ngjarjeve të vitit 1981, “Lidhja Kosovare” mbështeti luftën e popullit të Kosovës e trevave të tjera shqiptare në Jugosllavi për të drejtat kombëtare.

Organizata “Lidhja e Tretë e Prizrenit” u krijua në vitin 1962 në Nju Jork, me sekretar Ismet Uk Sadikun (Berisha). Influencë të madhe në të kishte Xh. Deva, i cili në vitin 1966 u bë edhe kryetar i saj, post të cilin e mbajti deri sa vdiq. Po kështu, një ndikim të madh kishte edhe R.Krasniqi. Kongresi i Parë i kësaj organizate u zhvillua në nëntor 1966 dhe u drejtua me shumë zotësi nga Xh.Deva⁸. Lidhja e Tretë e Prizrenit krijoi grupe të fshehta të armatosura e propagandistike në Kosovë. Qeveria komuniste e Tiranës i ndiqte me shumë shqetësim lëvizjet e kësaj organizate dhe të këtyre grupeve, pasi mendonte se ata do të vepronin edhe kundër saj. Me shqetësim shihej edhe

⁴Xhaferr Shatri, *Ndikimi i demonstratave të vitit 1981 në mërgatën shqiptare, në aktet e Konferencës Shkencore Nderkombëtare, “Roli i mërgatës në shtetformim”, Prishtinë 2012, f. 360.*

⁵Buletini i kongresit të BK, (fjala e L. Gashit), 1970, f. 85.

⁶Buletini i kongresit të BK, (fjala e L. Gashit), 1970, f. 85.

⁷Buletini i kongresit të BK, 1973, f. 35.

⁸Idriz Lamaj, *Xhafer Deva... f.15.*

bashkëpunimi i ngushtë i saj me krerët e Legalitetit, BKI, BK etj, Ajo tërhoqi në radhët e saj mjaft kosovarë të mërguar. Programi i saj kishte si boshqendror: Shqipërinë Etnike, mbrojtjen e të drejtave kosovare në frymën e Lidhjes së I, e të II të Prizrenit; “të jetë kurdoherë e gatshme të kontribuojë fuqimisht për çlirimin e Shqipërisë nga tirania e kuqe”⁹; dëshirën e saj për marrëdhënie vëllazërore me grupet e emigracionit shqiptar, mospranimin e përfaqësimit të çështjes së Kosovës nga ndonjë grup tjetër kosovar, që ajo nuk e njihte, njohjen e Xh.Devës si udhëheqës shpirtëror, mbështetjen e Legalitetit si organizatë historike për Shqipërinë Etnike etj. Me irredentizëm ajo kuptonte, jo vetëm të drejtat si shqiptarë, por “sidomos fitimin e së drejtës së vetëvendosjes dhe të shkëputjes nga shteti i huaj, e bashkim me atdheun e përbashkët, të lirë e vetsundues”. Disa krerë të saj si Xh.Deva, Haki Terpeza etj, zhvilluan veprimtari diversioniste, duke dërguar grupe të armatosura në Shqipëri.

Edhe në radhët e saj pati kontradikta midis fraksioneve të saj. Shquheshin fraksionet e Xh.Devës, që përbënte pjesën më antikomuniste të saj dhe ai i I.Sadikut e Hysen Terpezës, që ishin më pak të predispozuar për luftën kundër regjimit komunist në Shqipëri. Këta kishin mosmarrëveshje për format e taktikën e luftës. Xh.Deva përkrahej plotësisht nga KSHL i Nju Jorkut, BKI, Legaliteti etj,

Pati degë në SHBA, Francë, Turqi, RFGJ, Belgjikë, Australi, Kanada etj.. por ato u dobësuan për shkak të grindjeve të brendshme e të luftës që i bënte elementi majtist kosovar. Me përjashtim të BK e Lidhjes Kosovare, ajo mbante lidhje me grupimet e tjera antikomuniste. Sipas një raporti të Senatit Amerikan, që bën fjalë për Jugosllavinë në vitin 1969, rezultonte se spiunazhi jugosllav ishte përpjekur të penetronte dhe të shkatërronte grupet antikomuniste të mërgimit. Ndërsa gazetari amerikan Jack Anderson shkruante se, agjentët e Titos ishin përpjekur të bënin provokacione dhe atentate kundër të mërguarve politikë kosovarë, duke referuar atentatin kundër Isuf Azemit në Çikago në vitin 1971¹⁰. Në vitet '80, Lidhja e Prizrenit nuk shprehej hapur kundër regjimit komunist dhe po merrte distancë nga grupimet e tjera antikomuniste, duke u përqendruar në politikën nacionaliste për Shqipërinë Etnike.

“Komiteti Kosova e Lirë” - u krijua në vitin 1965 në Kanada me në krye Mitat Vranicën, i cili më parë bënte pjesë në Lidhjen e Prizrenit. Ky komitet propagandonte që Kosova të bëhej shtet më vite, e pastaj të bashkohej me Shqipërinë. Ai denoncoi si regjimin komunist të Tiranës, ashtu dhe drejtuesit komunistë shqiptarë në Kosovë dhe në viset e tjera në Jugosllavi. Pati pak anëtarë e pak influencë, mbante lidhje me grupet antikomuniste kroate.

“Rezistenca Kombëtare Kosovës” - u krijua në vitin 1975 në Bruksel me disa të arratisur nga Kosova. Ishte për Shqipërinë Etnike e për mbrojtjen e Kosovës. Gjithashtu denonconte edhe regjimin komunist të Shqipërisë. Veprimtaria e saj u intensifikua sidomos pas ngjarjeve të vitit 1981 në Kosovë. Botoi një gazetë me të njëjtin emërtim.

Organizata “Besëlidhja shqiptare” - u krijua më 1977 nga shkrimtari e grupeve “Lidhja e Vardarit” në Francë, “Shoqata Ismail Qemali” e “Klubi Skënderbeu” në RFGJ, “Besa Demokratike” në Kosovë e RFGJ dhe Lidhja e Prizrenit në Francë, të cilat më parë ishin bashkuar si “organizata kosovare revolucionare nacional demokratike shqiptare” me krerë Reiz Hoxha, Emil Kastrioti (Emin Fasllia), Hysen Çela etj., Ajo krijoi grupe me të mërguarit ekonomik shqiptar në RFGJ, Suedi, Belgjikë etj. Në programin e saj shpalli luftën: për një Shqipëri të lirë demokratike, etnike e të bashkuar gjeografikisht e historikisht prej Preveze në Tivar; luftë ideologjike komunistëve në përgjithësi e në veçanti regjimit komunist në Shqipëri, pastaj bashkimin e Shqipërisë me Kosovën. Ajo e denonconte marksizëm - leninizmin si të huaj për kombin shqiptar, që zhdukte e shkelte traditat e tij. Çështja e regjimit sipas kësaj organizate, do të zgjidhej me vullnetin” e popullit. Motoja e saj ishte “Atdheu mbi të gjitha” dhe propagandonte bashkimin e të

⁹ *Gazeta Shqipëria e re, gusht 1968, f. 4.*

¹⁰ *“Gazeta Flamuri”, 28 nëntor 1979, f. 9*

gjitha grupimeve antikomuniste, duke ofruar ndërmjetësimin e tij për këtë qëllim.

“Komiteti për Mbrojtjen e Kosovës” u krijua në Belgjikë nga kosovarë të arratisur pas ngjarjeve të viti 1981 në Kosovë. Kjo organizatë pati shumë grindje midis grupimeve politike brenda saj. Kryesisht dominonin ballistët agrarë e zogistët.

Organizata “Rinia Shqiptare dhe Kosovare në Botën e Lirë” në Nju Jork, e kryesuar nga Tahir Kërnaja e Maliq Arifi, përbëhej nga të rinj kosovarë.

BIBLIOGRAFIA:

1. Arkivi Qendror Shtetëror i Shqipërisë (AQSH).
2. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (AMPB).
3. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ).
4. Islam Lauka & Eshref Ymeri, “Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse (Përmbledhje dokumentesh)”, Toena, Tiranë, 2006.
5. Foreign Relations of the United States (FRUS), Greek (the) Minority in Albania – A Documentary Record (1921-1993), Thessaloniki, 1994.
6. “Shqipëria e lirë”, Boston MASS, 1945-1956.
7. “Flamuri i lirisë”, organ i emigracionit shqiptar në jugosllavi, Prizren, 1951-1953.
8. “L’Albanie Libre” Organ du BLOC National Indipendent, Roma, 1948-1955.
9. “Shqipëria”, Organ i Komitetit, “Shqipëria e Lirë” New York. N.Y., 1950-1951.
10. “Albanian Catholic Bulletin”, New York.
11. “Bashkimi”, Tiranë.
12. “Dielli”, Boston, New York.
13. “Flamuri”, New York.
14. “Zëri i popullit”, Tiranë.

Zgjidhja Alternative e Kontesteve (ZAK) - ndërmjetësimi në Kosovë



Abstrakt

Zgjidhja alternative e konflikteve në Kosovë është e rregulluar me legjislacionin pozitiv të Republikës së Kosovës. Nocioni zgjidhja alternative e kontesteve (ZAK) në Kosovë nuk është nocion i panjohur. Për më tepër, ndërmjetësimi është zbatuar në Kosovë edhe praktikisht. Madje, zbatimi në praktikë ka shërbyer shumë në momente të caktuara të historisë. Sidomos në vitet e fundit të shekullit të njëzetë. Atëherë kjo çështje nuk ishte e rregulluar me ligje pozitive, por sukseset ishin të jashtëzakonshme. Pas luftës në Kosovë nga organizata të ndryshme joqeveritare ndërkombëtare dhe vendore, janë zhvilluar aktivitete ndërmjetësimi dhe kështu ka filluar të krijohet një infrastrukturë ndërmjetësimi, që është kurorëzuar edhe me nxjerrjen e Ligjit për Ndërmjetësim në bazë të të cilit, janë përzgjedhur dhe janë licencuar ndërmjetësuesit e parë, të cilët kanë filluar aktivitetet e para duke u bazuar në legjislacionin pozitiv të Kosovës. Punimi do të përshkruaj paraqitjen dhe zhvillimin e ndërmjetësimit në Kosovë, për të vënë në pah sukseset e arritura dhe dobësitë e hasura.

Fjalët kyçe: *Ndërmjetësimi, konflikti, ligji, zgjidhja alternative.*

Hyrje - paraqitja dhe zhvillimi historik

Ndërmjetësimi është përdorur historikisht dhe përdoret edhe aktualisht në shumë vende të botës. Ndërmjetësimi si institut i të drejtës, autorë të ndryshëm i janë qasur nga këndvështrime të ndryshme. Përpara se të përpiqemi të paraqesim këndvështrimin shqiptar, do të paraqesim në vijim shkurtimisht këndvështrime nga shumë vende. Për zgjidhjen alternative të konflikteve mund t'i referohemi praktikës fenikase, greke, indiane dhe irlandeze por nga perspektiva e një lexuesi Australian fokusi spostohet në mënyrë dominante prej ndërkombëtares tek vendorja me fillim të historisë moderne amerikane¹. Ndërkaq për të parë një zhvillim historik të ndërmjetësimi po shkoqisim shkurtimisht këtë çështje nëpër regjione të ndryhme të botës.

"Kina dhe India: Confucius besonte se rruga më e mirë për të zgjidhur konfliktin ishte përpjekje për bindje morale dhe marrëveshje se sa shtrëngim. Ka një harmoni natyrale në punët njerëzore, të cilat nuk duhet të ndërpriten. Paqja dhe të kuptuarit janë qëndrore në filozofinë e tij. Në këto kultura paraqitja në gjykatë është resort i fundit që përfshin humbjen e fytyrës (...). *Japonia:* Ndjehet një mungesë e juristëve në Japoni, kjo mbase ekziston një histori e pasur e ndërmjetësimi. Lideri i fshatit pritej të ndihmonte njerëzit në zgjidhjen e konflikteve. Ka gjithashtu shumë pengesa procedurale për dalje formale në gjykatë dhe kjo mund t'i kontribuojë një theksimi të një procedure joformale të ndërmjetësimi. Sot ndërmjetësimi është pjesë e kulturës së biznesit ku ndërmjetësuesit janë prezantues të *shokai-sha* dhe të ashtuquajturit *chukai-sha* për raportet smooth të biznesit (...). *Afrika:* kushdo i përfshirë në konflikt mund të thërras mbledhjen joformale të asamblesë së fqinjësisë të quajtur *moot*. Një anëtar i respektuar i komunitetit shërben si ndërmjetës për të ndihmuar palët në zgjidhjen e konfliktit në mënyrë bashkëpunuese. Suksesi i kësaj forme mund të jetë bazuar në faktin e modeleve familjare të zgjeruar brenda shumë komuniteteve afrikane (...). *Islami:* kultura islame ka një traditë të fortë ndërmjetësimi dhe pajtimi si qasje të preferuara nga siç shihet nga hadiset, të specializuarit shkojnë në mes dhe tentojnë të ruajnë harmoninë sociale duke arritur marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit (...). Kultura përendimore, çifut-krishtere: perëndimi ka një traditë të gjatë ndërmjetësimi. Kishat janë përdorur si vendet e shenja dhe kështu kasha dhe kleri shpesh kanë vepruar si ndërmjetës në mes kriminelëve dhe autoriteteve. Në mesjetë kleri kristian kërkojn zgjidhjen e konflikteve familjare me ndërmjetësim dhe ndërmjetësimi kërkohet madje edhe për konflikte diplomatike. *Gjykatat Rabinikale* përdorin traditë dhe *Torahun* për zgjidhjen e konflikteve (...). *SHBA: Quaker*-ret kanë një histori të gjatë në të praktikuarit e ndërmjetësimi dhe të arbitrazhit. Shumë nga modelet e hershme të ndërmjetësimi në SHBA janë bazuar në punën e Quaker-rseve. Në New York komuniteti çifut ndërton forumin e vet të ndërmjetësimi. Emigrantët kinez ndërtojnë shoqërinë *Benevolent Kineze* për të zgjidhur konfliktet brenda familjes dhe brenda komunitetit përmes ndërmjetësimi (...). Shekulli njëzetë: histori e hershme-*Mbretëria e Bashkuar*, ndërmjetësimi institucionalizohet në shekullin njëzetë në arenën sekulare ku fillon të njihet për të pasur rolin e vet dhe për vetveten. Akti Koncil lidhur me ndërmarrjen e marrëdhënieve industriale në Mbretëri të Bashkuar herët në vitin 1896 dhe histori e hershme në SHBA, proceset e zgjidhjes alternative të konflikteve fillojnë të formalizohen si alternativë ndaj proceseve gjyqësore, më herët në Departamentin e Punës (të formuar me 1913) duke emëruar një panel me emrin "*commissioners of conciliation*" që do të merret me menaxhimin e konflikteve në punë. Këta komisionerë bëhen shërbim i pajtimit në SHBA dhe në vitin 1974 ky entitet bëhet Shërbim Federal i Ndërmjetësimi për Pajtim. Disa nga shkrimet e para për zgjidhjen alternative të konflikteve nënvizojnë përvojën e zgjidhjes së konflikteve në industri dhe kjo pastaj adaptohet për zgjidhje të konflikteve ndërpersonale"².

¹ Kështu është shprehur Profesori i Drejtësisë Laurence Boule nga Universiteti Bond, në recensionin e librit "A history of Alternative Dispute Resolution" botuar në Bulletin 7 Volume 7 të ADR Bulletin.

² <http://www.mediationmattersd.com/mediationmatters/history.html> (qasur me 28.05.2016)

Shkurtimisht tek ne

Nuk është objekt shtjellimi i këtij punimi e tërë çështja e ndërmjetësimit nëpër histori, por megjithatë një vështrim shumë i shkurtër historik besohet se i shërben punimit. Dhe këtu, krahas historikut të shkurtër do të sqarohet fjala ndërmjetësim sipas asaj që në të folmen dhe të shkruarën e shqipes, kur përdorim nocionin ndërmjetësim. Por para se të interpretohet fjala ndërmjetësim (mediacion) të shohim se cilat aktivitete apo forma të aktiviteteve mund të përmenden si të tilla tek ne. Dhe këtu menjëherë flasim për të drejtën zakonore shqiptare dhe rrjeshimisht me kanunin. Konfliktet dhe problemet shoqërore kanuni i rregullonte me, mbase në kanun ka disa emërime për ndërmjetësuesit, duke filluar te *pleqnia* (me karakter gjyqi), *dorëzanët e gjakut* (bestari), *pajtimi, gjindja e urtë*, pastaj si ndërmjetës ka qenë edhe ai që ka hy “*për me da fjalët e kria*”, pastaj *prifti si ndërmjetësues* në emër të “*Famullis a n'emër të flamurit*”³.

Kanuni i Lekë Dukagjinit ka paraparë ndërmjetësimin si një lloj instituti juridik, sikundër edhe dorëzaninë. Për të parë nëse ndërmjetësimi sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit kishte ngjajshmëri me ndërmjetësimin bashkëkohor, po paraqesim institutin e ndërmjetësimit siç është sanksionuar me kanun.

Kështu, *ndermjetsija* është:

§.667. Ndermjetsi, si lajmtari, nuk bân faj as nuk xëhet.

§.668. Ndermjetes thirret aj, i cilli hîn per me dà fjalët e kqij a, me shmangë rragen, prej të cillave mûnd të shkaktohet vrasa a ndo i rrênim tjetër.

§.669. Ndermjetes mûnd të jët burrë a grue, djalë a vajzë a edhe Prifti.

§.670. Ndermjetes mûnd të hijë per shpi me shpi, per katund me katund, per flamur me flamur.

§.671. Me i u pré ndermjetsija nijj shpis së veçanët, vetë e kerkon mikun.

§.672. Me i u pré ndermjetsija nijj kaktundi, katundishtë u lypë mikun.

§.673. Me i u pré ndermjetsija nijj flamuri, flamuri mbarë e lypë mikun.

§.674. Me i u pré ndermjetsija Priftit, mikun e lypë Famullija, në të cillen gjindet, a sè flamuri e lypë, po hîni ndermjët n'emën të flamurit.

§.675. Prifti, per me dà të keq, hîn ndermjët jo n'emën të vet, por a n'emën të Famullis a n'emën të flamurit; por vetëm atbotë, kûr mos ti pûnojë fuqija e fjalës fêtare.

§.676. Po s'u inuer para sysh fuqija e fjalës fetare, atbotë Prifti hîn ndermjet si çdo qytetas, por, tuj mos bajtë zyria e tij shpatë e litâr, po i u bâ n'asgja ndermjetsija si e çdo qytetasit, katundi a flamuri do t'a mkambin nderen e tij tuj e lypë mikun e prém.

§.677. Me kënë të vramë njiqind vetë në njânin krah e në tietrin kurnji, s'i të hijë kush ndermjët, pushka do të prajë, zjarmi do të shuhet.

§.678. Me bâ me u qitë poshtë flala e ndermjetsit, ajo lagje, qi të filloëj pusken, i a pret mikun ndermjetsit. (Po s'prâni pushka e fjala e gergasa permbas ndermjetsis, perzihet lamshi per mnerë, kryqzohet pushka, e grihen aty per aty.)

§.679. Fjalët e dokshme të ndermjetsis janë: “Leni flalët, or juni, jam ndermjët une! -Prani pushken, burra, un jam ndermjët mjë ké të mirremi vesh. - Prani pushken, sè katundi..., flamuri... âsht ndermjët!”

§.680. Ndermjetsi u mërr pëgjet të dyja lagjeve, tui u dà ditën sè kûr e kû do të mblidhen në kuvend, per me u mârre vesh.

§.681. Po nuk muejt me i ndreqë ndermjetsi, pëgjet e të dy lagjeve u lshon në dorë burrave t'urtë, e ky atbotë lirohet e del prej ndermjetsije.

§.682. Ndermjetsija mbaron gjithherë a me të rame diellit a me të mârrun të diellit (me të lem a me prenim të diellit).⁴

Pavarësisht interpretimit nga këndvështrimi dhe nga konteksti jo vetëm kohor, megjithatë mund të thuhet se gjinden elemente ndërmjetësimi, që në fund të fundit e

³Zef Ahmeti, *Mes traditës dhe modernes*, www.mediation-beratungen.ch

⁴NYE I NANDDHETENANDTËT, Kanuni i Lekë Dukagjinit

do zgjidhjen e një çikaje, zgjidhjen e një zënke, etj. Natyrisht ngjashmëritë gjithnjë duhet të kemi parasysh nivelin e zhvillimit shoqëror, ekonomik, sistemin ekzistues juridik, etj., të kohës së kanunit. Që të mos merremi më gjatë me historikun shqiptar të ndërmjetësimit po vemë në pah edhe këtë:

Atyre që sado pak i kanë ndjekur rrethanat në Kosovë, sidomos të atyre të viteve të fundit të shekullit njëzetë, menjëherë u bien ndërmed emrat e Anton Cettës, Zekeria Canës, Bardhyl Caushit dhe fshati Lumbardh, ku disa të rinj fillojnë aksionin e madh të pajtimit të gjaqeve në Kosovë”. Kjo do të arrihej me faljen e gjaqeve, të plagëve e të ngatërresave sipas shembullit të etërve e të stërgjyshërve të dëshmuar nga Skënderbeu, në mesin e shekullit XV (1443-1468), Bushatasit e Tepelenasit, nga mesi i shekullit XVIII-fillimi i shekullit XIX, nga Lidhja e Parë Shqiptare e vitit 1828-1831, midis Toskërisë e Gegërisë, nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881), nga Lidhja Shqiptare e Pejës “Besa-Besën” (1893-1902), nga Besëlidhja e Verrave të Llukës më 1910, nga Kryengritja e Madhe Kombëtare Shqiptare e vitit 1912, nga Besëlidhja popullore e Kosovës e viteve 1919-1921, nga Paqja (Islihati) i viteve 1941-1944 në Kosovë e në visë të tjera sapo të dala nga kuadri i Jugosllavisë versajase. Kujtesa dhe burimet historike vërtetojnë se shqiptarët para kthesave të mëdha shoqërore e politike, në interes të ekzistimit substancial e të ardhmërisë kombëtare, kanë falur gjaqet dhe hasmëritë, kanë ndalur dhe kanë ndëshkuar në mënyrë të organizuar, institucionalisht gjakmarrjen dhe vrasjet midis shqiptarëve për kohë të caktuar brenda Shëngjergjit - Shënmitrit, ose brenda vitit a periudhës së konfrontimit me armë me pushtuesit⁵.

Në fjalorin e shqipes së sotme, *ndërmjetësi* është “ai që hyn në mes të dy palëve për të arritur një marrëveshje, për të bërë një punë etj.”⁶. Ndërkaq *ndërmjetësia* është “veprimi i atij që hyn si ndërmjetësues”⁷. Fjalori na ndihmon dhe nga aty ne duhet të udhëzohemi të përdorim shpjegimin që e jep Ligji për Ndërmjetësim por edhe kuptimin që ky institut juridik e ka në teorinë dhe në praktikën bashkëkohore”. Ndërmjetësimi në thelb është negociim që përfshinë një palë të tretë që është e njohur me procedurën efektive të negociimit dhe mund të ndihmojë personat në konflikt që të koordinojnë aktivitetet e tyre dhe të jenë më efektiv në pazarin e tyre. Ndërmjetësimi është zgjatje e procesit të negociimit pasi që përfshinë zgjerimin e pazarit në format të ri dhe shfrytëzimin e ndërmjetësuesit që kontribuon me variabla dhe dinamika të reja në bashkëveprimin e palëve në kontest”⁸. Në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë “Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjanes (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin”⁹. Në Kosovë, ndërmjetësimi përkufizohet të jetë “veprimtari jashtëgjyqësore, që realizohet nga një person i tretë (ndërmjetësi), për zgjidhje të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës në pajtim me kushtet e parashikuara në këtë ligj”¹⁰. Sipas ligjit kosovar, “*Mosmarrëveshje*” nënkupton çfarëdo mospajtimi në mes të subjekteve të së drejtës, kurse “*Ndërmjetësuesi*” është pala e tretë, neutrale e autorizuar të ndërmjetësojë në mes dy palëve me qëllim të zgjedhjes së mosmarrëveshjeve, në pajtim me parimet e ndërmjetësimit¹¹.

⁵ http://pashtriku.beepworld.de/piraku_patimi.htm (qasur me 28.05.2016)

⁶ “Fjalor i shqipes së sotme”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Toena, Tiranë 2002 fq.833, Toena, Tiranë, 2002

⁷ Po aty

⁸ “Manual trajnimi”, Ligji për ndërmjetësimin, http://kontrata.net/repository/docs/USAID_CLE_Training_Manual_on_Mediation_24_May_2014_ALB_393354.pdf (qasur 29.05.2016)

⁹ Neni 1, Ligji për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Nr.10385 i datës 24.02.2011

¹⁰ Neni 2, Ligji për Ndërmjetësim Nr.03/L-057 i datës 18.09.2008

¹¹ Neni 2, Ligji për Ndërmjetësim Nr.03/L-057 i datës 18.09.2008

Në kohët e sotme mund të bëhen përkufizime të ndryshme të nocionit të ndërmjetësisimit, por esenca mbetet e njëjtë. Thënë ndryshe janë dy institute që përdoren në atë që njihet Zgjidhje Alternative e Konfliktëve. Në shqyrtime të thella teoriko-juridike mund të debatohet shumë për konfliktin dhe për kontestin, nëse ka dallime në mes tyre. Edhe këtu nuk e kemi për qëllim që të bëjmë shqyrtime krahasuese në mes fjalës konflikt dhe kontest. Pavarësisht kësaj do të jepet sqarim edhe për këtë, sidomos në fund të punimit. Prandaj vazhdojmë me përkufizimin e ndërmjetësisimit. “Ndërmjetësimi është forma më e pakët e kundërshtuar e ZAK. Mediatori ndihmon palët që të identifikojnë çështjet reale, kornizën e bisedimeve dhe gjeneron opsionet për zgjidhje. Qëllimi i ndërmjetësisimit është që të pajisë me zgjidhje win-win, duke mundësuar palët të sigurojnë satisfaksion zhdëmtues. Ndërmjetësuesit vijnë nga një numër i ndryshëm i sfondeve, por shumica praktikojnë punën e avokatit dhe që kanë njohuri për të nënvizuar tematikën e konfliktit. Ndërmjetësimi mund të përdoret në të gjitha shkallët e kontestit qoftë para fillimit të gjykimit e qoftë gjatë fazave të gjykimit edhe në proces ankimimi”.¹²

Sot ka shumë debate se çka është ndërmjetësimi, kush e zhvillon, si zhvillohet, si përfundon, etj. Përmenden sisteme të ndryshme të ndërmjetësisimit duke karakterizuar njërin më të mirë se tjetrin, njërin më të suksesshëm se tjetrin, etj. Por sidoqofshin animet për njërin apo për tjetrin sistem, karakteristikë e përgjithshme është se ndërmjetësimi së bashku me arbitrazhin janë si institute të së drejtës për zgjidhjen alternative të konfliktëve. Megjithatë, këto dy institute nuk janë krejtësisht të njëjta. Ndërmjetësimi është një proces alternativ i zgjidhjes së kontesteve, ku ndërmjetësuesi si subjekt neutral, përdorë teknika të nevojshme për të ndihmuar dy apo më shumë palë që të negociojnë në drejtim të arritjes së marrëveshjes që do të ketë efekte konkrete në interesin e tyre të përbashkët. Arbitrazhi përfshinë marrjen e vendimit nga një person që dëgjon palët dhe pastaj merr vendimin dispozitiv për zgjidhjen e kontestit. Dallimi në mes tjerash është se ndërmjetësuesi nuk merr vendim dhe ai vetëm ndihmon palët që të arrijnë marrëveshje, kurse arbitrazhi vendosë.

Mund të debatohet sigurisht shumë për përmbajtjen e kontesteve që zgjidhen me ndërmjetësim në njërin anë dhe me arbitrazh në anën tjetër. Por mud të debatohet gjithashtu shumë edhe për atë që mud të interpretohet lidhur me kontestin dhe me konfliktin. Sipas fjalorit të shqipes së sotme konflikti është “mosmarrëveshje e thellë ndërmjet dy palëve...”¹³ dhe meqenëse fjalët konflikt dhe kontest përdoren në vend të njëra tjetrës, “duhet të merret parasysh përkufizimi i poshtëm që është dhënë nga Gjykatat e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë në rastin e Mavrommatis Palestine Concessions (Jurisdiction) (1928): Programi i USAID-it në Kosovë për përmbartim dhe legjislacion komercial 7: *Kontest nënkupton mospajtimin rreth një pikë të ligjit apo një fakti, konfliktin e pikëpamjeve ligjore apo të interesave në mes të dy personave*”¹⁴.

Ndërmjetësimi dhe trendet në Kosovën e sotme

Shkaqet e kontesteve, forma e manifestimit të tyre, fusha ku paraqiten etj., janë të ndryshme, kurse shteti që ka në duart e veta monopolin e dhunës pritet që të zgjidhë kontestet e caktuara qofshin civile, familjare, biznese, e tjera. Për zgjidhjen e tyre ka instrumentet e veta dhe zgjidhjen mund ta imponojë. Dhe përkundër kësaj jo rrallë

¹² <http://www.cadmusjournal.org/node/98> - (qasur me 28.05.2016)

¹³ “Fjalor i shqipes së sotme”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Toena, Tiranë 2002

¹⁴ “Manual trajnimi”, Ligji për ndërmjetësimin, http://kontrata.net/repository/docs/USAID_CLE_Training_Manual_on_Mediation_24_May_2014_ALB_393354.pdf

zbatimi i vendimeve të institucioneve të shtetit është i vështirë. Duke u bazuar në këtë dikush lehtë parashtron pyetjen, nëse shteti nuk mund të vë në jetë vendimet e veta kur ka gjithë monopolin e dhunës në dorë, atëherë si mund të zbatohet një vendim si rrjedhojë e një marrëveshje, të arritur përmes ndërmjetësimit, kur këtë duhet ta bëjë shteti, i cili mundet që vendimin ta imponojë. Megjithatë, praktika ka treguar se ndërmjetësimi ka sjellë rezultate/zgjidhje, të cilat ndoshta nuk do të mund të zbatoheshin dhe nuk do të arrinin qëllimin, sikur zgjidhja të bëhej me vendim imponues-me aktgjykim. Në procesin e ndërmjetësimit kemi situatën win-win, pra të dyja palët fitojnë dhe kjo win-win është e dyanshme në fund të fundit. Procesi i ndërmjetësimit zgjidhjen e bënë më të shpejtë, më të lehtë, me më pak mund, me më pak shpenzime, është konfidencial dhe krejt në fund marrëveshja e arritur merr formën e vendimit të formës së prerë. Është proces më i shpejtë sepse ligji ka paraparë që zgjidhja të arrihet brenda afatit kohor prej 90 ditësh. Është proces më i lehtë sepse dy palët janë pajtuar që të zgjidhin kontestin përmes procesit të ndërmjetësimit. Pra procedura është më e lehtë sepse të dyja palët me angazhimin e tyre dhe me facilitimin e ndërmjetësuesit e arrijnë marrëveshjen. Palët vet janë pajtuar për ndërmjetësimin sepse nuk ka procedurë ndërmjetësimi nëse palët nuk janë pajtuar. Kur palët të janë pajtuar, atëherë vet marrëveshja e arritur është garancë e zbatimit praktikë. Është konfidencial sepse i gjithë procesi mbetet brenda procesit dhe brenda rrethit ku zhvillohet procedura e ndërmjetësimit. Është më pak i kushtueshëm jo vetëm në kontekst të parasë por në kontekst të kohës. Pra maksimumi ligjor për arritjen e marrëveshjes është 90 ditë. Parimisht dallohen tre lloje të ndërmjetësimit dhe ato do të paraqiten siç janë përshkruar në një manual trajnimit të USAID-it:

Ndërmjetësimi lehtësues, ndërmjetësuesi synon që të adresojë interesat e palëve në konflikt si mjete për të tejkaluar qëndrimet kokëforta të cilat i mbajnë palët gjatë konfliktit. Dallimi në mes të qëndrimeve dhe interesave mund të përshkruhen si vijon: Qëndrimet janë ato çfarë palët kërkojnë, kurse interesat janë motivimet dhe nevojat prapa atyre kërkesave. Ndërmjetësuesi synon që të angazhojë palët në negociata parimore në bazë të interesave dhe nevojave të tyre në vend se të përqendrohet në qëndrimet e tyre. Gjatë adresimit të nevojave, ndërmjetësuesi synon në inkurajimin e palëve që të zhvillojnë mendime kreative me qëllim që të vijnë në zgjidhjet fito-fito. Ndërmjetësimi, ashtu siç është përkufizuar në Ligjin e Kosovës për Ndërmjetësim, është ndërmjetësim lehtësues.

Ndërmjetësimi vlerësues, ndërmjetësuesi kryen procesin e ndërmjetësimit duke shfrytëzuar vlerësimin e rezultatit të ngjashëm të procedurave gjyqësore nëse kontesti i dorëzohet gjykatës me qëllim që të bind palët për të arritur kompromisin. Rezultati i ngjashëm i procedurës (hipotetike) gjyqësore mund të sigurojë bazën për zgjidhje e kompromisit në mes të palëve.

Ndërmjetësimi transformues, palëve i jepet mundësia e përkufizimit të çështjeve kontestuese dhe të vendosin për kushtet e ujdisë. Përmes kësaj, palët kanë rastin që të njohin dhe të kuptojnë perspektivat e njëri-tjetrit. Një element i rëndësishëm i ndërmjetësimit transformues është synimi i ndërmjetësit që të transformojë palët përmes rritjes së moralit dhe duke ndryshuar mënyrën se si ato ndërliken dhe komunikojnë me njëri-tjetrin¹⁵.

Nga sa u fol, në Kosovë çështja e ndërmjetësimit është rregulluar me ligj të veçantë. Në Ligjin nr.03-L-057 (Ligji për Ndërmjetësim) thuhet: Kuvendi i Republikës së Kosovës.

¹⁵ "Manual trajnimit", Ligji për ndërmjetësimin, http://kontrata.net/repository/docs/USAID_CLE_Training_Manual_on_Mediation_24_May_2014_ALB_393354.pdf. fq.15-16

Në bazë të nenit 65, pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; me qëllim të rregullimit, organizimit, funksionimit, si dhe zgjedhjes së kontesteve në mënyrë sa më efektive me ndërmjetësim; Duke respektuar historinë tradicionale të ndërmjetësimit në Kosovë, si dhe synimin për avancimin e sistemit juridik në Kosovë; Miraton këtë LIGJ PËR NDËRMJETËSIM.

Ligji për Ndërmjetësim i Kosovës rregullon themelimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit për ndërmjetësim, sikundër të drejtat dhe detyrimet e ndërmjetësuesit në Kosovë dhe kualifikimin e tij.

Kreu IV i ligjit, konkretisht nenet 17-21 rregullojnë çështjen e organizimit dhe kompetencat e Komisionit për Ndërmjetësim të Kosovës, i cili ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Përcaktimi i politikave zhvillimore lidhur me fushën e ndërmjetësimit;
- b) Nxjerrja dhe mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të Kodit të etikës profesionale për ndërmjetësues;
- c) Nxjerrja e vendimeve dhe rekomandimeve për rregullimin e fushëveprimtarisë së ndërmjetësimit;
- d) Nxjerrja e rregullores së punës së tij;
- e) Përpilimi dhe mbajtja e regjistrit për ndërmjetësues;
- f) Dhënia e mendimeve profesionale;
- g) Organizimi i trajnimeve dhe kurseve për ndërmjetësues;
- h) Informimi i publikut për mundësitë e ndërmjetësimit;
- i) Ushtrimi i detyrave tjera të përcaktuara me këtë ligj.¹⁶

Kurse është me rëndësi të nxirret edhe përbërja e Komisionit për Ndërmjetësim të Kosovës, si trupi kryesor i ndërmjetësimit në Kosovës. Ky Komision përbëhet nga përfaqësues të këtyre institucioneve:

- a) Ministria e Drejtësisë;
- b) Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- c) Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- d) Oda e Avokatëve të Kosovës;
- e) Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale;

Nga këtu shohim se përbërja e Komisionit për Ndërmjetësim është kualitative dhe kjo tregon se Komisioni përbëhet nga përfaqësues që janë profesionistë në fushën e drejtësisë në rradhë të parë dhe kjo tregon se ndërmjetësimit me ligj i është kushtuar rëndësia e duhur. Është çështje tjetër se sa është arritur që përmbajtësisht dhe kualitativisht të përdoret në praktikë ndërmjetësimi në Kosovë. Fillimisht është dashur të krijohet një strukturë dhe infrastrukturë e duhur që të fillohet me procesin e ndërmjetësimit në Kosovë. Kështu është krijuar Komisioni për Ndërmjetësim i Kosovës dhe duke u bazuar në Ligjin për Ndërmjetësim të Kosovës është bërë përzgjedhja e ndërmjetësuesve, që është bërë përmes procedurës së konkursit. Kandidatët e zgjedhur i janë nënshtruar trajnimeve të nevojshme sipas ligjit dhe sot në Kosovë figurojnë të janë certifikuar 170 ndërmjetësues¹⁷. Në zhvillimin e shkathtësive të ndërmjetësuesve kanë kontribuar krahas Komisionit dhe krahas angazhimit të Ministrisë së Drejtësisë edhe organizatat si UNDP, Partners Kosova, etj. Trajnimet dhe investimi në ndërmjetësues duhet të jetë një investim në një kapital që mund t'i shërbejë një shoqërie të shëndoshë në Kosovë. Por investimi që është bërë deri më tash duhet të ndryshojë medoemos. Kontestet dhe numri i tyre që delegohen nga gjykatat në procedurë ndërmjetësimi nuk

¹⁶ Neni 19 i Ligjit për Ndërmjetësim Nr.03/L-057

¹⁷ Lista e përditësuar me 19.05.2016 nga Komisioni për Ndërmjetësim

janë gjithaq të vogla krahasuar me kornizën kohore të paraqitjes së ndërmjetësimi në Kosovë. Në tabelën e mëposhtme, të marrë nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës shihet se trendi i numrit të lëndëve në procedurë ndërmjetësimi është në rritje dhe nëse i hidhet një sy faqes elektronike të kësaj Ministrie, aty mund të gjinden edhe të dhëna lidhur me fushat ku këto konteste janë deleguar nga gjykatat dhe prokuroritë tek ndërmjetësuesit kosovar. Gjithsesi trendi është në rritje. Në fazat e ardhshme duhet thelluar analiza edhe për kualitetin dhe për arritjen e qëllimeve dhe objektivave që parashtrihen përpara ndërmjetësuesve dhe procedurave të ndërmjetësimi në Kosovë. Ligji aktual i ndërmjetësimi është në procedurë të plotësimeve dhe të ndryshimeve.

Numri total 2012-2013-2014- 2015	Prishtinë	Ferizaj	Gjakovë	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Prizren	Total
Raste të referuara nga Gjykata	610	191	151	305	476	114	118	1965
Raste të referuara nga Prokuroria	430	181	202	56	16	129	122	1136
Raste me vet Referim	31	21	21	4	18	99	3	197
Të referuara gjithsej për Ndërmjetësim	1071	393	374	365	511	338	243	3295
Të zgjidhura gjithsej	1009	232	280	224	408	285	24	2462
Të pazgjidhura gjithsej	28	51	79	127	62	56	18	421
Në proces (shifra e totalit varion)								

Burimi: Të dhëna sipas Ministrisë së Drejtësisë¹⁸

Përfundimet

Kosova ka shënuar një progres në fushën e ndërmjetësimi. Progresi është i natyrës infrastrukturore, sepse është nxjerrë një Ligj për Ndërmjetësimin i cili ka gjetur zbatimin e vet në Kosovë. Bazuar në këtë ligj në Kosovë është krijuar një ekipë e trajnuar dhe e certifikuar e ndërmjetësuesve, të cilët kanë filluar të zhvillojnë aktivitete praktike të ndërmjetësimi. Numri i rasteve të deleguara nga gjykatat dhe nga prokuroritë ka shënuar rritje dhe me gjasë ky trend do të vazhdojë, sepse nevoja për shkarkim të numrit të lëndëve është e madhe. Gjykatat janë të stërngarkuara me lëndë dhe delegimi i lëndëve tek ndërmjetësuesit është një lehtësim për gjykatës dhe për prokuror. Është një lehtësim edhe për të gjithë ata që dëshirojnë të përpilojnë raporte, me të cilat tregojnë se është arritur kjo e kjo punë; se janë zgjidhur kaq e kaq raste; se shpenzimet kanë qenë më të vogla; se lëndët janë zgjidhur shumë më shpejtë; se palët janë ndarë të kënaqura dhe kështu me rradhë.

Nga ajo që mund të shihet deri më tash përkundër trendit në rritje në kuptim të delegimit të rasteve nga gjykatat dhe nga prokuroritë tek ndërmjetësuesit, mund të thuhet se në Kosovë akoma ndërmjetësimi është në fazën fillestare. Numri i trajnuar dhe i certifikuar i ndërmjetësuesve në Kosovë nuk është vetvetiu garancë e sukseseve për zgjidhje të kontesteve/konflikteve. Edhe tradita e pajtimit e bazuar në praktikën

¹⁸ <http://www.md-ks.net/?page=1,161> (qasur me 29.05.2016).

dhe në të drejtën zakonore nuk është garancë. Ndërmjetësuesit janë pjesë e sistemit të drejtësisë dhe nuk mund të shikohen ndaras nga sistemi i drejtësisë. Dhe nëse është pjesë e sistemit të drejtësisë, atëherë besueshmëria në këtë sistem është mjaft e vogël nga qytetarët. Kjo shihet nga shumë hulumtime të opinionit. Nëse qytetarët, konkretisht palët në konflikt apo në kontest nuk besojnë në drejtësi, si mund të besojnë në një apo dy ndërmjetësues, fuqia e të cilëve mbetet esencialisht e vogël. Si mund të besohet tek në rradhë të parë arritja e një marrëveshjeje me të cilën zjidhet kontesti dhe si mundet pastaj që kjo marrëveshje të zbatohet. Zbatimi i vendimeve gjyqësore është mjaft i vështirë në Kosovë dhe kur kemi një situatë të tillë, është vështirë që palët të besojnë në zbatimin e marrëveshjeje, të cilat natyrisht kanë formën e vendimeve të formës së prerë. Ndërmjetësuesit e dikurshëm apo ndërmjetësimi dikur kishte një forcë që dilte nga pushteti moral dhe si produkt i rrethanave të caktuara shoqërore. Ndërmjetësuesit e dikurshëm kishin një autoritet moral dhe forcë të jashtëzakonshme kohezioni. Ndërmjetësuesit e sotëm pavarësisht përgatitjeve profesionale, pavarësisht dëshirës dhe përkushtimit për të punuar në këtë fushë, nuk punojnë dhe nuk veprojnë në rrethana ku pushteti moral të ketë forcë dominante. Qëllimi i ndërmjetësimit nuk do duhej të jetë shkarkimi i numrit të lëndëve nga gjykata dhe prokuroritë (si qëllim në vete ose si qëllim i vetëm) sepse kjo atëherë nuk do të ketë rol substancial. Krahas investimeve në ndërmjetësues, nocioni ndërmjetësues duhet të bëhet më i depërtueshëm tek qytetari dhe kjo mund të arrihet përmes fushatave të ndryshme të sensibilizimit sikundër edhe përmes aktiviteteve të ndryshme kreative të edukimit. Bashkëpunimi në mes gjyqtarëve dhe prokurorëve në një anë dhe ndërmjetësuesve në anën tjetër duhet të jetë i vazhdueshëm, përmbajtësor dhe raporti nuk duhet të kuptohet si raport në mes eprorëve dhe vartësve, ku gjyqtarët/prokurorët do të paraqiten si epror të cilët lëndë të caktuara i delegojnë të zgjidhen tek ata që janë në pozitë më të ulët të vendimmarrjes. Këtu duhet të kuptohet dhe të veprohet në kuptim dhe në drejtim të asaj se të gjithë janë pjesë e sistemit të drejtësisë dhe të gjithë (prokurorët, gjyqtarët dhe ndërmjetësuesit) në fund të fundit angazhohen për një shoqëri të shëndoshë, ku dukuritë e konflikteve/kontesteve kur paraqiten zgjidhen përmes demokratizimit të sistemit gjyqësor dhe përmes aktiviteteve të pranueshme të ndërmjetësimit.

LITERATURA

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.
2. Ligji për Ndërmjetësim Nr.03/L-057 i datës 18.09.2008.
3. Ligji për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Nr.10385 i datës 24.02.2011.
4. Kanuni i Lekë Dukagjinit.
5. “Fjalor i shqipes së sotme”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Toena, Tiranë 2002.
6. Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë 2015.
7. Bulletin 7 ,Volume 7, të ADR Bulletin
8. <http://www.mediationmattersd.com/mediationmatters/history.html>
9. Zef Ahmeti, “Mes traditës dhe modernes”,www.mediation-beratungen.ch
10. http://pashtriku.beepworld.de/pirraku_patimi.htm
11. “Manual trajnimi”, Ligji për ndërmjetësimin, http://kontrata.net/repository/docs/USAID_CLE_Training_Manual_on_Mediation_24_May_2014_ALB_393354.pdf
12. <http://www.cadmusjournal.org/node/98>

Erosi i Migjenit në letërsinë shqipe



Abstrakt

Migjeni, shkrimtari që guxoi të thyejë tabu dhe kulte, që për vite të tëra ishin hyjenizuar dhe trajtuar si të tilla në letërsinë shqipe. Por meritë e Migjenit mbetet se ai e “çliroi” letërsinë shqipe nga tabutë dhe “çeli” rrugën për një letërsi të re, për një letërsi qytetare, pra një letërsi migjeniane, letërsi qytetase.

Në këtë punim do të theksojmë më shumë thyrjen e tabuve të tij, me anë të erosit, ai goditi çdo tabu, që mbante “peng” letërsinë shqipe deri në ardhjen e tij.

Ai goditi edhe me anë të erosit, ku arriti të flasë hapur brenda caqeve të realitetit të botës seksuale, që e rrethonte si dhe për “mollën e ndaluar”, që kishte “shijen më të mirë”.

Brenda shekullit që krijoi ai donte njeriun e ri, lindjen e një njeriu, që do të zhdukë çdo skamje, çdo lot, çdo dorë të shtirë.

Fjalët kyçe: *Eros, molla e ndaluar, qytet, “tabu”, “peng”, dy buzë, pak dashuri.*

Dashuria-Erosi është një zjarr, që duke ndezur hiret e tij të para në qoshen e fshehur të një kraharori i kapur, nga një shkëndijë endacake e një tjetër zemre digjet e përhapet, derisa ngroh e rrezaton mbi mijëra burra e gra, mbi zemrën universale të gjithçkaje, duke ndriçuar kështu gjithë botën dhe natyrën e tij bujare¹.

Migjeni godet aty ku duhet të godasë, ai i jep një goditje të fuqishme shekullit të kaluar, duke kënduar këngën e shekullit të ri.

*N'atë birtë e shekullit të ri,
Vllazën të lindun e të rritur në zi,
Kur tingëlloi çast'i ynë i mbramë,
Edhe fatlumë,
Ditën me thanë:
S'duem me humbë...².*

Kjo goditje e tij në letërsi lyen me buzëkuq dhe mollëzat e mjerimit, që kanë gjetur strehë te poema e mjerimit, por edhe në shumë novela të Migjenit. Kësaj goditje i kalon jeta ndër vargje dhe rima:

*... Dhe Syparja ra...
Protagonist vdiq...
Por nuk vdes shampanja!³.*

I moralshëm është njeriu që reagon ndaj tundimeve të brendshme pa rënë pre e tyre⁴.

Frodji ky mjekt-psikoanalist i kohërave ka studiuar “njeriun” në prani dhe mosprani, ka studiuar parimet e jetës duke thyer “tabu”, ka studiuar letërsinë dhe artet njëkohësisht. Migjeni nuk pranon “Tabu-Tema- dhe Tabu +Farma. Ai nuk kërkonte formula në të shkruar, thjesht kërkonte transformime artistike⁵.

Ethet e tuberkulozit ishin shenjë e një djegieje të brendshme: i sëmuri “tretej” nga një zjarmi e brendshme, zjarmi që shpinte në shpërbërjen e trupit.

Përdorimi i metaforave të marra nga tuberkulozi për të përshkruar dashurinë-figura e dashurisë së “sëmurë”, e pasionit që të “shkrin” është bërë shumë kohë para lëvizjes romantike⁶.

Te pak poezi, ku do të thotë pak dashuri, një dashuri e veçantë që reliteti dhe shoqëria e gjykojnë si këmbët që fsheh gjarpri: E due Lilushën!⁷

Po kush ishte Lilusha?...Lilusha ishte vajza e tezës së tij, ai nuk mund ta donte, siç mendonte ai, e në këtë mënyrë lind dëshira seksuale.

I poshtm! I poshtm! Hyn si hajn në shtëpi ku të presin si mik të sinqertë.

E due Lilushën! Si vajzë, si grue e due...

Poezia asht prona e të riu⁸, që nënkuptonte që dashuria është prona e të riu kushdo qoftë ai apo ajo.

Simptomat e sëmundjes nuk janë tjetër veçse një shfaqje e fshehtë e fuqisë së dashurisë; dhe çdo sëmundje s'është veçse dashuri e shpërfytyruar⁹.

Ashtu siç mund të parashikohet për një sëmundje, që ende nuk kuptohet plotësisht, dhe që është tejet e vështirë për t'u mjekuar, shfaqja e kësaj sëmundjeje të re të frikshme, të re të paktën në formën e saj epidemike, ka krijuar mundësi për metaforizimin e sëmundjes në shkallë të gjerë¹⁰.

¹Ralf Waldo Emerson, *Esse, Plejad, Tiranë, 2002, f. 100.*

²*Recital i malësorit, vepra.*

³*Rima e tretun, vepra.*

⁴Zigmund Frojd, *Mbi letërsinë dhe artet, Fan Noli, Tiranë, 2004.*

⁵Ibrahim Rugova, *Kahe dhe premise të kritikës letrare shqiptare, Euroilindja, 1996.*

⁶Susan Sontag, *Semundja si metaforë dhe sida dhe metaforat e saj, Korbi, Tiranë, 1991, f. 29.*

⁷*Pak poezi, vepra, f. 62.*

⁸*Pak poezi, vepra, f. 62.*

⁹Susan Sontag, *Semundja si metaforë dhe sida dhe metaforat e saj, Korbi, Tiranë, 1991, f. 29.*

¹⁰Susan Sontag, *Semundja si metaforë dhe sida dhe metaforat e saj, Korbi, Tiranë, 1991, f. 124.*

Pra nisur nga simptomat e para të Migjenit, kur flet hapur me dajeshën e tij për sëmundjen ai shprehet kështu: Jam i sëmurë, jam shumë i sëmurë; kam pështyrë gjak! Mbajini larg meje fëmijët! Mos më jepni me një enë me të tjerët¹¹.

Duke u nisur nga metoda biografike dhe ajo psikologjike na vijnë në ndihmë për rastin e Migjenit i cili na jep jo pak fakte në lidhje me jetën e tij personale dhe mbi të gjitha për sëmundjen e shekullit që e brente dita ditës.

Migjeni e dashuronte zonjushën B, kushërirën e tij ku njohim një histori krejt diskrete, si të mos shkruante “Pak poezi”, pra ai ishte qytetar, liberal.

Mjerimi dhe skamja në krijimtarinë e Migjenit janë ulur këmbëkryq duke shtypur, ndrydhur e shijuar format e veta siç ishte realiteti, e si të mos shkruante për “Lulin e vocërr”¹².

Se poezia e bukurisë asht aq e ngushtë e lidhun me atë që asht ma e fortë-me erotikën¹³. E një dashuri të tillë e gjejmë edhe te “Studenti në shtëpi”, ku perëndimi vret veten në heshtje, kur kthehet në lindje.

Ma shumë qau kur u nda me të vëllanë apo.. Nushi për motrën ma të madhe, e cila me vjet iu avite, ndiqte një dashuri të pasun me kujtimet feminare. Gjithmonë bashkë. Ndër mbrambje të dimnit kur u duhej me fjetë, tue mbërhitë nga çarçafë te ftohtë të dyshekut iu avitshin shoqi-shoqit..trupnat e tyne u nxejshin mjaft, atëherë ndjejshin praninë e një gjas së tretë, të huej¹⁴.

Miti poetik tregon se Njeriu ishte ndarë në dy gjysma, burrë dhe grua ku këto dy gjysma pra sic shihet duke thyer caqe të çdo natyre dhe kategorie synojnë të bashkohen, të ribashkohen përmes dashurisë, duke mos përfillur psikologjinë e thashëthemeve ku ato jetojnë dhe duan të ribashkohen. Frojdi shprehet se: “Ka vetëm një formë dashurie dhe kjo është dashuria erotike¹⁵.”

Migjeni jetonte në mes dy raporteve të atij politik dhe të atij fetar, por shohim se Migjeni sfidoi çdo ideologji, duke shkruar deri në përqeshje të tyre.

*Në vend të devotshmërisë ndaj fesë ajo do t'i nxiste,
përçimin ndaj saj në vend të përvuajtjes, krenarinë,
në vend të mospërfilljes për gëzimet e jetës etjen për to,
madje në skajshmërinë e tyre, atje ku feja sfidohej,
më vdeksëm: mëkatën, erotizmin gjer në iceshtë¹⁶.*

Identifikimi me mjerimin shoqëror kombëtar, si edhe me atë njerëzor i Migjenit, del si rezultat i natyrshëm nga konteksti dhe nga rrethanat historiko-shoqërore-aq sa edhe nga natyra e brendëshme e njeriut, sidomos krijuesit¹⁷.

Ndoshta ka me ardhun...

Ndoshta ka me zbardhun..

Një agim i pritun, dit' e parathanun¹⁸.

Tematika erotike në vëllimin e Migjenit zë një vend dhe hapësirë jo të vogël, por kjo temë nuk është trajtuar aq sa duhet në studimet shqiptare. Sjellim ndërmend poezën “Dy buzë”, ku autori jep idenë e tij përmes këtyre vargjeve:

*Dy buzë të kuqe,
Dy dëshira të flakta,
Që afshin ma thithën,
Gëzimin ma fikën,
Si fantazma hikën,*

¹¹Vehbi Bala, *Portret monografi-Migjeni*, Tiranë, 8 Nëntori, 1977.

¹²Ramazan Vozga, *Thellësia e fjalës në: Studime dhe artikuj kritikë*, Naim Frashëri, Tiranë, 1983.

¹³Pak poezi, vepra, f. 62

¹⁴Student në shtëpi, vepra, f. 132.

¹⁵Frojd, *Rëndësia e babait në jetën e fëmijës*.

¹⁶Ismail Kadare, *Arhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, f. 20.

¹⁷Migjeni-Kritikë 4, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 23.

¹⁸Trajtat e mbinjeriut, vepra, f. 29.

*ndër do bota t'larta.
Ato dy buzë të kuqe,
dhe dy lotë të mija,
qenë shenjat e dhimbjes,
kur më vrau bukuria,
me më dogji rinia.*

Thelbi i arsyes është garanci ,se atëherë do tu jepet vendi i duhur ndjenjave njerëzore dhe faktorëve që i përcakton ato¹⁹, por pasioni rindërton botën për rininë. Ai bën të gjitha të gjalla dhe kuptimplota²⁰.

Thellë në shpirtin e Migjenit, gjykatësi i ashpër moral i quejtur Super Ego ia ndalon të dashurohet në femrën prej mishi e gjaku, me të meta dhe me virtyte, që gjithmonë shkojnë bashkë. Ai dashurohet në femrën-ide-e-dashurisë, në femrën e adhureshme, në gruan-hyjneshtë, në gruan që nuk ekziston, në gruan që ekziston në imagjinatën e tij. Ai kërkonte një dashuri, pa prekje fizike.

Përfundime:

Parë në tërësi vepra e Migjenit shënon një hap të ri në historiografinë dhe letërsinë shqipe.

Protagonistët e tij thyjnë caqe të çdo natyre dhe kategorie, ku synojnë të bashkohen, të ribashkohen përmes dashurisë duke mos përfilluar psikologjinë dhe thathemet ku ato jetojnë.

Ai goditi edhe me anë të erosit, ku arriti të flasë hapur brenda caqeve të realitetit të botës seksuale, që e rrethonte si dhe për “mollën e ndaluar” që kishte “shijen më të mirë”.

Është shkrimtari që i këndoi në këngët e tij vullleve dhe psikologjive të deformuara nga forca e rëndë e kanunit, ku të gjithë ata që guxojnë të thyejnë ndonjë nye të tij denohet po sipas kanunit.

Sipas Migjenit “Mbinjeriu” s’duhet të ketë baba, s’duhet të ketë prejardhje gjenetike, ai duhet të sfidojë shumëçka për të fituar domosdoshmërinë e diçkaje me shumë vlera dhe virtyte, të një pasurie pa teste, pa dokumente, e kjo është jeta.

¹⁹ Zigmund Frojd, *Hyrje në psikoanalizë, vëllimi 3*, Fan Noli, Tiranë, f. 204.

²⁰ Ralf Waldo Emerson, *Esse, Plejad*, Tiranë, 2002, f. 102.

LITERATURA:

1. Ibrahim Rugova, *Kahe dhe premise të kritikës letrare shqiptare*, Eurorilindja, 1996.
2. Ismail Kadare, *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*,
3. *Migjeni-Kritikë 4*, Rilindja, Prishtinë, 1977.
4. Ralf Waldo Emerson, *Esse*, Plejad, Tiranë, 2002.
5. Ramazan Vozga, *Thellësia e fjalës në: Studime dhe artikuj kritikë*, Naim Frashëri, Tiranë, 1983.
6. Sefedin Fetiu, *Veptra e Migjenit dhe kritika e saj*, Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1984.
7. Susan Sontag, *Sëmundja si metaforë dhe sida dhe metaforat e saj*, Korbi, Tiranë, 1991.
8. Vehbi Bala, *Portret monografi-Migjeni*, 8 nëntori, Tiranë, 1977.
9. Zigmund Frojd, *Hyrje në psikoanalizë*, vëllimi 3, Fan Noli, Tiranë.
10. Zigmund Frojd, *Mbi letërsinë dhe artet*, Fan Noli, Tiranë, 2004.

Federata "Vatra", organizata "Shqipëria e Lirë" dhe denoncimi i politikave aneksioniste greke në Shqipërinë e Jugut gjatë Luftës së Dytë Botërore



Abstrakt

Federata "Vatra" dhe organizata "Shqipëria e Lirë", përbëjnë dy nga shtyllat më të fuqishme rreth të cilëve janë mbështetur emigrantët shqiptarë në Shtetet e Bashkuara. Federata "Vatra" ka një histori suksesi që nga viti 1912 vit i themelimit të saj si organizatë dhe këtë politikë suksesi u mundua që t'a zhvillonte edhe në ditët më të vështira të Shqipërisë, në Luftën e Dytë Botërore. Marrëdhëniet e federatës "Vatra" me Shqipërinë kanë qenë të lidhura ngushtë që në momentin e krijimit të saj si organizatë më 1912-ën. Kjo vinte nga fakti se themeluesit e kësaj organizate, në pjesën më të madhe ishin njerëz të cilët kishin jetuar në Shqipëri dhe sepse ata mund të lëviznin shpesh herë nga Shqipëria në Amerikë. Por zhvillimi i Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë do të thoshte, një kërcënim territorial. Përveç veriut të Shqipërisë, në rrezik ekzistencial do të ishte edhe Shqipëria e Jugut. Historikisht për këtë pjesë të territorit shqiptar, Greqia ka patur pretendimet e saja. Federata "Vatra" dhe organizata "Shqipëria e Lirë", marrin të gjitha masat e duhura diplomatike dhe propagandistike që kjo politikë ekspansioniste të mos realizohej. Por në rrugën e saj të vështirë me përballjen e kërcënimit grek, federata "Vatra" kishte disa vështirësi të cilat përbënin pengesë për të. Njëra nga këto vështirësi

ishte edhe mungesa e një qeverie shqiptare në emigracion. Kjo ishte mungesa kyçe e cila do t'a bënte shumë të vështirë që federata "Vatra" dhe organizata "Shqipëria e Lirë", të avanconin në aktivitetin e tyre.

Në të njëjtën kohë, federata "Vatra" dhe organizata "Shqipëria e Lirë" do të përballeshin me injorimin e fuqive aleate si: Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe. Kjo politikë e dyerve të mbyllura ndaj emigracionit shqiptar në Shtetet e Bashkuara dhe Britaninë e Madhe, do t'a ekspozonte atë përballë fuqisë ekonomike dhe politike të emigracionit grek dhe qeverisë greke në ekzil. Qëllimi kryesor i punimit, është që të tregojë me anë të fakteve dhe dokumentave, angazhimin maksimal të emigracionit shqiptar në Shtetet e Bashkuara përballë presionit grek. Duke qenë e vetëdijshme se çështja shqiptare tashmë ishte vulosur në ambientet e kancelarive perëndimore, federata "Vatra" dhe organizata "Shqipëria e Lirë", mundoheshin që për çështjen e Shqipërisë, të kishin një qëndrim të njëjtë, duke lënë mënjanë ndasitë dhe kapriçot e çastit. Metoda e përdorur konsiston në një analizë të thelluar teorike duke u mbështetur në burime primare, autentike siç janë: dokumentat arkivore dhe burime dytësore si: gazetatat apo revistat shkencore. Në këtë punim një rëndësi e veçantë i është kushtuar cilësisë duke përdorur një logjikë të kulluar dhe një gjuhë të rrjedhshme e të kuptueshme.

Fjalë kyçe: *Federata "Vatra", organizata "Shqipëria e Lirë", Kisha Greke në SHBA, Departamenti i Shtetit, Foreign Office, gazeta "Dielli"*

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Federata "Vatra" dhe Organizata "Shqipëria e Lirë" u përballën me shumë pengesa në rrugën e tyre për njohjen e çështjes shqiptare dhe për mundësinë e formimit të një qeverie në emigracion. Me kohë ndërmjet këtyre dy organizatave kishin filluar kontraditat në lidhje me formën e regjimit pas luftës dhe udhëheqësin e saj. Fuqitë e Mëdha kishin shfaqur hapur mosdakortësinë me këto dy organizata për veprimet dhe vendimet që ato merrnin në lidhje me çështjen shqiptare. Britania e Madhe ishte kthyer në një makth për emigracionin shqiptar në Shtetet e Bashkuara dhe Londër. Asnjë iniciativë apo projekt nuk mund të shqyrtohej pa marrë më parë miratimin e Foreign Office. Prej kohësh Britania e Madhe kishte një prestigj, ndryshe nga fuqitë e tjera, për çështjen e Ballkanit. Ky patronazh i Britanisë së Madhe bëhej edhe më i rëndësishëm gjatë Luftës së Dytë Botërore. Greqia ishte aleati i saj kryesor, jo vetëm në Ballkan por edhe në Mesdhe. Ndryshe nga qeveria shqiptare në emigracion, Britania e Madhe pati një qasje krejt tjetër me qeverinë greke në Londër. Madje Britania e Madhe kontribuoi personalisht për ta lëvizur Mbretin George të Greqisë nga Kajro për në Londër. Shtetet e Bashkuara nuk kishin ndonjë satisfaksion për qeverinë greke të emigracionit, pasi Greqia dhe Ballkani në përgjithësi ishin konsideruar nga amerikanët jashtë sferës së tyre të interesit, duke e lënë atë nën kujdesin e veçantë britanik¹. Qasja amerikane ndaj Greqisë ishte thjesht një qasje miqësore me një vend i cili po luftonte kundër Gjermanëve. Gjithashtu Amerikanët kishin edhe një interes ushtarak për faktin se Greqia mund të bëhej qëndra e rezistencës kundër Gjermanëve ose një burim për inteligjencën². Për sa i përket qeverisë greke në emigracion, Shtetet e Bashkuara nuk shprehën ndonjë këndvështrim ndryshe nga ai i Britanisë së Madhe. Amerikanët e njohën Qeverinë Greke në emigracion si një qeveri legjitime, por nuk kishin ndonjë tërheqje për monarkinë greke³. Kjo nuk vinte nga fakti se Shtetet e Bashkuara kishin ndonjë kundërshti të veçantë ndaj Mbretit George të II të Greqisë, por sepse amerikanët besonin se republikanizimi është një formë qeverisje më efektive⁴. Emigracioni shqiptar në Shtetet e Bashkuara dhe Britaninë e Madhe njihej më në thellësi të presionit grek për

¹Robert Fraizer, "British and American Policy With regard the Greece, 1943-1947: the transformation from British to American patronage, Nottingham University, London: 1989, fq. 7.

²Po, aty, fq. 8.

³Po, aty, fq. 8.

⁴Po, aty, fq. 8.

çështjen shqiptare në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Për këtë arsye në shumë letra dhe telegrame ata kërkonin që të gjithë shqiptarët të ishin vigjilentë për pasojat e reagimit grek në Jug të Shqipërisë. Frikën e emigracionit shqiptar e kishte kuptuar edhe Foreign Office, e cila u gjend nën presion të vazhdueshëm nga ana e qeverisë greke në emigracion për çështjen e Shqipërisë së Jugut dhe të formimit të ndonjë qeverie shqiptare nga emigrantët politik në Angli dhe Shtetet e Bashkuara.

Aktiviteti i dëndur i emigracionit grek në Britaninë e Madhe bëri që deklarata e Foreign Office për Shqipërinë të vinte shumë vonë, në dhjetor 1942. Qeveria greke e njihte nga afër situatën në Britaninë e Madhe dhe planet që bëheshin atje. Vetë Anthony Eden u mundua që ta justifikonte deklaratën e 17 dhjetorit 1942. Në një letër që Eden i dërgon ambasadorit grek në Britaninë e Madhe, Aghnides ai shkruan: *"Unë e mendoj se qeveria greke duhet të vihet në djeni se Qeveria e Madhërisë së Tij ka vendosur se ka ardhur momenti për të njohur pavarësinë e Shqipërisë. Shqipëria u pushtua nga Italia në prill të 1939. Në atë kohë Qeveria e Madhërisë së Tij e dënoi pushtimin Italian. Në 19 qershor 1940, pasi Italia hyri në luftë, Qeveria e Madhërisë së Tij deklaroi se ata kanë fituar ndjenjën e lirë për çdo aksion që zëvillonin kundër pushtimit Italian. Që në kohën e pushtimit të Shqipërisë nga Italia, Qeveria e Madhërisë së Tij duke mos përcaktuar një qëndrim për të ardhmen e Shqipërisë, ka qenë e lirë për ta bërë këtë gjë në qoftë se ajo e dëshiron. Mbreti Zog do të informohet se Qeveria e Madhërisë së Tij nuk është e përgatitur për ta mbështetur atë për në fron. Unë kam besim se kjo deklaratë do të ketë aprovimin e qeverisë suaj"*⁵. Me anë të kësaj letre Anthony Eden u mundua të qetësonte zërat kritikë në ambientet e qeverisë greke në Londër. Por qeveria greke nuk do të qëndronte mënjane përballë kësaj situatë dhe planeve britanike për Shqipërinë. E informuar mirë për planin e Britanisë së Madhe për një deklaratë në favor të Shqipërisë dhe të ardhmes së saj, qeveria greke bën demarshe të pafund që kjo të mos ndodh. Por edhe sikur të ndodhte ajo të sigurohej që deklarata të ishte sa më e cinguar në lidhje me çështjen e kufijëve. Më 14 dhjetor 1942, vetëm tre ditë nga deklarata e Edenit në Dhomën e Komunave, ambasadori grek Aghnides i dërgon një letër të gjatë Anthony Edenit ku i shpjegon: *"Qeveria jonë ka njoftuar menjëherë Qeverinë e Madhërisë së Jugosllavisë dhe kanë rënë dakort që: duke marrë parasysh idealin e lartë të Kombeve të Bashkuara dhe Greqisë, Qeveria Mbretërore Greke nuk ka ndonjë kundërshtim ndaj Qeverisë së Madhërisë së Tij në lidhje me vendosjen e pavarësisë së Shqipërisë. Ne besojmë se një rivendosje e pavarësisë të jetë e lidhur me mbrojtjen e nevojshme të të drejtave vitale dhe legjitime të Greqisë. Qeveria ime ka njoftuar se çështja e regjimit të Shqipërisë të vendoset pas lufte dhe kjo do të jetë një çështje e vetë shqiptarëve. Në biem të gjithë dakort se deri në fund të luftës asnjë Qeveri Shqiptare ose lëvizje për Shqipërinë në emigracion nuk duhet të njihet. Ne ndjehemi të sigurt se ju do ta kuptoni se siguria e Greqisë dhe e të gjithë Gadishullit Ballkanik, varet nga ndalimi i shteteve jo-Ballkanike për të shkelur në territorin shqiptar. Ne guxojmë të shpresojmë se deklarata juaj është një njohje e nënkuptuar e interesave speciale në Shqipëri të cilat duhet t'i njihen Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Gjithashtu të drejtat tona në lidhje me Epirin e Veriut janë shumë të njohur për ju pasi j'ua kemi bërë me dije disa herë. Çështja e Epirit të Veriut është shumë vitale për Greqinë dhe ne nuk do të bëhemi pjesë e ndonjë plani nga ana juaj nëse e injoroni këtë çështje"*⁶.

Insistimi i qeverisë greke në emigracion e detyroi edhe njëherë Anthony Eden që të bënte një sqarim në lidhje me deklaratën e tij. Në një komunikim me ambasadorin grek ai i deklaroi se: *"Për sa i përket çështjes së kufijve ajo ndryshon nga letra që të kam dërguar më 11 dhjetor, pasi në deklaratën e 17 dhjetorit unë kam thënë një gjë tjetër, që çështja e kufijve të Shqipërisë do të diskutohet në një konferencë të paqes. Objektivi ynë kryesor për Shqipërinë është ta bëjmë të qartë se në asnjë mënyrë ne nuk do të njohim ndonjë interes të veçantë të Italisë në Shqipëri. Deklarata nuk paragjykon në asnjë mënyrë kërkesat greke për*

⁵ FO, 371/33108-089, V.1942, Fl. 8, "Letër e dërguar nga Anthony Eden për Ambasadorin grek në Angli për çështjen e deklaratës së 17 dhjetorit 1942".

⁶ FO, 371/33108-090, V.1942, Fl. 2, "Letër e Ambasadorit Grek në Angli për Anthony Eden në lidhje me deklaratën e dhjetorit 1942".

territore. Unë e di se Greqia do të donte të na shikonte ne me një deklaratë në mbështetje të interesave Greke në Shqipërinë e Jugut, por unë e them me siguri se ne duhet të ndjekim një politikë të zgjuar për të mos i diskutuar kërkesat territoriale gjatë luftës. Rezultati do të ishte një konfuzion i pazgjidhshëm”.⁷ Diplomacia greke vepronte me shpejtësi për të shfrytëzuar në maksimum mundësinë që i jepej duke qënë e njohur nga autoritete britanike. Në dhjetor 1942 ambasadori grek me antë të një note të qeverisë greke, kërkonte të dinte për çështjen e jugut të Shqipërisë. Edhe në këtë rast britanikët u munduan të qetësonin ambasadorin grek duke i thënë se çështja e kufijëve të shqipërisë do të shqyrtohet në konferencën e paqes. Sado të mëdha do të ishin lëvizjet greke në emigracion, qëndrimi britanik nuk do të ndryshonte kurrë publikisht për sa i përket deklaratës së tyre.⁸ Britanikët kishin shumë eksperinecë në marrëdhëniet ndërkombëtare saqë situata të mos u dilte jashtë kontrollit. Ata synonin që të fitonin besimin e emigracionit shiptar dhe të mos humbisnin miqësinë greke. Për këtë arsye kërkesave të grekëve për Shqipërinë e Jugut, Foreign Office ia kthente se: “Kjo çështje, të rrish i sigurt, do të trajtohet në momentin e duhur”.⁹

Qeveria greke në Londër mbas këtyre premtimeve është në mbështetje të plotë të deklaratës së Antony Eden. Në fund të dhjetorit 1942 qeveria greke dhe jugosllave pas diskutimeve bënë një deklaratë të përbashkët në të cilën: “E kuptojnë arsyen të cilën e shtynë Qeverinë e Madhërisë së Tij për të bërë një deklaratë për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë. I është dhënë një rëndësi e veçantë mbrojtjes së Ballkanit nga fuqitë jashtë saj. Ramë dakortë që regjimi i ardhshëm i Shqipërisë duhet të vendoset mbas përfundimit të luftës dhe asnjë qeveri shqiptare apo lëvizje të emigracionit shqiptar nuk do të njihet. Kuptuam që çdo bisedë në për sa i përket çështjes së territorit do të ishte e parakohshme”.¹⁰ Qeveria greke dhe jugosllave ishte dakortësuar tashmë se çështja e kufijëve të Shqipërisë së Jugut do të diskutohet mbas luftës. Planet britanike për të ardhmen e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore filluan të intesifikoheshin në vitin 1943. Çdo projekt që përgatitje apo analizohej për Shqipërinë nuk bëhej pa marrë parasysh kërkesat greke. Zyrat e shërbimeve strategjike dhe Foreign Office e shikojnë të ardhmen e Greqisë të lidhur me Shqipërinë e Jugut. Britania i mëshonte faktit se mbas luftës shteti shqiptar do të kishte nevojë për një asistencë ndërkombëtare dhe në disa fusha të drejtohej nga këshilltarë të huaj.¹¹ Britanikët parashikonin se mundësia e një Shqipërie të pavarur do të varej nga kapaciteti i popullit shqiptar për t’u bashkuara mes tyre; zhvillimet ekonomike dhe financiare të Shqipërisë dhe qëndrimi ndaj fqinjëve të Shqipërisë.¹² Për sa i përket çështjes së parë, britanikët analizonin se situata në Shqipëri gjatë viteve të para 1939 ishte nën kontrollin e Ahmet Zogut. Populli shqiptar është mësuar të udhëhiqet nga shumë liderë të ndryshëm fisnor dhe në disa raste nuk e ka njohur autoritetin e Zogut. Për këtë arsye për Shqipërinë nevojitet një lider i fortë dhe përbashkues.¹³ Në rastin e financave del se ato kanë qënë vështirësia më e madhe e Shqipërisë. Ajo duhet të mendojë për nevojat bazë të popullit shqiptar dhe duhet të jetë e aftë të fitojë kreditë nga shtetet e huaja, në mënyrë që ato të mos e humbasin besimin si në kohën e Ahmet Zogut.¹⁴ Në lidhje me fqinjët dokumentacioni britanik analizon se Shqipëria ka vuajtur nga sulmet greke në Jug të Shqipërisë. Kërkesat greke për Shqipërinë kanë qënë dhe janë më të shpeshta dhe më të forta se kërkesat Jugosllave. Emigracioni grek ka bërë të qartë se ajo meriton të drejtën të kërkojë këtë pjesë të Shqipërisë jugore pas Luftës së Dytë Botërore.¹⁵

⁷FO, 371/33108-091, V.1942, F, 3, “Përgjigje e Anthony Eden për ambasadorin grek në lidhje me kërkesat e tyre të shprehura në deklaratën e 17 dhjetorit”.

⁸FO, 371/33108-079, V.1942, Fl, 2, “Bisede e Foreign Office me ambasadorin grek”.

⁹Po, aty, fl, 2.

¹⁰FO, 371/33108-126, V.1942, Fl, 42, “Deklaratë e përbashkët e qeverisë greke dhe jugosllave në emigracion në lidhje me deklaratën e Anthony Eden”.

¹¹AQSH, F.1510/1, V.1943, D.88, Fl, 4, “Draft i përgatitur nga Foreign Office për të ardhmen e Shqipërisë”.

¹²Po, aty, fl, 7.

¹³Po, aty, fl, 7-8.

¹⁴Po, aty, fl, 8.

¹⁵Po, aty, fl, 10.

Në po të njëjtën mënyrë Foreign Office u soll me qeverinë Jugosllave në emigracion. Ambasadori Jugosllav në Londër, Milanovitch, njofton Sekretarin e Shtetit për Çështjet e Jashtme Anthony Eden, se i udhëzuar nga qeveria Jugosllave e mirëkuptonte shumë mirë pozitën e Britanisë së Madhe kur Kombet e Bashkuara janë në ofensivë në Detin Mesdhe dhe bëra publike e një deklarate për pavarsinë e Shqipërisë është një shpresë për të provokuar një rezitencë të shqiptarëve kundër Italianëve¹⁶. Jugosllavët kërkonin garanci se asnjë fuqi e huaj nuk do të shkelte më territorin shqiptar në mënyrë që të mos kërcënonin të tërë Ballkanin. Të njëjtën qëndrim Jugosllavët mbajnë për çështjen e njohjes së një qeverie në mërgim të cilën e konsiderojnë të panevojshme për t'u njohur zyrtarisht dhe se një gjë e tillë duhet të vendoset mbas luftës. Ndërsa për çështjen e kufijve Jugosllavët mendojnë se është më e arsyeshme për t'u diskutuar në të ardhmen dhe se e kupton qëndrimin e Britanisë së Madhe¹⁷. Anthony Eden e falenderon ambasadorin Jugosllav për këtë letër dhe e siguron se deklara e 17 dhjetorit në Parlament ndryshon nga drafti i 11 dhjetorit 1942, për të cilën kemi rënë dakort se nga këndvështrimi i Qeverisë së Madhërisë së Tij çështja e kufijve të Shqipërisë mbas lufte është një çështje e cila duhet të lihet për diskutim në Konferencën e Paqes.¹⁸

Përveç Britanisë së Madhe, ishin Shtetet e Bashkuara të cilat shqetësoheshin për reagimet e grekëve dhe jugosllavëve që ndodheshin atje. Këtë shqetësim Departamenti i Shtetit dhe Kabineti i Luftës ia shpreh me anë të një telegrami Foreign Office ku ndër të tjera citon: *"Në pritje të përplasjeve midis grekëve dhe elementëve shqiptarë në Amerikë, unë do të gëzohesha nëse do të dija se me çfarë argumentash ta përballojë këtë kritikizëm të tyre. Deklarata e Cordell Hull nga ana tjetër ka frymëzuar një letër të shkruar nga Liga Pan-Epirotike e Amerikës. Liga gjithashtu ka dërguar një kopje të kësaj letre edhe tek mua me kërkesën që ta nisja ty duke thënë që: "Publikimi i fundit në Shtetet e Bashkuara dhe në Angli kanë shqetësuar Epirotët shumë seriozisht për të ardhmen e provincës natyrale të tyre". Kjo letër pasi shpjegonte historinë e marrëdhënieve greko-shqiptare përfundon "ne lutemi që asnjë gabim politik i qeverisë së Shteteve të Bashkuara të dekurajojë epirotët grekë kaq të çmuar dhe të vështirë për ta, për lirinë që ata po sakrifkohen"*¹⁹.

Me anë të kësaj letre kërkohet që veprimet mes dy shteteve të koordinoheshin qartësisht në mënyrë që të mos ngjallnin reagime të padëshiruara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. E menjëherëshme është edhe përgjigja e Foreign Office duke thënë se: *"Qeveria Greke dhe Jugosllave tashmë është e informuar për deklaratën e dhjetorit 1942. Çështje e kufijve, për të cilën ata janë shumë të interesuar, do të vendoset në Konferencën e Paqes mbas lufte. Gjithashtu për çdo insistim të emigracionit në Amerikë, ju rekomandojmë që ju të përdorni paragrafin 3 për t'iu dhënë përgjigje çdo kritike nga Grekët dhe Jugosllavët"*²⁰.

Ata që nuk mund të rrinin të qetë për presionin grek në Shtetet e Bashkuara por edhe në Britaninë e Madhe, ishte Federata "Vatra" dhe Organizata "Shqipëria e Lirë". Që në fillim të vitit 1940 Faik Konica kishte bërë një broshurë të vogël në lidhje me rrezikun grek, historinë e konfliktit me Shqipërinë dhe të ardhmen e këtyre marrëdhënieve. Në faqet e gazetës "Dielli" Konica donte të demaskonte të gjitha përpjekjet e ulëta të emigracionit dhe qeverisë greke për të bërë presion mbi Departamentin e Shtetit dhe Foreign Office, sidomos mbas deklaratës së Dhjetorit 1942. Por Faik Konica ishte gjithmonë në borxhe dhe kërkonte vazhdimisht para nga Ahmet Zogu që ta vazhdonte aktivitetin e tij në

¹⁶ FO, 371/33106-129, V.1942, F, 44, "Letër e Ambasadorit Jugosllav në Britaninë e Madhe për Anthony Eden ku e njofton për qëndrimin e qeverisë së tij për deklaratën e dhjetorit 1942".

¹⁷ Po, aty, fl, 44.

¹⁸ FO, 371/33108-128, V.1942, Fl, 12, "Telegram i Anthony Eden për Ambasadorin Jugosllav në Londër, Milanovitch në lidhje me çështjen e kufijve të Shqipërisë".

¹⁹ FO, 371/33107-1031, V.1942, Fl, 153, "Letër konfidenciale e Zyrës së Kabinetit të Luftës për Foreign Office në lidhje me emigracionin grek në Amerikë dhe reagimet e tyre për deklaratën e dhjetorit 1942".

²⁰ FO, 371/33107-1033, V.1942, Fl, 155, "Letër e Foreign Office për Zyrën e Luftës në Amerikë për çështjen e reagimeve të emigracionit grek dhe jugosllav në atë territor".

Shtetet e Bashkuara²¹. Në tetor 1942 Konica ka një korrespondencë me Ministrin e Zogut në Londër, Sotir Martini, të cilin e njofton për shumën e parave që kishte marrë nga Zogu. Kjo shumë ishte afërsisht 1000 dollarë . Për t'i ngritur moralin Ahmet Zogut, Konica e njofton Martinin së gjendja në kolonitë e “Vatrës” është e mirë dhe e përkrah qëndrimin e Zogut. Shpesh herë ata qeshin me deklaratat e Chekrezit dhe nuk i marrin ato seriozisht²². Kërkesat e Konicës për para ishin të vazhdueshme. Jeta e shtrenjtë që ai bënte mund ta kushtëzonte aktivitetin e tij në Amerikë. Shpesh herë Konica ishte tekanjoh me kërkesat e tij duke i vënë edhe kushte Sotir Martinin se për paratë duhet të mendojë për t'i dërguar me postë nga ajri dhe jo postë të zakonshme²³. Sipas Konicës 400 dollarë nuk mjaftojnë këtu duke marrë parasysh koston e lartë të jetesës²⁴. Gjithashtu Konica rekomandonte që shuma e parave të dërguara për çdo muaj nga Zogu të ndahej në këtë mënyrë: *“T’i thua 200 ose 300 dollarë për Nolin. Unë të lutem që të zgjedhësh për Nolin 300 dollarë. Për drejtorin e federatës “Vatra” Vasil Pani t’i duhet të dërgosh 600 dollarë. Këtu do të përfshihet dhe aktiviteti i gazetës “Dielli”. Të gjithë shumën mund të ma dërgosh mua dhe unë më pas ta shpërndaj”*.²⁵ Por Faik Konica vdes në 12 Dhjetor 1942 duke lënë një vakum në emigracionin shqiptar në Shtetet e Bashkuara. Tashmë një peshë të madhe do të merrte Fan Noli të cilin do t’i kërkohej që të bëhej kryetar nderi i Federatës “Vatra”. Në fund të dhjetorit 1942 Fan Noli, Federata “Vatra” dhe Kisha Ortodokse Shqiptare i dërgojnë një letër Ambasadorit Britanik në Shtetet e Bashkuara, Lord Halifax dhe Ambasadorit Sovjetik në Washington, Maxim Litviniov, në të cilën i kërkonin hapur që të ruhej integriteti territorial i Shqipërisë. Mbas deklaratës së dhjetorit 1942, kërkesat Greke dhe Jugosllave kundrejt Shqipërisë janë rritur tej mase, për këtë arsye njohja e Ahmet Zogut si kryetar i qeverisë shqiptare në emigracion është e pashmangshme²⁶. Në fund të letres ata shpreheshin të pakënaqur me qëndrimin e Chekrezit duke e quajtur një njeri pa arsye dhe se njohja e Zogut është e vetmja rrugë për të ndihmuar Shqipërinë²⁷.

E bindur se një peshë të madhe për të ardhmen e Shqipërisë ka edhe Britania e Madhe, Federata “Vatra” i dërgon një letër Anthony Eden në të cilën e falenderon shumë për deklaratën e Dhjetorit 1942, por nga ana tjetër ata janë të habitur se me anë të kësaj deklarata Shqipëria po përjeton një copëtimin shumë herë më të madhe se 1912-ta, e cila do ta bëjë pavarsinë shqiptare një iluzion²⁸. “Vatra” është e sigurt se fuqitë e aksit qëndror do ta përdorin deklaratën e tij për qëllime propagandistike dhe për të dekurajuar luftëtarët shqiptarë të cilët po luftojnë për një fitore të përbashkët²⁹. Në përfundim të letres federata “Vatra” kërkonte: *“Shqiptarëve duhet t’u jepet garanci e nevojshme për fatin e vendit të tyre në Konferencën e Paqes. Një siguri e tillë duhet të përfshijë garantimin e integritetit territorial të Shqipërisë e cila kërcënohet nga Greqia dhe së dyti njohjen zyrtare të një qeverie në emigracion me Ahmet Zogun në krye të saj duke i siguruar një vend për në Konferencën e Paqes”*³⁰. Në po të njëjtën mënyrë u shpreh edhe dega e “Vatrës” së Waterburyt në Shtetet e Bashkuara me kryetar Mehmet Tosun. Të gjitha

²¹Jason Tomes, “Zogu, self-made King of Albania”, London:2009, fq. 256.

²²Po, aty, fq. 131.

²³Po, aty, “Letër e Faik Konicës për Sotir Martinin më 26 Nëntor 1942”, fq. 96.

²⁴Po, aty, fq. 96.

²⁵Po, aty, fq. 96.

²⁶AQSH, F.14, V.1942, D.268, Fl. 2, “Letër e Federatës “Vatra” dhe Kishës Ortodokse në Amerikë rejtuar Ambasadorit britanik dhe sovjetik në Washington”.

²⁷Po, aty, fl. 2.

²⁸FO, 371/37138-849, V.1943, Fl. 1, “Letër e Federatës “Vatra” për Anthony Eden në lidhje me deklaratën e dhjetorit 1942”.

²⁹Po, aty, fl. 3.

³⁰Po, aty, fl. 3.

kolonitë shqiptare në Shtete e Bashkuara ishin të shqetësuara për kërcënimet greke dhe të ardhmen e Shqipërisë. Vasil Puci president i organizatës "Willson" shprehet se fqinjët tanë po e dekurajojnë lëvizje guerrile në Shqipëri³¹. Edhe shqiptarët e Filadelfias shpreheshin të kërcënuar nga kërkesat greke për Korçën dhe Gjirokastrën. Ata ishin të bindur se zhvillimi i një plebishiti për këto dy qytete mund të manipulohej nga ana e grekomanëve. Me këtë deklaratë bashkohej edhe organizata "Shqipëria e Lirë"³². Në po të njëjtën linjë ishte edhe Fan Noli. Rrezikun grek Noli ia transmeton edhe Cordell Hullit në vitin 1943 duke i thënë se: "*Simbas mendimit tim do të jetë në dobi për Kombet e Bashkuara me njoftë zyrtarisht Mbretin Zog dhe me i dhanë rast me luejt rolin e vet për shpejtimin e fitoreve që neve të gjithë e presim. Shpresoj se edhe juve e shifni këtë çështje me të njëjtën dritë dhe se do t'ju jepni sigurimet konkrete shqiptarëve se ç'ka Amerika ka ndërmend me ba në Konferencën e Paqes. Unë besoj se sigurimi më i mirë për t'iu ba shqiptarëve do të ishte me pranue zyrtarisht një qeveri shqiptare në mërgim nën Mbretin Zog në Lidhjen e Kombeve të Bashkuara dhe një garanci për integritetin tokësor të Shqipërisë. Një garanci e tillë është absolutisht e nevojshme për të eliminuar paqartësitë të ngritura nga Anthony Eden me deklaratën e tij në të cilën një nga çështjet të cilat do të diskutohen në Konferencën e Paqes do të ishin edhe copëtimi i Shqipërisë nga fqinjët Grekë dhe Jugosllavë*"³³.

Gazeta "Dielli" përpigjej të shfrytëzonte çdo mundësi për të shkruar dhe propaganduar fakte në dobi të Shqipërisë. Në marsin e 1943-ës gazeta "Dielli" publikon një shkrim të New-York Times me autor Sulzberger, i cili thekson se: "*Shqipëria është duke luftuar përsëri për lirinë e saj e distancuar plotësisht nga pjesa tjetër e botës. Shqipëria historikisht ka qënë e kërcënuar nga Greqia, Italia dhe Jugosllavia, që në momentin e shtatërrimit të Perandorisë Osmane. Përderisa asnjë qeveri shqiptare në emigracion nuk është njohur nga Kombet e Bashkuara kjo është një mision tepër i vështirë, por në vija të trasha pavarësia e Shqipërisë është njohur nga Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe Bashkimi Sovjetik*"³⁴. Sulzberger shprehet se shqiptarët kanë frikë për një copëtim të Shqipërisë midis Greqisë dhe Jugosllavisë. Kolonitë shqiptare në Shtetet e Bashkuara shpreheshin të vendosur për të vazhduar luftën e tyre në mbrojtjen e Shqipërisë. Ata nuk ishin dakort me pretendimet greke për Shqipërinë e Jugut dhe sillnin fakte se shqiptarët janë banorë autoktonë të atyre trevave. Një dyzinë me fakte për Shqipërinë e Jugut sollën edhe shqiptarët e Londrës. Tajar Zavalani dhe Anton Logoreci i bënin të ditur Hodgkinsonit se shqiptarët i kanë rrënjët e thella në këto territore. Ata nuk ishin dakort me pretendimet greke për të shqyrtuar çështjen e kufijve të Shqipërisë së Jugut mbas Luftës së Dytë Botërore dhe shpreheshin se Shqipëria, e cila u pushtua e para nga Italia fashiste, tani po vuan inefficencën e mos kooordinimit mes shqiptarëve të emigracionit³⁵. Gazeta "Dielli" aludonte se kërkimet e grekëve në Shqipërinë e Jugut nuk kanë bazë historike dhe ligjore. "Dielli" shprehej se marrja e Korçës dhe Gjirokastrës nga ana e Greqisë do t'a privonte Shqipërinë nga të qenit shtet³⁶.

Tashmë u ndie e nevojshme që emigrantët shqiptarë të sillnin sa më shumë fakte për jugun e Shqipërisë. Në gazetën "Dielli" botoheshin vazhdimisht fakte të cilat vërtetonin se: "*Shqipëria e Jugut përfshin dy qytetet më të mëdha si Korçën dhe Gjirokastrën;*

³¹ FO, 371/37138-886, V.1943, Fl, 2, "Letër e Vasil Pucit për Anthony Eden për rrezikun grek të Shqipërisë".

³² FO, 371/37138-890, V.1943, Fl, 4, "Letër e shqiptarëve të Filadelfias për Anthony Eden".

³³ FO, 371/37138-912, V.1942, Fl, 1-2, "Letër e Nolit për Cordell Hull ku i shpreh shqetësimin për rrezikun grek dhe nevojën e njohjes së Zogut në krye të një qeverie në emigracion".

³⁴ L. Sulzberger, "Albania fights on, though disregards by United Nations", Gazeta "Dielli", 27 Mars 1943, fq. 1-2.

³⁵ Tajar Zavalani dhe Anton Logoreci, "Ballkan Stability depends on justice for Albania", shkrim për Europën e Lirë por i marrë nga Gazeta "Dielli", 21 Maj 1943, fq. 3.

³⁶ Kërkimet e Grekëve s'kanë bazë sa i përket Shqipërisë së Jugut, Gazeta "Dielli" 24 Korrik 1943, fq. 2.

*Shqipëria e Jugut ka qënë zemra e nacionalizmit shqiptar; Nga Korça kanë dalë disa nga liderët kryesorë të Shqipërisë; Popullsia e Shqipërisë së Jugut është 100% shqiptare si në gjubën e folur, në tradita dhe ndjenja; Shqipëria e Jugut përfshin një popullsi sa një e katërta e gjithë popullsisë shqiptare që është vetëm 250.000; Të tjerët janë ortodoks dhe për këtë arsye Greqia bën propagandë për Jugun e Shqipërisë*³⁷. Në shumë shkrime të saj federata “Vatra” bënte me dije se grekët vazhdimisht bëjnë presione për Shqipërinë e Jugut. Në përgjigjen ndaj ambasadorit grek në Amerikë, Diamnatopulos, Peter Tyko shfaqte hapur gabimet që përmbante kjo letër e ambasadorit grek. Sipas tij kjo letër përmban shumë deklarata të çuditëshme dhe të gabuara krejtësisht. Peter Tyko si kundërpërgjigje deklaronte se në Shqipëri janë 250.000 njerëz dhe që të paktën 150.000 janë muhamedanë.³⁸ Kundërshtimeve të grekëve, federata “Vatra” u shton edhe informacionet e fundit që u vinin nga situata në Shqipëri. Sipas gazetës “Dielli”: *“Akuzat fantastike të Ambasadorit Grek në Washington s’bëjnë pesë para kur kqyren në bazë të lajmeve që vijnë nga Shqipëria. Pothua një mot më parë 1942, lart nga 50 grupe patriotësh që luftuan armikun, e gjetën të arsyeshme të heqin dorë nga ndryshimet që zotëronin mes tyre, nga pikpamja politike ose nga çdo pikpamje tjetër dhe të bëjnë një bashkim të përgjithshëm. Prandaj u formua Fronti i Përgjithshëm Çlirimtar. Kështu çetat dhe guerrilet dhe i tërë populli shqiptar treguan një maturë shembullore në shesh të politikës*”³⁹. Federata “Vatra” shprehej e pakënaqur edhe nga veprimet e ulëta të disa me demek epirotëve të cilët gjendeshin në Shtetet e Bashkuara.

Nga ana tjetër ideja e Tajar Zavalanit se njohja e një qeverie në emigracion do të shpëtonte Shqipërinë ose të paktën do të negociohej më me rigorozitet është e vërtetë. Të gjitha qeveritë e strehuara në Londër e kishin këtë privilegj. Vetëm Shqipëria detyrohej që të bënte demarshe të shumta nëpër dyert e kancelarive për të shprehur të paktën pikëpamjet e tyre për Shqipërinë. Por qëndrimet injoruese të Britanisë së Madhe dhe moskoordinimi me grupet shqiptare në emigracion e lanë vendin nën presionin e fqinjëve. Përpjekjet e shqiptarëve në Londër për formimin e çdo Komiteti apo përfaqësie të shqiptarëve atje, do të merrte përgjigje negative. Anglezët shpreheshin qartë se krijimi i një shoqate mes Zogut, dhe shqiptarëve të tjerë do të na shkaktonte shqetësime serioze⁴⁰. Komiteti për Miqtë e Shqipërisë janë më shumë pro-shqiptarë dhe pro-zogist se sa Shoqata që po mundohen të krijojnë tani me Zavalanin dhe Chekrezin. Anglezët kishin të dhënë se ky grup përbehej nga njerëz pa influenca dhe se këtu në Londër nuk kishin arritur ndonjë gjë të madhe. Ky grup do të udhëhiqej nga Zonja Sylvia Pankhurst. Gjithashtu Foreign Office deklaronte se: *“Shpresojmë shumë që Z.Pankhurst të mos e marrë shumë lartë çështjen shqiptare ose do të na shkaktojë në një mal të madh me shqetësime*”⁴¹.

Por kjo mungesë vullneti dhe trysnie nga ana e Foreign Office nuk i pengoi shqiptarët e Amerikës të formonin një organizatë të vogël me emrin “American Friend of Albania”. Kjo organizatë, me shtysën e Nolit, u krijua më nëntor 1943. Charles Hart u zgjodh kryetar i kësaj organizate duke marrë përsipër dërgimin e një numri telegramesh në adresë të Cordell Hull në lidhje me rrezikun grek dhe krijimin e një qeverie shqiptare në emigracion. Mbas deklaratës së dhjetorit 1942 për të ardhmen e Shqipërisë, njohja e qeverisë me Zogun në krye do të ishte një kusht i domosdoshëm për federatën “Vatra” pasi në këtë mënyrë do të lihej mënjane projekti i qeverisë greke për Shqipërinë e Jugut. Por këtë fakt shpeh herë do ta kundërshtonte Chostandine Chekrezi si kryetar i organizatës

³⁷ *The fact about Southern Albania, gazeta, “Dielli”, No.340, 31 korrik 1943, fq. 3.*

³⁸ *Përgjigja e editorit të Diellit për Diamantopulos, gazeta, “Dielli”, No.5589, 23 tetor 1943, fq. 2.*

³⁹ *Maturiteti politik i poullit shqiptar, gazeta, “Dielli”, No.5590, 30 tetor 1943, fq. 2.*

⁴⁰ FO, 371/37138-941, V.1943, Fl. 1, “Letër e Ryan për Foreign Office mbi gjendjen e shqiptarëve në Londër”.

⁴¹ Po, aty, fl. 2.

"Shqipëria e Lirë". Për Chekrezin, Zogu ishte i papërshtatshëm sepse nuk shikohej me sy të mirë në Shqipëri. Megjithatë kur presioni grek po rritej Chekrezi e kuptoi se një afrim me Zogun do të ishte në favor të tij dhe të Shqipërisë. Në një letër të marsit 1943 ai i drejtohet Cordell Hullit me kërkesën për sigurimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe se ishte i gatshëm të njihje Mbretin Zog, nëse këtë gjë do ta kërkonin Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe⁴². Chekrezi si mënyrën më të mirë për të shpëtuar Shqipërinë shikonte pranimin e saj në Kombet e Bashkuara. Edhe pse ka qënë ndër shtetet e para që ka luftuar kundër fashizmit Shqipëria nuk u ftua as në Konferencën e Ushqimit⁴³.

Në fundin e marsit 1943 Chekrezi, me rastin e përvjetorit të katërt të pushtimit të Shqipërisë, i shkruante Departamentit të Shtetit se do të bënte një deklaratë drejtuar shqiptarëve. Me këtë rast Chekrezi kërkonte një takim me Harold Hoskins si njeriun të cilin ai e kishte shumë përzemër në Washington. Duke parë këmbënguljet e vazhdueshme të Chekrezit për çështjen shqiptare dhe njohjen e një qeverie në mërgim, autoritetet amerikane mundohen që të bëjnë një rezymë të organizatës "Shqipëria e Lirë" dhe të aktivitetit të saj. Ky memorandum është përgatitur nga Departamenti i Shtetit për Seksionin e Agjensisë së Jashtme. Në këtë memorandum thuhet: *"Shqipëria e Lirë është një organizatë qëndrore, e përbërë nga degë të brendshme dhe nga shoqatat e tjera të pavarura të lidhura me të. Në përbërje të saj janë qytetarë shqiptaro-amerikan. Ajo kërkon një mbështetje për një qeveri në mërgim, por kundërshtohet nga Zogu i cili njihet nga Kombet e Bashkuara si kryetari legal i Shqipërisë. Në përbërje të Shqipërisë së Lirë janë rreth 1500 persona. Gazeta "Liria" është organi i Shqipërisë së Lirë dhe propagandon politikën e saj. Zyrat e kësaj organizate janë në Boston"*⁴⁴. Në bazë të këtij memorandumit bëhet e ditur se Chekrezi erdhi në Shtetet e Bashkuara në 27 tetor 1941 dhe se udhëtimi i tij u pagua nga Zonja Curtney Thomas, një banuese në Hotel Lafayette në New-York. Madje kjo zonjë bashkë me një grua të një ish-misionari në Shqipëri Violet Kennedy e kanë ndihmuar Chekrezin edhe në problemet në zyrën e hetimit për emigrantët në New-York. Këto të dhëna Departamenti i Shtetit i zotëronte nga agjentët e tyre⁴⁵. Sipas këtij memorandumit Chekrezi ka një aktivitet të dendur kundër kërkesave territoriale të Greqisë. Një letër e hapur për kryeministrin Grek Tsouderos në Gazetën "Liria" në Janar 1943, "Shqipëria e Lirë" proteston kundër këtyre kërkesave. Raportohet se Chekrezi ka patur konferenca dhe takime me Ministrin Jugosllav Fotich dhe Ministrin Grek të Propagandës Michalopoulos për kërkesat greke për Shqipërinë e Jugut⁴⁶. Lidhjet e Chekrezit me Shtetet e Bashkuara janë shumë të hershme. Për herë të parë ai shkon në Amerikë më 1914-ën dhe që në atë kohë ai bëhet pjesë i disa organizatave me karakter nacionalist të New Engladit, ku kishte një prezencë të konsiderueshme shqiptarësh. Në 1915 u ftua nga Federata "Vatra" për të drejtur gazetën "Dielli" për faktin se Faik Konica dhe Fan Nolin ndodheshin në Europë. Në kohën e drejtimit të gazetës "Dielli" nga ana e Chekrezit kjo gazetë u bë e përditëshme sepse më përpara dilte vetëm një herë në javë. Pikërisht këtë fakt Chekrezi do t'ia përmendte kundërshtarëve të "Vatrës" vazhdimisht. Por shumë shpejt e humbi këtë pozicion me ardhjen e Nolit nga Shqipëria. Në 1920-ën Chekrezi bëhet komisioner i lartë për Shqipërinë në Washington. Që këtu mund të zbulohen rrënjët e Chekrezit në Shtetet e Bashkuara dhe kjo lidhje kaq e afërt me ta. Amerikanët kishin krijuar shumë besim tek ai

⁴² NARA MI211-15, 0783, V.1943, Fl, 1, "Letër e Chostandine Chekrezit për Cordell Hull ku i kërkon njohjen e një qeverie në mërgim me Zogun në krye".

⁴³ NARA, MI211-15, 0820, V.1943, Fl, 1-2, "Letër e Chekrezit për Cordell Hull për luftën e shqiptarëve në Shqipëri dhe pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara".

⁴⁴ NARA, MI211-15, 0894, V.1943, Fl, 1-15, "Memorandum i përgatitur nga Departamenti i Shtetit për organizatën "Shqipëria e Lirë".

⁴⁵ Po, aty, fl, 6.

⁴⁶ Po, aty, fl, 12.

dhe për shumë vite Chekrezi ka qënë një nga figurat që spikaste për emigracionin shqiptar. Në vitet 1929 deri në 1935 Chekrezi ka shkruar shumë artikuj nëpër gazeta dhe revista prestigjioze si: The Baltimore Sun, Current History dhe për një nga revistat më prestigjioze e cila publikohet dhe sot Foreign Affairs⁴⁷. Në disa momente Chekrezi spikat më shumë se Fan Noli. Për Chekrezin nuk kishte kurrë dyshime për besnikërinë e tij ndaj Shteteve të Bashkuara, ndërsa për Nolin shpesh herë viheshin pikëpyetje. Pavarësisht këtyre fakteve për Chekrezin dhe organizatën “Shqipëria e Lirë”, Departamenti i Shtetit do të kishte përgjigje negative për krijimin e ndonjë qeverie shqiptare në emigracion. Letrat e Chekrezit trajtoheshin pa interesin e duhur, apo të paktën të atij interesi minimal që kishin kur e morën nga kampi në jug të Francës. Nga një letër shumë e gjatë dhe e mbushur me fakte historike drejtuar Cordell Hullit, Chekrezi do të merrte si përgjigje vetëm një paragraf të vogël nga asistenti i çështjeve të Europës Juglindore me përmbajtje kryesore: “Unë të siguroj ty se të gjitha pyetjet janë marrë seriozisht nga qeveria jonë. Të gjitha pyetjeve të tua ne nuk mund t’u përgjigjemi sepse janë lënë për çështjet ushtarake të cilat do të diskutohen mbas lufte”⁴⁸.

Federata “Vatra” dhe Organizata “Shqipëria e Lirë” do të bëheshin bashkë për të kundërshtuar pretendimet absurde greke për Shqipërinë e Jugut. Përballë tyre do të gjendej emigracioni grek i cili ishte shumë mirë i organizuar dhe i konsoliduar. Për federatën “Vatra” kjo sipërmarrje do të ishte tepër e vështirë. Fakti që emigracionin grek e dëgjonte me vëmendje si Britania e Madhe ashtu edhe Shtetet e Bashkuara do të thotë se kishte shumë avantazhe të cilat buronin që nga organizimi, por edhe mbështetja e një qeverie në emigracion. Pothuajse shumica e emigrantëve grekë në Shtetet e Bashkuara janë Ortodoks dhe i përkasin Kishës Ortodokse Greke në Veri dhe Jug të Amerikës. Që nga viti 1931 kjo kishë është drejtuar nga Peshkop Athenagoras në New-York, një shtetas amerikan⁴⁹. Kisha Greke në Shtetet e Bashkuara është një armë e fortë në dorë të emigracionit grek. Vetëm numri i tyre e tregon këtë forcë. Në 1936 kishte gjithsej 276 kisha dhe 296 priftërinj⁵⁰. Një numër shumë i madh krahasuar me kishën shqiptare e cila deri në 1944-ën kishte vetëm një prift kryesor dhe një buxhet shumë të varfër. Buxheti i kishës greke numëronte rreth 93.000 dollarë vetëm në 1936⁵¹. Ky buxhet ka qënë gjithmonë në rritje. Ndoshta kjo tregon një shenjë varësie të Kishës grekë të Amerikës nga ana e qeverisë greke. Sipas të dhënave, Kisha greke e Amerikës në vitet 1936-1937, morën me vendim të qeverisë greke një numër të madhe pronash dhe aksione në shumë truste kompanish. Kisha greke në Amerikë ishte organizatorja dhe koordinatorja e parë e komunitetit grek në Shtetet e Bashkuara.

Përveç Kishës në Shtetet e Bashkuara zhvillonte veprimtarinë një numër i madh organizatash dhe klubesh të cilat ishin pararojë e propagandës për mbrojtjen e interesave greke në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një nga këto organizata nacionaliste ishte edhe AHEPA ose American Hellenic Educational Progressive Association. Anëtarët e saj numërohen në 20.000. Kjo organizatë u krijua në 1922-1923 me qëllimin që të gjithë emigrantët grekë të asimiloheshin me jetën amerikane⁵². Është kjo organizatë e cila mendohet se në 1942-in kë mundësuar krijimin e një batalioni ushtrie për të mbështetur kthimin e qeverisë greke e cila ndodhej në emigracion. Në 28 Nëntor 1942, AHEPA

⁴⁷ NARA, MI211-15, 0894, V.1943, Fl, 1-15, “Memorandum i përgatitur nga Departamenti i Shtetit për organizatën “Shqipëria e Lirë”.

⁴⁸ NARA, MI211-15, V.1943, Fl, 1, “Kthim përgjigje nga John Hickerson për Chekrezin për sa i përket çështjes së ardhshme të Shqipërisë”.

⁴⁹ John Poulour Collector, “Propaganda in the Greek-American community”, në Journal of the Hellenic Diaspora, Vol.XIV, Nr.1-2, Spring-Summer 1987, fq, 109.

⁵⁰ Po, aty, fq, 109.

⁵¹ Po, aty, fq, 110.

⁵² Po, aty, fq, 117.

mblodhi për një fushatë në ndihmë të popullit grek rreth 100.000.000 dollarë⁵³. Një shumë tepër e madhe për të cilën federata "Vatra" dhe organizata "Shqipëria e Lirë" as nuk do e mendonin se mund ta arrinin në fushatat që ata zhvillonin.

Një tjetër organizatë greke ishte edhe Shoqata Progresive Greko-Amerikane, e quajtur GAPA. Ajo u themelua në vitin 1923⁵⁴. Deri në fundin e viteve 30' kjo organizatë numëronte rreth 10.000 anëtarë. Qendrat e saj kryesore ishin në Pittsburgh dhe Pennsylvania. Misioni parësor i kësaj organizate ishte: "*Ruajtja dhe forcimi i idealit grek dhe veçanërisht të pavdekësisë së gjuhës greke dhe të besimit Ortodoks*"⁵⁵. GAPA ka sponsorizuar rreth 50 shkolla për të mësuar greqishten tek gjeneratat e ardhshme. Gjithashtu një tjetër organizatë ishte Federata Pan-Helenike e Amerikës, e themeluar në vitin 1941⁵⁶. Kjo organizatë aspiron që të jetë një organizatë totale dhe që mbulon të gjitha organizatat e tjera në Amerikë.

Ajo që i dallonte këto organizata ishte lidhja shumë e fortë që mbanin me qeverinë në emigracion. Këtë mangësi që ne kishim filluan ta shfrytëzonin mjaft mirë organizatat greke në Amerikë, ndër to edhe Liga Kombëtare Pan-Epirotike e Amerikës. Në dhjetor 1942 Liga Pan-Epirotike e Amerikës i dërgon një letër të gjatë Sekretarit të Shtetit Cordell Hull. Në këtë letër shpreheshin qartë sentimentet e trye antishqiptare dhe gjoja vuajtjet që kishin kaluar nën regjimin shqiptar dikur dhe atë Italian tani⁵⁷. Në shumë rreshta aludohej se vetë Departamenti i Shtetit nuk ishte në dijeni të shumë fakteve rreth kësaj krahine, ku shumë figura të rëndësishme greke janë asgjësuar gjatë Luftës së Parë dhe tani në Luftën e Dytë Botërore. Fan Noli dhe Faik Konica u paraqitën si të shtur tek italianët dhe se kjo letër është një dëshmi e nënave dhe motrave tona për vuajtjet dhe sakrificat e tyre⁵⁸.

Organizata greke i kushtonte tepër rëndësi luftës Italo-Greke të vitit 1940. Në të gjitha letrat dhe memorandumet që dërgonin, përpiqeshin të nxirrnin fakte të paqena dhe skrupuloze. Në letrën dërguar Cordell Hull organizata "Liga Kombëtare Pan-Epirotike" deklaronte: "*Në vitin 1940 bandat shqiptare sulmuan pa dallim Italianët dhe Grekët, të cilët ishin bllokuar në malet e Epirit*"⁵⁹. "Liga Pan-Epirotike e Amerikës" proklamonte më të madhe se problemin me Shqipërinë nuk e shikonte me frymën e nacionalizmit por me faktet e martirëve të Epirit dhe për qëllimin e vetëm, ruajtjen e paqes në Ballkan. Për të ardhmen e shtetit shqiptar, ata deklarorin se shteti Shqiptar mbas Luftës së Dytë Botërore të vendosej nën një mandat të një fuqie të madhe, për një kohë të konsiderueshme, në mënyrë që të mos ketë synime ekspansioniste në të ardhmen në Ballkan. Të gjitha këto argumenta përgatiteshin dhe dërgoheshin me firmën e kryetarit të "Ligës Pan-Epirotike të Amerikës", Basil Moulas⁶⁰.

"Liga Pan-Epirotike e Amerikës" mendohej të mbante nën kontroll çdo lëvizje të kreëve të emigracionit shqiptar në Shtetet e Bashkuara. Dy nga këta do të ishin Fan Noli dhe Faik Konica. Kjo organizatë ishte tepër e kënaqur për mosdakortësinë ndërmjet dy organizatave shqiptare në Shtetet e Bashkuara, "Vatra" dhe "Shqipëria

⁵³ John Poulour Collector, "Propaganda in the Greek-American community", në *Journal of the Hellenic Diaspora*, Vol.XIV, Nr.1-2, Spring-Summer 1987, fq. 117.

⁵⁴ Po, aty, fq. 119.

⁵⁵ Po, aty, fq. 119.

⁵⁶ Po, aty, fq. 120.

⁵⁷ NARA, MI 211-15, 0559, V.1942, Fl, 1, "Letër e Ligës Pan-Epirotike të Amerikës për Cordell Hull, ku i shpjegoj historinë e Epirit të Veriut".

⁵⁸ Po, aty, fl, 5.

⁵⁹ NARA, MI211, Roll, 15, 0572, V.1942, Fl, 1-6, "Letër e Ligës Pan-Epirotike të Amerikës për Cordell Hull, ku flitet për padrejtësitë e shqiptarëve ndaj grekëve gjatë gjithë historisë."

⁶⁰ Po, aty, fl, 6.

e Lirë”. Ata bënin me faj këta dy personalitete shqiptare duke i quajtur si njerëz të pabesueshëm dhe si ish-agjentë të Musolinit⁶¹. Të gjitha këto fakte jepeshin për arsyen e vetme që Departamenti i Shtetit të kujdesej në maksimum për interesat greke në Epirin e Veriut. Gjithashtu për deklaratën amerikane të vitit 1942 emigracioni grek shpresonte që Departamenti i Shtetit të mos njohë ndonjë qeveri shqiptare apo front të bashkuar në emigracion. Për dy figurat kryesore si Fan Noli dhe Faik Konica nuk mund të jepeshin sigurime pasi ata ishin të korruptuar⁶².

Përballë këtyre presioneve nga ana e emigracionit grek, Departamenti i Shtetit shprehej i habitur se si ka mundësi që grekët nuk e kuptojnë akoma deklaratën e dhjetorit 1942. Në një takim me ambasadorin grek Diamantopulos, Departamenti i Shtetit i kujtoi ambasadorit se për Shqipërinë është thënë ajo që është thënë për të gjitha shtetet e tjera të përfshira në luftë kundër boshtit⁶³. Departamenti i Shtetit nuk shikonte arsye të vlefshme se pse Qeveria amerikane të bënte një deklaratë fikse për sa i përket kufirit tokësor të Greqisë⁶⁴. Pamvarësisht kërkesave të shumta nga ana e emigracionit grek në Shtetet e Bashkuara, Departamenti i Shtetit ishte i bindur se çështja e kufijve duhej të lihej mbas Luftës dhe se nuk ka ndonjë nxitim për këtë çështje. Në shkurt 1943 më shpenzimet e saj kjo organizatë paraqiti një artikull të gjatë në gazetën prestigjioze të Londrës “New Times and Ethiopia News”. Në këto artikuj emigracioni grek kërkonte rishqyrtimin e kufirit greko-shqiptar dhe çështjen e Epirit të Veriut t’u shqyrtone me kujdes Konferenca e Paqes. Këtyre pretendimeve do t’u kundërvihej edhe Charles Hart si përfaqësues i orgnizatës Amercan Friends of Albania. Në tetor 1943 Charles Hart kritikon ashpër me anë të një artikulli në gazetën “Dielli” Ambasadorin Grek në Amerikë Diamantopulos duke i thënë: *“Populli shqiptar nuk i ka ndihmuar Italianët siç proklamoni ju, por kanë qënë kundërshtarë të tyre. Epiri i Veriut është tokë shqiptare dhe asnjë shtet tjetër nuk ka të drejtë për to. Shqetësimi është se liderët e Greqisë janë, më shumë se kurrë, reaksionarë. Ata nuk kanë mësuar asgjë nga kjo luftë dhe nga vuajtjet e popullit të tyre. Ata nuk e kuptojnë se në po luftojmë për një ideal, për t’i dhënë fund skllavërisë ndaj shteteve të fuqishme fqinje. Greqia duhet të harrojë këtë kërkesë false kundrejt Shqipërisë”⁶⁵*.

Shqetësimet greke për këtë aktivitet të emigracionit shqiptar ishin rritur ndjeshëm. Me futjen në skenë të Charles Hart situata mernte përmasa më të mëdha. Për këtë arsye Konsulli Grek në Shtetet e Bashkuara Philon Philon këtë shqetësim ia komunikoi edhe Departamentit të Shtetit duke e njoftuar se Charles Hart ka shpërndarë për botim një numër të konsiderueshëm aritkuajsh lirisht nëpër gazeta të ndryshme për t’u botuar. Ajo që i kishte trembur grekët ishte përdorimi i togfjalëshit “ruajtje e integritetit” të Shqipërisë, nga shkrimet e Charles Hart. Konsulli kërkonte garanci se ky togfjalësh nuk do të kishte efekt për çështjen e mëvonëshme të kërkesave territoriale të Greqisë⁶⁶. Departamenti i Shtetit e mori në konsideratë këtë notë diplomatike të konsullit grek dhe menjëherë i komunikoi Charles Hart se e vlerësonte atë që po bënte për Shqipërinë, por në fillim duhet larguar nazizmi dhe më vonë të bëheshin përpjekje për ndonjë front të përbashkët në emigracion⁶⁷. Në asnjë mënyrë ky togfjalësh i Charles Hart nuk do të

⁶¹NARA, MI211, Roll, 15, 0592, V.1942, Fl,1, “Letër e Ligës Pan-Epirotike të Amerikës për Cordell Hull në lidhje me aktivitetin e dy organizatave shqiptare në Amerikë.”

⁶²NARA, MI211-15, 0582, V.1942, Fl, 4, “Letër e Ligës Pan-Epirotike të Amerikës për Cordell Hull në lidhje me deklartën e dhjetorit 1942”.

⁶³NARA, MI211-15, 0634, V.1942, Fl, 1, “Komunikim mes Ambasadorit Grek dhe Departamentit të Shtetit”.

⁶⁴Po, aty, fl, 1.

⁶⁵NARA, MI211-15, 0980, V.1943, Fl,12, “Komunikim ndërmjet Konsullit Grek dhe Departamentit të Shtetit rreth aktivitetit të Charles Hart”.

⁶⁶Po, aty, fl, 12.

⁶⁷Po, aty, fl, 13.

merrej si provë nga ana e Departamentit të Shtetit. Tashmë kërkesa greke ishte ezauruar me sukses dhe Hart duhej të mos bënte më të tilla shkrime⁶⁸. Charles Hart u mundua të bënte edhe një herë emigrantët shqiptarë bashkë por ishte e pamundur sepse viti 1944 shënon edhe daljen zyrtarisht në skenë të komunistëve, të cilët do të bënin të gjitha përpjekjet që zëri i tyre të ishte zëri i vetëm që mund të dëgjohej në marrëdhëniet ndërkombëtare. Për sa i përket federatës "Vatra" ajo mbështeti pa kushte Enver Hoxhën, ndërsa Chostandine Chekrezi e mbaroi misionin e tij në shërbim të amerikanëve dhe dha dorëheqjen në fillim të vitit 1945 duke e lënë orgnizatën "Shqipëria e Lirë" të asimilohej nga regjimi komunist.

BIBLIOGRAFIA:

1. Fondi. (Fan Noli) 14, Faik Konica, 13.
2. Dokumenta të arkivit Britanik Foreign Office, Londër. FO, viti 1940-1943.
3. Dokumenta Amerikane të, National Archives and Record Administration, MI211-15, Viti 1940-1945.
4. Meta, Beqir, "Tensioni Greko-Shqiptar, 1939-1949", Botimet Globus R, Tiranë: 2008.
5. Bashkurti, Lisen, "Shqiptarët në rrjedhat e diplomacisë", Botimet Geer, Tiranë: 2003.
6. Chekrezi, Constandine, "Plani i tretë për coptimin e Shqipërisë", Botimet Naim Frashëri, Tiranë: 2012.
7. Bejtullah Destani, "Faik Konica slected correspondence, 1896-1942", Botimet Center for Albanian Studies, Lonër: 2000.
8. Jason Tomes, Zogu, self-made King of Albania, London:2009.
9. John Poulour Collestor, "Propaganda in the Greek-American community", në Journal of the Hellenic Diaspora, Vol.XIV, Nr.1-2, Spring-Summer 1987.
10. Dielli, vitit 1939-1944.

⁶⁸ NARA, MI211-15, 0980, V.1943, Fl.12, "Komunikim ndërmjet Konsullit Grek dhe Departamentit të Shtetit rreth aktivitetit të Charles Hart". fl, 14.

Baza ligjore dhe parimet e Institucionit të Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipërisë



“Njerëzit lindin e jetojnë të lirë e të barabartë në të drejta. Diferenca shoqërore mund të bazohet vetëm mbi dobinë e përbashkët”¹

Abstrakt

Autorët gjatë këtij punimi do përqipen ta analizojnë bazën ligjore të institucionizimit dhe funksionimit të Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipërisë. Analiza e punimit është e orientuar në kompetencat, në raportet me organet e tjera, përgjegjësitë e Avokatit të Popullit në shtetin shqiptar, por edhe në atë se si iniciohet procedura pranë këtij organi dhe cilat janë mjetet juridike, organizimi i brendshëm, por edhe roli i tij si Mekanizëm Kombëtar për parandalimin e torturës. Organi i Avokatit të Popullit si organ kushtetues-ligjor, mbrojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të qytetarëve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës publike. Ky organ është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij. Sepse mbrojtja, garantimi dhe përparimi i të drejtave dhe lirive të njeriut çdo herë ka qenë prioritet i shteteve sovrane ligjore dhe demokratike.

Fjalët kyçe: *Avokati i popullit, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarëve, mekanizëm i posaçëm, kushtetues, ligjor.*

¹Neni 1, Deklarata Universale për të drejtat e njeriut dhe të qytetarit, 1789.

Hyrje

Traumat sociale që ndodhën në Shqipëri, gjatë dhjetë viteve të para të tranzicionit(1991-2000), si pasojë e ndryshimit të sistemit politik, tregojnë se kjo gjendje nuk arriti të menaxhohet dhe të mbahet nën kontroll nga autoritetet shtetërore shqiptare, që le të nënkuptojmë se institucionet nacionale nuk arritën të tregojnë përgjegjshmëri të duhur. Sepse pikërisht në këtë periudhë sidomos gjatë viteve 1997, shteti shqiptar nuk tregoi një horizont shembull të vetëqeverisjes në sy të strukturave ndërkombëtare, por përkundrazi, kjo periudhë ishte mjaft e errët për Shqipërinë, sepse trazirat që ndodhën brenda për brenda shtetit për shkak të ndërrimit të sistemit politik, bënë që institucionet shtetërore, gjykatat, policia, prokuroria, ushtria, administrata, agjencitë e ndryshme etj, të cilat njëherazi përbëjnë motorin lëvizës të aparatit shtetëror për funksionimin e tij, u zhytën në një kolaps të thellë, po ashtu në këtë periudhë kemi një regres në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, sepse sistemi politik gjatë këtyre viteve abuzoi me liritë dhe të drejtat e individëve në mënyrë sistematike.

Udhëheqësit e institucioneve shqiptare dëshmuar edhe njëherë se nuk mund të dalin nga ky ngërç institucional, në të cilin ngërç ishin zhytur për shkak të botëkuptimeve të ndryshme politike, pa ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar, i cili në Republikën e Shqipërisë ishte prezent në atë periudhë dhe kishte një ndikim të madh, sidomos në fillim të proceseve demokratike në shtetet në tranzicion. Faktori ndërkombëtar vazhdoi edhe pas trazirave të vitit 1997 të qëndroj në Shqipëri, mirëpo me një strategji dhe plan ideator shumë më ndryshe, sepse në një shtet të tillë siç ishte shteti shqiptar, ishte më se e nevojshme edhe zbatimi i programeve të cilat do ti ndihmonin faktorit nacional për themelimin, ngritjen si dhe forcimin e institucioneve të reja demokratike. Kështu që shteti shqiptar ishte në një farë forme i detyruar ti ndërtoj institucionet e veta demokratike, sigurisht nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e vazhdueshëm nga ndërkombëtarët, që mbetet të nënkuptohet se organet shtetërore nuk mund të ndërtohen nëse më parë themelimi dhe funksionimi i tyre nuk është i rregulluar me sistemin normativ. Kështu që Kushtetuta e re shqiptare u aprovua në vitin 1998, me referendumin e mbajtur, gjë e cila filloi të tregoj se Shqipëria bëri hapa pozitiv në ndërtimin e institucioneve shtetërore në mënyrë demokratike, sepse për herë të parë akti më i lartë juridik në vend morri dritë jeshile edhe nga populli e jo vetëm nga të deleguarit e popullit në parlament. Ky veprim historik tregoi edhe gatishmërinë e ekspertëve vendor dhe të huaj që të punojnë në ndërtimin e një shteti demokratik, në të cilin qytetarëve iu mundësohet e drejta në vendimarrje.

Duke pasur parasysh edhe rekomandimet që në atë periudhë, Këshilli i Evropës por edhe Bashkimi Evropian i jepnin vazhdimisht, për vendet të cilat pretendonin të jenë anëtare të saj, edhe për Shqipërinë, ky Këshill kishte dhënë përkushtimin dhe mbështetjen e tij për themelimin e institucionit të Ombudsmanit. Pasi një organ i tillë në vendet të cilat ndodhen në tranzicion, është më se e natyrshme. Nga se sot shkalla e zhvillimit demokratik të një shteti dhe të një shoqërie, vlerësohet apo matet më së shumti me nivelin e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Sepse të drejtat dhe liritë e njeriut sot janë bërë një parametër mjaft me rëndësi, përmes të cilit shprehet gatishmëria e qeverive aktuale për përmbushje të standardeve ndërkombëtare, sidomos një vlerësim i tillë i bëhet qeverive të cilat dalin nga sistemet komuniste, siç është Shqipëria. Ngase të drejtat dhe liritë e njeriut sot nuk janë pjesë vetëm e politikës së brendshme, nacionale, por ajo merr masa edhe më të gjëra, duke kërkuar mbrojtjen, respektimin dhe realizimin e tyre edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, pra janë pjesë edhe e politikës së jashtme. Dhe më në fund edhe Kushtetuta e re parashikonte

edhe krijimin e një institucioni të ri, pra të Avokatit të Popullit. Në shkurt të vitit 1999 Parlamenti shqiptar miratoi edhe ligjin për Avokatin e Popullit, i cili ky ligj ishte një modalitet i kombinuar i dy legjislacioneve shembull për këtë institucion, atij danez dhe suedez. Ky organ u parashikua edhe me nenet përkatëse në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe drejtimi i tij është monarkik.

Avokati i parë i Popullit në Republikën e Shqipërisë u zgjodh më 16 shkurt të vitit 2000, nga parlamenti shqiptar edhe atë me 3/5 e të gjithë deputetëve.² Timonin udhëheqës, përfaqësuesit e popullit në parlamentin e Shqipërisë ia besuan z.Ermir Dobjani, me të drejtë rizgjedhje, i cili në shkurt të vitit 2005 udhëhoqi edhe me mandatin e dytë, deri në 16 shkurt të vitit 2010. Ndërsa më 22 dhjetor të vitit 2011, Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi për Avokat të Popullit z.Igli Totozani. Avokati i Popullit ka rolin e mbrojtësit të qytetarëve nga keqmenaxhimi dhe abuzimi i të drejtave të tyre natyrore dhe ligjore nga ana e organeve publike dhe private që posedojnë autorizime publike, duke promovuar në mënyrë aktive të drejtat e njeriut.

Kushtet e nevojshme për të përvijuar tiparet kryesore të institucionit të Ombudsmanit janë:

- ✓ **Së pari**, të ketë një bazë ligjore kushtetuese, që të parashikojë ngritjen e funksionimit të institucionit dhe zgjedhjen e kandidatit të përshtatshëm, për ti garantuar Ombudsmanit si pavarësinë, patundshmërinë në detyrë, brenda mandatit kohor.
- ✓ **Së dyti**, nevoja për ta pajisur Ombudsmanin me burime të mjaftueshme financiare.
- ✓ **Së treti**, institucioni i Ombudsmanit nuk zëvendëson gjykatat, pra nuk është zëvendësues i një sistemi gjyqësor që duhet të jetë efektiv dhe i pavarur. Ai përbën një pjesë të makinerisë së të drejtave të njeriut, me të cilën duhet të pajisen të gjitha shtetet demokratike, duke mos mbajtur as anën e administratës, as anën e individit, por duke punuar për kulturën e mirëqeverisjes dhe për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut. Ombudsmani është një institucion jogjyqësor, diçka ekstra, që i ndihmon qytetarët kur ndeshen në vështirësi në raportin e tyre me administratën³.

Institucionalizimi i organit të Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipërisë

Avokati i Popullit është organi i vetëm kombëtar me status kushtetues dhe ligjor si mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ky institucion është krijuar në vitin 1998 me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, (miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998) dhe në vitin 1999 Parlamenti i Republikës

²Për here të parë në mënyrë institucionale Ombudsmani paraqitet në Suedi. Ombudsmani suedez apo "Justitieombudsman" u krijua me kushtetutën e këtij vendi më vitin 1809, si i besuari i parlamentit, i cili është i pavarur nga qeveria dhe i cili në emër të parlamentit kontrollon administratën dhe gjykatat dhe mbron të drejtat e qytetarëve nga aktet e tyre joligjore dhe parregullsitë. Me kushtetutë ky organ është krijuar në Serbi më vitin 2005, Maqedoni më vitin 1997 etj, në Kosovë më vitin 2000 krijohet Ombudspersoni edhe atë me rregulloret e posaçme të UNMIK-ut. Me ligj të veçantë ky organ është themeluar në Britani të Madhe, Kanadë, Itali, SHBA, Zelandën e Re, Francë, Islandë etj.Me dekretë të veçantë ky organ është themeluar në Portugali, në Bosnjë dhe Hercegovinë Ombudsmani është krijuar me Aneksin 6 të Marrëveshjes së Dejtonit dhe më vonë është rregulluar edhe me kushtetutë dhe ligj. Në Francë Ombudsmani ose Ombudspersoni njihet si „Mediator“, Britani të Madhe «Përfaqësues parlamentar për administratën», Spanjë "Mbrojtësi i Popullit", Kuebek "Mbrojtësi i Qytetarëve", Poloni "Mbrojtësi i të drejtave të qytetarëve", Gjermani "Komiteti për petition", Austri, Maqedoni, Kosovë, Shqipëri "Avokati i Popullit", Serbi "Mbrojtësi i qytetarëve" etj.

³D. Emir, E Drejta Administrative, Tiranë, 2003, faqe 215.

së Shqipërisë miratoi ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, “Kodi i Procedurave Administrative” (nr.8485, datë 12.05.1999), Ligji “Për të drejtën e informimit” (nr.8503, datë 30.06.1999), ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (nr.9888, datë 10.03.2008), Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit” (nr.9135, datë 11.09.2003), si dhe Ligji “Për shëndet mendor (nr.44/2012, datë 19.04.2012) përbëjnë bazën ligjore, ku përcaktohen thuajse të drejtat dhe detyrat e funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e parasheh këtë organ si instancë kombëtare dhe si garant të demokracisë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Janë pesë nene kushtetuese të cilat përcaktojnë detyrat, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit mbron të drejtat dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij. Avokati i Popullit ka buxhet të veçantë, të cilin e administron vetë. Ai propozon buxhetin sipas ligjit⁴. Juridiksioni i Avokatit të Popullit shtrihet dhe përfshinë, edhe ministrinë, institucionet e tjera qendrore, agjencitë e ndryshme, komunat etj, që ushtrojnë autorizime publike. Funksionimi i institucionit të Avokatit të Popullit është i përcaktuar dhe rregulluar dhe me ligj të veçantë për këtë organ, pra me Ligjin për Avokatin e Popullit, i cili ligj për herë të parë u miratua më vitin 1999, dhe pastaj u ndryshua dhe u plotësua me vitin 2000 dhe në vitin 2005. Ligji është ai mekanizëm ligjor i cili në mbështetje të neneve 60, 63, 81 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton parimet dhe vlerat mbi të cilat vepron ky organ. Ligji për Avokatin e Popullit përcakton edhe detyrat themelore të këtij institucioni. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj⁵. Detyra e këtij organi rezulton në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve, pavarësisht faktin nëse kemi të bëjnë me shtetas të shtetit shqiptar, shtetas të huaj, persona apatrit, azilkërkues (persona fizik), apo persona juridik të vendit apo të huaj. Ky institucion vepron dhe udhëhiqet në bazë të parimit, të paanësisë, konfidentalitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë, si dhe në bazë të dispozitave kushtetuese, ligjore dhe në bazë të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti nacional. Pavarësia dhe paanësia janë dy kritere të cilat e dallojnë këtë organ shtetëror nga të tjerët, sepse edhe me nenin kushtetues parashihet distancimi i këtij organi nga politika ditore dhe veprimtaritë partiake, sepse këto parime janë vitale për punën e këtij organi.

Për detyrën e Avokatit të Popullit mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e parapara me këtë ligj edhe atë, të jetë shtetas shqiptar, të ketë veprimtari të shquar në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe ligjit, të shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale, të mos jetë i dënuar penalisht dhe të mos jetë deputet në legjislaturën e Kuvendit që bën propozimin a zgjidhjen e tij⁶. Me dispozitat kushtetuese dhe ligjore parashihet se Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi me 3/5 e të gjithë deputetëve, me mandat pesë vjeçar me të drejtë riemërimi. Avokati i Popullit gëzon imunitetin e gjykatës të Gjykatës së lartë, si dhe me të drejta dhe me privilegje. Funksioni i Avokatit të Popullit mbaron sipas kushteve të parapara ligjore. Ndërsa kur jemi të shkarkimi i Avokatit të Popullit, ai mund të shkarkohet edhe me

⁴ Neni 60, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar me ligjin nr.8417/98, nr.9675/2007, nr.9904/2008.

⁵ Neni 2, Ligji për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë, “Fletorja zyrtare” nr.8600/2000, nr.9398/2005, nr.155/2014.

⁶ *Ibidem*, neni 3.

kërkesë të motivuar (mocion) të jo më pak se 1/3 të deputetëve dhe në këtë rast Kuvendi vendos me 3/5 e të gjithë anëtarëve të saj⁷. Shkarkimi i tij mund të ndodhë në këto raste:

- Është dënuar me një vendim gjykate të formës së prerë;
- Është i paaftë mendërisht a fizikisht për të ushtruar funksionin e tij;
- Kryen veprimtari në kundërshtim me dispozitat ligjore;
- Nuk paraqitet në detyrë për më shumë se 3 muaj⁸.

Organizimi i brendshëm i Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipërisë

Pavarësia e këtij institucioni shprehet në radhë të parë në përcaktimin e vetë strukturës organizative, me qëllim që realizimi i punës dhe sukcesi në punë të arrihet përmes një stafi profesional i cili njëherazi është organizuar mirë. Kjo nënkupton se ky organ është kompetent për të miratuar akte dhe rregullore të brendshme. Në këtë mënyrë Avokati i Popullit ka miratuar, Rregulloren e brendshme të punës, si dhe Kodin e mirësjelljes së mirë administrative, apo Kodin etik të punës. Vlen të theksohet se Rregullorja e brendshme është një akt që miratohet nga Avokati i Popullit, në zbatim të ligjit të tij organik, me qëllim përcaktimin e strukturave të organit, organizimin e punës konkrete dhe rregullat për procedurat administrative. Kurse Kodi Etik përbën po ashtu një akt të brendshëm të institucionit, në të cilin përcaktohen mënyrat e sjelljes gjatë përmbushjes së detyrës së nëpunësit në raport me qytetarët dhe organet tjera, masat e zbatimit të etikës profesionale, si dhe përcaktimin e parimeve bazë mbi të cilat duhet të vihet në zbatim dispozitat e këtij kodi⁹. Struktura e institucionit të Avokatit të Popullit përcaktohet me urdhër nga Avokati i Popullit:

- ✓ Kabineti i Avokatit të Popullit;
- ✓ Tre seksione të specializuara, në krye të së cilëve qëndrojnë komisionarët;
- ✓ Njësia për parandalimin e torturës;
- ✓ Sekretari i përgjithshëm;
- ✓ Drejtoria e informimit, marrëdhënie me publikun dhe me jashtë;
- ✓ Sektori i pritjes së popullit;
- ✓ Sektori i sekretarisë dhe arshivës;
- ✓ Drejtoria e personelit dhe administratës;
- ✓ Sektori i financës;
- ✓ Sektori i administratës¹⁰.

Kjo strukturë është e ndryshueshme varësisht prej prioriteteve të caktuara nga Avokati i Popullit, disa prej kompetencave të tij mund t'ia delegoj Komisionerëve, apo personave të veçantë nga personeli. Në ushtrimin e funksionit të tij, Avokati i Popullit ndihmohet nga Kolegjiumi i institucionit, i cili përbëhet nga komisionerët, sekretar i përgjithshëm, drejtori i kabinetit, drejtorët dhe drejtuesit e njësive për parandalimin e torturës. Ky kolegjium mblidhet sa herë që e gjykon të nevojshme Avokati i Popullit dhe ka karakter këshillues¹¹.

Zyra e Avokatit të Popullit ndahet në 3 seksione të specializuara, në krye të të cilave vendosen komisionerët, me qëllim që sukcesi në punë të jetë më produktiv dhe në kohë:

⁷Neni 62, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

⁸Neni 8, Ligji për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë.

⁹D. Emir, *E Drejta Administrative, Tiranë, 2003, faqe 217. Neni 6, Rregullorja e brendshme e punës „Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit nr.64/2008, kapitulli i dytë.*

¹⁰Kodi i sjelljes së mirë administrative.

¹¹*ibidem, neni 8.*

- Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.
- Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura, dhe pushtetin gjyqësor.
- Seksioni i përgjithshëm për trajtimin e çështjeve jashtë fushave të mësipërme, për bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe për studimet e veprimtarisë në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut¹².

Ajo që e bën të dallohet këtë institucion nga të tjerët është mirësjellja në raport me personat e tretë, në të kundërtën, suksesi nuk mund të paramendohet pa mirësjellje. Edhe kodi etik parashih këto parime të cilat duhet ti përmbahen punonjësit e institucionit edhe atë; ligjshmëria, mosdiskriminimi, proporcionaliteti, (masat e marra duhen të jenë proporcionale me arritjen e qëllimit), mosabuzimi me pushtetin, paanshmëria, ndershmëria, objektiviteti, etj¹³.

Fillimi i procedurës dhe mjetet juridike për iniciimin e procedurës pranë zyrës së Avokatit të Popullit - kompetencat

Çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës ose lirisë së shkelur¹⁴. Ligji në fjalë parashih dhe garanton të drejtën ligjore për mbrojtje nga veprimet abuzive dhe joligjore të organeve të administratës publike pranë këtij institucioni nacional. Sipas procedurave të përcaktuara, ankesa pranë këtij organi, paraqitet me shkrim me të gjitha të dhënat e duhura, në rast mungese Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga parashtruesi i ankesës mbledhjen e fakteve, apo edhe nga organi konkret informacione të duhura, përjashtimisht ankesa mund të paraqitet edhe gojarisht në rrethana të rastit. Në të gjitha rastet, organet e administratës janë të obliguara të bashkëpunojnë në çdo aspekt me Avokatin e Popullit, në të kundërtën pësojnë masat disiplinore dhe sanksionuese për nëpunësit e administratës. Si dhe të njëjtat duhet ti përgjigjen me shkrim rekomandimeve të Avokatit të Popullit, dhe masat të cilat i kanë ndërmarrë në rastin konkret. Sepse Avokati i Popullit nuk sjell vendime, gjykime, por me rekomandimet, sugjerimet e tij, mundohet që organet me autorizime publike ti respektojnë të drejtat e qytetarëve, si dhe këtyre të fundit ti mundësohet qasje më e lehtë në realizimin e të drejtave dhe lirive të tyre. Procedura për hetim në një rast konkret mund të fillojë në të gjitha rastet kur qytetarët parashtrojnë ankesë apo kërkesë për procedim të tillë, por ky organ edhe me nismën e vet mund të fillojë hetimin në të gjitha rastet kur ekziston mundësia e çfarëdo shkeljeje të të drejtave dhe lirive të qytetarit, ndërsa Avokati i Popullit ka kuptuar për një gjë të tillë në mënyra të ndryshme e jo përmes ankesës apo kërkesës së parashtruar.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjerë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative¹⁵. Varësisht prej rastit Avokati i Popullit mund të mos e fillojë ose e

¹²Neni 31, Ligji për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë.

¹³Kodi i sjelljes së mirë administrative në Republikën e Shqipërisë.

¹⁴Neni 12, Ligji për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë.

¹⁵Ibidem, neni 13.

ndërpret hetimin nëqoftëse e njëjta çështje është vendosur ose është në shqyrtim nga prokuroria apo gjykata. Në këto raste ai ka të drejtë të kërkojë informacione pranë këtyre organeve, të cilat duhet tu përgjigjen kërkesave të tij sa më shpejtë të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë. Avokati i Popullit pasi të njihet me ankesën, kërkesën, njoftimin për një shkelje ai vendos:

- ✓ Ta pranojë ose jo çështjen në shqyrtim;
- ✓ Ti kthej përgjigje të interesuarit, duke i treguar të drejta dhe rrugët nëpërmjet të cilave ai mund ta mbrojë këtë të drejtë;
- ✓ T'ia kalojë çështjen organit kompetent.

Pavarësisht vendimin që do të marr, Avokati i Popullit është i obliguar në afat brenda 30 ditëve ta njoftojë edhe të interesuarin (palën). Pasi ta pranojë ankesën, Avokati i Popullit mund të kryej njërin nga hetimet:

- Të ndërmarr vet një proces hetimi;
- Të kërkojë shpjegime nga organet e administratës, si dhe prokuroria, në rastet e arrestimeve dhe ndalimeve;
- Mund ti rekomandojë Kontrollit të Lartë të shtetit të ushtrojë funksionet e veta¹⁶.

Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit është i obliguar që palët ti njoftojë rreth rezultateve të arritur në hetim, që kanë të bëjnë me kërkesën e paraqitur. Avokati i Popullit palës do ti shpjegoj, nëse kemi të bëjmë me shkeljen apo jo të të drejtave të tyre, dhe nëse kemi, atëherë Avokati i Popullit do të përgatisë dhe do ti paraqes rekomandimet përkatëse për vënien apo kthimin e të drejtës së shkelur tek organet administrative. Kur kemi paraqitje të rekomandimeve në të gjitha rastet atëherë, paraqitja e rekomandimit pezullon aktet ose veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e rekomandimit dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit¹⁷.

Avokati i Popullit ka kompetenca të bëjë rekomandime, propozime në sistemin legjislativ në të gjitha rastet kur vëren se është vetë përmbajta e ligjit apo akteve normative dhe jo zbatimi i tyre shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, apo edhe përshtatjen e lex nacionlis me standarde ndërkombëtare. Në vitin 2002 Parlamenti shqiptar ka përmirësuar dy ligje sipas propozimeve të Avokatit të Popullit, në praktikë ka shumë raste kur organet administrative kanë përmirësuar dhe ndryshuar aktet nënligjore sipas rekomandimeve të bëra. Po ashtu si kompetencë ekskluzive dhe e veçantë e cila parashihet edhe me norma kushtetuese edhe ligjore është e drejta e Avokatit të Popullit ti rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve juridike. Në vitin 2001, me kërkesë të Avokatit të Popullit, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi një vendim të qeverisë që shkelte të drejtën e pronës private¹⁸. Jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit sipas ligjit në fuqi janë:

- ✓ Kryetari i Këshillit të Ministrave;
- ✓ Presidenti i Republikës;
- ✓ Urdhrat me karakter ushtarak të Forcave të Armatosura;
- ✓ Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrje të vendimit. Në praktikë në lidhje me gjykatat, Avokati i Popullit mbështetet edhe në praktikën e homologëve të tij, pa cënuar veprimtari-

¹⁶ *Ibidem*, neni 17 dhe 19.

¹⁷ *Ibidem*, neni 21.

¹⁸ D. Emir, "E drejta Adminsitartive", Tiranë, 2003, faqe 221.

në e pavarur të tyre, ka pasur gjithmonë marrëdhënie në rolin e “**amicus curiae**”¹⁹ si dhe ka marrë në shqyrtim ankesa në lidhje me administratën gjyqësore. Ai ka të drejtë të kërkojë informacione apo dokumente që lidhen me çështjen në shqyrtim, edhe kur ato janë të klasifikuara si sekrete shtetërore;

- ✓ Konfliktet civile kur nuk janë palë organet e administratës publike (marrëdhëniet civile ndërmjet personave privat ose tregtar).

Në të drejtën bashkëkohore ky institucion paraqitet si bartës i kontrollit mbi administratën shtetërore.

Raporti i Avokatit të Popullit me organet e tjera të pushtetit shtetëror dhe përgjegjësia e tyre

Organet e pushtetit shtetëror si dhe ato organe private që posedojnë autorizime publike janë të obliguar sipas dispozitave ligjore të kenë bashkëpunim adekuat dhe të frytshëm me institucionin e Avokatit të Popullit, me qëllim që këtij të fundit ti mundësohet qasje me e shpejtë rreth zgjidhjes së çështjes së ankmuar. Avokati i Popullit cakton një afat kohor, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë për dhënien e të gjitha informacioneve të duhura, sipas kërkesës së Avokatit të Popullit. Qasja e papenguar e institucionit të Avokatit të Popullit në organet e administratës shtetërore gjithmonë ka për qëllim, eliminimin, evitimin e pengesave apo barrierave si fizike ashtu edhe juridike, ku si pasojë e tyre mund të vijë deri te shkelja e të drejtave dhe lirive të qytetarit, dhe njëherazi duke ia pamundësuar këtij të fundit ti realizojë të drejtat apo edhe detyrimet e tij ligjore.

Kompetenca ekskluzive e Avokatit të Popullit parashihet edhe me Kodin e Procedurës Administrative, sepse ky kod zbatohet për persona fizik dhe juridik, të cilëve u është dhënë e drejta e ushtrimit të detyrimeve dhe kompetencave publike me ligj, akt nënligjor ose kontratë. Mbajtësit e të drejtave dhe interesave të ligjshme, të cilat preken nga vendimet që merren gjatë procedimit administrativ, kanë të drejtë të fillojnë procedimin administrativ, si dhe të marrin pjesë në të. Në mbrojtje të interesave të gjëra, të cilat mund të preken nga procedimi administrativ, kanë të drejtë të fillojnë një procedim administrativ apo të marrin pjesë në të:

- Personat të cilëve procedimi administrativ u shkakton ose mund t’u shkaktojë dëme në të drejtat e përbashkëta si p.sh., shëndeti publik, arsimimi, trashëgimia kulturore, mjedisi, si dhe në cilësinë e jetës;
- Personat që jetojnë brenda apo pranë një prone publike, e cila mund të dëmtohet nga procedimi administrativ;
- Avokati i Popullit;
- Shoqatat që veprojnë në mbrojtje të interesave të gjëra publikut²⁰.

Dispozitat e këtij neni zbatohen nga të gjitha organet e administratës publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nëpërmjet akteve individuale, si ato organe të pushtetit qendrorë, të enteve publike, pushtetit vendor etj. që kryejnë autorizime publike. Po ashtu neni 45 i Kodit të Procedurës Administrative, institucionit të Avokatit të Popullit i jep legjitimitimin e pa kufizuar për pjesëmarrje në procedim administrativ. Ngase praktika ka dëshmuar se nëpër dikastere të ndryshme administrative, qytetarët përballen me shkelje të mëdha të mos respektimit të të drejtave të tyre. Ky kod njëherazi paraqet edhe

¹⁹ *Ibidem*, faqe 216.

²⁰ Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, “Fletorja zyrtare” ligji nr.8485/1999.

bazën ligjore të funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flas në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merren në shqyrtim rekomandimet, kërkesat apo propozimet e tij²¹. Një nga çështjet e cila në vendet në tranzicion krijon bujë të madhe për realizim e saj dhe cila çështje nga instancat ndërkombëtare është vazhdimisht në shënjestër të kritikave që u bëhet shteteve që gjenden në tranzicion është e drejta e informimit.

E drejta e informimit paraqet njërën nga të drejtat themelore të njeriut e cila është e fokusuar në lirinë e individit për qasje në informacione dhe të dhënat që posedojnë autoritete shtetërore, dhe njëherazi paraqet një lloj llogaridhënie për mënyrën e menaxhimit të burimeve shtetërore me qëllim që veprimtaria e tyre të jetë më transparente. Institucioni i Avokatit të Popullit në këtë drejtim na paraqitet si aktorë kryesor, për transparencën dhe realizimin e të drejtës së informimit në Republikën e Shqipërisë, sepse një kompetencë ekskluzive, Avokatit të Popullit ia njeht edhe Ligji për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë, i cili ligji rregullon të drejtën e informimit për dokumente zyrtare, dhe njëherazi të drejtat e informimit dhe detyrimet e autoriteteve publike.

Sipas ligjit në fjalë, çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet. Nga ana tjetër autoritetet publike janë të detyruar të japin çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe. Çdo informacion për një dokument zyrtar, që i është dhënë një personi, nuk mund t'i kufizohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur ky informacion përbën të dhëna vetjake të vetë personit, të cilit i është dhënë informacioni. Ndërsa kufizohet qasje në informacione zyrtare vetëm në ato raste kur me ligj është paraparë një kufizim i tillë në tërësi, apo pjesërisht²².

E drejta për informim është një e drejtë themelore e individit e cila njëherazi është e garantuar me nenin 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe me ligjin për Avokatin e Popullit, i cili i jep të drejtë këtij organi të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror²³. Ky ligj parashih institucionin e Avokatit të Popullit si kujdestar ligjor për mbikëqyrjen e zbatimit në praktikë të këtij ligji nga autoritetet publike, si dhe kompetencat e Avokatit të Popullit në lidhje me këtë çështje rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. Ligji për të drejtën e informimit thotë, Avokati i Popullit kujdeset për zbatimin e këtij ligji²⁴.

E drejta në informim si një e drejtë demokratike, dhe njëherazi duke prezantuar si një nga elementet kyçe të lulëzimit të demokracisë funksionale, e drejta për informim është afirmuar edhe me një sërë aktesh ndërkombëtare, të cilat në të njëjtën kohë vendosin edhe standarde të respektimit të saj, standarde të cilat kërkohen të reflektohen nga legjislativi vendor duke i harmonizuar legjislativonet vendore me standarde ndërkombëtare. Që të kemi një legjislativ më të përshtatshëm dhe më të harmonizuar me standardet e kërkuara nga strukturat ndërkombëtare, shteti shqiptar ka ratifikuar një sërë aktesh ndërkombëtare të cilat parashohin konceptin e mbrojtjes dhe përparimit

²¹ Neni 21, Ligji për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë.

²² Neni 3 dhe 4, Ligji për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë, "Fletorja zyrtare" nr.8503/1999.

²³ Neni 20, Ligji për Avokatin e Popullit.

²⁴ *Ibidem*, neni 18.

të të drejtave dhe lirive të njeriut. Disa nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare në këtë fushë, që japin kuptimin dhe vendosin baza konceptuale dhe afirmojnë të drejtën e informimit si të drejta themelore janë:

- ✓ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948);
- ✓ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (e hartuar nga shtetet anëtare të KE);
- ✓ Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike (më 1966 e nënshkruar në mbështetje të Deklaratës Universale për të drejtat e njeriut);
- ✓ Deklarata e Këshillit të Evropës mbi Lirinë e Shprehjes dhe Informimit (1982) etj.

Këto akte ndërkombëtare dhe shumë të tjera, të cilat janë njëherazi të ratifikuara nga parlamenti shqiptar, të drejtën e informimit e parashohin si një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e shoqërisë²⁵.

Institucioni i Avokatit të Popullit në pozicionin e kujdestarit të respektimit të së drejtës për informim, ka arritur në konkluzionin se, funksionimi i regjimit të informimit publik në vend vazhdon të ketë probleme të dukshme, arsye e cila nxjerr nevojën e ndryshimeve dhe përmirësimeve në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”²⁶.

Mbrojtja e konsumatorëve paraqitet edhe si një nga çështjet kryesore të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Rëndësia e kësaj çështje aludon në disa shtylla shumë të rëndësishme siç është, shëndeti i opinionit (konsumatorëve), sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomike të konsumatorit etj, nga se konsumimi, furnizimi, përdorimi i produkteve dhe preparateve të ndryshme, duhet të kontrollohen edhe të identifikohen para se ti ofrohen konsumatorëve në treg, nga se këtu kemi të bëjmë jo vetëm me një ankesë apo rast individual, por fjala është për komunitetin më të gjerë në të gjithë vendin. Këto mund të jenë shumë arsye të cilat kanë shtyrë legjislacionin vendor për rregullimin juridik në lidhje me të drejtën dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve, trajton të drejtat e konsumatorëve, marrëdhëniet ndërmjet konsumatorëve dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve, ofruesve të shërbimeve dhe organeve të kontrollit të tregut e të standardizimit. Qëllimi i tij është mbrojtja e shëndetit, mjedisit, sigurisë së jetës dhe të të drejtave të tjera të konsumatorëve, të sanksionuara me ligj, si dhe përcakton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, që kanë lidhje me interesat e konsumatorëve²⁷. Po ashtu ligji në fjalë parashihet, se konsumatorët dhe shoqatat e tyre, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës shtetërore, mund të paraqesin ankesë pranë Avokatit të Popullit²⁸.

Gjatë një raporti të publikuar nga Avokati i Popullit, theksohet se ky institucion në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorëve, ka konstatuar si problematikë sigurinë ushqimore dhe mallrat e skaduara të cilat qarkullojnë në treg dhe nuk asgjësohen nga subjektet tregtare. Për rastet në fjalë institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar nga autoritetet përkatëse monitorime dhe kontrole të vazhdueshme ndaj subjekteve tregtare, si dhe asgjësimin e produkteve në të gjitha rastet kur konstatohet se janë të skaduara dhe

²⁵ Shih , Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në Shqipëri i janar-31 dhjetor. 2013, botuar Tiranë, shkurt 2014.

²⁶ Ibidem.

²⁷ Neni 1 dhe 2, Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve në Republikën e Shqipërisë, “Fletorja zyrtare”, nr.9135/2003

²⁸ Ibidem , neni 55.

vendosjen e masave ndëshkuese ndaj subjekteve tregtare²⁹.

Nga ana tjetër obligohen, shoqatat, ndërmarrjet, korporatat e ndryshme etj, që gjatë veprimtarisë të bëjnë përshtatjen e masave për mbikëqyrjen dhe kontrollin e produkteve, si dhe organet kompetente shtetërore të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përshtatshmërinë e veprimtarive të ndryshme profitabile sipas direktive të dhëna edhe nga BE-ja. Në këtë mënyrë, do kemi një kualitet dhe cilësi të lartë të mallrave, produkteve dhe shëndet më të mirë për popullatën në vend, sepse sigurimi i parametrave higjieniko-sanitare çdo herë ka qenë në fokus të veprimtarisë për mbrojtjen e interesave të ligjshme të konsumatorit.

Avokati i Popullit një rëndësi të madhe i ka dhënë edhe çështjes së mos diskriminimit, në baza gjinore, racore, minoriteteve, komunitetit lgbt, mbrojtjen e fëmijëve etj, (si grupe të marginalizuara) që edhe këto grupe të kenë qasje të barabartë në vendimmarrje dhe trajtim të një njëjtë përpara institucioneve shtetërore. Duke pasur parasysh se tek ne është ende tabu çështja e komunitetit lgbt, do ndalemi pak te kjo çështje, ngase është trajtuar si problematikë sidomos në shtetet në tranzicion të cilët ende nuk e kanë të rregulluar në mënyrë ligjore këtë problematikë. Kritika të ashpra për mos respektimin e komunitetit lgbt ka dhënë edhe Këshilli i Evropës në bazë të direktivave të tij, por edhe BE-ja. Sepse edhe të drejtat e komunitetit lgbt janë pjesë të pandashme të tërësisë së të drejtave të njeriut dhe si të tilla ata nuk duhen të kenë pengesa në realizimin e të drejtave të tyre. Nga se shumë shoqëri, kanë një qëndrim shumë paragjykes ndaj këtij komuniteti duke e konsideruar “krim të urrejtjes” këtë fenomen. Duke pasur parasysh legjislationet e shumë vendeve të cilat kanë bërë një përparim në lidhje me këtë dhe duke marrë parasysh direktivat e Këshillit të Evropës dhe BE-së, Avokati i Popullit ka vazhduar ti trajtojë të drejtat e këtyre komuniteteve, sepse ato hasen në vështirësi të mëdha në përditshmëri, në mos realizimin dhe kufizimin e të drejtave të tyre.

Avokati i Popullit ka vazhduar të promovojë në mënyrë aktive të drejtat e njeriut. Ai ka rekomanduar ndryshime legjislative që synojnë përmirësimin e respektimit të të drejtave të grupeve vulnerabël, përfshirë, lesbiket, gay, biseksual, transxhender dhe personat interseks, romët, ish të dënuarit politikë dhe personat e persekutuar. Bashkëpunimi i tij me organizatat e shoqërisë civile u përmirësua më tej me krijimin e një bordi këshillues të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut në muajin dhjetor (2012/2013). Në këtë drejtim³⁰, Avokati i Popullit, Ministrisë së Drejtësisë iu ka drejtuar dy rekomandime të cilat kjo ministri i ka marrë në konsideratë, duke ndryshuar edhe nenet përkatëse. **Rekomandimi i parë** ka të bëjë me atë, se Avokati i Popullit kërkon që në Kodin penal të shihet si rrethanë rënduese kryerja e veprës penale e shtyrë nga motivet që kanë të bëjnë me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, si dhe **rekomandimi i dytë** ka të bëjë me atë se sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të parashihet në Kodin penal si vepër penale edhe shpërndarja e materialeve homofobike si dhe fyerjes nëpërmjet rrjetit kompjuterik për motive të orientimit seksual apo gjinor. Ndërsa një rekomandim për ndryshime legjislative iu drejtua edhe Kodit Familjar të Republikës së Shqipërisë, ku parashihet ligjshmëria e bashkëjetesës mes personave të së njëjtës gjini. Mirëpo ky rekomandim i bërë sipas direktivave të komisionerit për mbrojtje nga mos diskriminimi si dhe nga Këshilli i Evropës, ende nuk është marrë në konsideratë nga legjislatura nacionale.

²⁹ Shih , Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në Shqipëri Ijanar-31 dhjetor 2013, botuar Tiranë shkurt 2014, faqe 34.

³⁰ Shih , Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në Shqipëri Ijanar-31 dhjetor 2013, botuar Tiranë, shkurt 2014, faqe 16.

Lidhur me rezultatet dhe arritjet e veprimtarisë së tij, Institucioni i Avokatit të Popullit përgatit raport vjetor për suksesin e punës, ku në këtë raport paraqitet edhe progresi dhe regresi i veprimtarisë në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend. Në raste të caktuara përpos raportit vjetor kërkohet të paraqiten edhe raporte 3 mujore apo 6 mujore për një çështje, kurse në raste të veçanta të paraqiten dhe të përgatiten edhe raporte të posaçme apo speciale nga Avokati i Popullit edhe atë me nismën e këtij organi, apo me kërkesë me shkrim të Kryetarit të Kuvendit, ose të një grupi deputetësh. Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit i paraqet raport vjetor Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili diskutohet në seanca plenare, po ashtu një kopje e këtij raporti i dërgohet edhe Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave. Të gjitha raportet në fjalë janë publike me qëllim që opinionin e ketë qasje në to. Një kopje e raportit të Avokatit të Popullit publikohet edhe në gjuhën angleze dhe u shpërndahet nga zyra e Avokatit të Popullit, institucioneve homologe të vendeve të huaja si dhe institucioneve ndërkombëtare që kanë lidhje me këtë institucion. Po ashtu Avokati i Popullit mund të ofrojë ndihmë dhe të jap mendime, rekomandime, në përgatitjen e raporteve dhe të dokumenteve tjera, të hartuara nga shteti shqiptar, për të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Shqipërisë. Avokati i Popullit ka bashkëpunim të ngushtë me organizatat joqeveritare vendore dhe të huaja, dhe organizon të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

Avokati i Popullit - Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT)

Institucioni i Avokatit të Popullit funksionin si në bazë tëtributeve të cilat ja jep Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji për Avokatin e Popullit, po ashtu ka edhe atributin e mbikëqyrjes së zbatimit të standardeve të përcaktuara nga instrumente të ndryshme ndërkombëtare të cilat në fokus kanë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar edhe Protokollin Fakultativ (opsional) të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT), nga e cila rrjedhë edhe detyrimi i shtetit ratifikues që të krijojë një strukturë kombëtare për parandalimin e torturës ose për të bashkëngjitur një aktivitet të tillë një institucioni me profil të ngjashëm pune. Avokati i Popullit si një institucion i pavarur me fokus të veçantë tek të drejtat e njeriut dhe tek "Parimet e Parisit" rezultoi të ishte autoriteti i duhur në garantimin e funksionimit profesional dhe të pavarur të këtij Mekanizmi sikurse në OPCAT. Në mënyrë që të formalizonte këtë propozim, Avokati i Popullit iu drejtua Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryeministrit me një rekomandim, duke shpjeguar arsyet se pse ky institucion ishte zgjedhja më e mirë për të luajtur rolin e një Mekanizmi Mbikëqyrës. Pas këtij rekomandimi dhe me miratimin e buxhetit të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2008, më 3 janar 2008, **de facto** filloi puna e Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Avokati i Popullit në rolin e MKPT ushtron kontroll të vazhdueshëm në qendrat ku ndodhen personat të cilëve u është privuar liria në zbatim të një vendimi gjyqësor duke vlerësuar kushtet e trajtimit njerëzor dhe respektimin e të drejtave të tyre si individë nga administrata e këtyre qendrave³¹. Po ashtu Avokati i Popullit, mendon që ti kushtohet vëmendje e veçantë edhe trajnimit të stafit të këtyre qendrave lidhur me respektimin e lirive dhe të drejtave

³¹ Në SHBA, Angli, Kanada, Danimarkë etj(Prisons Ombudsman, Pretreal Custody Ombudsman, e luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave të izoluar nëpër burgje), Në Slloveni një organ i tillë i specializuar për mbikëqyrjen e personave të paraburgosur vepron në kuadër të Ombudsmanit të përgjithshëm. Në Danimarkë, Avokati i Popullit është i autorizuar ta kontrollojë administratën civile, ushtarake dhe atë komunale, në Zelandën e Re ky organ nuk ka kompetencë të kontrollojë aktet e ministrave por punën e cila ushtrohet brenda ministrive. Në Maqedoni dhe Serbi po ashtu Ombudsmani ka rolin e Mekanizmit nacional kundër torturës.

të tyre si qenie njerëzore, si dhe nevojën për ri-integrimin dhe ri-socilizimin e personave të tillë gjatë jetës penitensiare si dhe ofrimin e ndihmës postpenale. Po ashtu një rëndësi të theksuar i kushtohen edhe parimit të humanizmit gjatë gjithë proceseve penale dhe gjyqësore (një rregullim parashihet edhe me Rregullat Standarde Minimale të OKB-së, mbi trajtimin e personave të dënuar). Njohja ligjore e MKPT-së shqiptare, si një strukturë e veçantë pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri u bë efektive kur ligji 9888/08 "Për të drejtat dhe trajtimin e personave të paraburgosur" pësoi disa ndryshime, dhe u miratua nga Parlamenti Shqiptar. Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit apo dënimit të egër njerëzor ose poshtëruës, vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, mbikëqyrë zbatimin dhe realizimin e ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, si dhe mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve. Sipas këtij ligji, Mekanizmi Kombëtar ka këto kompetenca:

- Të vëzhgoj vazhdimisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose të burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor.
- Të paraqes rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës³².

Sipas OPCAT, qëllimi i veprimtarisë së MKPT-së, është zbatimi i vizitave të rregullta në të gjitha hapësirat e institucioneve publike, ku liria e individit është e kufizuar³³. Me këtë kuptim inspektimet, vizitat dhe çdo kontroll tjetër i kryer në institucionet e policisë së shtetit, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (burgje dhe paraburgime), në spitale psikiatrike dhe infektive, në baza dhe reparte ushtarake, në drejtorinë rajonale të kufirit dhe migracionit, si dhe në qendrat e tjera të strehimit të emigrantëve të paligjshëm dhe personave të trafikuar, ka pasur si objekt të sigurojë një mbulim të plotë monitorues mbi situatën e të drejtave të njeriut në këto institucione, të parandalojë shkeljet, si dhe të mbajë një qëndrim zyrtar mbi problematikat e konstatuara. Garancitë në veprimtarinë e MKPT-së, sipas dispozitave ligjore janë këto:

- ✓ Marrja e çdo informacioni në lidhje me numrin e individëve që u është hequr liria, si dhe marrja e të gjitha informacioneve për trajtimin e këtyre personave, si dhe kushtet e tyre të ndalimit;
- ✓ Hyrja e lirshme në të gjitha vendet dhe mjediset ku është kufizuar liria e individit;
- ✓ Kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët që u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si dhe me çdo individ tjetër që mund të japë informacionin e nevojshëm;
- ✓ Zgjedhja lirisht e vendeve që kërkon të vizitohen dhe e individëve që kërkon të intervistojë³⁴.

Avokatit të Popullit si dhe personave që shoqërojnë atë, me dije të titullarit të institucionit por pa leje paraprake, i lejohen vizitat nëpër të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vendet ku prokuroria dhe policia mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar (të paraburgosurit) në reparte apo institucione

³² Neni 74/1, Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim në Republikën e Shqipërisë, "Fletorja zyrtare" nr.9888/2008.

³³ www.avokatipopullit.gov.al.

³⁴ Neni 74/2, Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim.

shtetërore, spitale psikiatrike, në azil, në shtëpi të fëmijëve, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Në të gjitha këto raste Avokati i Popullit mund të marrë në takim, të bisedojë, në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise. Korrespondencat nuk duhet të kontrollohen³⁵. Sipas një raporti të vitit 2013, në fushën e parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit, mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës pranë Avokatit të Popullit u plotësua me staf. Ai kreu 27 inspektime dhe mori 29 ankesa të cilat 15 u zgjidhën në favor të ankesuesve. Në 2013, kallëzime penale u bënë ndaj 13 oficerëve të policisë, prej të cilave prokurorët vlerësuar se dy kishin të bënin me torturë. Kjo përfaqëson 60% ulje të rasteve të torturës krahasuar me 2012–ën dhe një rritje prej më shumë se 60% të veprimeve ligjore kundër oficerëve të policisë. Prej 79 rekomandimeve të Avokatit të Popullit në lidhje me parandalimin e torturës dhe keqtrajtimin si dhe standardet e burgimit, 36 rekomandime ju drejtoheshin burgjeve dhe policisë së shtetit. Shumica e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile në lidhje me burgjet u trajtuan³⁶. Për më tepër, problemet e identifikuar nga këto vizita inspektuese janë përkthyer apo shndërruar në rekomandime dhe raporte periodike kombëtare dhe ndërkombëtare progresi, në mënyrë që të promovohet respektimi i vazhdueshëm i të drejtave, si dhe përmirësimi i standardeve të trajtimit të personave të privuar nga liria, nga personeli që shërben në këto ambiente apo hapësira. Edhe me rregulloren e institucionit të Avokatit të Popullit parashihet njësia për parandalimin e torturës e cila vepron direkt nën drejtimin e Avokatit të Popullit. Kjo njësi ushtron të drejtat dhe detyrimet, njëlloj si ato të komisionerit për çështjet që janë objekt i punës së kësaj njësie³⁷.

Mbikëqyrja e Mekanizmit Kombëtar realizohet nëpërmjet:

Pranimin të ankesave apo kërkesave nga të dënuarit, të paraburgosurit, me shkrim (gojë).

- Marrjes së informacionit, ankesave, kërkesave të të dënuarit, apo nga individët që kanë statusin e vizitorit apo të organeve shtetërore ose organizatave joqeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin sipas kompetencave ligjore, apo nga avokati i të dënuarit respektivisht i të paraburgosurit.
- Kërkim të informacioneve nga administrata e institucionit.
- Verifikim të dokumenteve, objekteve, pajisjeve ose mjediseve, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, brenda dhe jashtë institucionit³⁸.

Konventa kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese e cila ka hyrë në fuqi më vitin 1987, parasheh se njohja e të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme e të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, i drejtësisë dhe i paqes në botë, si të drejta që burojnë nga dinjiteti njerëzor³⁹. Sipas kësaj konvente shtetet palë të kësaj konvente, janë të obliguar të përkujdesen që të gjitha veprimet e torturës të

³⁵ Neni 19/1, Ligji për Avokatin e Popullit.

³⁶ Shih, Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në Shqipëri 1 janar-31 dhjetor 2013, botuar Tiranë, shkurt 2014.

³⁷ Neni 20, Rregullorja e brendshme e punës "Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit" nr.64/2008, kapitulli i dytë.

³⁸ Neni 74/3, Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim.

³⁹ Shih, "Konventa kundër torturës dhe dënimeve e trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese", miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj 39/46 të 10 dhjetorit 1984, ndërsa ka hyrë në fuqi më 26 qershor 1987.

konsiderohen shkelje nga legjislacioni i tij penal, kjo vlen edhe për tentativën e praktikumit të çdo veprimi të torturës, dhe për të cilat parashihen dënime. Po ashtu Avokati i Popullit luan një rol aktiv në rrjetin rajonal dhe ai është një nga anëtarët themelues të rrjetit rajonal MKPT, e cila është krijuar në Beograd më vitin 2013. Avokati i Popullit mban lidhje dhe raporte shumë të mira me Ombudsmanët në rajon dhe botë. Kontakte të tilla mbajnë edhe anëtarët e stafit të tij sipas reparteve konkrete dhe në mënyrë të veçantë vazhdon bashkëpunimi i njësisë për MKPT me njësitë homologe të institucioneve të Ombudsmanëve të vendeve të ndryshme.⁴⁰ Gjatë vitit 2013 është fuqizuar akoma më tej bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me organizatat e ndryshme ndërkombëtare, rajonale dhe vendore përfshirë këtu edhe OKB, Këshillin e Evropës, OSBE, UNDP, UNICEFF etj. Karta e të Drejtave të Njeriut e Bashkimit Evropian e miratuar në samitin e Nisës në dhjetor të vitit 2002, në nenin 43, ka përcaktuar si kusht edhe ekzistimin e institucionit të Ombudsmanit. Ngritja dhe funksionimi i Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipërisë plotëson një kusht për pranimin në Bashkimin Evropian.⁴¹

Përfundimi

Në Republikën e Shqipërisë, Avokati i Popullit si organ i pavarur dhe shtetëror, bazën e vet ligjore e ka në kushtetutën e vendit, në Ligjin për Avokatin e Popullit, por edhe në ligjet tjera të cilët i japin kompetenca ekskluzive këtij organi për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, në raste të cënimit apo të tentim pengimit në realizimin e të drejtave qytetare, po ashtu ky organ vepron edhe në përputhje me aktet apo rregulloret e brendshme por edhe në pajtim me konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti nacional. Ky organ është modalitet i kombinuar i dy legjislacioneve atij danez dhe suedez. Për një administratë me funksionale dhe më efektive sipas standardeve ndërkombëtare, pa diskutim se duhet në radhë të parë të krijohet një raport më i “shëndoshë” në mes të administratës dhe qytetarëve të shtetit. Sepse Avokati i Popullit në Shqipëri, përmes veprimtarisë së tij ndikon që të afroje gjithnjë e më shumë administratën publike me qytetarin të cilit ajo i shërben, duke synuar që sa më shpejtë të arrihen standarde që Komuniteti Ndërkombëtar kërkon që të zbatohen edhe në praktikë nga institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në Shqipëri, Avokati i Popullit nuk është i autorizuar ta kontrollojë punën e gjykatave, prokurorive, apo të ndryshojë vendimet gjyqësore, por vetëm ta kontrollojë punën e administratës gjyqësore, e gjithë kjo paraqet një zbrazëti ligjore dhe kufizim të kompetencave dhe autorizime të këtij organi. Avokati i Popullit nuk është organ që sjellë vendime sepse nuk është trup ligjvënës, pushtet gjyqësorë, por ai me rekomandimet, këshillat, udhëzimet e tij mundohet që organeve të administratës shtetërore t’ia bëjë me dije rreth parregullsive eventuale dhe evitimin e tyre me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Avokati i Popullit në Shqipëri funksionon si MKPT në nivel nacional. Problematika në çështjen e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut vazhdon të jetë preokupim serioz dhe permanent i njerëzimit, organeve shtetërore, organizatave ndërkombëtare, për të siguruar mbisundimin e shtetit ligjor, të drejtës dhe demokracisë. Sepse historia e të drejtave të njeriut dhe qytetarit është e vjetër sa vetë natyra njerëzore.

⁴⁰ *Shih, Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në Shqipëri 1 janar-31 dhjetor 2013, botuar Tiranë, shkurt 2014.*

⁴¹ *Dobjani, Emir, “E Drejta Administrative”, Tiranë, 2003, faqe 222.*

LITERATURA:

1. Emir Dobjani, “E drejta administrative”, Tiranë, 2003.
2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar me ligjin nr.8417/98, nr.9675/2007, ne.9904/2008.
3. Ligji për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë „Fletorja zyrtare” nr.8600/2000, nr.9398/2005, nr.155/2014.
4. Ligji për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë „Fletorja zyrtare” nr.8503/1999.
5. Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve në Republikën e Shqipërisë „Fletorja zyrtare” nr.9135/2003.
6. Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim në Republikën e Shqipërisë „Fletorja zyrtare” nr.9888/2008.
7. Kodi i sjelljes së mirë administrative në Republikën e Shqipërisë.
8. Kodi i procedurës administrative në Republikën e Shqipërisë “Fletorja zyrtare” nr.8485/1999.
9. Rregullorja e brendshme e punës për organizmin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipërisë, nr.64/2008.
10. Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në Shqipëri, 1janar-31dhjetor 2013, botuar më 2014, Tiranë, www.avokatipopullit.gov.al.
11. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit, 1789.
12. Deklarata mbi mbrojtjen e të gjithë personave kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve të tjera mizore, johumane ose degraduese, 9 dhjetor 1975.
13. Konventa kundër torturës dhe dënimeve e trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore, degraduese, 1984/87.

Krahasimi i botimeve të veprës “Këngët e Milosaos”



Abstrakt

Vepra “Këngët e Milosaos” është shkruar në gjysmën e shekullit të nëntëm-bëdhjetë në atmosferën e romantizmit evropian që ishte në kulmin e vet në Gjermani, Francë, Angli dhe në Itali kishte marrë ngjyrim patriotik duke u lidhur me luftën për çlirimin nga austriakët dhe burbonët. Pikërisht autori i kësaj vepre, një arbëresh i ri nga Kalabria, Jeronim De Rada¹, nga fshati Maqi, do të bëhet nga themeluesit e romantizmit shqiptar (themelues tjetër në Shqipëri është Naimi)². Synimi i tij ka qenë t’i japë atdheut të të parëve një letërsi me frymë patriotike dhe liridashëse për nga mesazhi, e karakterizuar nga një formë e lartë estetike. Kjo vepër do të kishte karakteristika romantike, nëqoftëse talenti i poetit, në thelb lirik, po që synonte te eposi, kishte nevojë për lirinë që mund t’i jepte drejtimi letrar i romantizmit, qoftë nga atmosfera kulturore që e rrethonte në Itali dhe nga veçori e një dege të veçantë të romantizmit italian siç ishte romantizmi kalabrez.

Megjithatë De Rada duke qenë i lidhur ngushtë me gjuhën dhe zakonet e stërgjyshërve shqiptarë të ruajtur me kujdes nga bashkëvendësit dhe duke qenë njëkohësisht nën ndikimin e poezisë popullore arbëreshe, nuk u bë një poet provincial që të përfshihej në letërsinë italiane, por një poet me talent te fuqishëm, themeluesi i letërsisë së re shqiptare të Rilindjes.

Fjalë kyçe: *De Rada, Milosao, Poemë, Vepra, Këngë.*

¹Jeronim De Rada (1814 - 1903), u lind në vitin 1814 në Maqi të Kalabrisë, ishte poet, publicist, folklorist, filolog dhe mësues shqiptar, një nga shkrimtarët më të mëdhenj arbëresh, themeluesi i Rilindjes shqiptare.

²Naim Frashëri lindi më 25 maj 1846 në Frashër të Përmetit dhe vdiq më 20 tetor 1900 në lagjen Erenqoj të Stambollit, ku edhe u varros. Eshtrat e tij janë sjellë në Shqipëri në vitin 1937. Ishte poeti më i madh i Rilindjes kombëtare shqiptare, atdhetar, mendimtar dhe veprimtar i shquar i arsimit e i kulturës shqiptare.

De Rada arriti t'i botojë veprat e veta prandaj kemi dëshmi të sigurta për to. Jeronim De Rada, i është kthyer disa herë kryeveprës së vet “Këngët e Milosaos” për ta ripunuar. Ky është shkaku që ekzistojnë deri më sot pesë variante të kësaj poeme.

Varianti fillestar që u përket viteve 1833-1834 (dorëshkrim) varianti i botuar për herë të parë më 1836, varianti i botuar për herë të dytë më 1847, varianti i botuar për herë të tretë më 1873 dhe një variant dorëshkrim që ndodhet në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në të cilin shihen gjurmë të një ripunimi të paplotë.

Prej variantit të parë ekziston vetëm një kopje në Arkivin Qendror të Shtetit³ që njihet me emërtimin “dorëshkrimi i Tiranës” në Fondin De Rada. Ky variant gabimisht kishte qenë klasifikuar si dorëshkrim i botimit të parë i cili doli më 183-ën, çka shpjegon zbulimin e tij të vonë prej studiuesve. As Gualtieri, as Markiano i që shkruajtën monografi të plota për poetin nuk dinin gjë për ekzistencën e këtij dorëshkrimi. Meritën e zbulimit të këtij varianti të parë (pre-Milosao) e ka studiuesi Dhimitër Shuteriqi⁴ i cili vërtetoi se varianti në fjalë është shumë më i ndryshëm se varianti i botuar nga De Rada më 1836, në moshën 22- vjeçare, pra gjatë dy-tre vjetëve ndodhi një hap krijues: nga një krijim disi i pa formë, embrional dhe fragmentar doli në dritë një vepër e plotë dhe e përsosur në të cilën fragmentarizmi është shndërruar në parim krijues.

Botimi i parë u bë në Napoli më 1836 dhe i dha De Radës famë në Itali dhe jashtë kufijve të saj. (U vlerësua nga shkrimtarë të shquar francezë). Disa studiues e quajnë atë më të përsosur estetikisht dhe pohojnë se dy variantet e tjera që u përgjigjen dy botimeve (1847-1873) janë më pak të realizuara nga ana e formës.

Ekziston dhe një mendim që mbrohet nga studiuesi Xhuzepe Gradilone⁵ sipas të cilit çdo botim ka vlerën e vet estetike. Studiuesja Klara Kodra⁶ pranon se këto botime “janë më pak fatlume” por i lidh dy botimet e mëtejshme “Këngëve të Milosaos” me evolucionin e romantizmit të tij i cili në fillim ishte më i lidhur me poezinë antike dhe më vonë shtoi ngjyrat e errëta dhe të zymta që e bashkojnë me romantizmin tipik të disa vendeve evropiane. Mendohet se De Rada e ka ripunuar “Milosao” për ta përfshirë atë në poemën epiko-lirike “Skënderbeu i pafan”⁷.

Ne do të analizojmë sipas rregullave filologjike në rrafsh estetik dy këngë nga vepra “Këngët e Milosaos”, këngën e dytë që shikon në strukturën e subjektit nyjen, domethënë lindjen e dashurisë dhe këngën e fundit e cila në variantin e AQSH është kënga e njëzetë, po më vonë vjen duke u zgjeruar: në botimin e parë ajo është bërë kënga XXX, në dy botimet e tjera, më të zgjeruara, kënga XXXVII.

E nisim analizën nga kënga e dytë. Në variantin e AQSH, në fakt aty nuk nis dashuria e dy të rinjve, por fitet për një nuse të re që është bërë nënë dhe kërkon të shoqin që është larguar pa e lajmëruar mbase për të shkuar në luftë. Supozohet që poeti futet në mes të gjërave të të rinjve që tashmë janë martuar dhe kanë fëmijë dhe protagonistin largohet njëherë në drejtim të panjohur.

Një këngë të ngjashme do të gjejmë në botime të mëvonshme të spostuara në thellësi të tekstit. Ndofta në variantin e parë poeti nuk do të ndiqte rolin kronologjik.

³ Arkivi Qendror i Shtetit - AQSH

⁴ Dhimitër S. Shuteriqi lindi në vitin 1915 në Elbasan dhe vdiq më 22 korrik të vitit 2003, ishte shkrimtar, poet dhe studiues i shquar shqiptar. Shuteriqi ka bërë një analizë të hollë në revistën “Nëntori”, nr. 3, të vitit 1963 ku përshkruan marrëdhëniet e artit të De Radës dhe poezisë popullore për të shkruar poemën e Milosaos

⁵ Giuzepe Gradilone është një studiues italian i letërsisë shqiptare dhe asaj arbëreshe

⁶ Klara Kodra - Prof. Dr është poete, kritike e letërsisë, përkthyes.

⁷ Skënderbeu i pafan, një nga kryeveprat e De Radës, të cilën e mbajti në duar një kohë të gjatë (1837-1896). Në vepër janë shkruar mjaft nga këngët dhe poemat që kishte botuar më parë. Aty u shpreh në mënyrë më të plotë dhe më të qartë patosi kombëtar që kishte frymëzuar veprën e De Radës.

Kënga është shumë e afërt me poezinë popullore arbëreshe⁸.

Në variantin e këngës së dytë të botuar më 1836 nis dashuria pasi jepet një detaj (vreshtat in të verdhullore) që karakterizojnë një tablo të tërë vjeshte, hyjnë në skenë kafshë disi të antropomorfizuar “dheljpra” me “t ljothta të bilat” pra “dheljpra” jepet si nënë që lufton jo vetëm për mbijetesën e vet por kryesisht për atë të fëmijëve dhe jo më kot, për të theksuar brishtësinë e tyre jepen si të gjinisë femërore. Pra kjo tablo simbolizon amësinë që zotëron edhe bota e kafshëve, gjithashtu vështirësitë e mbijetesës meqenëse vreshtat ishin “të vjela” dhe dhelpra nuk gjen asnjë kokërr rrushi për fëmijët. Tabloja, pra, është sa realiste, aq edhe simbolike. Ajo aludon për familjen që protagonistin bëhet gati të krijojë. Dashuria e tij, si e thellë dhe e sinqertë projektohet tek e ardhmja dhe te familja. Pra, ndikimi i poezisë antike është i gjallë dhe krijues. Në vargjet e tjera vijëzohet portreti fizik i vashës:

*“E përveshurëz e ljar
Me kë shenë të pjeksurith
Nde një jetulëz të bardhë
I ljidhur te brezi kaljthër
Shumantilji i ngit me i trual”*

Që shkrihet me portretin e saj shpirtëror , i cili jepet përmes një vargu të vetëm: Nje keshilë i kish he (hje)

Pra vajza është jo vetëm e bukur, ajo di të meditojë, pra është e mençur dhe kjo mençuri e plotëson, nuk e zbeh bukurinë e saj. Ndjenja ambivalente e ndrojtjes dhe dashurisë që lind e jep vargu: “ me të trembur një gharë”. Në këngë gjejmë motivin e burimit që ka qenë i pranishëm në poezinë antike, në poezinë popullore arbëreshe, madje gjendet edhe në poezinë pastorale të shekullit të XVIII ose në letërsinë bashkëkohore romantike. Pra, është fjala, për një motiv letrar të cilit i jepet freski e re. Dy të dashurit po flasin si fshataret arbëreshe, me thjeshtësi dhe ndrojtje, vajza me një përlësi të veçantë se djali është “bir zoti”. Djali guxon t’i bëjë vajzës një kompliment të thjeshtë për bukurinë e saj, ajo skuqet. Kënga mbyllet me një detaj që të kujton poezinë kalorësiake; djali me duart e përgjakura largon gjembat nga balli i vajzës.

Në variantin e botimit të dytë ka ndërruar tabloja e fillimit, tabloja e gjallë e dhelprës me fëmijët e vet që kërkon ndonjë kokërr rrush për të shuar urinë; tani ia ka zënë vendin një tablo tjetër nga bota e njerëzve: tabloja e zjarreve të vatrave nga shtëpitë që qëndrojnë të hapura. Në rast se simboli i zjarrit të kujton dashurinë që është gati për të lindur, vatrën simbolizojnë familjet dhe gjithashtu kolektivin që zë vend të madh në botën arbëreshe dhe shqiptare dhe që i dikton ligjet e veta individit, në këtë rast djalit, që do të sfidojë tabunë e pabarazisë letrare. Detaji që thekson se “zjarret” nuk e “ngrohin ajrin” megjithëse shkëlqejnë, ndofta simbolizojnë dashurinë që ishte ende aq e thellë sa t’i ngrohë krejt dy të rinjtë. Kjo tablo përsëritet edhe te botimi i tretë. Nga botimi në botim mund të vëmë re se dy “buzët” e “qeshme” të botimit të parë dhe të dytë janë shndërruar në të “heshme” (hëshme) në të tretin. Kulti i gëzimit i variantit të parë që buron nga ndikimi i poezisë antike vjen duke u zbehur; bukuria ose hijeshia zënë vendin e së qeshurës.

Në dy botimet e mëtejshme data (21 të shën Martirit 1405) shton koloritin historik.

Për sa i përket këngës së fundit nga varianti i AQSHT në botimin e parë shohim atë hap krijues që karakterizon tërë veprën nga një variant në tjetrin. Në variantin

⁸Të gjitha zakonet, doket, koloriti lokal dhe botëkuptimet që ndeshim në këtë poemë përkojnë me ato të këngëve popullore arbëreshe nga ku De Rada mori edhe strukturën e vargut për veprën e vet. Nga ajo mori vargun tetërrokësh trokaik të parimuar dhe figurat stilistike, si krahasimin, hiperbolën, personifikimin, kontrastin, epitetin, metaforën, etj.

paramilosaik vëmë re drurin e arrës që në botimin e parë zëvendësohet me lirin simbol ky shqiptar dhe simbol qëndrese. Druri i arrës i variantit të parë nuk e zotëron atë forcë shprehëse. Përveç këtij simboli lis përsërit fillimin me një efektshmëri të re: në fillim ky simbol shprehte përjetësinë e brezave njerëzore, pra jetën, në këngën e fundit nëpërmjet rrezikut e vdekjes. Mandej folja “rrëzoj” jep idenë e një vdekjeje jo të natyrshme, të dhunshme, konkretisht vdekja në luftë që ka një dimension tragjiko-heroik. Vdekja e zakonshme e variantit të parë që përcjell vetëm trishtimin e ikjes së një krijese njerëzore tani ka fituar kuptim, është vdekja për një ideal lirie.

Në variantin e AQSH:

“Pra c’tërmbë, imme gjell?

Më u mbiakë e mbi rejje

Shpet te ilun dielli”

Te botimi i parë shohim vargun kuptimplotë :

“gjaku im te Ljumi Vodhit”

Pra, gjaku, simbol i jetës këtu bëhet simbol vdekjeje, vdekjeje të dhunshme, po prej trimi. Protagonisti u bën thirrje ushtarëve (ushtertor), shokëve të tij të hapin çadrën që të shohë nga larg qytetin e lindjes Skutarin (Shkodrën) për të cilin vdes. Imazhi i dy “qirinjve mbi varr” imazh melankolik e sentimental, zëvendësohet me dallgën e pafund (surelje e pa- firmuam) të “Ljulievet c tunden era”, imazh që shpreh vazhdimësinë e pafund të jetës. Në variantin e AQSH janë “vashat” që mblidhen, “ndë katund, ndë vatterit”, në botimin e parë janë “shokët”. Imazhi i vazhdimit të jetës bëhet më burrëror. Në variantin e AQSH mbarimi i protagonistit nënvizohet dy herë “E më soste Millosat”, dhe “Së më e Milosat” në botimin e parë vetëm një herë. Vargu “u m’i lje si ëndërrëz” përsëritet në të dyja variantet, por në të parin përcjell mesazhin e jetës si iluzion, në të dytin theksohet me tepër vazhdimësia, kolektivi, buzët e mëtejshëm vazhdojnë jetën e individit që ka vdekur nga dashuria për ta. Është interesante se vargu përmbyllës “së më e Milosit”, i botimit të parë në botimin e dytë bëhet “As ishte më Milosit” dhe në botimin e tretë ishte zhdukur fare, ndofta që të theksohej vargu i fundit që e lidh jetën me ëndrën. Mund të vërenim se poeti fetar mund të fliste për një “zgjim”, nga “endërra”, e jetës njerëzore në pafundësinë e “jetës së amshuar”, siç bëri më vonë Mistrali⁹ duke përshkruar vdekjen e Mirelës, protagonistes së veprës së tij, po nuk e bëri mjaftohet me pavdekësinë relative njerëzore.

Konkluzion

Bazuar në analizën e mësipërme, arrijmë në konkluzionin se të gjitha variantet kanë bukurinë e vet, duke përjashtuar variantin e fillimit që vlen vetëm si “bërthamë” e “Këngëve të Milosaos” dhe shpjegon krijimin e një kryevepre që në fillimet e veta nga një poet i ri pa përvojë.

⁹ Franco Mistrali (Parma, 27 korrik 1833 - Porretta Terme, 18 dhjetor, 1880), ish oficer i marinës austriake, ishte një gazetar, novelist dhe historian italian.

Literatura:

1. Libri “Canti di Milosao” De Rada, Napoli 1836.
2. Libri “De Rada Girolamo, Opera Omnia, I Canti Premilosaici (1833-1835), Edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari.
3. Revista “Nëntori”, nr. 3, Viti 1963, Analizë Këngët e Milosaos, Dhimitër Shuteriqi.
4. Studi di letteratura Albanese, Roma: Urbinati, 1960, Giuseppe Gradilone.
5. La figura di Scanderbeg nell’opera del De Rada, Klara Kodra.

Zhvillimi historik i fitimit të pronësisë në periudhën post-komuniste



Abstrakt

Fitimi i pasurisë së paluajtëshme, si një Institut i të Drejtës Civile por edhe si element bashkëjetues i jetës njerëzore, është trajtuar me seriozitet si një nga aspektet më të prekshëm të ligjit material ashtu edhe atij procedural, në rende të ndryshme shoqërore e në epoka të ndryshme të zhvillimit. Edhe me lëvizjet e mëdha historike, lufta, zhvendosje, migrime apo emigrime, prona ka qenë në vëmendje dhe është trajtuar në të gjitha legjislacionet, paçka regjimit juridik apo formës së ndërtimit të shtetit, në çdo kohë. Trajtimi juridik i të gjitha problematikave jo pak herë të vështira dhe komplekse, në lidhje me fitimin dhe ruajtjen e pronës, ka nxjerrë në pah se çështja pronë mbart në vetvete, përveç aspektit ligjor të saj, edhe një aspekt shumë kompleks dhe unanim siç është ai antropologjik, pra i sjelljes sociale në lidhje me konceptin e fitimit të pronës e parë kjo në një spektër të gjërë.

Analizimi i fenomenit të fitimit të pronësisë duhet parë nën një fokus historik, dhe duke iu referuar periudhës kohore që shkon nga viti 1991 e deri në ditët e sotshme, vihet re se tipari më objektiv dhe karakteristik i saj është sjellja sociale në Shqipërinë post komuniste ndaj mënyrave, jashtë ligjore të fitimit të pronës, në një aspekt gjithëpërfshirës. Vërtet në vëmendje është fitimi i pronës, por binari paralel është analiza e sjelljes së popullatës shqiptare në lidhje me fitimin dhe ruajtjen e saj. Duke vënë re që sjellja e popullatës shqiptare ndaj pronës jo vetëm nuk ka ndjekur ligjin por ka bërë të vetën mënyrën e përvetësimit pa shkak të saj, duke arsyetuar shpesh herë me bazë të drejte zakonore e herë të tjera me përshtatje ndaj fenomenit të uzurpimit të tokave shtetërore ose të pronave të pronarëve të vjetër. Problematikat që krijohen dhe që kanë nevojë për zgjidhje janë të shumta. Qëllimi nuk është thjesht të sjellë në vëmendje të lexuesit

evoluimin në progres apo regres që legjislacioni i pronës ka mbartur dhe vazhdon të mbartë, por përpjekja për të vënë përballë sjelljen sociale në lidhje me format e përdorura për fitimin e pronës, dhe mbi të gjitha të përçojë në vëmendjen e gjithkujt influencën e imponuar nga kjo sjellje sociale në legjislacionin shqiptar, duke e bërë këtë të fundit të përshtatet me ndryshime jo shpeshherë të dobishme.

Fjalët kyçe: *Prona, trualli, tokat bujqësore, reforma agrare, Ligji 7501 "Për tokën", AMTP akti i marrjes së tokës në pronësi, Ligji 7698 "Mbi Kthimin dhe Kompensimin e Pronave" për kthimin dhe kompensimin e ish pronarëve, historik i pronësisë, legalizimin i ndërtimeve informale.*

Historik i Përmbledhur i Pronësisë së Tokës në Shqipëri

Pas pavarësisë së vendit në vitin 1912, shpërndarja e tokës ishte jo proporcionale: një pjesë e vogël e popullsisë (3%) kishte në pronësi përrreth 27% të tokës. Një pjesë e pronarëve, institucionet shtetërore dhe disa institucione fetare kishin në pronësi pjesën më të madhe dhe pjellore të tokave. Pronarët e vegjël dhe të mesëm kishin në pronësi rreth 60% të tokave bujqësore. Gjatë regjimit komunist toka u shpronësua. Brenda një viti, në vitin 1945 një pjesë e tokës, e cila iu përkiste pronarëve të pasur dhe klasës së mesme, iu rishpërndarë atyre që kishin qenë më parë pa tokë, ose atyre që kishin më pak se 5 hektarë. Pronarët e mesëm dhe të mëdhenj kishin të drejtë të mbanin vetëm 5 hektarë tokë bujqësore. Kjo rishpërndarje u bë e legjitimuar, për arsye sepse së bashku me posedimin e pronës iu dha familjeve dokumentacioni i quajtur «tapi» (vërtetim pronësie). Megjithatë, edhe pse e drejta e pronësisë u transferua në këtë mënyrë, të drejtat të tjera në lidhje me pronësinë e tokës sikurse ishte shitja apo dhënia me qira nuk ishin të njohura, gjë e cila padyshim çonte në pengimin e zhvillimit të ekonomisë agrare në tërësi. Viti 1946 pasoi me kolektivizimin e tokës, që do të thotë se të gjitha asetet/pronat e tipit tokë duhet të përdorëshin për kooperativat e prodhimit dhe fermat shtetërore bujqësore, me qëllim arritjen e vetë-mjaftueshmërisë bujqësore. Në këtë mënyrë, në vitin 1976 të gjitha tokat e vendit u shtetëzuan. Në vitin 1979, 76% e tokës bujqësore u kolektivizua nga kooperativat, 21% nga fermat bujqësore dhe vetëm 3% ishte në pronësi private. Në vitin 1979¹ të gjitha tokat ishin në pronësi të shtetit, duke e bërë Shqipërinë një nga vendet më të kolektivizuara në Evropë. Në fund të viteve '80, ekonomia e vendit ishte në krizë për shkak të një sërë politikave të shtrembëruara ekonomike, por kontrolli i repte i tokës ishte një element shumë i rëndësishëm.

Në fillim të viteve '90, pas rreth gjysmë shekulli ekonomie shtetërore, u gjykua e drejtë nga faktori politik në Shqipëri, që të ridimensionohej koncepti i pronës dhe transferimi i të drejtave të pronësisë qofshin ato troje apo pasuri të tjera të paluajtshme, nga shteti i cili i kishte centralizuar për më shumë se 40 vjet, tek individit, si person fizik apo person juridik². Ideja e heqjes nga shteti të pronës publike, dhe dhënies tek qytetari si pronë private gjë e cila do të hapte siparin e një forme totalisht të ndryshme nga ajo e deri atëherëshme në ekonominë e ashtu quajtur të tregut, në gjenezën e saj ishte shumë e drejtë. U krijuan kësaj ligjet e para, të cilat do të bënin këtë ndryshim epokal, dhe që në vetvete përmbanin një përzierje konceptesh ligjorë bashkëkohore mbi pronësinë, të huazuar nga jashtë me elementë të traditës shqiptare të marrëdhënieve familjare, klaneve dhe zakonore³.

¹Partia Komuniste e Shqipërisë kishte planin e saj për bujqësinë. Ajo vuri theksin kryesisht tek transformimi i saj në kolektivizimin e prodhuesve të vegjël dhe krijimin e fermave të mëdha shtetërore. Ky proces filloi me ngritjen e kooperativës së parë socialiste në vitin 1946, ndërkohë që kolektivizimi i plote i bujqësisë përfundoi në vitin 1976. Në këtë vit kooperativat zinin de facto 75.8% të tokave bujqësore; fermat shtetërore 20.7% të saj dhe kopshtet individuale vetëm 3.5% të saj. Ndërsa ligjërisht ky proces përfundoi në vitin 1976 me aprovimin e Kushtetutës së re, e cila sanksiononte eliminimin e pronësisë private mbi tokën dhe transformimin e saj në pronë shtetërore. Në vitin 1979, në Shqipëri nuk kishte më asnjë fermë individuale private.

²U miratuan kësaj ligjet e para në lidhje me shpërndarjen e tokës. Nga shumë njerëz besohet se ligji i parë për ndarjen e tokave bujqësore është ai i vitit 1991 n.7501, por përpara kij ligji ka qenë ligji 7001/91.

³Qeveria e Stabilitetit me Kryeministër Ylli Bufin, paraqiti një variant në Kuvend për ndarjen e tokës në përdorim. Parlamenti shqiptar kryesohej nga Kastriot Islami dhe pasohej nga Aleksander Meksi. Socialistet ishin për dhënien e tokës në përdorim, duke arsyetuar se nuk mund të bëhej kalimi i pronësisë së tokave shtetërore pa pasur më parë ndryshime thelbësore kushtetuese (ku kushtetuta e re nuk ishte miratuar akoma). Demokratët të shoqëruar edhe nga

Kuadri legjislativ për administrimin e tokës

Më datën 19.7.1991 u miratua ligji “Për Tokën”⁴, i cili autorizonte ndarjen dhe transferimin e tokës nga fermat kolektive dhe më konkretisht tek anëtarët e familjeve të këtyre fermave në qytete ose kooperativave bujqësore në fshatra, në pjesë të barabarta. Sipas këtij ligji: “...Familjet anëtare të kooperativës bujqësore, ose fermerët e qyteteve pas ndarjes së tokës kanë të drejtë të shkëputen dhe të dalin subjekt më vete, duke marrë në pronësi tokën bujqësore që iu takon nga tërësia e subjektit ku bëjnë pjesë. Sasia dhe vendi ku do të jepet toka, përcaktohet nga komisioni i tokës”. Ligji nr.7501 gjithashtu kishte në përmbajtje të tij se “...Në dhënien e tokave në pronësi e në përdorim personave juridikë a fizikë nuk njihet pronësia e mëparshme, as madhësia dhe kufijtë e saj para kolektivizimit” duke mohuar në këtë mënyrë shprehimisht pronësinë dhe pronarët e mëparshëm të tokës bujqësore». Ligji përcakton se toka do t’i shpërndahet familjeve që kanë banuar në kooperativë, por nuk jep asnjë informacion apo të dhënë në lidhje me çfarë do të bëhet me pronat që do t’i zëvendësohen familjeve të prekura nga reforma agrare. Komisionet e tokës shpërndanë parcelat e tokës së kooperativave bujqësore tek familjet që jetonin dhe punonin në zonat rurale. Vendimet për shpërndarjen e tokës dhe «tapitë» u dhanë nga komisionet e përzgjedhura, duke lëshuar dokumentin “AMTP-akti i marrjes së tokës në pronësi”. Pronarët e rinj e morën tokën falas. Ky është një moment mjaft i rëndësishëm në historinë e pronësisë së tokave në Shqipëri, pasi ndodhi një reformë tjetër agrare pas vitit 1945 që shpërndante tokën me anë të zbatimit të parimit të barazisë dhe pa marrë parasysh interesat e ish-pronarëve që ishin shpronësuar. Kështu, në përcaktimin e pronësisë së tokës dhe të drejtave të përdorimit të saj, ligji “Për Tokën” nuk njeht pronësinë e tokës, madhësitë dhe kufijtë që ishin përcaktuar para kolektivizimit të kryer sipas regjimit të mëparshëm. Sipas burimeve të ndryshme, Parlamenti dhe Qeveria e Stabilitetit në vitin 1991 justifikuan përjashtimin e ish pronarëve dhe mohimin e të drejtave të tyre të pronësisë, me argumente të tilla si: a-sipërfaqja e tokës bujqësore për frymë ishte shumë e vogël - 0.22 hektar për person (ndoshta më e vogla në Evropë) në raport me shumicën e popullsisë që jetonin në zonat rurale (64%); b-popullsia ishte trefishuar në krahasim me vitet e Reformës Agrare; c-kishte pasur ndryshime të mëdha dhe një zhvendosje gjeografike midis rajoneve të ndryshme; d-si dhe transformimet në infrastrukturën dhe gjeografinë e vendit kanë krijuar probleme serioze për identifikimin e pronave. Për shkak se ligji i vitit 1991 ndaloi blerjen ose shitjen e tokës së zotëruar privatisht fillimisht nga shteti, situata ndryshoi në vitin 1993 me miratimin e ligjit⁵ të qirasë së tokës, i cili lejonte dhënien me qera të tokës bujqësore, dhe në vitin 1995 me miratimin e ligjit⁶ për (shitjen e tokës)⁷, i cili lejonte shitjen e tokës.

Ligji “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish Pronarëve”⁸

Një ligj tjetër shumë i rëndësishëm në lidhje me pronësinë është Ligji nr.7698 i vitit 1993 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave”, i cili kishte për qëllim kthimin e pronave ish pronarëve të cilët e kishin pasur atë me titull përpara reformës agrare. Çështja nuk ishte e lehtë për t’u zgjidhur, pasi me ligjin 7501 ndarja e bërë, sikurse u tha më lart, nuk kishte marrë parasysh as pronarët e mëparshëm (para reformës) dhe as kufijtë e tyre⁹. Në disa fshatra, familjet hodhën poshtë rezultatet e ndarjes sipas Ligjit nr.7501 dhe

grupi parlamentar i Omonio-s (deputetët e zgjedhur nga radhët e komunitetit grek në Shqipëri) ishin për kalimin e pronësisë. Ky variant më pas ndryshon gjatë diskutimeve pas kundërshtimit të fortë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike. Me ndërhyrjen e Kryeministrit Bufi dhe kreut të PS-së, Fatos Nano, teksti ndryshon dhe në mënyrë të rrufeshme termi “përdorim” kthehet në “pronësi”, pa u konsultuar paraprakisht. Çështja shkakton paqartësi te deputetët socialistë, të cilët në fund vihen të votojnë në mënyrë kaotike pa e ditur se si dhe pse. Edhe pse i hyrë në fuqi që prej 23 vjetësh, ende nuk është zbatuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që aty ku është zbatuar është bërë “fshatçe” ashtu siç dhe u miratua, pa një praktikë të saktë ligjore dhe procedurë standarde.

⁴Ligji N.7501 “Për Tokën” miratuar pas dhjetë ditësh diskutimesh të gjata, 10-19 korrik 1991, nga qeveria e koalicionit PS-PD, ose e quajtur ndryshe qeveria e stabilitetit, me kryeministër Ylli Bufin.

⁵Ligji n.7715 datë 2.6.1993 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.7501, DATË 19.7.1991 “PËR TOKËN”

⁶Ligji n.7983 i datës 14.08.1995 “Për shit-blerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave”

⁷Ligji n.8503 datë 21.12.1995

⁸Ligji nr.7698 i datës 15.04.1993 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish Pronarëve”

⁹Gjendur në të tilla rrethana qëllimi i ligjit në fjalë ishte me dy përqsaje, në njërin anë kthimin e tokës për ata pronarë

ndanë tokën mbi bazën e konceptit të pronësisë sipas kufijve të përpara reformës agrare. Ky fenomen veçanërisht u vu re në zonat bregdetare ¹⁰. Ky proces u shoqërua nga shumë probleme dhe ende nuk ka përfunduar. Parimi i kthimit dhe kompensimit ish pronarëve, prona e të cilëve u konfiskua në periudhën komuniste, iu shtua legjislacionit shqiptar në vitin 1993. Në kohën kur ky ligj u miratua nga parlamenti, programet e shpërndarjes së tokave bujqësore dhe privatizimit të banesave ishin në proces. Kështu, ka lindur një problem i ri që ligjet duhet të zgjidhin konfliktin midis pronarëve të rinj (ata që fituan tokën e tyre sipas legjislacionit të privatizimit të vitit 1991) dhe ish pronarëve. Ligjet fillestare për kthimin dhe kompensimin parashikonin dhënien e tokës alternative ose kompensimit financiar dhe jo kthimin e pronës aktuale. Kjo përfshinte të gjithë tokën bujqësore, tashmë objekt shpërndarjeje sipas ligjit nr.7501.

Pikat kryesore të Ligjeve 7501-7698

Ligji mbi kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ligje të tjera të lidhura me tokën, me mirëqenien sociale krijuan një përpjesëtim të zhdrejtë pronësie midis shumë zonave dhe individëve të të njëjtit grupim krahinor. Ky proces është shoqëruar me probleme dhe ende nuk ka përfunduar as në ditët e sotme. Programi i Kompensimit dhe Kthimit ish pronarëve, pronat e të cilëve u shpronësuan gjatë regjimit të komunizmit, u konsolidua me ligj 2 vjet pas zbatimit dhe veprimit të programit të shpërndarjes së tokave bujqësore dhe privatizimit. Kjo hapësirë kohore shkaktoi konfliktet e para midis pronarëve të rinj (atyre që fituan të drejta sipas legjislacionit të privatizimit pas vitit 1991) dhe ish pronarëve, konflikte që me kalimin e kohës sollën probleme të mëdha teknike dhe ligjore. Të gjitha tokat bujqësore, në bazë të shpërndarjes sipas Ligjit 7501, të zotëruara para vitit 1946 nga ish pronarë, u llogaritën dhe u njohën vetëm formalisht, me shtesën që duhet t'i jepet tokës bujqësore ose kompensimit financiar.

Pasojat në terren

Pas nënndarjes së tokës së punëshme në të gjithë vendin, projektimi i pejsazheve të vendit pëson ndryshime të ndryshme. Pavarësisht nga problemet ligjore të pronësisë së tokës, një çështje e rëndësishme që na shoqëron kohët e sotme është ndarja fizike. Në historinë ligjore dhe institucionale shqiptare, ky është një nga ligjet më të debatuar. Ky është një diskutim shumë i gjatë i cili ka ngelur pa zgjidhje dhe mbetet i hapur edhe në ditët e sotshme. Në lidhje me studimin, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të theksohen pasojat dhe problemet e projektimit të pejsazheve që pasuan, pas zbatimeve të ligjit 7501. Kështu, në lidhje me projektimin e pejsazheve është evidente ndarja tepër specifike dhe e veçantë e tokës bujqësore. Ndarja fillestare ishte sipas kufijve të njërive vendore administrative. Secili fshat është unik në lidhje me mënyrën si ka zbatuar apo jo procesin e reformës së tokës, pra është shumë e rëndësishme që të bëhen përgjithësime të zgjeruara. Para vitit 1990, kur njerëzit banonin afër qendrës së qytetit ose fshatrave, toka bujqësore përdorej vetëm për qëllimin kryesor të kultivimit. Pas zbatimit të Ligjit nr. 7501, toka e punëshme pas ndarjes ishte përdorur për ndërtimin e shtëpive dhe godinave të objekteve (treg, bar etj.), duke shndërruar destinacionin ligjor të saj, nga tokë bujqësore në truall ndërtimi, gjë e cila bëhet shkak edhe për vlerësimet e ndryshme në tregun ekonomik të të dyja tipologjive.

që rastësisht toka e tyre nuk ishte bërë objekt shpërndarjeje sipas 7501, dhe kompensimin për ata pronarë të tjerë të cilëve toka iu ishte shpërndarë sipas 7501. Këta të fundit shteti do t'i kompensonte për humbjen e pronës nëpërmjet: kompensimit financiar, dhe/ose me obligacione shtetërore, dhe/ose me truall ekuivalent. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ligje të tjera të lidhura me tokën, me mirëqenien sociale krijuan jo vetëm një ndjenjë pronësie midis shumë grupeve dhe individëve, por edhe ndasi sociale në nivelin e të ardhurave.

¹⁰ Në procesin në fjalë, në lidhje me ndarjen e tokave bujqësore i referohet kryesisht Bregdetit të Himarës. Këtu në respektim të ligjit, procesi i ndarjes së tokave, gjithmonë sipas ligjit 7501 u trajtua në funksion të pronave të vje tra. Banorët, përgjithësisht, me marrëveshje mes tyre, vendosën që në këtë aspekt të veprojnë, duke i ndarë tokat "fshatçe". Me konkretisht fenomeni i vu re në Palasë dhe Himarë. Ky fenomen ka krijuar problematika për ata banorë të cilët erdhën në këto zona gjatë viteve të komunizmit dhe punonin në kooperativat apo fermerat e bregdetit. Problemi qëndron në faktin se tokat e marra prej tyre sipas 7501, iu përkasin pronarëve të tjerë (atyre përpara reformës), gjë e cila ka shkaktuar konflikt dhe për këtë arsye pala fituese me 7501 i është drejtuar gjykatës. Nga ana tjetër, ka edhe banorë autoktonë që nuk kanë patur prona të trashëguara, por kanë përfituar përmes ligjit 7501. Edhe ata kanë çështje gjyqësore të hapura me persona që pretendojnë për pronësi, sipas hartave të vjetra të para vitit 1946.

Pasojat e paligjshme

Situata ishte ndërlikuar nga nënndarja e tokës në mënyrë informale. Pronarët që fituan tokën në bazë të ligjit 7501 më vonë i shitën një pjesë të asaj toke pronarëve të rinj, në shumë raste, pa dokumente ligjore. Sikurse ka ndodhur rëndom, një parcelë i ndahet më shumë se dy pronarëve dhe të dy kanë ndërtuar shtëpitë kryesisht në mënyrë të paligjshme. Këtu ka një problem të dyfishtë, fillimisht për sqarimin e pronësisë së tokës (kush e zotëron ligjërisht dhe kush jo) dhe së dyti ndërtimet e paligjshme. Në raste të ndryshme, sipas të dhënave të Aluizni-t, as fshatari i shtëpisë, as fshatari i tokës nuk ka dokumente të ligjshme¹¹. Pra një tokë e cila i ka përkitur një ish pronari, është dhënë me 7501 tek një pronar i ri, i cili ka bërë dy gjëra:

1. Ose e ka shitur këtë tokë, akoma të pa pajisur me certifikatë pronësie tek një individ tjetër i cili në rastin më të mirë ka ndërtuar një banesë apo njësi pa leje;
2. Ose ka ndërtuar vetë mbi këtë sipërfaqe një banesë të pa legalizuar. Si në njërin ashtu edhe në tjetrin rast, me lekët e paguara për procesin e legalizimit si të truallit ashtu edhe të godinës, shteti ka kompensuar ish pronarët, të cilët gjithsesi janë të pakënaqur si me shumën e lekëve të fituar ashtu edhe, mbi të gjitha, me heqjen e mundësisë së posedimit edhe një herë të pronës së tyre, ku përfitimi nga përdorimi direkt i saj do të ishte shumë më i madh se sa kompensimi që shteti iu bën në lekë.

Me zbatimin e ligjit n.7501 të vitit 1991, u bë një padrejtësi e madhe kundrejt pronarëve të tokave, të cilët kishin pronësinë të certifikuar, që përpara reformës agrare 1946. Jo vetëm kaq, por ajo u nda duke mosrespektuar asnjë nga mënyrat e caktuara në Kushtetutë. Edhe pas hyrjes në fuqi në vitin 1998, të Kushtetutës aktualisht në fuqi, ligji nr.7501/91, i cili doli dhe hyri në fuqi para Kushtetutës pikërisht atëherë kur u prishen kooperativat bujqësore, nuk u shfuqizua asnjëherë. Gjykohet se problemi i tokës mund të ishte zgjidhur sikurse u veprua në malësitë e veriut shqiptar, ku malësoret nuk e zbatuan kurrë ligjin nr. 7501/91. Për këta pronarë nuk kishte dhe nuk ka probleme që kërkojnë zgjidhje për tokën, pasi ndarja e tokës për ta ishte thjesht kthimi tek tokat e vjetra, përpara vitit 1946.

Situata paraqitet krejt ndryshe në zonat e Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut. Gjykohet, se nxitimi i palëve politike të qeverisjes teknike të vitit 1991, bazuar në koalicionin PS-PD, për të fituar sa më shumë vota, bëri ndarjen e tokave duke mos konsideruar asgjëkund pronarët e ligjshëm, dhe shkaktoi një dëm të pariparueshëm përherë. Me qindra e mijëra pronarë të ligjshëm, të cilët në vitet e diktaturës komuniste kishin lënë trojet dhe tokat, pasi ato ishin kolektivizuar, dhe ata ndërkohë mund të ishin larguar në kërkim të një pune pranë qyteteve, me ligjin e lartpërmendur u zhveshën nga e drejta e pronësisë mbi tokën, sepse ajo iu nda nga komisionet anëtarëve të familjes bujqësore.

Në terma më konkret, situata në disa fshatra të Jugut shfaqet e tillë: qindra familje janë zhvendosur në qytete brenda vendit apo edhe në emigracion jashtë shtetit. Këto familje janë zhveshur plotësisht nga e drejta e pronësisë. Pronarë të tokave të tyre dhe të qindra e mijëra rrënjëve të pemëve frutore në bazë të ligjit nr. 7501/91, janë bërë familje të tjera, të cilat më parë merreshin kryesisht me blegtori, banonin në mal, ishin në fermë apo kooperativa. Këto familje aktualisht shfrytëzojnë tokën dhe pemët frutore, shesin vaj ulliri e raki, ndërsa pronarët e ligjshëm nuk kanë të drejtë të marrin qoftë edhe një kilogram mollë.

Me fjalë të tjera, ky shpronësim i detyruar me ligjin 7501 të vitit 1991, është edhe më i keq se reforma agrare e vitit 1946, e cila, në të mirë apo të keqe iu linte pronarëve një sasi të kufizuar toke.

¹¹Vetëm nga të dhënat e Drejtorisë së Aluiznit (Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimit Informale) ne janar të vitit 2014, rezultojnë 50.000 ndërtime të paligjshme të cilat kanë bërë pagesat dhe nuk kanë bërë matjet në vend, proces ky i domosdoshëm përpara pajisjes nga ky Institucion me dokumentin Leje Legalizimi, i cili pararend pajisjen me certifikatë pronësie.

Pronësia dhe kthimi i tokës.

Ligjet për kthimin dhe kompensimin e tokës nën pronësi para vitit 1946, rezultuan të pakënaqshme sepse familjeve të prekura që pretendonin kthim duhet t'u jepeshin alternativa të tjera të tilla si një dhënie e tokës tjetër ose kompensim financiar. Ndërkohë, mbështetësit e procedurës së kthimit të tokës gjithashtu filluan të fokusojnë vëmendjen e tyre në zonat turistike, si fusha të mundshme nga të cilat mund të nxirrej dhënia e tokës alternative. Në fund, procesi i kompensimit nuk u zbatua dhe pretendimet e ish-pronarëve mbeten të papërmbyshura. Ligjet mbi kthimin dhe kompensimin duhet të interpretohen në kontekstin e dispozitave kushtetuese për të drejtën e pronës private.

Në të vërtetë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përfshin dispozita më të konsoliduara e të fuqishme. Ligji mbi pronësinë përgjatë brezit bregdetar ende kundërshtohet nga Qeveria, dhe rezulton të jetë një pengesë kritike për zhvillim. Në dijeninë e shkruases nuk ka asnjë vend në Evropë ku prona shtetërore detare të jetë privatizuar tek individët, ashtu sikurse rëndom ka ndodhur në Shqipëri (dhe vazhdon të ndodh) në të ashtuquajturat fshatra turistike përgjatë bregdetit të Durrësit, Golemit etj...

Padyshim këto forma përfitimi të pasurisë janë pasqyruar në ndryshime të para legjislative, të cilat iu kanë hapur rrugën ndryshimeve më të plota dhe të rëndësishme, të tilla si nenet që i referohen pronës sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i cili i ka hyrë në fuqi në vitin 1994, dhe për pasojë nuk ka mundur të përfshijë brenda koncepteve themelart juridike, sikurse është ai i pronës, "Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji"¹². Pra nuk është e vogël problematika e krijuar pasi koncepti pronë, sikurse është fituar nga viti 1991 e këtë, jashtë kontureve dhe përmbajtjes së kodit civil, nuk gjen mbështetje në ligj. Subjektet e pronës mund të jenë persona fizikë dhe juridikë, si dhe ente publike. Është e qartë vështirësia e ndarjes së koncepteve sipas Kodit Civil të R.SH, bazuar në situatën në terren të pronës. Por Ligji nr. 7501/91 nuk është në pajtim edhe me nenin 41 të Kushtetutës (1998) ku thuhet se:

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike.
4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundërt një shpërblimi të drejtë.

Pra duket qarte se forma e fitimit të pronësisë, sipas 7501/1191 nuk gjen veten brenda dispozitave kushtetuese.

Një përshkrim i shkurtër mbi kuadrin legjislativ për legalizimin e ndërtimeve informale

Tregu informal

Pas vitit 1990 Shqipëria pësoi ndryshime të jashtëzakonshme pasi zbatoi modelin e shpejtë të kalimit në një ekonomi tregu, gjë e cila nënkuptonte ndryshime rrënjësore. Popullsia filloi të zhvendoset dhe të vendoset lirisht në zona të tjera të vendit, veçanërisht në ato që ose ishin afër detit, ose në qendra më të mëdha urbane, ku mund të gjenin punë dhe shërbime të tjera. Ky fluks popullsie nuk parashikohej dhe nuk mund të menaxhohej me ligjet dhe rregulloret e vjetra që rregullonin territorin para tranzicionit. Megjithatë, mund të themi se nuk menaxhohej dot për shkak të mungesës së njohurive për politikatat moderne të menaxhimit urban dhe të tokës, ku mbrojtja e pronës private dhe e drejta e trashëgimisë është thelbësore për demokracinë dhe zhvillimin ekonomik, ndërsa mbrojtja e interesit publik është baza për zhvillimin qytetar. Zakonisht, të ardhurit informalë zënë tokë publike dhe/ose private ose kanë blerë tokën nga një pronar i ligjshëm, por në disa raste ato zihen nga të ardhur të paligjshëm. Në të gjitha rastet ata kanë ndërtuar pa leje, gjë që nënkupton se ambientet e tyre nuk përshatën me një plan

¹² Neni 149, Ligji nr. 7850 date 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"

të caktuar.

Padashur të fokusohem tek informaliteti dhe ndërtimet e paligjshme, të cilat jo vetëm përbëjnë një temë të veçantë dhe të zgjeruar studimi, por tashmë edhe pse jo të cituar tekstualisht në Kodin Civil, mund të konsiderohen si forma të (jashtë) ligjshme të fitimit të pasurisë, të paktën sipas Kodit Civil dhe Kushtetutës së Shqipërisë. Jo vetëm kaq, por në vazhden e padrejtësive që iu është bërë pronave në Shqipëri, formalizimi i zënies së tokave bujqësore, trojeve apo pronave të çfarëdolloj forme, ka vënë gurin e ndunit të rëndësës në pronë. Historia botërore njeh shumë raste të informalizimit të ndërtimeve të paligjshme, siç është rasti i Serbisë, Rumanisë, Maqedonisë etj., por asnjëherë këto ndërtime nuk prekën pronën private, por atë shtetërore, dhe në këtë rast ndërhyrja e shtetit ishte aktive dhe tempestive (në kohë) për të imponuar plane rregullatore, veçanërisht në zonat urbane¹³.

Konkluzione

Në Shqipërinë aktuale fenomeni pronë dhe fitimi i saj, është një koncept juridik dhe social, që shfaqet herë herë i panjohur e herë herë i keqinterpretuar. Është vënë re se duke nisur nga viti jo fort i largët 1991 e deri në ditët e sotshme, instituti juridik i fitimit të pasurisë së paluajtëshme ka pësuar një modifikim radikal. Arsyeya, gjykohet se i ka rrënjët në sjelljen sociale të të gjithë aktorëve në proces, privatëve dhe shtetit. Kjo sepse, në njërin anë popullata në ndryshim të sistemeve, është orientuar drejt fitimit të pronës, duke rikuperuar kohën e humbur në diktaturë, pa marrë parasysh atë çfarë ligji parashikon. Por në anën tjetër edhe kuadri ligjor post komunist, i ndodhur në varfëri normash juridike që tutelonin pronën, nuk ishte i gatshëm të përballonte ndryshimet frenetike që po impononte kërkesa/sjellja e popullatës dhe si rrjedhim vendmarrja në këtë fushë ka qenë e cekët dhe e pa thelluar. Pasojat që la nuk janë të pakta, në njërin anë ndodhet moria e ligjeve e cila edhe për praktikuesit e të drejtës e bën të vështirë orientimin si në det të hapur, dhe në anën tjetër bashkëjeton tendenca sociale e cila në rrugën e saj për të vënë rregull në njohjen e pronësisë ka sjellë padrejtësi të mëdha sidomos me klasën e pronarëve të vjetër. Fenomeni që ka detyruar shtetin të pranojë këto reforma, është ai social. Pyetja shtrohet nëse shteti duhej apo jo të lëkundej përpara sjelljes sociale, dhe nëse ai kishte pasur mundësi që këtë fenomen ta kontrollonte përpara se situata të ndryshonte në gjendjen në të cilën ajo paraqitet aktualisht. Pasojat ligjore në terren, nga zbatimi i ligjit 7501/1991 nuk janë të pakta: rrahje, plagosje, vrasje dhe konflikte të tjera pronësore, të cilat përbëjnë rreth 40–45 përqind të gjithë konflikteve që ndodhin në shoqërinë e sotshme shqiptare. Ligji në fjalë është në kundërshtim edhe me rekomandimet e K.E.-së, e të organizmave të tjera ndërkombëtare, të cilat vazhdimisht kanë kërkuar edhe kërkojnë nga organet tona shtetërore rregullimin ligjor të pronësisë mbi tokën¹⁴.

Vlen të theksohet se rastet e kazistikës dhe veçanërisht jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut 15, kanë për synim të vënë theksin në një fakt të vetëm: cilado qoftë zgjidhja gjyqësore, ashtu edhe veshja e problemit me faj apo jo, çështja e pronës dhe e kompensimit të saj ka shkaktuar në Shqipërinë e këtyre 25 vjetëve të fundit një problematikë sociale të rëndë dhe shumëdimensionale: pabarazi klasore, padrejtësi, shkelje të të drejtave themelore të njeriut, defekte këto që rëndojnë drejtpërsëdrejti tek kategoria e personave të interesuar, por mbi të gjitha një padrejtësi sociale e cila rëndon dhe do të vazhdojë të rëndojë në taksat e çdo qytetari shqiptar që i derdhë këtij shtetit, pasi vetë ky është shkaktar me veprim apo mos veprimin e tij, i këtyre padrejtësive.

Aktualisht në gjykimin e shkrueses, nuk vihet re asnjë formë zgjidhje radikale, e cila do të vinte në drejtpeshim interesat e palëve direkte të interesuara. Përfashtuar fushat politike, që për hir të së vërtetës as nuk prekin me ligjin famëkeq 7501, asnjë

¹³ Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE) (2006) Report on Roma Informal Settlements in Bosnia and Herzegovina. (Mission to Bosnia and Herzegovina, http://www.cohre.org/view_page.php?page_id=237, accessed on November 15, 2007). OSCE, Sarajevo

¹⁴ Ismet Elezi, intervistë VOA (Voice of America) gusht 2007.

¹⁵ Shih vendimet e GJEDNJ, “Manushaqe Puto kundër Shqipërisë”; “Treska kundër Shqipërisë”; “Vrioni kundër Shqipërisë”..etj

përpjekje serioze për të kthyer situatën në rendin e duhur, nuk vihet re. Pra interesi politik, tashmë është shuar njëherë e përgjithmonë në zgjidhjen e çështjes së kthimit të pronave ish pronarëve. Ajo që rëndon më shumë, është “dorëzimi” nga ana e të gjithë ish-pronarëve në shpresën se kjo situatë do të rregullohet ndonjëherë. Tashmë, ata nuk dëgjohen më, dhe kuptohet vetvetiu pasi të lodhur nga kalvaret e pafund të të gjitha shkallëve të gjyqimit brenda dhe jashtë Shqipërisë, nuk e gjetën ndonjëherë të drejtën dhe shpresën për të rregulluar situatën e pronave të tyre. Shpresohet fort, se ndonjë forcë politike, e cila do të marrë seriozisht zgjidhjen e “plagëve” të pronave në këtë vend, do të gjykojë një ditë të zgjidh çështjen e pronave dhe ish pronarëve, jo si një detyrim moral ndaj këtyre të fundit, por si një pengesë e pashmangshme për të ecur përpara si shoqëri civile dhe me ndjenja evropiane. Sigurisht pa u bërë shumë vonë.

BIBLIOGRAFIA:

1. Besnik, A., Lulo, K. & Myftiu, G. (2003), Tirana – sfida e zhvillimit urban. CETIS, Tirana
2. Tsenkova, S. (2009), Housing reforms in post-socialist Europe: Lost in transition.
3. Heidelberg, Springer-Verlag. DOI: 10.1007/978-3-7908-2115-4
4. Tsenkoa, S. (2010), Informal settlements in post-communist cities: Diversity factors and patterns DOI: 10.5379/urbani-izziv-en-2010-21-02-001
5. Pojani, D. (2011), Maintenance and Management of Communist-Era Privatized Flats and New Condominiums in Tirana: Legal Requirements and Actual Practices. Universiteti Epoka, Tiranë, Shqipëri
6. Spencer, H. Njeriu kundër shtetit – pesë ese politike
7. King, P. Housing, Individuals and the State, United Nations. (2002), Country Profiles on the Housing Sector – Albania. New York and Geneva, ISBN 92-1-116832-5
8. Ministerial Conference on Informal Settlements in South Eastern Europe (2004) Vienna declaration on informal settlements in South Eastern Europe. Available at: http://www.unhabitat.org.pl/files/300/vienna_declaration.pdf (accessed 10 Jul. 2010).
9. De Soto, H. (2003), The mystery of capital: Why capitalism triumphs in the West and fails elsewhere. New York, Basic Books.
10. Andoni D (2007) Legalization of Informal Settlements in Albania. Paper presented at 5th Regional Vienna Declaration Review Meeting, Stability Pact for South Eastern Europe, 22-23 October 2007
11. Bolay JC (2006) Slums and Urban Development: Questions on Society and Globalisation.
12. The European Journal of Development Research 18, 2: 284-298 Council of Europe Development Bank and the World Bank (2004) Housing in South Eastern Europe: Solving the Problem. Paris
13. De Soto H (2003) The Mystery of Capital: Why Capitalism Triumphs in the West and Fails Elsewhere. Basic Books
14. United Nations Economic Commission for Europe (2002) Country Profiles on Housing: Albania.
15. Gabriel B (2007) Informal Settlements in SEE – A Regional Support Approach. Paper presented at Informal Settlements – Real Estate Markets Needs Related to Good Land Administration and Planning FIG Commission 3 Workshop, Athens, March 28-31, 2007.
16. Housing and Property Directorate The (HPD) (2004) Status Report. HPD, Pristina Internal Displacement Monitoring Centre (IDMC) (2007) Global Monitoring Project. <http://www.internal-displacement.org/>, accessed October 26, 2007
17. Leckie S (2002) Regional Housing Issues Profile, Implementing Housing Rights in South East Europe.
18. UN-Habitat, Nairobi Settlements in South Eastern Europe 28 September to 1 October 2004, Retrieved on November 16th, 2007 from: <http://www.stabilitypact.org/humi/040928-presentations/>
19. Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE) (2006) Report on Roma Informal Settlements in Bosnia and Herzegovina. (Mission to Bosnia and

- Herzegovina, http://www.cohre.org/view_page.php?page_id=237, accessed on November 15, 2007). OSCE, Sarajevo
20. Payne G, Majale M (2004) *The Urban Housing Manual: Making Regulatory Frameworks Work for the Poor*. Earthscan, London 19 Involvement. (Paper presented at the European Network for Housing Research Conference, Rotterdam, 21-25 June, 2007) for Adequate Policy Responses. UNECE, Geneva
 21. Tsenkova, S. (2009) *Housing Reforms in Post-socialist Europe: Lost in Transition*.
 22. United Nations Human Settlements Programs (UN-HABITAT) (2003). *Global Report on Human Settlements 2003: The Challenge of Slums*. Earthscan, London.
 23. European Commission. 2010. *Opinion on Albania's Application for Membership of the European Union*. Brussels, November 9.
 24. European Commission. 2010. *Albania 2010 Progress Report*. Brussels, November 9.
 25. European Commission. 2011. *Albania 2011 Progress Report*. Brussels, October 12.
 26. European Court of Human Rights. 2012. *Violations by Article and by State: 1959-2011*.
 27. Economist Intelligence Unit. 1993. *Country Report for Albania*.
 28. Clarissa de Waal. 2004. *Post-socialist Property Rights and Wrongs in Albania: An Ethnography of Agrarian Change*. Conservation and Society 2.
 29. World Bank. 2006. *Status of Land Reform and Property Markets in Albania*. Tirana.
 30. European Parliament, Directorate General External Policies of the European Union. 2008. *Property Restitution in Albania*. Brussels.
 31. OSCE. 2003. *Commentary on the Draft Law on Restitution and Compensation of Property*.
 32. Report by the EC EURALIUS project. 2010. *Final Assessment Report on the Situation of Property Rights in Albania*. Tirana.
 33. Republic of Albania Council of Ministers. 2009. *National Strategy for Development and Integration: Progress Report 2008*. November.
 34. Republic of Albania Council of Ministers. 2011. *Decision no. 350 of April 29, 2011, On the Adoption of the Action Plan concerning the Property Rights Issues as Identified in the Memorandum of the Committee of Ministers of the Council of Europe*.
 35. World Bank. 2006. *Status of Land Reform and Property Markets in Albania*. World Bank: Tirana: appendix 12
 36. *Legal and Institutional Assessment, World Bank Integrated Coastal Zone Management and Clean-up Project*.
 37. Centre on Housing Rights and Evictions. 2002. *Albania: Resolving the Question of Land and Property Restitution and Compensation*. Report to the World Bank and OSCE.
 38. Government of Albania. 2009. *Draft Inter-Sectoral Strategy Reform in the Field of Property Rights*.
 39. Transparency International Albania. 2008. *Corruption with Property: An Impediment to Sustainable Development*.
 40. EBRD-World Bank. 2010. *BEEPS 2008*.
 41. Republic of Albania Council of Ministers. 2011. *Action Plan Addressing the Recommendations of the EU Opinion for Albania*. January.

Panairi i Shën Gjon Vladimirit, - Analizë antropologjike



Abstrakt

Materiali që vijon më poshtë është një përpjekje modeste për të bërë një analizë më të zgjeruar mbi koncepte të ndryshme antropologjike, të cilat ndërthuren në temën “Kulti i Gjon Vladimirit në Shqipëri”. Në rrjedhim të materialit hidhet një shikim ndryshe mbi vendndodhjen e hershme dhe tashmë në Elbasan. Më pas disa sqarime mbi mendimet e ndryshme se Shën Gjoni shihet si legjendë dhe pse respektohet figura e tij? Më tej do të analizojmë anën sociale dhe marrëdhënjet e ngritura në panair. Do të merremi në mënyrë më konkrete, me momente të jetuara nga udhëtarë të huaj, pikërisht për këtë panair. Do të ndërthurim domethënjen e kostumeve popullore pikërisht për këtë festë e në fund duke menduar se kontributi ynë modest do të jetë i vlefshëm për të ngjyrosur me disa interpretime të reja materialin do të japim disa përfundime.

Zhvillim

Nga sa kemi thënë deri më tani për panairin si ngjarje, do të ishte e pakët të shkruanim vetëm pak. Ne kemi obligim të analizojnë disa çështje, që do të ndihmonin në zbrërthimin e plotë të ngjarjes. Mbi origjinën e vjetër të kësaj ngjarje, legjendës që ngrihet si dëshmi e jetësuar ende në popull e shumë interpretime interesante.

Vendndodhjen e kishës e Shën Gjonit, na e kthjellon Milan Shuffaj. Ai na jep një peizazh mjaft të kthjellët mbi vendndodhjen e hershme të kësaj kishë. Në anën perëndimore të Shkodrës, i ndodhur tre orë e gjysmë rrugë këmbësore larg Shkodrës, në Krahinën e Krajës me banorë kryesisht shqiptarë, në këmbë të malit Katërkoll shtrihej

që në shek. X ... Kjo kishë, që dikur ndodhej në afërsi të rezidencës (*curia*) së një princi serb dioklitian, i cili nën emrin e Shën Vladimirit (+ rreth 1016 në kalendarin grek (*oficiet grek*) festohet madje edhe si patron i Durrësit, por që u pranua si i tillë edhe nga romanët dhe nga shqiptarët e qyteteve, arriti të kishte në pronësi të saj për një farë periudhe, reliket e këtij shenjt. Rreth këtyre relikeve në ditën e Shën Vladimirit më 22 maj mbledhesh një grumbull i madh besimtarësh qysh në ndërrimin e shek. XII-XIII¹. Duke parë vendndodhjen e kësaj kishe nën këndvështrimin antropologjik, do të duhet të bëjmë një qasje interpretative për të kuptuar “*place*” – vendi nga Margret Rodman. Ajo shqyrton mënyrat me të cilat vendi është një konstrukt social dhe kulturor². Ajo vazhdon më tej me sqarimin se, siç jetesa e antropologëve dhe njerëzve të zakonshëm në botë, po njëjtë ne jemi në kohë ose në kulturë. Këtu duam të sqarojmë se vendndodhjen e kishës duhet ta shohim në kompleks, si kohë, vend dhe rrjedhimisht ky vend si pjesë e një kulture të shtruar këmbëkryq aty. Antropologët në mënyrë të ngjashme mbajnë këto dy pikëpamje në dukje të kundërta në lidhje me vendin ku mund ta përcaktojmë: si një konstrukt antropologjik për «vendosjen» ose lokalizimin e koncepteve dhe si konstrukt social, përvojë e specializuar³. Dov Nir propozon që të dy këndshikimet mund të jenë të pajtueshëm për aq sa studimet rajonale janë në fakt studime të vendeve, marrëdhënieve shoqërore (Claval’s. 1984 “Social space”). Duke marrë këtë interpretim mund të themi se rajoni perëndimor i Shkodrës, krahina e Krajës ka një kulturë krejt ndryshe nga Shijoni i Elbasanit. Kështu, ritualet, mënyra e organizimit dhe komplet situata e panairit të Shën Gjon Vladimirit janë krejt të ndryshme. Milan Shuflaj thotë se Manastiri i Shën Gjon Vladimirit, sot Shin-Gjini afër Elbasanit në Shqipëri, u rindërtua nga themelet në vitet 1381-1383. Elbasani në atë kohë nuk ekzistonte⁴. Në vitin 1381 u rindërtua prej Karl Topisë⁵. Milan Shuflaj jep interpretimin e vet për vendin e kësaj kishe me një legjendë e cila duhet analizuar. Autori shpjegon më tej, se njihet mirë tek të gjithë sllavët e jugut, që në versionin e saj më të vjetër vjen nga presbiteri Diokleas (*Cmcic*, Kronika popa Dukljanina (Krajlevica 1874), fq 41), aty këtu është e gërshtuar me motive pagane shqiptaro-sllave⁶. Madje ai e hiperbolizon këtë legjendë duke e quajtur “Legjenda më e fuqishme e shenjtit në Ballkan”⁷. Kjo legjendë, si të gjitha legjendat në Ballkan krijojnë ura komunikimi të kulturave të ndryshme. Legjenda në vetvete mbart një shkëlqim kurjozues prej misterit që fsheh. Shuflaj thotë, se kjo legjendë e mbuloi me një rrezatim të vërtetë shenjtërimi kishën e vjetër që në atë kohë ishte ortodokse, bashkë me manastirin e Krajës që ekzistoi deri në fund të shek. XII-XIII. Tek Serbët dhe shqiptarët autori interpreton më gjatë lavdinë e habitshme që mbuloi kjo legjendë kishëzën e Zonjës së Papëlqyer të Krajës, në të cilën, në fund të shek. XII u mbajt një panair i madh ose falje në ditën e Shën Vladimirit (22 maj). Shën Joan Vladimiri jetoi e luftoi në Ballkan dhe ndaj tij ka një detyrim shpirtëror për lutjen dhe nderimin që i bëhet. Kuptohet që Shën Gjoni është një tregim folklorik i trashëguar gojarisht rreth ngjarjeve reale të personave ose vendeve që janë mjaft të rëndësishme për një shoqëri, si të tillë ato mitozohen. Vlerat e rëndësishme në një legjendë janë rrënjësor nga shoqëria. Si në legjendat e shkruara po ashtu dhe në ato gojore përfshihen elemente hyjnore. Ky fakt tregon dhe natyrën estetike të tij. Legjendat rreth mrekullive të shenjtoreve janë rast veçanërisht për shejntorët e fesë monoteiste. Në legjendë mrekullia ndonjëherë indetifikohet edhe me horrorin. Emile Durkenheim sqaron se çdo grupi i duhet flijimi, sepse ky më pas çon në bashkimin e

¹ Milan Shuflaj “Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke”, *Botimet Franceskane, Shkodër 2013, Fq 70, 71,*

² Margarect Rodman “Empowering Place: Multilocality and Multivocality”, *York University, (dok elektronik)*

³ Margarect Rodman “Empowering Place: Multilocality and Multivocality”, *York University, (dok elektronik)*

⁴ Milan Shuflaj “Serbët dhe shqiptarët”, përktheu nga kroatishja Prof. dr. Hasan Çipuri, *Botimet Toena, Tiranë, Fq 26*

⁵ A.Q.Sh. F. 138, D. 16, Fq 13.

⁶ Milan Shuflaj “Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke”, *Botimet Franceskane, Shkodër 2013, Fq 71,*

⁷ Milan Shuflaj “Serbët dhe shqiptarët”, përktheu nga kroatishja Prof. dr. Hasan Çipuri, *Botimet Toena, Tiranë, Fq 26*

grupit. Ai më tej shpjegon se flijimi i mbyllur dhe laiciteti janë disa nga karakteristikat e fesë⁸. Këto karakteristika fetare propozojmë t'i kuptojmë si rituale që mbruhën ndër shekuj në ditën e Shën Gjoni. Rituale të tilla janë pjesë e animizmit që mishërohen me legjendën dhe mitin e kësisoj ritualet e kryera nga një grumbullim njerëzish formojnë pelegrinazhin si organizim shoqëror. Meqënëse, ritualet interpretojnë dhe luajnë historitë që tregohen nëpër mite, dhe meqë nga ana tjetër mitet i shpjegojnë, dhe i racionalizojnë interpretimet rituale, prej shumë kohësh antropologët janë angazhuar në një debat të gjatë, dhe jo të frytshëm, se cila prej tyre ishte reflektim apo projektion i tjetrës. Në mënyrë më konstruktive antropologët janë përpjekur të gurmtojnë marrëdhënjen mes ritualit, mitit dhe strukturës shoqërore⁹. Durkheim (1912) dhe Radcliffe Brown i kanë parë ritet si përfoces të ndjenjës kolektive dhe të integritimit shoqëror¹⁰. Termit e fundit përkthehen në peligrinazhe. Kështu Shuflaj na tregon se kjo festë zhvillohet çdo vit në ditën e Krështajëve qoftë mysliman, qoftë të krishterët ortodoksë apo katolikë bëjnë pelegrinazh në Malin e Rumijës (1595 m) duke mbajtur këtë kryq. Ata ngrihen herët në mëngjes, pa lindur dielli, me qëllim që rrezet e tij ta gjejnë rreshtin e pelegrinëve në majë, para se cilës hapet një pamje gjigante përreth, ku mund të shihen Liqeni i Shkodrës, malësitë e Malit të Zi dhe të Shqipërisë së Veriut si dhe zona bregdetare midis Kotorrit dhe Durrësit. (*Jirecek*, G. der Serben 1, 207 f. sipas Jasrebov-Isevic, *Godisnjica Nikole Cupica* 24 (1905) 235 f.). Duke dashur të kthejmë pak analizën tek feja, duhet të analizojmë se besimi fetar i një populli dhe organizimi i tyre shoqëror janë të ndërlidhur ngushtë¹¹. Ky pelegrinazh i nxitur nga besimi në mitin e legjendës merr formën e një panairi. Johan Georg von Han na tregon se ky panair është festë për nderim të emrit të shenjtit dhe patronit të saj. Në këtë festë marrin pjesë fqinjët dhe të huajt simbas rëndësisë që ka manastiri ose kisha në fjalë. Në disa panairë të tjera marrin pjesë vizitorë të shumtë nga krahina shumë të largëta. Secilit person i jepej një bukë e një kupë verë, por nganjëherë edhe ullinj ose djath. Në këmbim secili prej tyre jep nga një parë të cilat i mbledh kujdestari i manastirit ose kishës. Kur panairët janë të përmasave të mëdha thirren paria e qyteteve, u japin rolin e kujdestarëve dhe i nderojnë me pritje e gosti të veçanta¹². Në panair merrnin pjesë një numër i madh pjesëmarrësish, gati 3000 vetë¹³. Madje në raste të ndryshme kishte përfaqësi diplomatike të huaja¹⁴. Padyshim në panair kishte edhe dhurata¹⁵, këmbime dhe tregëti. Për të analizuar më tej këtë ngjarje, po sjellim disa qasje teorike prej Marsel Maus, Branislav Malinowsky dhe Max Weber. Këtu duhet të kuptojmë së pari se dhurimi i sendeve apo ushqimeve në panair është një gjest social i definuar në trajtën e këmbimit material apo shpirtëror. Teoria e dhuratës është një teori e solidaritetit njerëzor dhe se këmbimi si dhuratë është si një vendim gjyqësor¹⁶. Sponsorizimet, domethënë, kontributet me dëshirë bëhen nga njerëz të cilët mund t'i përballojnë ato dhe të cilët kanë interesa materiale apo ideore tek komuniteti, qofshin apo jo anëtarë në drejtime të tjera. (Në rastin e komuniteteve fetare, format tipike janë ndihmat fetare. "Dhurata" me dëshirë për lypësit dhe manastiret, të cilat jepeshin nga princërit në kohërat e hershme historike.) Nuk ka ndonjë detyrim të caktuar apo lidhje të nevojshme midis ndihmave dhe formave të tjera të pjesëmarrjes¹⁷.

⁸ Anastasia Zherdieva "New social anthropological approach to the examination of legend", (dok elektronik).

⁹ Roger Keesing & Andrew Strathern, "Antropologjia kulturore", Një perspektivë bashkohore, UFO Press, 332.

¹⁰ Roger Keesing & Andrew Strathern, "Antropologjia kulturore", Një perspektivë bashkohore, UFO Press, 333.

¹¹ Roger Keesing & Andrew Strathern, "Antropologjia kulturore, një perspektivë e shkrutër, UFO Press, Fq 322.

¹² Dr. Jur. Johan Georg von Han, "Studime Shqiptare", përkthyer nga gjermanishtja Veniamin Dashi & Afron Koçi, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Fq 233.

¹³ Revista "Kisha Kombëtare", Dt. 30 Qershor 1935, Fq. 1.

¹⁴ Revista "Predikimi", Dt. 27 Korrik 1930, Fq. 4.

¹⁵ Në revistën "Predikimi", i dt. 30 Qershor 1935, Fq 1, jepet rasti kur Manastirit i dorëzohet këmbana e madhe prej personelit të Legatës Jugosllave, më sakt e dhuruar prej Sh. Tij Patriarkut Varnava dhe Sinodhit të Shenjtë të Jugosllavisë.

¹⁶ Marsel Mauss, "The gift", Fq Xi,Xii (dokument elektronik)

¹⁷ Max Weber "Studime sociologjike", përkthyer nga Enida Rusi, Plejad, Fq 75.

Njerëzit brenda strukturës sociale që ato bëjnë pjesë, mbartin vetinë e përsosur të solidaritetit social, e shprehur nëpërmjet të mirave materiale. Ky solidarizim ngjan në këto punë edhe si ndarje e paqtë e një çështje gjyqësore e cila domosdo shprehet me reciprocitet ekzakt. Mënyra sociologjike në të cilën rregullohen marrëdhënjet e reciprocitetit, i bën ato akoma më të rrepta¹⁸. Nga shpjegimet e mëtejshme që sjell Branislav Malinowski për teorinë e reciprocitetit, kuptojmë se teoria e reciprocitetit që ne e hasim paralel në panairin e Shën Gjjonit, sikundër ndodh edhe në shoqërinë njerëzore që ai ka studiuar (fisat Trobriande), quhet “kula”¹⁹. Ndërsa në panair forma reciproke e këmbimit shprehet në tregëtinë e kryer midis individëve tregtarë e blerësve që vijnë nga krahina të ndryshme. Po të futemi në analizën e marrëdhënjëve që ndodhin në panair, vërejmë se parimi i reciprocitetit ngjan si një normë, por kjo e përkthyer edhe në aspektin fetar. Kjo normë shprehet me ritualin dhe si rrjedhojë i gjithë panairi mund të shprehet si një ekuacion social. Kësisoj po guxoj e ta strukturoj të tillë: është një ngjarje popullore, një festë orthodoxe e ngjizur si pelegrinazh prej legendës dhe e veshur me rituale si norma sociale. E kështu solidariteti human i cili i detyron pa ndonjë ligj të shkruar të këmbëjnë reciprocikisht apo të shesin-blejnë, dhurojnë të bashkuar nën hijen e animizmit. Duam të sqarojmë se ritualet e kryera dhe besimi i individëve në shpirtëzimin e ujit në burimin e manastirit, ushqimi i dhuruar apo i këmbyer në manastir kryhet me besimin se mbarësia, shëndeti e bollëku do të jenë prezent në familjet shqiptare pas festës. Gjithsesi, zakonet dhe veprimet për të cilat folëm më sipër, nuk ndeshen në të gjitha shoqëritë²⁰. Duam të ndalemi dhe pak në interpretimin e veshjeve. Vlen të themi se për festën e Shën Gjjonit Vladimirit, apo edhe panairin që kryhet më 22 maj, gratë, burrat dhe vajzat mundohen të zgjedhin dhe të paraqiten sa më të zbukuruar e të veshur mirë. Kjo ndodh jo vetëm për krahinën ku ndodhet manastiri i Shën Gjjonit Vladimirit, por edhe individë të ardhur nga krahina të tjera kanë të njëjtin obligim, si shenjë rrespekti për shenjtin Gjjon.

Në përcaktimin e përgjithshëm veshja e Shpatit të Sipërm bën pjesë në veshjen me këmishë të giatë e përparje²¹. Në këto kohë veshja e grave dhe vajzave përbëhej nga linja (këmisha), përparja, guna (xhulkë, mëngore, mintan, xhokë), brezi, corapet, opingat dhe shamia e kokës. Veshja e kohës kryesisht linja përbëhej me pëlhurë pambuku mjaft të trashë, të punuar në vegjë nga vetë gratë e vendit. Gunat bëheshin prej shajaku të punuara në derstil me katër lisa. Ato zbukuroheshin me gajtan të bardhë prej leshi. Cibuni, një tjetër element i veshjes, me funksion të njëjtë si guna, vishej mbi linjë. Ishte e zbukuruar tek jaka dhe përfundi. Brezat e grave, gjithashtu punoheshin në vegjë nga vetë gratë e vendit. E ndërsa corapet ishin të bardha, të punuara me pesë shtiza. Për vajzat e vogla dhe plakat veshja kryesisht kishte elementë të thjeshtë, vetëm për nuset kishte zbukurime plot ngjyra pranë jakës dhe fundit të kostumit²². Në disa punime si rizat dhe përparjet veshja e gruas së krishterë e krahinës së Shpatit të sipërm, nga mënyra e trajtimit të motivit, ngjyrave të përdorura dhe teknikës së punimit, kjo krahinë përfshihet plotësisht në zonën e madhe, ku bën pjesë Myzeqeja, Dumreja, Sulova, Shpati, e Verca²³. Në veshjet e Shpatit gratë dhe vajzat kishin diferencë të vogla për sa u përket përkatësisë sociale. Kjo diferencë shprehej edhe nëpërmjet përdorimit të stolive të kushtueshme²⁴. Padyshim, në rrethana të një panairi apo pelegrinazhi festiv banorët vishnin veshjet më të mira e sa më të zbukuruar me fije ari. Këtë e shikojmë fare mirë në fotografitë e kryera nga Hugo Bernartzik.

¹⁸ Branislav Malinowski “Krimi dhe doket në shoqërinë e egër”, përkthyer nga Arsim Canolli, Cuneus 2003, fq 49-50.

¹⁹ Branislav Malinowski “Krimi dhe doket në shoqërinë e egër”, përkthyer nga Arsim Canolli, Cuneus 2003, fq 50.

²⁰ Claud Levi Strauss, “Mendimi i egër”, Shtypshkronja Fryma, Prishtinë, fq 250

²¹ Andromaqi Gjergji, “Ligjerata për etnologjinë shqiptare”, Tiranë 2004, fq 151.

²² Andromaqi Gjergji, “Etnografia Shqiptare IV”, Tiranë 1972, fq 141-143.

²³ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, “Shpati i Sipërm”, Tiranë 1987, fq 176.

²⁴ Andromaqi Gjergji, “Ligjerata për etnologjinë shqiptare”, Tiranë 2004, fq 159.

Hugo Adolf Bernatzik një udhëtar i etur mbas kulturës dhe traditës shqiptare na përcjell disa foto mjaft të spikatura si më poshtë:

Për foton 1, autori përshkruan kështu: “Fshatare në festën ortodokse të Shën Janit në Shingjon. Petku festiv është punuar me dorë, mbizotëron kryesisht e kuqja dhe e bardha, jeleku është qëndisur me ar, bizhuteritë e shumta të qafës janë prej argjendi. Në duar, unaza të gdhendura nga metale të çmuara”. Në këtë foto vihet re nga veshja, se gruaja i përket fesë ortodokse. Zbukurimet janë të shumta, me pafte zbukuruese e unaza në duar. Në foton 2 ai shkruan: “Fshataret marrin pjesë në një festë bashkë me fëmijët e tyre²⁵. Edhe këtu gratë me xhoket dhe këmishet e gjata të mbërthyera me brezin plot ngjyra e me përparjet e zbukuruara ngajnë se janë të Shpatit të Sipërm.



Foto 1



Foto 2

Në foton 3 po i njëjti autor e përshkruan: “I shkëlqyeshëm është petku i kësaj fshatareje të pasur”. Kjo pasi në raste festash gratë zgjidhnin bizhuteritë më të mira e veshjet më të bukura. Në foton 4, ku shfaqet një burrë me veshjen popullore, të cilin H. A. Bernatzik e përshkruan: “Fshatar në Shingjon me petk bardhë e zi, të qëndisur me ar dhe me shirita të larmë”. Nga hulumtimet e kryera ky zotëri quhet Jorgji Gega, stërgjysh i At Irine Gega, prifti i manastirit Shën Gjoni Vladimirit. Veshja e burrit në foto është e tipit veshje me brekësha. Këtu pjesa tipike është brekëshat, pantallona disi të gjera, të gjata deri tek nyja e këmbës, të bëra herë me pëlhurë liri ose pambuku si veshje për stinën e verës, e herë me tirk të trashë leshi për dimër por gjithmonë me prerjen e të mbathurave të zakonshme. Në pjesën e sipërme të trupit vishej këmisha prej pëlhure dhe mbi të jeleku ose xhamadani, kurse për stinën e ftohtë vishej mbi to edhe jakuça ose gjurdia e zezë. Kostumi me brekësha përdorej në Zadrimë, por në Shqipërinë e mesme brekushet bëheshin prej një pëlhure të leshtë ngjyrë kafe ose edhe të zezë. Me kohë përdorimi i tyre u shtri edhe në pjesë të Matit, Martanesh, Çermenikë, Librazhd, Shpat, Dumre e Myzeqe²⁶ Padyshim me sa shpjeguam me lart, e marrim me mend se ky zotëri është i zonës përreth. Dallojnë zbukurimet e shumta dhe brezi me ngjyra që ka shtrënguar në brez.

²⁵ Hugo Adolf Bernatzik, “Shqipëria, vendi i Shqiptarëve”, përktheu Taulant Hatia, Shtëpia botuese Uegen, fq 88, 90, 91

²⁶ Andromaqi Gjergji, “Ligjerata për etnologjinë shqiptare”, Tiranë 2004, fq 148.



Foto 3



Foto 4

Ndërkohë seria e fotove vazhdon me foton 5 ku autori përshkruan: “Në burimin e vjetër pranë kishës së Shingjonit sheh tipe të ndryshme grash. Djathtas një muhamedane, pjesëmarrëse në festën ortodokse shqiptare”²⁷. Na duhet të sqarojmë dy gjëra këtu. Mbushja e ujit tek burimi i manastirit ditën kur zhvillohet panairi ka një ndërlidhje sa të fshehtë aq edhe logjike dhe sipërfaqësore. Kjo lidhet me veprimin e mbushjes së shtambave me ujë nga burimi i manastirit. Besimi i popullit se, uji që marrin në çezmën e ndodhur në oborrin e manastirit do sjelli fat e mbarësi, apo se edhe uji është i mirë atë ditë, lidhet me mpleksjen e besimit në mite, legjendën e treguar për atë manastir dhe besimin në kozmosin ireal. Kjo bën që shqiptarët e asaj zone, apo edhe të krahinave të tjera nga vinin të bashkohen në rrespektimin e kësaj ngjarje. Etnografi Mark Tirta shpjegon se uji i mirë, i marr nga burimet e mira, çezmat e objekteve të kultit shpirtëzohen dhe ndaj tyre shprehet një rrespekt mjaft i madh duke u kujdesur madje për mos-dëmtimin e tyre. Këtë gjë e dëshmon skizistenca e kësaj çezme edhe sot në të njëjtën formë. Gjithashtu edhe forma e ritualit që kryhet, pra marrja e ujit nga çezma e manastirit ruhet edhe sot në banorët e asaj zone. Së dyti në foto lexohet edhe bashkëjetesa ndërjetare, një element mjaft i spikatur i kulturës tonë. Për këtë aspekt, padyshim udhëtarë të shumtë, si Pukvil, Hahn, Durham etj, që kanë udhëtuar në Shqipëri kanë folur sa me habi aq edhe të mrekulluar.



Foto 5

²⁷ Hugo Adolf Bernatzik, “Shqipëria, vendi i Shqiptarëve”, përktheu Taulant Hatia, Shtëpia botuese Uegen, Fq 92, 93.

Nga hulumtimet e mëtejshme gjejmë edhe disa foto (Foto 6) me shpjegimin: “Grua e re në panairin e kishës Orthodokse (afër Elbasanit), e cila nuk dëshiron të bëjë foto dhe qëndron në ballkon. Sërisht në të njëjtin faqe interneti gjejmë edhe këtë foto (Faqe 7), ku paraqiten dy burra me citimin nga autori: “Fshatarët duke shkuar për të marrë pjesë në festën ortodokse të Shën Gjonit afër Elbasanit²⁸” Nga veshja duken të zonës së Shpatit, pasi si shpjeguam edhe më sipër, janë të tipit “*Veshje me breksha*”. Këtë lloj veshje e përdornin edhe zona të tjera, por në rastin tonë zotërinjtë i përkasin Shpatit të Sipërm. Ndërkohë edhe vajza në foto, ka një veshje të përdorur nga gratë dhe vajzat orthodokse. Zbukurimet e shumta që ka përdorur vajza në foto, zakonisht përdorehin edhe nga vajza e gra të tjera, për panairin e Shën Gjon Vladimirit.



Foto 6



Foto 7

Përfundime

Të shkruash për një mbyllje, është po e njëjta vështirësi si të shkruash një hyrje. Mbartin një dilemë prej të cilës nuk dallon dot se hyrja është një shteg që paraprin përfundimet apo përfundimet në të anasjelltën e mendimit. Shpesh në materiale të ngjashme përfundimet definohen ngadalë në tekst e kur dalim në përfundime jemi përballë një “easy work” – pune të thjeshtë e cila thjesht na vlen të rendisim konkluzionet. Në material kemi mundur të analizojmë në këndvështrimin antropologjik-etnografik, aspekte të ndryshme si vendndodhja e këtij manastiri dhe zhvendosja e tij. Krijimi i figurës së shenjtit Shën Gjon Vladimiri në mit e kësaj tregimi popullor i metamorfizuar si një legjendë. Më pas jemi hedhur në aspektin e rrespektimit të këtij shenjt, në bazë të legjendës në trajtën e një pelegrinazhi e më pas në trajtën e panairit. Në ngjarjen sociale²⁹ jemi munduar të thellohemi në marrëdhënjet sociale midis individëve. Reciprociteti dhe dhurata kanë hyrë në analizë për faktin e vetëm të thjeshtëmit të kuptueshmërisë. Më pas ndërthurja jo pa qëllim fe – mit – legjendë – ritual sjell arsyen e rrespektimit të datës 22 maj nëpërmjet zhvillimit të panairit. Jemi munduar të sjellim foto nga udhëtari i huaj, i vetmi që ka dokumentuar deri më sot elemente etnografikë prej kësaj feste. Në mbyllje të materialit e në llogjikë të udhëtarit kemi zhvilluar më tej përshkrimin e plotë të veshjeve për gra e burra dhe arsyen e zgjedhjes së veshjeve më të mira për shkak të festës.

²⁸ <http://www.albanianphotography.net/bernatzik/>

²⁹ Term i përdorur për të shpjeguar zhvillimin e panairit.

LITERATURA:

1. Milan Shuflaj “*Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke*”, Botimet Franceskane, Shkodër 2013.
2. Margarect Rodman “Empowering Place: Multilocality and Multivocality”, York University, (dok elektronik)
3. Milan Shuflaj “*Serbët dhe shqiptarët*”, përktheu nga kroatistja Prof. dr. Hasan Çipuri, Botimet Toena, Tiranë.
4. A.Q.Sh. F. 138, D. 16, Fq 13.
5. Anastasia Zherdieva ‘*New social anthropological approach to the examination of legend*’, (dok elektronik).
6. Roger Keesing & Andrew Strathern, “*Antropologjia kulturore, një perspektivë e shkrutër*”, UFO Press.
7. Dr. Jur. Johan Georg von Han, “*Studime Shqiptare*”, përkthyer nga gjermanishtja Veniamin Dashi & Afrim Koçi, Instituti i Dialogut & Komunikimit.
8. Revista “*Kisha Kombëtare*”, Dt. 30 Qershor 1935.
9. Revista “*Predikimi*”, Dt. 27 Korrik 1930.
10. Marsel Mauss, “*The gift*”, (dokument elektronik)
11. Max Weber “*Studime sociologjike*”, përkthyer nga Enida Rusi, Plejad.Branislaw Malinowski “*Krimi dhe doket në shoqërinë e egër*”, përkthyer nga Arsim Canolli, Cuneus 2003.
12. Claudd Levi Strauss, “*Mendimi i egër*”, Shtypshkronja Fryma, Prishtinë.
13. Andromaqi Gjergji, “*Ligjerata për etnologjinë shqiptare*”, Tiranë 2004.
14. Andromaqi Gjergji, “*Etnografia Shqiptare IV*”, Tiranë 1972.
15. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, “*Shpati i Sipërm*”, Tiranë 1987. Andromaqi Gjergji, “*Ligjerata për etnologjinë shqiptare*”, Tiranë 2004.
16. Hugo Adolf Bernatzik, “*Shqipëria, vendi i Shqiptarëve*”, përktheu Taulant Hatia, Shtëpia botuese Uegen.

Kontribuan në këtë botim


Prof. Asoc. Dr. **Endri Papajorgji**
Msc, **Kujtim Bytyçi**
PhD Candidate, **Sonila Tatili**
Prof. Dr. **Osman Ismaili**
MA. **Dea Karakaçi**

PhD Kandidate. **Drita Avdyli**
Dr. Sc. **Bashkim Rrahmani**
Dr. **Rovena Vata**
PhD Kandidat, **Erjon Dervishi**
Msc. **Lemane Mustafa / Kastriot Jakupi**

Studente. **Vjoleta Statha**
PhD Kandidate, **Gelanda Shkurtaç**
Msc, **Adi Shehu**



ISSN 2227-8540



Çmimi 400 Lekë